



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 5, 6, 8, 14, 28 QERSHOR DHE 12, 23 KORRIK 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 5, 6, 8, 14, 28. JUNA I 12, 23 JULA 2018. GODINE**

**QERSHOR/KORRIK - JUN/JUL  
2018**

## Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mëparshme,
4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP-LVV dhe të GP të LDK në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës,
5. Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP- LDK, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione,
6. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare,
18. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017,
19. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017,
20. Shqyrtimi i raportit vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017,
21. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017,
22. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017,
23. Shqyrtimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017,
24. Shqyrtimi i Projekt-platformës shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve,
25. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës,
26. Emërimi i një (1) anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
27. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve joshumicë,
28. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

## Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne plenarne sednice,
4. Interpelacija Premijera Republike Kosova, g. Ramush Haradinaj, na zahtev PG LVV i PG LDK u vezi sa situacijom javnih preduzeća Telekoma i Pošte Kosova,
5. Interpelacija Premijera Republike Kosova, g. Ramush Haradinaj, na zahtev Parlamentarne grupe Demokratskog saveza Kosova o odlukama Ministra za poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj, g. Nenad Rikalo o razrešenju direktora i dodeli sredstava za grantove i subvencije,
6. Prvo razmatranje Nacrta krivičnog zakonita Republike Kosova,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o mikro finansijskim institucijama i ne bankarskim finansijskim institucijama,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-179 o drumskom prevozu,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-183 o zemljišnom prevozu opasne robe,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-088 o pravilima drumskog saobraćaja,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-064 o vozačkoj dozvoli,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/11 o putevima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 03/L-120,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-063 o železnicama Kosova,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona o pravnim aktima,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o memorijalnom kompleksu "Adem Jashari" u Prekazu,
16. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskim slobodama na Kosovu,
17. Razmatranje Izveštaja Komisije za zdravstvo, rad i socijalno staranje, u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona o socijalnim i porodičnim uslugama i Zakona o izmeni i dopuni Zakona o socijalnim i porodičnim uslugama,
18. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Agencije protiv korupcije za 2017. godinu,
19. Razmatranje Godišnjeg izveštaja kosovskog autoriteta za konkurenciju za 2017. godinu,
20. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Agencije za zvanične statistike za 2017. godinu,
21. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatorne komisije za javne nabavke za 2017. godinu,
22. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Tela za razmatranje javnih nabavki za 2017. godinu,
23. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Akademije pravde za 2017. godinu,
24. Razmatranje Nacrta - državnog projekta za fokalizaciju dijaloga između Republike Kosova i Republike Srbije za normalizaciju odnosa između obe države,
25. Izbor direktora Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova,
26. Imenovanje (1) jednog člana Odbora Radio Televizije Kosova,
27. Formiranje Ad - hoc Komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana u Nezavisnoj Komisiji za medije iz redova nevećinskih zajednica,
28. Predlog parlamentarnih grupa o zameni članova u parlamentarnim komisijama.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

I nderuar kryeministri, nuk qenka i pranishëm,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018.

Pika e parë, sipas rregullave që i kemi, është:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

E dini që koha është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen paraprakisht se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Faleminderit!

Zoti Driton Selmanaj është i pari i paraqitur, në emër të grupit.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dua të shpreh mospajtimin tonë për mënyrën e shpenzimit të parasë publike nga institucionet publike, në këtë rast nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Fillimisht ju njoftoj se përkundër kërkesave të mia për qasje në dokumentet publike drejtuar Kabinetit të kryetarit të Kuvendit, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, unë nuk kam arritur të marrë përgjigje zyrtare për pyetjet e mia, të cilat ishin si në vijim:

1. Sa është numri dhe lista e këshilltarëve të kryetarit të Kuvendit?
2. Sa janë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për vitin 2017?
3. Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile?
4. Shpenzimet për karburante, për vetura?
5. Shpenzimet e reprezentimit, si dhe lista e pagave për vitin 2017?

Fillimisht e kuptova që shkaku i mospërgjegjjes ishte se shefi i Kabinetit, Blerand Stavileci, ka kohë që nuk del fare në zyrë. Disa thonë që nuk është mirë me shëndet, kurse disa të tjerë thoshin që ka një kohë që është jashtë shtetit. Cila është e vërteta unë nuk e di, por një fakt e di, që pagën mujore ai vazhdon ta marrë.

Më vonë kërkesën ia drejtova zëvendësshefit të Kabinetit të kryetarit dhe përgjigjja e tij ishte se të gjitha informatat janë publike në ueb-faqen e Kuvendit, e që në fakt disa nga informatat që unë i kërkoja aty nuk janë fare. Dhe, normalisht, edhe pse unë jam deputet i Kuvendit, edhe pse jam kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, mua m'u desh të gjeja mënyra alternative të marrjes së informatave, përfshirë këtu edhe formularët e deklarimit të pasurisë tek Agjencia Kundër Korrupsionit.

Merreni me mend, kur unë si deputet kam vështirësi në qasje të dokumentet publike, por njerëzit tjerë që jetojnë në Kosovë?

Për kujtesën tuaj, të nderuar deputetë, po ju njoftoj se kryetarët e kaluar të Kuvendit të Kosovës kishin numër shumë më të vogël të këshilltarëve. Nexhat Daci i kishte vetëm dy këshilltarë; Kolë Berisha i kishte katër; Jakup Krasniqi, 7; kurse kryetari aktual i ka hiç më pak se 15 këshilltarë dhe 8 në staf mbështetës. Nuk do ta kisha problem numrin, po ta kuptoja çfarë nevojë ka kryetari i Kuvendit për kaq shumë këshilltarë. Çfarë pune bëjnë ata? Çka ka ndryshuar nga koha e kryetarëve të mëparshme që me 2 apo 4 këshilltarë e kryenin punën më mirë se kryetari aktual që i ka 15, pra vetëm 1 më pak sesa kryeministri i vendit. A mos e kemi një garë ndërmjet pushtetesh për numrin e këshilltarëve, apo kemi ndërtuar kabinete politike brenda feudeve politike për ambicie dhe qëllime krejtësisht personale.

Ta shtrojmë çështjen edhe nga një perspektivë tjetër: Cila është kostoja e buxhetit të shtetit për këtë armatë njerëzish?

Të nderuar deputetë,

Vetëm për paga dhe mëditje për vitin 2017 shpenzimi arrin shifrën në 508 689 euro. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, 28 713 euro. Shpenzimet telefonike, 6 500 euro. Shpenzimet për derivate, 10 670 euro. Numri i kilometrave të veturave që shfrytëzohen nga këshilltarët kapin shifrën e 102 138 km, apo 8 511 km për çdo muaj. Kostoja totale për vitin 2017 vetëm për këshilltarët politikë të Kabinetit të kryetarit, duke e përjashtuar edhe stafin tjetër mbështetës, kap shifrën mbi gjysmë milioni euro, 554 572 euro.

Ndërkohë që po hulumtoja për këtë temë, kuptova që përveç shefit të Kabinetit që ka kohë që nuk del në zyrë, është edhe njëra nga këshilltarët e kryetarit që ka pesë muaj që gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vazhdon ta marrë pagën në rregull. Madje, për një kohë, ajo ka marrë edhe të ardhura për shujtën e ngrohtë, që e marrin gjatë kohës sa janë në orarin e punës

në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, ju njoftoj se të ardhurat mujore të këtyre këshilltarëve, ku përfshihet paga bazë, plus 50% e pagës bazë, plus shujta e ngrohtë, si dhe përvoja e punës nxjerr përfundimin se asnjë nga këshilltarët nuk e ka pagën mujore nën vlerën 1 800 euro, duke përjashtuar privilegjet me makina zyrtare, shpenzimet e telefonave, si dhe vizitat jashtë shtetit. Jam i sigurt që sot puna më joshëse në sektorin publik është të jesh afër kryetarit të Kuvendit, pavarësisht nëse e kryen ndonjë punë apo jo, pavarësisht nëse del ndonjë ditë në zyrë, apo jo. Përkundër që nuk kam fare shpresë që shpejt do të ndryshojë kjo qasje, atëherë më mbetet të kërkoj mbështetjen tuaj për rritjen e presionit dhe të marrim masa për t'i penguar ata që me kaq lehtësi abuzojnë me paranë publike në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, a ka të paraqitur? Nait, e ke fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për ministrat,

Të nderuar kolegë deputetë,

Neve në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Medie na ka ardhur një shkresë nga një Këshill Grevist, i nënshkruar nga Qemajl Sokoli, producent i Radiotelevizionit të Prishtinës, dhe ka ardhur në kërcënimin e deputetëve Nait Hasani, Arban Abrashi, Shqipe Pantina, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj dhe komisionit, i cili na akuzon dhe kërkon me kanun të na ndalë neve që të mos e hartojmë një projektligj për Radiotelevizionin e Kosovës dhe të njëjtën kohë të mos e bëjmë kërkesën për kthimin e objektit të Radio Kosovës në objekt të Radiotelevizionit të Kosovës.

Radiotelevizioni i Prishtinës është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në atë kohë dhe si objekt, shoqëri, televizion dhe si radio nuk u takon individëve atje që të merren me këtë çështje. Individët që merren me këtë çështje bëjnë shkelje po ashtu, dhe kërcënimet e tyre janë për t'u gjykuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të merren masa ndaj këtyre personave, të cilët e keqpërdorin këtë institucion. Për mua, jo që na frikëson greva, por na jep një stimulim më shumë si komision që ta hartojmë këtë projektligj dhe këto objekte, të cilat ata i kanë shfrytëzuar dhe i shfrytëzojnë padrejtësisht, t'ia kthejmë transmetuesit publik të Kosovës dhe ai t'i menaxhojë ato dhe t'i japë njoftimet ose lajmet si objekt.

Për mua, persona të tillë që e kanë shkruar këtë letër janë njerëz qëllimkëqij, njerëz pa dinjitet, njerëz mund të them që, në bazë të informatave që kemi, janë pjesë e shërbimeve të ndryshme, prandaj kërkoj që Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë të marrin masa ndaj këtyre ose këtij personi, që është kryetar i Këshillit Grevist, Qemajl Sokoli, producent. Prandaj, në emër të komisionit kërkoj që Ministria e Drejtësisë t'i ngrejë procedurat, ne personalisht ia kemi drejtuar Prokurorisë Shtetit shkresën për marrjen e masave, ndërsa kërkoj edhe na Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme t'i marrin të gjitha këto masa që këta persona

të dalin para drejtësisë, sepse ka kaluar koha e kanunit. Nëse duan kanun, kanunit i jemi përgjigjur kur ka qenë lufta, e tash e kemi ligjin. Ne do t'i përgjigjemi me ligj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj është paraqitur.

**ARBËR REXHAJ:** Përshëndetje, të nderuar qytetarë!

Unë do ta ngre një çështje, e cila ka të bëjë me Komunën e Prizrenit. Në fund të vitit të kaluar gjykata ka marrë vendim për pezullimin e planit zhvillimor komunal, sipas të cilit Komuna e Prizrenit nuk mund ta marrë lejen, në fakt qytetarët e Prizrenit nuk mund ta marrin asnjë leje, qoftë edhe nëse ajo leje ka të bëjë me leje për shtëpi private.

Dhe, një ditë këtu kryeministri i Kosovës tha që e ka vizituar Komunën e Prizrenit dhe është interesuar për çështjen, mirëpo si duket interesimi i tij për këtë çështje nuk qëndron dhe nuk ka pasur efekt. Paramendojeni, seanca gjysmë ore, e cila është dashur të mbahet për këtë çështje, e që e ka bllokuar një qytet të tërë, qytetin kryehistorik të Kosovës dhe qytetin e dytë për nga madhësia, ajo seancë gjyqësore nuk është mbajtur që gjashtë muaj. Domethënë, kjo të lë të kuptosh se të gjitha premiset të shtojnë se aty ka elemente të bllokimit të qëllimshëm për ta bllokuar, jo vetëm komunën, por edhe qytetarët, dhe si rezultat i kësaj Komuna e Prizrenit pëson 700 000 euro dëme ekonomike. E dëmet nuk janë vetëm këto, por janë dëme edhe të pamundësisë të qytetarëve të ndryshëm që të investojnë.

Komuna e Prizrenit ka pasur ankesa të ndryshme drejtuar edhe Gjykatës Themelore, edhe Hekurudhave, dhe së fundmi ka negociuar edhe me këtë instancë, pra me Hekurudhat e Prizrenit, e kjo vjen si pasojë e qeverisjes së kaluar, kur nëpërmjet ndërtimit të lartë ajo qeveri e pati bllokuar komplet një pjesë të vijës hekurudhore me ndërtime dhe krejt ajo çfarë kërkojmë është që sa më shpejt të merren të gjitha masat që të zhbllokohet Komuna, të zhbllokohen qytetarët dhe të mos ketë më tutje humbje në vlera edhe për qytetarët, edhe për Komunën e Prizrenit.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Më lejoni që në emrin tuaj dhe në emër të Kuvendit të Kosovës dhe kryetarit ta përshëndes deputetin e Parlamentit Evropian, raportuesin për Kosovë, zoti Igor Solltes, që gjendet sot në sallën e Parlamentit. Mirë se keni ardhur!

*(Duartrokitje)*

Po vazhdojmë me të paraqiturit, në radhë është zoti Molliqaj.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Deklarimi është në emër të Grupit të PSD-së.

Do të flas për një çështje që ka disa muaj që po sillet nëpër medie dhe diskutime, ajo është zgjedhjet e mundshme të parakohshme parlamentare.

Si përplot çështje tjera, edhe për këtë çështje ka pasur një sulm ndaj Partisë Socialdemokrate sa i përket se kujt po i ndihmon, e kush kujt po i ndihmon. Më lejoni që të qartësoj numrat qysh unë i di që janë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me aq sa unë e di, partitë opozitare bashkë me deputetët e pavarur i kanë 58 deputetë, të cilët nuk janë pjesë e Qeverisë. 53 deputetë nga koalicioni qeverisës dhe nëntë deputetë janë të Listës serbe, të cilët i kanë ndërruar vendet në Kuvend, por prej asaj dite vazhdimisht ministrat janë në Qeveri.

Të gjithë ne këtu që jemi në opozitë e kemi kritikuar me të madhe, e të gjithë ata që janë në pushtet janë ndjerë shumë keq ditën kur është krijuar Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse kjo Qeveri është krijuar me ndihmën e Listës serbe dhe është e varur prej saj, për shkak të ndikimit të Beogradit. Madje na u pati dashur të presim nja pesë orë, derisa erdhën prej Beogradit për ta krijuar Qeverinë. Dhe, gjithnjë e kemi kritikuar që nuk duhet të ndërtohet asnjë qeveri e Republikës së Kosovës që është e varur nga shumica e thjeshtë prej deputetëve të Listës serbe, për shkak se i kemi cilësuar të gjithë si njerëz instrumente të Serbisë, pra Beogradit.

Më lejoni të citoj disa deklarata publike të kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, të njërit prej subjekteve opozitare, për këtë subjekt, "... kurse në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të na sjellin në Kuvend Listën serbe, një formacion ky çetnik, i përbërë prej çetnikëve, në Listën serbe nuk janë thjesht serbë, ata janë çetnikë", përfundon njëri prej citateve. Deputetë dhe analistë të regjimit merreshin aq shumë atëbotë me ne, e tash, ja ku i kemi çetnikët në pushtet në nëntë komuna të Kosovës. Kur ne thoshim se sajohet Republika serbe, ata na shanin, na fyenin. Dhe, citati më i rëndësishëm këtu është: "U thoni jo çetnikëve të Listës serbe, se kështu i thoni po Republikës dhe historisë sonë".

Kam pyetje publike, a e ka ndërruar qëndrimin Lëvizja Vetëvendosje për këtë punë, apo janë gati edhe me çetnikë, sipas tyre, ta rrëzojnë Qeverinë e Kosovës?

Në emër të PSD-së i përgjigjem Lëvizjes Vetëvendosje që nëse këta janë gati dhe nëse këta shkojnë e i marrin nënshkrimet e Listës serbe, PSD qysh sot ua jep nënshkrimet për ta rrëzuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Nëse s'është e vërtetë, atëherë është mirë të mos bëjmë lojëra. O tregoni që keni ndërruar qëndrimin, o thoni që kjo Qeveri është aq e keqe, sa që edhe me çetnikë e ndërrojmë. Kështu që është mirë publikisht të na kallëzoni, e jo të fshiheni pas qëndrimeve, të cilat vazhdimisht janë hipokrite.

Ftesa ime për opozitën si përfaqësues i PSD-së është kjo: Të mblidhemi bashkë dhe ta bëjmë një front, një bashkim, një platformë, çfarëdo qoftë ajo, opozitare, e cila e ka përbrenda edhe



kërkesën për zgjedhje, edhe për çështje të tjera dhe aty së bashku ta ndërtojmë strategjinë. Nëse plani i opozitës është t'i bartet faji njëri-tjetrit nëpërmjet sulmeve të ulëta, nuk mendoj që i kryen punë kurrkujt. Nëse e keni për zgjedhje, ju lutem, çohuni sot këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe shko merrini nënshkrimet dhe ta rrëzojmë Qeverinë. Nëse Nisma ju ka thënë se jua jep votat, kallëzoni, nëse AAK-ja ju ka thënë që jua jep votat, na tregoni edhe neve, nëse PDK-ja ju ka thënë që jua jep votat, na tregoni edhe neve. Por, tregona qysh po doni ta rrëzoni Qeverinë dhe i keni nënshkrimet e PSD-së. Nëse nuk e keni përnjëmend, mos bëni zhurmë në publik. Nëse e keni përnjëmend, qysh sot çohuni, por keni kërkesë prej meje të na tregoni a e keni ndërruar qëndrimin për këtë që keni thënë më herët, apo edhe pse e keni këtë qëndrim, ju jeni gati ta rrëzoni Qeverinë sa i përket kësaj çështjeje.

Është i pandershëm sulmi që po bëhet, për shkak se është i padrejtë dhe jo i saktë. Edhe sot keni vazhduar bashkëpunimin me Komunën e Prishtinës. Hipokrizia nuk po ndalet. Jeni në koalicion, keni tre drejtorë në koalicionin qeverisës të Komunës së Prishtinës, jeni duke negociuar me kryetarin Ahmeti për koalicion dhe sot prapë jeni bërë bashkë me PDK-në dhe me LDK-në, duke qenë në Qeveri në Komunë, për ta sabotuar punën e komisioneve në Kuvendin Komunal.

Hajde, qartësojeni pozicionin, a jeni për ta rrëzuar Qeverinë? Me kë jeni për ta rrëzuar Qeverinë? Merrni nismën, merrni nënshkrimet së pari nga Lista serbe, hajde merrini te PSD-ja nënshkrimet. Nëse s'e merrni këtë, lëreni këtë muhabet, flasim për tema të tjera, ta bëjmë opozitën bashkë me...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola ta marr fjalën për një çështje shumë të ndjeshme, që ende s'po zgjidhet, gati po bëhen njëzet vjet, për statusin e banorëve të Kosovës Lindore.

Në çdo shtet, nëse një banor jeton për pesë vjet, i mundësohet shtetësia, i mundësohet të jetë i barabartë në atë vend, ndërsa bashkëkombësit tanë gati për 20 vjet, siç e ceka, nuk gëzojnë kurrfarë statusi. Në njëfarë mënyre jetojnë ilegalisht në Kosovë, pa iu dhënë e drejta as në punë, as në çështje të tjera që janë jetësore për ta. Prandaj, edhe me këtë rast dua të ftoj institucionet kompetente që të ndërmarrin hapa, në mënyrë që çdo banor i Kosovës Lindore, sidomos ata që janë të ndjekur e në institucionet tona u kërkohen dokumente që t'i marrin në administratën serbe atje, vërtet është e patolerueshme që edhe më tutje këta banorë të terrorizohen në këtë mënyrë, duke mos pasur të drejtë as në dokumente, as në punë dhe as në shërbime të tjera që i ka obligim ky shtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë në emër të Nismës do të paraqes një shqetësim qytetar lidhur me disa fenomene që po ndodhin në shoqëri kohëve të fundit. Besoj se e keni qartë, nuk është shumë larg debati që është zhvilluar në këtë sallë lidhur me mishin dhe debatet, sugjerimet, kërkesat bazuar edhe në të dhëna e në fakte, domethënë ka qenë e drejtë çdo gjë.

Mirëpo, diçka që po reflekton pas atij debati është se produkti i mishit ka filluar të ngritet dhe dyshoj se gjithë ajo aferë rreth mishit, vallë mos është bërë që dikush të krijojë monopol lidhur me furnizimin me mish në Kosovë!

Mendoj se Qeveria, institucionet në këtë drejtim duhet të kenë një platformë të qartë, se produktet e huaja që vijnë nga vendet e tjera, si ishte rasti me mishin që ka ardhur nga Belgjika, të zëvendësohen me investime në prodhimin vendor. Diçka të ngjashme kemi edhe me ngritjen e derivateve të naftës ditëve të fundit dhe unë po dyshoj se ngritja e naftës po favorizon operatorët ilegalë në Kosovë, në pjesën veriore, ku siç dihet po futet pa akcizë nafta dhe normalisht, dallaveraxhinjtë dhe matrapazët bëjnë në mënyrë ilegale furnizimin nga ajo pjesë, kur tashmë për të satën herë është folur se kush e furnizon dhe kë e përfaqësojnë ata operatorë në pjesën veriore.

Mendoj se Parlamenti shpeshherë është duke debatuar me deklaratat “patriotike”, po u shërben vijave të caktuara, të cilët pastaj po krijojnë monopol dhe në këtë drejtim si shqetësim e ngre para të gjitha institucioneve, veçanërisht ekzekutive, që jetën e rënduar të qytetarëve të mos e rëndojmë edhe më tej. Qeveria në radhë të parë të marrë masa që të intervenojnë te produktet, të cilat mund t’i mbajë në një balancë që është e barabartë me jetën sociale të qytetarëve, jo me kategoritë e caktuara dhe kështu që, ne dalëngadalë duhet përpos temave të mëdha, të cilat nganjëherë nuk janë as në dorën tonë, përveç fjalëve të bukura, t’u kthehem temave jetike dhe që e rëndojnë jetën e qytetarëve, jetë që pastaj po na shtyn të nxjerrim rezoluta e rezoluta, të cilat po pluhurosen.

Si Kuvend konsideroj se duhet të jemi më kritikë, por edhe vetëkritikë, në raport me disa çështje që janë duke ndodhur në Kosovë, me theks të veçantë ngritja e çmimeve që po vjen si rezultat pas debateve të ashpra që po zhvillohen. “Të ashpra”, se me gjasë të gjitha po del se janë me prapavijë, kështu që përfundimisht qytetari të ndjehet komod në shtetin që është bërë me shumë mund e sakrificë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Veton Berisha.

VETON BERISHA: I nderuar kryesues Haliti,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Unë sot po e shtroj një çështje, e cila ka kohë që nuk është trajtuar këtu dhe neve po na preokupon. Është çështja e ekzistencës së refugjatëve prej vitit '98 - '99 dhe akoma ballafaqohemi me ekzistencën e refugjatëve në Mal të Zi, Maqedoni, Serbi nga komunitetet egjiptian, ashkali, me siguri edhe rom.

Para tre vjetësh kemi bërë një vizitë në kampin e refugjatëve në Maqedoni dhe çuditërisht ekzistojnë akoma 65 familje, të cilat janë në pritje të kthimit të tyre dhe arsyet e mosndërmarrjes së veprimeve konkrete në kthimin e tyre janë çuditërisht të panjohura për ne. Të gjithë ne e dimë që ekziston një ministri e dedikuar komuniteteve dhe kthimit. Dhe, kjo ministri udhëhiqet nga ministri Jevtiq, në të njëjtën kohë edhe zëvendëskryeministër, po ashtu e kemi ftuar edhe në Komisionin e Komuniteteve dhe ne vazhdimisht nuk marrim përgjigje dhe nuk kemi prani të ministrit.

Shtrohet pyetja, cila është arsyeja e moskthimit të këtyre komuniteteve, këtyre familjeve, të cilat me vetëdëshirë kanë shprehur gatishmëri, kanë filluar procedurat me vullnetin e tyre dhe pse këto familje mbeten të papërkrahura dhe nuk kthehen akoma?

Unë personalisht e kam përshtypjen që këto familje janë viktimë e asaj që dikush, qoftë nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, dëshiron ta vazhdojë mandatin e tyre, duke u thirrur në këto familje.

Bëj thirrje që të ndërmerren të gjitha veprimet qeveritare dhe të nisë procedura e kthimit brenda këtij viti, sepse kërkesë e këtyre familjeve është që këto të kthehen brenda këtij viti. Ne kemi po ashtu reagime edhe nga kryetarë të komunave të caktuara, kur refuzojnë kthimin e atyre familjeve në komunat e tyre. Me sa di unë, një pronar që e ka pronën në atë komunë, të blerë apo të trashëguar, ka të drejtë legjitime të kthehet në pronën e tij dhe nuk ka të drejtë asnjë kryetar komune t'ia mohojë cilësdo familje të kthehet në vendbanimin e tyre.

Meqenëse e kemi ministrin Reçica këtu, e ftoj të fillojë sa më parë implementimin e fondit 1.8 milion, i cili me të vërtetë është bërë fond i famshëm dhe meqenëse kemi marrë edhe konfirmimin nga kryeministri që ne kemi të drejtë barabartë të ndahet ky fond, e ftoj sinqerisht të fillojë dhe të mos dëgjojë asnjë nga ne palët, por të implementojë ligjin që e ka në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shabani e ka fjalën.

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se, potpredsedniće!

Poštovani građani,

Poštovani ministri,

Uvažene kolege poslanici,

Danas želim da iznesem jedan slučaj koji se ovih dana desio u osnovnoj školi „Motrat Čiriaz“ u Prizrenu, i koji je izazvao veliku pažnju ali i veliko nezadovoljstvo u Bošnjačkom zajednici.

Učenicima ove škole u nastavi na Bosanskom jeziku nije bilo dozvoljeno da učestvuju na obeležavanje dana škole od strane direktora ove škole. Te kasnije reakcijom roditelja, koji su bili prisutni i koji su se okupili znači da prisustvuju obeležavanju dana škole, ipak na kraju dozvoljeno je da učenici učestvuju na toj priredbi.

Ja kao predstavnik ispred Bošnjačke zajednice zahtevam od Direktorijata Obrazovanja u Prizrenu momentalnu reakciju i smenu direktora osnovne škole „Motrat Čiriaz“ u Prizrenu zbog njegovog apsolutno nedopustivom ponašanju prema učenicima i roditeljima u nastavi na Bosanskom jeziku. Također službenici i zamenici ministra koji su u ime Bošnjačke zajednice u Prizrenu i Montu trebaju da budu mnogo agilniji u praćenju situacije na terenu.

Još jednom apelujem i zahtevam od nadležnih da reaguju, da se ovakve stvari više u budućnosti ne događaju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Çështja që dëshiroj të ngre sot lidhet me Ligjin e Trepçës, i miratuar në vitin 2016.

Për shkak të zhvillimeve në këtë ndërmarrje, ky ligj atëherë e pati shpëtuar Trepçën nga shkuarja në likuidim, unë gjej rastin t’i falënderoj të gjithë deputetët e asaj legjislature dhe partitë politike që e kanë mbështetur këtë ligj. Sipas atij ligji 80% të aseteve janë në pronësi të Qeverisë, ndërkaq 20% në pronësi të punëtorëve. Mendoj se kjo është formula më e mirë për një kujdes të duhur të brezave të minatorëve që kanë punuar në këtë ndërmarrje të rëndësisë strategjike dhe emocionale për Kosovën.

Në nenin 6 të këtij ligji specifikohet se statuti i Trepçës propozohet nga Bordi mbikëqyrës dhe miratohet nga aksionarët, pas aprovimit në Kuvendin e Kosovës. Javën që shkoi në Qeveri është miratuar statuti i Trepçës dhe ky tani është përcjellë në Kuvend për aprovim përfundimtar. Është e qartë se ky statut nuk është përgatitur në konsultim të ngushtë me punëtorë, që mbajnë 20% të aksioneve. Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës ka shprehur shqetësime serioze lidhur me këtë statut dhe i ka kontaktuar, me sa di, të gjitha grupet parlamentare. Janë dy vërejtje kryesore në këtë statut. E para, problemet sociale të punëtorëve dhe, e dyta, mospërfshirja e të gjitha aseteve të Trepçës në këtë statut.

Mendoj se e para mund të akomodohet eventualisht, por kjo e dyta është mjaft serioze, se si dikush mund të gjejë lirinë e të lerë jashtë statutit të Trepçës asete të rëndësishme. Unë kërkoj nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik që të ftojë në diskutim Bordin e Trepçës, menaxhmentin dhe Sindikatën, në mënyrë që përpara se ky statut të hyjë në seancë plenare, të merren parasysht të gjitha këto vërejtje që i ka Sindikata e punëtorëve. Kjo do të na mundësojë që ne të arrijmë një konsensus për këtë aset të rëndësishëm të Kosovës!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka zonja Blerta-Deliu, në emër të grupit.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Do të bart sot shqetësimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës lidhur me aktivitetin e fundit të Lëvizjes Vetëvendosje në Besianë, e cila nëpërmjet një njoftimi publik i fton të gjithë maturantët e kësaj komune që të bëhen pjesë e trajnimeve që kjo lëvizje do t'i organizojë për t'i përgatitur maturantët për provimin pranues në Universitetin e Prishtinës. Për më tepër, ky aktivitet, sipas këtij njoftimi, i tëri do të jetë falas.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndonëse në shikim të parë iniciativa të tilla si kjo mund të duken tërësisht korrekte dhe në të mirë të shoqërisë, prapa tyre fshihet krejt diçka tjetër. Legjislacioni në fuqi nuk u jep të drejtë partive politike të organizojnë trajnime. Do të thotë, bie ndesh me Ligjin për arsimin e lartë, për më tepër organizatorët e këtyre trajnimeve duhet t'i kenë të akredituara programet e tyre të trajnimit.

Përgjegjësia e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës i takon Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Arsimit. Ministria e Arsimit duhet të reagojë konform ligjit që të mos lejohen organizime të tilla të abuzimit me fëmijë, ndryshe metoda si kjo i shoh si qëllime të qarta të disa subjekteve politike në Kosovë që të instrumentalizojnë këtë gjeneratë dhe për këtë kërkoj sqarim nga Ministria e Arsimit, e cila ditën e djeshme e ka pasur një reagim.

Thirrja publike për t'u ndihmuar maturantëve në dhënien e provimit pranues në universitet nuk është asgjë më shumë se sa qasje perfide dhe perfiditet, si dhe manipulim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ua rikujtoj edhe një herë që Grupi Parlamentar i PDK-së para dy vjetësh ka ngritur shqetësimin e shkollës "Elena Gjika", të prindërve që i kanë fëmijët në këtë shkollë, të cilët kishin reaguar lidhur me mbajtjen e tubimeve të Lëvizjes Vetëvendosje me fëmijët e tyre, duke kërkuar që partitë politike në Kosovë t'i mbajnë duart larg fëmijëve të tyre.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës kërkoj që të ndalen propaganda të tilla partiake nëpër shkolla dhe të ndërpritet partizimi i fëmijëve, e në këtë rast, i maturantëve. Po ashtu, kërkoj që Ministria e Arsimit sa më parë të marrë masa lidhur me këtë shqetësim që e kemi adresuar ne sot.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën, në emër të grupit parlamentar.

**GLAUK KONJUFCA:** Dardan Molliqaj para pak minutash u nxeh fort duke i dhënë zor të m'i bëjë disa pyetje dhe unë e kam kënaqësinë t'ia jap disa përgjigje.

Lëvizja Vetëvendosje kurrë nuk i ka dhënë fort zor për zgjedhje, sepse zgjedhjet i kupton qysh shkojnë, ajo ndodh nëse opozita ka numra më shumë se mazhoranca. Bile, kur jam pyetur në një emision për tryezën e LDK-së për zgjedhjet, kam thënë që jam shumë pesimist, nuk pres kurrë prej tryezave të tilla, duke qenë që pushteti i ka 62 vota, opozita i ka 58 dhe kjo është gjendja ekzistuese. Ne e dimë matematikën, i dimë numrat dhe kjo është gjendja ekzistuese.

Domethënë, Lëvizjen Vetëvendosje kurrë mos e merr me pompozitet, edhe që bën aktrime e filma për zgjedhjet. Ne jemi, kur të bëhen numrat, për ta rrëzuar Qeverinë, jemi të gatshëm, nuk e di a jeni të gatshëm edhe ju.

Sa i përket pikës së dytë të Listës serbe, Lista serbe është krijesë e Beogradit, e Serbisë. Nuk dallon kurrë prej politikave të Aleksandër Vuçiqit, veç i merr urdhrat në Serbi dhe vjen i zbaton në Kosovë. Këtë mësim, Dardan, e ke mësuar në Lëvizjen Vetëvendosje, këtë doktrinë, këtë koncept, se çka është Lista serbe. Lëvizja Vetëvendosje e mban këtë qëndrim.

Nën 3, kush është kush në koalicion, që the dje, me PDK-në? 30 minuta pasi që ke thënë se Vetëvendosja është në koalicion me PDK-në, këtu në Kuvend të Republikës së Kosovës e shkelët Lëvizjen Vetëvendosje dhe të drejtën e saj për nënkryetar, bashkë me partitë në pushtet. U bëtë bashkë, i bëtë votat, po e mbani pozicionin me ndihmën e mazhorancës, e cila doli në krah tuajin. 30 minuta, interesant, pasi që ke thënë Lëvizja Vetëvendosje është me pushtetin, këta ta mundësuan ty të vazhdosh pozitën, e cila i takon pa dyshim Lëvizjes Vetëvendosje. Nuk po e di kush me kë është në koalicion tash, Dardan!

Sa i përket Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti nuk është më Vetëvendosje, duhet kuptuar këtë send. Më duket është bërë kryetar i PSD-së. Nuk është më kryetar i Vetëvendosjes, po dua të them, anëtar i Vetëvendosjes. Kjo i bie që ai duhet të kontrollohet dhe të monitorohet sikur një kryetar i PDK-së, i LDK-së, i AAK-së, njëjtë sikur që ndodh nëpër komunat e tjera, ai duhet të monitorohet dhe të kontrollohet prej Lëvizjes Vetëvendosje, aq më shumë nëse kemi

bashkëqeverisje në Prishtinë. Ama Shpend Ahmeti, ju duhet të kuptoni, nuk ka kurrfarë obligimi më ndaj programit të Lëvizjes Vetëvendosje, me të cilën kishte qejf të dalë e t'i mbledhë votat me atë program. Edhe, nuk është më në Lëvizjen Vetëvendosje. Pra, me vetë faktin që nuk ka kurrfarë përgjegjësie më ndaj programit, Lëvizja Vetëvendosje atë do ta trajtojë në mënyrë kritike, jo duke e ledhatuar. Edhe ju duhet të mësoheni me këtë, mund t'ju vijë pak vapë, por duhet mësuar me këtë.

Tjetra, ti nuk mund të flasësh në mënyrë parimore për Lëvizjen Vetëvendosje. Ti do ta shkatërrosh Lëvizjen Vetëvendosje. Domethënë, prej këtij dimension ti nuk mund të flasësh në mënyrë neutrale dhe objektive për Lëvizjen Vetëvendosje, se ti për çdo ditë nuk po takon aktivistë të PDK-së, o Dardan, ti po takon aktivistë të Vetëvendosjes. A ke takuar ndonjë aktivist të PDK-së këto ditë, për ta bërë PSD? Ti po takon aktivistë të Vetëvendosjes! Qysh mund të flasësh në mënyrë objektive për Vetëvendosjen?

E fundit, a duhet të rrëzohet Qeveria me Listën serbe? A më mirë është ta lëmë këtë Qeveri e të bëhet statuti i 'Zajednicës' me Listën serbe, apo nëse do Lista serbe t'i japë votat, më mirë është ta rrëzojmë Qeverinë, qoftë edhe me vota të atyre?

Unë mendoj që nëse e lëni këtë Qeveri ta bëjë statutin e Zajednicës, të vazhdojë ta ndajë veriun, është rrezik më i madh se të rrëzohet kjo Qeveri qoftë edhe me atë çmim, kjo për mua është shumë e qartë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Frashër Krasniqi e ka fjalën.

**FRASHËR KRASNIQI:** Glauku sapo e tha që jemi të gatshëm ta rrëzojmë Qeverinë nëse urdhrin e jep Vuçiqi nëpërmjet Listës serbe. Po i more nënshkrimet, Glauk, të Listës serbe, i ke edhe nënshkrimet e PSD-së.

E dyta, sa u përket koalicioneve, deputetët e mazhorancës, shumica prej tyre, kanë abstenuar në çështjen Dërguti, ndërsa është shumë e qartë çka po ndodh në nivel lokal në Komunën e Prishtinës. Janë bërë bashkë Vetëvendosja me PDK-në dhe me LDK-në për ta sabotuar Shpend Ahmetin dhe, dorën në zemër, sot Glauku na e tregoi edhe një fakt tjetër që ndjenjën e Vetëvendosjes që ajo është zotëruesja e vetme e të vërtetës dhe e parimësisë, me demokraci është në Vetëvendosje, është në rregull, po dole prej Vetëvendosjes, duhet të kontrollohesh prej Vetëvendosjes se mund të devijosh. Pikërisht kjo është qasja problematike që e ka pasur Vetëvendosja dhe që e ka.

Po e themi edhe një herë, Partia Socialdemokrate është e gatshme t'i japë nënshkrimet për të shkuar vendi në zgjedhje, mirëpo jo të bëjë lojë politike qysh po boni ju, pa e pasur shumicën

dhe pa qenë të gatshëm t'i merrni nënshkrimet e Listës serbe. Atë ditë që jeni të gatshëm t' i merrni këto nënshkrime, ne jemi të gatshëm t'jua japim.

Çdo deklaram tjetër për zgjedhje është hipokrizi dhe është tendencë të tregohet që gjoja Lëvizja Vetëvendosje qenka më e gatshme ta rrëzojë Qeverinë se sa subjektet e tjera opozitare.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Ministra,

Së pari dua ta arsyetoj votën kundër shkarkimit të Aida Dërgutit dje. Nëse ju kujtohet, në vitin 2013 pikërisht Aleanca ka kërkuar ndërrimin e zëvendëskryetarit dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka qenë që deputetët në seancë kanë vullnet individual dhe e japin të drejtën e vet.

Vota jonë ka qenë konform atij vendimi të gjykatës, pavarësisht që në vitin 2013 hiç nuk na ka ardhur mirë, Glauk, se nuk i ka takuar AAK-së, kemi pasur edhe një deputet më shumë.

Sido që të jetë, kur t'i bëni numrat, shkarkojeni Qeverinë.

Tri-katër pika i kam për diskutim. I kemi 17 mijë kandidatë për policë në Shërbimin Policor të Kosovës për t'u pranuar 360 dhe ministri ishte dashur po ashtu të ishte, mendoj edhe Komisioni për Siguri të ftoheshin në një debat, në një diskutim, për shkak se ka dyshime të bazuara që nuk ka transparencë në pranimin e tyre dhe të njëjtën kohë të kërkohet sa më shpejt Ligji për pensionimin e parakohshëm të policëve, për shkak se moshja e tyre ka shkuar mbi 46 vjet dhe një farë standardi, nëse mund të themi, është rreth 33-vjeçare, që i bie rreth 2700 policë tanë e kanë kaluar moshën dhe vazhdojnë ta ushtrojnë detyrën e policit në patrullë, për shembull, në moshën 65-vjeçare është krejt e palogjikshme. Pra, kisha kërkuar sa më shpejt që ky ligj të vijë këtu dhe ta votojmë, e para.

E dyta, kohët e fundit ka studentë, të cilët janë shumë të pakënaqur rreth mungesës së profesorëve në Universitetin e Prishtinës, ka pasur edhe një protestë të brendshme dhe ministri i Arsimit do të ishte mirë, në bazë të instrumenteve ligjore që i ka, t'i mbikëqyrë pse mungojnë profesorët në universitet në kohën kur tashmë e dimë që është afati i provimeve.

E treta, dhe hiç më pak e rëndësishme, mjekët në Komisionin vlerësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i trajtojnë në mënyrë jo të dinjitetshme invalidët e luftës, të cilët shkojnë për verifikim ose vlerësim.



Ata mjekë duhet kuptuar që një ushtar, i cili e ka marrë një plumb, nuk pyetet ku e ke plumbin, por e di që ata mjekë zotërinj që janë emëruar nuk e kanë shijuar shijen e plumbit, për këtë arsye edhe abuzojnë në këtë kategori, por nuk do ta kenë gjatë.

Pika tjetër që kisha thënë, buxheti i Kosovës ka ndarë 350 mijë euro për pushimet e kategorive të veçanta të luftës, në këtë rast, invalidë, familjet e dëshmorëve dhe veteranët.

Sa për informim të opinionit publik, për çdo vit Qeveria e Kosovës ka ndarë buxhet të njëjtë për këtë kategori dhe shumë mirë ka bërë edhe kjo Qeveri që e ka vazhduar atë traditë.

Ju kisha lutur të gjithëve që ta kuptojnë drejt, ka shumë njëzë të cilëve u mungojnë gjymtyrët, ka shumë familje të dëshmorëve që i kanë humbur nga 2-3 djem e sot janë në mëshirën e...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Nuk ke të drejtë, por përfundoje.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit! Kisha kërkuar mirëkuptim se kjo Qeveri nuk ka bërë asgjë më shumë se sa Qeveria Mustafa, Qeveria Thaçi dhe të gjitha qeveritë e kaluara. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Imet Rrahmani.

**IMET RRAHMANI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot dua të ngre një çështje që po neglizhohet në masë të madhe si problematikë.

Prishja e rendit dhe qetësisë publike po merr përmasa shqetësuese nga mosreagimi i organeve kompetente për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Obligim ky që buron nga dispozitat e Ligjit për rend dhe qetësi publike.

Dua të theksoj se gjithnjë e më shumë po shtohen rastet e zhurmës, pra të ndotjes akustike të ambientit, sidomos në orët e vona të natës, duke krijuar rrethana të padurueshme për të jetuar në zona urbane.

Dukurisë së krijimit të zhurmës natën po i prijnë lokalet afariste dhe bizneset e ndryshme në qytetet e mëdha, e sidomos në kryeqytet.

Po e përmend Prishtinën, sepse ka ankesa të shumta nga banorët e saj të drejtuar në Drejtorinë e Inspektoratit Komunal, në Policinë e Kosovës dhe në inspektoratet në Ministri të Tregtisë dhe

industrisë dhe në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për zhurmën e padurueshme që po shkaktojnë kazinotë, bizneset hoteliere dhe kafenetë diku-diku deri në orët e hershme të mëngjesit.

Sikur organet e shtetit të ndërhyjnë që të respektohet ligji, shkelësit e tij do të ndëshkoheshin dhe do të vendosej rendi dhe qetësia publike. Kjo lere që nuk po ndodh si obligim ditor i inspektimit dhe i ruajtjes së rendit, por ka shembuj të shumtë kur nuk reagohet fare ose reagohet vetëm sa për të thënë. Bile, ka raste kur qytetarët bëjnë ankesa, bëjnë denoncime ose edhe nënshkruajnë peticione.

Sot po paraqes vetëm një shembull, banorët e lagjes “Kalabria” (ish-Emshir), konkretisht rruga “Ali Vitia” numër 242 kanë bërë ankesë me shkrim më 2 mars 2018 dhe sot e asaj dite nuk kanë marrë përgjigje, derisa prishja e rendit dhe qetësisë po vazhdon.

Shkelje të tilla dhe ankesat e kërkesa për ndihmë ka edhe nga banorët në rrugën B dhe në lokalitete të tjera.

Krejt këto ankesa dhe kërkesa përfundojnë ose të pashqyrtuara, ose nuk japin rezultate në terren.

Ka një tendencë të hedhjes së fajit herë te njeri, herë te tjetri institucion, kinse për mungesë të kompetencës.

Një gjë është e sigurt se derisa institucionet shtetërore nuk sigurojnë ligjshmërinë edhe për gjëra bazike që janë mirë të sqaruara me ligj, qytetarëve po u vështirësohet jeta, po u shuhet motivi për të bashkëpunuar me organet shtetërore dhe po rrezikojnë që të krijojnë probleme ndërpersonale të panevojshme.

Drejtoria e Inspektoratit të Komunës së Prishtinës dhe dikasteret e tjera qeveritare, të cilat kanë marrë ankesa duhet të intervenojnë urgjent që të krijojnë ambient të sigurt dhe të qetë.

Nëse kjo nuk ndodh, atëherë edhe më shumë do të forcohet bindja se shqetësimi dhe debati për cilësinë e ajrit dhe kinse brengosja për shëndetin e qytetarëve i shprehur në këtë Parlament dhe të gjithë ju ishte vetëm një farsë dhe asgjë më shumë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! E fundit është Ganimete Musliu.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë, dhe ju kolege deputete,

Sot unë do ta ngre një çështje në lidhje me Stacionin e Autobusëve në Prishtinë, ku nga atje kam shumë ankesa të qytetarëve, të cilët për të hyrë në Stacion të Autobusëve në Prishtinë duhet të paguajnë për automjetin, i cili e shpie udhëtarin deri te linjat e autobusit, duhet të paguajë udhëtarin për të hyrë në stacion dhe po qe se ndodh të ketë edhe një shoqërues, duhet të paguajë edhe shoqëruesin për të hyrë në Stacionin e Autobusit që e shpie familjarin e tij deri tek autobusi i linjës.

Nëse rastis që këta udhëtarë të jenë veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nga zyrtarët të cilët punojnë në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë kartela e veteranit nuk merren parasysh, me pretekstin se janë bërë shumë veteranë dhe nuk kanë llogari t'i lirojnë nga mospagesa.

Këtu kemi të bëjmë me deficite menaxheriale dhe nuk guxojmë që deficitet menaxheriale të bëhen plaçkë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nuk e di cili model është marrë që të plaçkitet qytetari i Republikës së Kosovës deri në këtë masë dhe nuk e di ku po merren këto forma të plaçkitjes së qytetarit. E përmenda jorastësisht tri herë 'plaçkitje të qytetarit', sepse unë nuk gjej një term tjetër përveç se kur detyrohet qytetari t'i mbulojë shpenzimet e institucionit në këtë mënyrë, kjo është vetëm plaçkë.

Prandaj, kërkoj nga menaxhmenti i Stacionit të Autobusëve dhe njerëz përgjegjës që ta ndërpresin menjëherë këtë praktikë dhe t'ua lehtësojnë barrën qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ne kemi tash shumë mërgimtarë, të cilët udhëtojnë nëpërmjet linjave të autobusit dhe ata po e bartin në kurriz, kurse ne e dimë që në çdo vend të botës, qoftë në stacionet e autobusëve, qoftë në aeroporte, qoftë në stacionet e trenit, përveç biletës së udhëtimit, qytetarët nuk kanë asnjë obligim tjetër të pagesës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** E kemi tejkaluar kohën, të tjerët të paraqitur kanë kohë në seancën e ardhshme sipas Rregullores.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Pyetja e parë është e deputetit Naser Rugova, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zoti Rugova, Pali ishte këtu, ndoshta vjen. Nëse do ta bësh pyetjen?

**NASER RUGOVA:** Ndoshta vjen, në rregull.

Atëherë pyetja për ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, është: ka shqetësime që traseja e autostradës që do t'i lidhë disa komuna të rrafshit të Dukagjinit janë duke qarkulluar që janë dy

ide: njëra të respektohet traseja ekzistuese e rrugëve të vjetra magjistrale dhe një ide që po qarkullon që do të shkojë rrëzë Bjeshkëve të Nemuna. Ka mjaft shqetësime nga qytetarët e komunës së Istogut, bizneset atje, sepse po të fillohet nga Burgu i Dubravës, ajo pjesë që po mendohet që traseja të shkojë kah bjeshkët do të shkatërrojë mjaft biznese, turizëm, agroturizëm, turizëm malor, ku është zona më e bukur e komunës së Istogut. Janë bërë investime edhe nga ana e Kuvendit Komunal atje, edhe bizneseve, kështu që i bëj apel ministrit Leka, sepse tani kemi informata që një kompani sapo e ka marrë tenderin për ta projektuar trasenë. Unë dua të besoj që edhe komunat e tjera fqinje do të reagojnë, sepse vërtet po të orientohet traseja në atë pjesë që është pjesa më e bukur turistike dhe njerëzit, edhe komuna, edhe personat fizikë, edhe juridikë, edhe bizneset kanë bërë investime të jashtëzakonshme, do ta shkatërrojë do të thotë atë investim të njerëzve e të Komunës dhe është një nga asetet më me vlerë të komunës së Istogut.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri nëse vjen, po besoj që do të përgjigjet. Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kryeministri nuk është këtu, zoti Haxhiu, doni ta bëni pyetjen?

**HAXHI AVDYLI:** Pyetje për kryeministrin Haradinaj që ka të bëjë për koordinatorin Besnik Tahiri dhe koordinatorët e tjerë do ta lë në momentin kur ai do të jetë i pranishëm.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismajli, zoti Avdyli, e keni fjalën.

**HAXHI AVDYLI:** I nderuar ministër,  
Besoj që jeni në dijeni për numrin e madh të mjekëve, të cilët sot e kësaj dite po vazhdojnë ikjen e tyre nga Kosova për një jetë më të mirë, për kushte më të mira të punës dhe janë me qindra mjekë të rinj, të cilët po ikin jashtë Kosovës.

Pyetja ime ka të bëjë direkt me juve: çka jeni duke ndërmarrë që ta ndalni këtë fluks? Çka jeni duke ndërmarrë për përmirësimin e kushteve të punës së mjekëve, duke përfshirë edhe premtimin që e keni bërë më herët dhe si pasojë e një greve që ka ekzistuar në fillim të këtij viti për rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësorë dhe është premtuar që punëtorëve shëndetësorë do t'u rregullohet paga e tyre me kategorizimin e pagave.

Sa keni arritur që t'i harmonizoni dhe ta bëni kategorizimin e pagave, e cila do të ishte një pagë meritore për një jetë të dinjitetshme të punëtorëve shëndetësorë? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër Ismajli, e keni fjalën.

**MINISTRI URAN ISMAJLI:** Faleminderit, nënkryetar!  
Faleminderit, deputetë!

Ju e dini që Kosova realisht ka një sektor të shëndetësisë, i cili ka qenë i paplotësuar me profesionistë shëndetësorë për një kohë shumë të gjatë dhe si e tillë puna e parë që kemi filluar gjatë marrjes së mandatit ka qenë që të hapim vende të reja të punës për mjekë specialistë.

Më lejo që të kaloj pak nëpër to se çfarë ka ndodhur.

Ne kemi marrë një buxhet për rreth 300 vende të reja të punës, kur në SHSKUK, për shembull, janë punësuar 37 mjekë specialistë, ndërsa në QKUK dy (2) specialistë të kardiokirurgjisë apo në total 39 mjekë specialistë.

Në procedurë kemi konkurs edhe për 28 specialistë të tjerë të spitaleve të përgjithshme, apo 23 mjekë specialistë të profileve të ndryshme për QKUK-në, kur llogariten të gjitha këto, do të arrijmë në numrin e 90 mjekëve specialistë, të cilët do të punësohen vetëm gjatë këtij viti.

Po ashtu kemi pasur edhe profile të ndryshme të infermierisë, të cilat janë plotësuar apo janë plotësuar rreth 96 infermierë të profileve të ndryshme vetëm gjatë këtij viti.

Në qoftë se marrim tërë SHSKUK-në, numri i të punësuarve të gjithë infermierëve arin 141 persona vetëm gjatë këtij viti. Pra, shihet një numër shumë më i madh i punëtorëve shëndetësorë, të cilët sot hyjnë në vende të punës, që realisht ka qenë një praktikë shumë e nevojshme që të ndodhë edhe në vitet e ardhshme.

Një hap tjetër që është ndërmarrë për krijimin e kushteve më të mira për personel shëndetësor është edhe plotësim-ndryshimi i Udhëzimit administrativ, sipas të cilit të gjithë specializantët kanë fituar të drejtën e tyre për të paguar nga shteti dhe të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë.

Me këtë udhëzim kemi futur në pagesë qindra specializantë vullnetarë.

Duke mbajtur premtimin që kemi dhënë në fillim të mandatit me rregullimin e kësaj padrejtësie, e cila ka ndodhur vite me radhë, jemi zotuar se gjatë këtij viti do të nisim përmirësimin e kushteve për tërë personelin mjekësor. Si do ta bëjmë këtë?

E para, të gjithë punonjësve të sektorit të shëndetësisë do t'u rritet paga. Pra si e kemi miratuar koncept-dokumentin e hartuar në Qeveri, dokument që i ka hapur rrugë kategorizimit të pagave për profesionistë shëndetësorë, Ministria e Shëndetësisë ka proceduar ditë më parë në Ministrinë e Administratës Publike edhe komentet dhe propozimet e saj lidhur me Projektligjin për pagat, i cili pasi do të miratohej, do të përfshijë nivelimin e pagave edhe për mjekët.

Pra, do të punoj ngushtë me të gjithë aktorët me rëndësi për finalizimin e detajeve dhe shumë shpejt do të vijmë deri te një zgjidhje, e cila është e pranueshme edhe për vetë punëtorët shëndetësorë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

HAXHI AVDYLI: Faleminderit, për përgjigje!

Vetëm desha ta bëj një pyetje shtesë, kur është ajo datë që planifikohet, a planifikohet me rishikim të buxhetit, a planifikohet vitin tjetër dhe dua ta shpreh edhe një shqetësim të punëtorëve shëndetësorë për konkurset e drejtorëve në shumë institucione shëndetësore, për politizimin e skajshëm që po ndodh në zgjedhjen e drejtorëve në institucione shëndetësore, në spitale rajonale dhe në klinika dhe a do ta luftoni politizimin, i cili kryesisht këta drejtorë janë nga Partia Demokratike e Kosovës, si njerëz të lidhur me Partinë Demokratike apo familjarë të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajli, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Po filloj nga ajo e para që thatë, se kur do të fillojë. Ne koncept-dokumentin e kemi përgatitur, të gjitha i kemi përgatitur, kjo varet nga Ministria e Administratës Publike, e cila do ta dërgojë në muajin qershor gjithë dokumentin dhe mënyrën se si do të procedohet, a është për rishikim a për vitin e ardhshëm, nuk më mbetet mua të përgjigjem.

Me rëndësi është që për së pari herë sektori i shëndetësisë, personaliteti mjekësor do të ketë një kategorizim të pagave, do t'u kthehet dinjiteti, qysh ishte dashur t'i kenë edhe gjatë viteve të kaluara që nuk i kanë pasur.

Sa u përket doktorëve të PDK-së ne, ne PDK-ja nuk kemi hapur Fakultet të Mjekësisë, nuk i kemi dhënë askujt diplomë, mjekët janë mjekë, të gjithë nga do që vijnë, për mua janë të gjithë njësoj, nuk ka doktorë të PDK-së, doktorë të LDK-së për mua, ka menaxherë të suksesshëm, menaxherë të pasuksesshëm, doktorë të suksesshëm, doktorë të pasuksesshëm, sa janë pacientët të kënaqur me ta.

Prandaj, duke pasur tentativë që doktorin ta bëjmë të PDK-së, ju realisht tregoni konceptin e politizimit, konsideroj unë, dhe nuk është mirë të merremi me diskutimet që i ka bërë ndonjë kryetar i komunës pa pasur informata të plota. Nuk më keni pyetur, po të më kishit pyetur, ju kisha treguar, ose më drejt e kishit pyetur SHSUK-në se si ka ardhur deri te vlerësimi i tyre.

Andaj, depolitizimi realisht do ta bëjmë, ashtu që pacienti ta marrë shërbimin e duhur. Nuk do ta rehatojmë individin, po do ta rehatojmë pacientin, që ai ta marrë shërbimin e duhur dhe kjo për mua ka rëndësi, besoj edhe për juve si profesionistë shëndetësorë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ndonëse kryeministri nuk është këtu, por edhe pyetja ime ka më shumë të bëjë me ngritjen e një çështje që Qeveria të fillojë të mendojë. Ka të bëjë me hapësirën e lartë ajrore të Kosovës, e cila tash katër vjet menaxhohet nga kompania hungareze e navigimit ajror “Hungaro kontroll”, të cilës i skadon kontrata më 1 qershor të vitit të ardhshëm.

Në atë kohë vendimi për të kaluar nën menaxhim hapësira e lartë ajrore e Kosovës kësaj kompanie është marrë nga NATO, gjegjësisht nga KFOR-i.

Pyetja ime për Qeverinë në përgjithësi, kryeministrin në veçanti, është se çfarë është duke bërë Qeveria që në qershorin e vitit të ardhshëm menaxhimin e hapësirës ajrore ta bëjnë autoritetet tona, gjegjësisht Autoriteti i Aviacioni Civil. A kanë filluar negociatat e nevojshme me autoritetet e NATO-s dhe a janë tejkalluar pengesat e tjera, përfshirë këtu edhe ngritjen e kapaciteteve profesionale, në mënyrë që hapësira jonë ajrore t’u kalojë nën menaxhim autoriteteve të Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri nuk është këtu. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër Ismajli,

Po bëhen më shumë se 10 muaj që dhjetëra barna të listës esenciale mungojnë aktualisht në SHSKUK. Mungesat janë evidente në çdo spital regjional dhe në klinikat e Qendrës Klinike Universitare.

Pacientët ankohen se duhet t’i blejnë barnat dhe pajisjet e tjera, duke filluar nga gjilpëra, fashat, dorëzat, e deri te tostatikët e të tjerë, të cilat mungojnë tani e disa muaj.

Pasi që me Ligjin për buxhetin e vitit 2018 është rritur buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë, e në veçanti për furnizim me barna, ju parashtroj këtë pyetje.

I nderuar ministër,

Kur pritet që Ministria e Shëndetësisë të sigurojë furnizimin 100% me barna nga lista esenciale, që është obligim ligjor i Ministrisë së shëndetësisë? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: I nderuar nënkryetar,

I nderuari deputet Haxhiu, faleminderit!

Të nderur deputetë,

Një nga problemet kryesore në mungesat e paraqitura për barna dhe material shpenzues medicinal nuk ka qenë vetëm buxheti i vogël, por edhe problemet shumëvjeçare të shfaqura me kontratat paraprake.

Kryesorja, ka pasur mungesë të planifikimit që është shfaqur në dy dimensione.

Në dimensionin e parë, sasia e planifikuar nuk ka qenë sasi e duhur, pra nuk ka qenë e mjaftueshme dhe, si rrjedhojë, është bërë përpjekje të bëhet racionalizimi i saj. Në këtë mënyrë nuk është arritur efekti i duhur, përkundrazi në shumë reparte janë shkaktuar mungesa të disa lloje të barnave, disa lloje të materiali shpenzues medicinal.

Dhe dimensionin e dytë ka qenë planifikimi i kontraktimit të blerjes së barnave me shuma shumë më të larta, pa pasur një analizë të tregut dhe këtu disa nga barnat e kontraktuara nuk kanë pasur vlerën reale në treg.

Këto dy dimensione, këto dy forca, pra sasia e vogël me barna më të shtrenjta, kur kanë bashkëvepruar kanë sjellë çrregullim shumë të madh të furnizimit me barna nga lista esenciale.

Një mbështjellës tjetër i këtij problemi ka qenë edhe mungesa e informatave.

Ministria e Shëndetësisë nuk e ka pasur informatën reale në kohën e duhur, informatat kanë qenë të fragmentuara, të pjesshme ose shpesh kanë munguar.

Nuk kemi pasur sistem të paralajmërimit se sa barna kemi në stoqe, cilat prej tyre janë gati të harxhohen, apo kur është koha e duhur për të filluar kontraktimin e tyre.

Për një ditë kemi mbetur pa 300 artikuj, zero sasi në stoqe dhe pa kontrata të përgatitura.

Kjo pjesë e ka çrregulluar tërësisht sistemin dhe i ka kushtuar shëndetësisë kosovare si në çmime, ashtu edhe në mungesë të barnave gjatë këtyre 18 vjetëve.

Zgjidhja për këto që përmenda nuk ka qenë e shpejtë dhe nuk ka qenë e lehtë.

Tani realisht kemi një sistem elektronik, i cili na paralajmëron për secilën kontratë, e cila ka afate dhe 4 muaj të shpenzohet, ose arrin 70% të përdorimit në sasi.



Për secilin kontratë është vendosur menaxheri i kontratës, ta bëjë përcjelljen dhe të kemi llogari të shtuar.

Kemi bërë hulumtim të tregut për secilin bar të prokuruar.

Në bazë të hulumtimit të tregut, është bërë zotimi i mjeteve dhe efekti i saj është parë menjëherë, ku për 18 produktet e para të kontraktuara janë kursyer mbi gjysmë milioni euro.

Këto duken si hapa të lehtë, po realisht ka pasur një rezistencë të madhe dhe këtë e dëshmon çrregullimi që është krijuar me vjet, një lloj kaosi që ka dëmtuar pacientin dhe shtetin, pra kanë humbur të dyja palët.

Po ashtu, me ndihmën e ekspertëve të OBSH-së, të cilët kanë ofruar ekspertizën e tyre në të gjitha fazat e hartimit, është bërë një Udhëzim administrativ për rregullimin e çmimeve të barnave. Janë përgatitur tabelat e harmonizimit me direktivën e Bashkimit Evropian lidhur me këtë proces dhe tani ky Udhëzim administrativ është në fazën kur duhet të kryhet shpejt dhe të hyjë në fuqi. Një nga komponenti i këtij Udhëzimi është edhe vendosja e çmimeve referente me shtetet e rajonit të Bashkimit Evropian. Të mos lejohet që çmimet, të cilat kontraktohen në Kosovë, të jenë më të larta se ato të shteteve referente.

Të nderuar deputetë,

Ashtu sikur e kam paralajmëruar, muaji qershor do të jetë muaji i fillimit të stabilizimit me barna dhe material shpenzues medicinal për të gjitha institucionet shëndetësore publike. Vetëm gjatë këtyre dy javëve të fundit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Vazhdojani fjalën, le ta kryejë raportin.

**MINISTRI URAN ISMAJLI:** Vetëm gjatë këtyre dy javëve të fundit janë nënshkruar 81 artikuj të materialeve shpenzuese dhe jemi para nënshkrimit të 32 artikujve të tjerë për materialet shpenzuese. Po ashtu, janë nënshkruar 30 lloje të barnave gjatë javës së kaluar, ndërsa 45 lloje të barnave priten të nënshkruhen këtë javë.

Pra, ka qenë një situatë mjaft e vështirë, e cila ka pas një mungesë të planifikimit, ka pasur mungesë të sasive reale, por që është dashur të kalohet nëpër to, në mënyrë që të kemi vendosjen në binarë një herë e përgjithmonë të këtij problemi, i cili ka shkaktuar të themi një kokëçarje të madhe te pacientët tanë, por edhe te personeli shëndetësor për vite me radhë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër!

Ju e dini që në vazhdimësi kam përcjellë problemet e shëndetësisë dhe jashtë asaj evokimit ose paraqitjes së atyre problemeve për të cilët të gjithë ne këtu që jemi në Parlament, e në veçanti për ne që jemi tri mandate, do të thotë janë probleme të njohura, të cilat në vazhdimësi i kemi ngritur dhe përpara se t'i paraqesim ato, kërkesa është imja dhe e qytetarëve dhe atyre që kanë nevojë për të marrë shërbime shëndetësore për hapa konkretë, për përmirësim të gjendjes përpara se të bëhet shpалosja e atyre devijimeve që kanë ndodhur në të kaluarën në Ministrinë e Shëndetësisë. Nëse një kontratë është tejkualuar 300%, nëse përgjegjësit e depos të Ministrisë së Shëndetësisë kanë mbetur me zero barna, a mund të tregoni cilat janë masat ligjore që keni ndërmarrë? Cilat janë suspendimet?...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Përfundoje pyetjen!

BEKIM HAXHIU: Cilat janë suspendimet, të cilat i keni marrë, sepse çdo kontratë, edhe pse do të thotë deri më tani ka pasur menaxher kontrate, ka pasur tejkualim, ka pasur edhe nëse planifikimet kanë qenë të gabuara, çka ka ndodhur me ata menaxherë, a janë përsëritur zgjedhjet? A janë zgjedhur të njëjtët që s'kanë ditë të planifikojnë? Dhe, çka ka ndodhur me ata të cilët kanë bërë tejkualim të kontratave në 300%, sepse nëse në ndërtimtari e tejkualon kontratën 10%, bën vepër penale. E pse lejohet në shëndetësi, edhe çmimet, edhe kontratat të tejkualohen për 300% dhe nuk ka përgjegjësi?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, bjeri shkurt pak.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Situatë e rëndë, nënkryetar. Kështu, e para sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë kontratat në Ministrinë e Shëndetësisë, jo në SHSKUK, nuk kanë pasur menaxherë të kontratave, këtë e them me kompetencë, nuk e kanë vendosur. E kanë pasur obligim ligjor të vendosin, nuk është vendosur.

E dyta, realisht unë jam përgjigjur edhe një herë sepse kam pasur pyetje nga deputetët: çfarë je duke bërë? Ne u jemi drejtuar organeve përgjegjëse për shkeljet, ku kemi parë që ka shkelje. Pra, arsyeja pse ka ndodhur, unë nuk mundem, domethënë Prokuroria le të vendosë pse kanë ndodhur ato shkelje. Por, një bar, i cili në barnatore tre hapa më larg se Ministria e Shëndetësisë paguhet me 9 euro, e ka ardhur në Ministrinë e Shëndetësisë me 20-30 euro, nuk është, tregon për klimën e cila është krijuar brenda dhe për mekanizmat brenda Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat nuk kanë funksionuar. Me një hulumtim të tregut, duke kaluar nëpër 10 barnatore apo në 5 depo farmaceutike, arrin të marrësh një çmim të numrave, a do të bëjmë edhe ne lëshime gjatë kalimit, e tregon koha. Me rëndësi është të ketë vullnet që në atë vend ku e shohim që ka tejkualim të buxhetit, të ndalen.

E dyta, sa u përket çështjeve konkrete, sistemi që e kemi krijuar tani, një sistem menaxherial, nuk ka qenë të blihet, po të kishte qenë të blihen diku, i kishim blerë, po nuk ka pasur mundësi, është dashur të ushtrohen njerëzit, është dashur të bëhet analizë tregu, është dashur t'u tregohen njerëzve që nuk e lejojmë më shkeljen e një kontrate të tillë. Të gjitha këto kanë kërkuar javë. Për një ditë të mbeten 300 artikuj, 300 artikuj të mungojnë dhe asnjë të mos jetë prej atyre 300 artikujve në depo, dhe të mos dënohet kurrkush, nuk është e mundur. Unë jam ministër i Shëndetësisë dhe punën e kam ndaj pacientit, ta rregulloj sistemin shëndetësor ndaj pacientit, gjersa pjesët e tjera, të cilët u takojnë organeve përgjegjëse, janë të hapura. Unë i kam dërguar disa, ato të cilat kam menduar që janë tepër të tejkaluara, mirëpo nuk më takon mua, sepse nuk kam qenë atëherë, nuk e di qysh ka ndodhur.

Unë e di çka është duke ndodhur prej...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Bytyqi. Ministri s'është këtu.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit! Nuk ka qenë edhe herën e kaluar, prej 21 ministrave sa i kemi, mbi gjysma po e luajnë rolin e ministrit të Punëve të Jashtme, është mirë pak të qëndrojnë këtu dhe të merren me problemet e brendshme. Unë do t'i lexoj pyetjet, meqë është hera e dytë që po mungon ministri.

Çështja e parë që e kam si pyetje parlamentare është çështja e çantave të filloristëve, që është ngritur shumë herë këtu edhe nga deputetët e tjerë. Ministër, ai mungon, gjatë dekadës së fundit pesha e rëndë e çantave të nxënësve është bërë problem i madh jo vetëm për nxënësit, por edhe për prindërit. Si pasojë e çantave të rënda shumë nxënës kanë pësuar dëmtime të rënda shëndetësore pavarësisht kërkesave për zvogëlimin e peshës së çantës së nxënësve, asgjë konkrete nuk është ndërmarrë deri më tani. Kohëve të fundit ka prind në shumë komuna që po paralajmërojnë protesta dhe heqjen e disa librave që konsiderojnë ata që nuk janë të domosdoshme t'i bartin nxënësit në çantë dhe pyetja ime është: çka po ndërmerr Ministria e Arsimit për zvogëlimin e peshës së çantave të nxënësve në shkollat fillore?

Kjo ishte pyetja besoj që ministri ka për të gjetur kohë që të më përgjigjet. Nëse pajtoheni, unë e kam edhe një pyetje për të njëjtin ministër, që po ashtu, për herë të dytë ka ardhur këtu dhe po e lexoj edhe këtë: pyetja tjetër ka të bëjë me ekskursionet e maturantëve. Viteve të fundit shkuarja në Shqipëri në formë të organizuar nga shkollat e mesme që po quhet "ekskursione" po cilësohen nga shumë pjesëmarrës të këtyre shëtitjeve dhe shumë prindërve të nxënësve si shëtitje të shfrenuara, të cilat nuk përbëjnë asnjë element të ekskursionit.

Nga viti në vit po rritet numri i prindërve që po kërkojnë ndërprerjen e këtyre udhëtimeve të pakontrolluara dhe të dëmshme për nxënësit. Këto ekskursionë që po organizohen në fillim të vitit të fundit të shkollës së mesme, po ndikojnë negativisht edhe në procesin mësimor të maturantëve pas kthimit nga ekskursionit në vitin e tyre të fundit. Pyetja për ministrin është se a kanë planifikuar të ndërmarrin masa për tejkalimin e këtij problemi serioz për maturantët? Pra, për kontrollimin dhe mbajtjen nën kontroll të këtyre ekskursionëve ose të ndërpriten këto shëtitje, të cilat nuk janë ekskursionë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Nagavci, pyetje për ministrin Bytyqi. S'është zonja Nagavci këtu. Zoti Hoti, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, s'është as Hoti, as ministri. Zonja Musliu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

**GANIMETE MUSLIU:** Mua më vjen keq, por pyetjen për Uran Ismajlin e kam bërë herën e kaluar, ndërsa sot i kam dy pyetje: një për kryeministrin dhe një për ministren Reshitaj.

**KRYESUESI:** Pyetjen e ke për Ramush Haradinajn, se...

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Po, unë i kam bërë një pyetje kryeministrit Haradinaj lidhur me projektligjin për kompleksin memorial "Adem Jashari", mirëpo, edhe pse këtë pyetje e kam bërë më 7 maj 2018, fatmirësisht ligji ka ardhur në Kuvend dhe jemi gjithçka në rregull.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Valon Ramadani, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

**VALON RAMADANI:** Pyetja ime e drejtuar ministrit Ismajli është kjo: a jeni në dijeni mbi gjendjen dhe funksionimin e spitalit në komunën e Shtërpçës? Ose më saktësisht në fshatin Biti e Ulët dhe a ka ministria ndonjë raport mbi shërbimet ose numrin e punëtorëve të këtij spitali?

**MINISTRI URAN ISMAJLI:** Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar deputet,

Ky spital realisht është në proces të funksionalizimit, por nuk është ende funksional dhe nuk ofron shërbime shëndetësore. Në këtë spital, i cili sipas planit komunal do të ketë rreth 60 shtretër, janë të punësuar 24 punëtorë, ndërkaq planifikohen që të punësohen edhe 96 të tjerë.

Por, meqë spitali i stacionuar në fshatin Biti e Ulët nuk është funksional, të punësuarit janë të shpërndarë në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor të komunës së Shtërpçës. Komunës së Shtërpçës qysh në vitin 2010 i është lejuar financimi për kujdesin shëndetësor sekondar dhe në bazë të tij ka filluar projekti i ndërtimit të këtij spitali. Ka filluar dhe blerja e pajisjeve dhe punësimi i punëtorëve në mënyrë që të funksionalizojë normalisht dhe të ofrojë shërbime të nevojshme për qytetarët e kësaj ane. Infrastruktura e spitalit është e gatshme, por pritet instalimi i

rrymës elektrike, i ujit dhe i nxehtësisë që pritet të kryhen deri në fund të verës. Spitali ka 1 mijë e 800 metra katror, reparte të planifikuara interno, pediatri, gjinekologji me akusherë, kirurgji e përgjithshme dhe ortopedi. Po ashtu, sipas planifikimeve të bëra nga Drejtoria e spitalit në Komunën e Shtërpcës, ky spital parashihet të ketë dy salla operacioni, bllokun radiologjik, laboratorin, barnatore, kuzhinën, lavandarinë.

Para disa ditësh përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë janë takuar me drejtorin e këtij spitali, prej të cilit kanë kërkuar një plan veprimi të detajuar, në mënyrë që bashkarish të analizojmë mundësinë për shtim të buxhetit dhe të kërkojmë edhe ndihmën e donatorëve, nëse është nevoja, që ta funksionalizojmë këtë spital. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ramadani?

VALON RAMADANI: Fillimisht, ministër, nuk m'u përgjigjet në pyetje në lidhje me punëtorët që punojnë në këtë spital, si dhe shërbimet a merren nga ky spital. Nuk e di, ju a keni qenë ta vizitoni këtë spital? Mendoj që duhet të shkoni ta vizitoni dhe të shihni që ky spital është jofunksional, mirëpo në listën e pagave dhe lista e shpenzimeve të shërbimeve është funksional ky spital. Domethënë, ka punëtorë që marrin paga dhe nuk punojnë në këtë spital ose thjesht prej vitit 2011 ky spital nuk është bërë funksional dhe vazhdojnë çdo vit keqshpenzimet, ashtu si e the ti që nuk është funksionalizuar rryma, ujësjellësi,...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën, nëse dëshironi!

MINISTRI URAN ISMAJLI: I nderuar deputet!

Pra, spitali nuk mund të jetë edhe funksional, edhe jofunksional. Spitali ka paga, të cilat konsiderohen që jepen për punëtorët shëndetësorë të shërbimeve sekondare, por për arsye që nuk janë duke dhënë shërbime sekondare, ata janë vendosur në kujdesin primar. Pra, janë të buxhetuar si punëtorë shëndetësorë sekondarë, ndërsa shërbimet i kryejnë në kujdesin parësor.

Unë kam kërkuar nga drejtori i Shërbimeve Mjekësore që ta vizitojë Shtërpcën, e ka vizituar dhe ka pasur diskutim dhe ka kërkuar nga drejtori që të dalë me një plan funksional nga ta, sepse është nën kompetencën e tyre që të na e paraqesin dhe të shohim mundësinë se si t'u ndihmojmë në realizimin më të shpejtë në mënyrë që ta marrin shërbimin. Pra, ka pasur ngecje që nga 2010-ta, po besoj kur e kanë fituar të drejtën, por si e tillë sot ne jemi duke kërkuar që të ketë pronësi edhe autoriteti komunal. Domethënë të na japë, pra të mendojnë ata pak për planifikim dhe aty ku ka nevojë, ne u ndihmojmë, por ta marrin pronësinë, sepse e kanë fituar të drejtën dhe ta realizojnë të drejtën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Mikullovc, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit!

Për ministrin e Financave, zoti nënkryetar, për ministrin e Financave kam një pyetje. Zoti ministër, a keni ndërmarrë ndonjë hap ose çka keni bërë që ta ktheni Fondin pensional, të cilin e ka grabitur Serbia nga Kosova? Flitet për një shumë bukur të madhe, por njëherësh kam edhe një pyetje shtesë: një numër i konsiderueshëm të qytetarëve të Kosovës atë kohë kanë pasur të deponuara të holla në “Jugo Bank”. I kanë librezat, kanë vërtetimet, kanë pasur të holla të afatizuara. Sipas shkrimit të “Kohës Ditore”, në pyetje janë 7 deri 8 milionë marka, asokohe. Çka keni ndërmarrë që këto mjete t’ua kthehen qytetarëve? Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Ministri nuk është këtu. Fjalën e doni? S’është kryeministri, Ramush Haradinajt ia keni bërë pyetjen.

Zoti Mikullovc pyetja i është drejtuar Ramush Haradinajt dhe kryeministri me siguri që e ka marrë pyetjen tuaj. Zoti ministër i Financave nuk e ka pasur pyetjen, përderisa s’ia keni bërë pyetjen ministrit, ky s’është përgatitur për sot të përgjigjet. Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, a dëshironi ta bëni pyetjen?

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Meqenëse kjo pyetje është drejtuar edhe në seancën e kaluar, mirëpo në mungesë të ministrit, pyetjen e barta për seancën e re, mirëpo edhe në këtë seancë nuk është i pranishëm ministri. Unë pyetjen do ta bëj, me shpresë që do ta marr përgjigjen me shkrim, në të kundërtën, në qoftë se nuk e marrë përgjigjen me shkrim, pyetjen e përsëris në seancën tjetër.

Desha t’i drejtohem ministrit se a është në dijeni që është dorëzuar një kërkesë me shkrim, domethënë një peticion të protokolluar prej studentëve të Prizrenit më 28. 2. 2017, me numër të protokollit 1 153, ministrit të atëhershëm, zotit Arsim Bajrami dhe qysh nga atëherë e deri më sot studentëve ende askush nuk u është përgjigjur.

Pra, në qoftë se përgjigjen nuk e marr me shkrim, atëherë do ta përsëris në seancën tjetër.

KRYESUESI: Deputeti Shemi Syla, pyetje për ministrin Berisha, ministri s’është këtu. Shemi, mund ta lexosh pyetjen.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse ministri po mungon, dua ta bëj pyetjen, sepse edhe në seancën e kaluar ka munguar, nuk e di ku është faji, a është hidhëruar me Parlamentin, a me Qeverinë, s’e di.

Pyetja është kjo: a është duke u zbatuar afati kohor për transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, sipas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë? Sepse, kohëve të fundit kemi pasur një bartje të ligjit herë në Qeveri, herë në Ministri, deshëm ta dimë nëse nuk ka shkuar në rregull kjo punë, atëherë a ekziston ndonjë plan B i Ministrisë së Forcës së Sigurisë që të bëjë transformimin e Forcave të Sigurisë në Ushtri të Kosovës? Besoj se më përgjigjet me shkrim, nëse jo, atëherë shikojmë në seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin Haradinaj. Driton, a do ta bësh pyetjen?

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit! Është, në fakt, hera e dytë që vjen kjo pyetje në mungesë të kryeministrit. Bile herën e fundit ai me një shkresë kishte kërkuar që të shtyhen, unë nuk besoj që është në rregull që kryeministri të caktojë agjendën e Kuvendit. Megjithatë, unë sot po e shtroj këtë pyetje, për shkak se e kam dorëzuar, e kam protokolluar më 14 maj 2018, ndërkohë janë mbi tre muaj që kjo çështje mbeti pa përgjigje, pra është fjala për skandalin dhe problematikën e sigurisë ushqimore ose nivelit të ulët të sigurisë ushqimore që para tre muajsh filloi me çështjen e mishit të importuar.

Siç e dimë të gjithë, gjatë këtyre tre muajve vazhdojnë të konfiskohen tonelata të tëra mish në komuna të ndryshme nga inspektoratet komunale, jo nga Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinës që është përgjegjësi kryesor për këtë situatë të rëndë të shëndetit publik. Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një debat parlamentar, siç ju kujtohet, në lidhje me këtë çështje, më 18 prill dhe është votuar një rezolutë me rekomandime më 26 prill.

Mirëpo, deri më sot nuk kemi pasur asnjë përgjigje. Situata aktuale e sigurisë ushqimore paraqet kërcënim serioz të shëndetit publik në Republikën e Kosovës, qytetarët vazhdojnë të jenë të ekspozuar çdo ditë ndaj këtij rreziku për shëndetin e tyre, shpesh edhe pa vetëdije, për shkak të mungesës së informacionit. Megjithatë, deri më sot nuk kemi pasur asnjë masë të ndërmarrë nga kryeministri, pika e parë, rekomandimi i parë i kësaj rezolute është që të merren masa emergjente ndaj përgjegjësve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, drejtorit dhe menaxhmentit të kësaj organizate.

Mua më mbetet vetëm të vazhdoj të bëj, të ngre këtë çështje, radhën tjetër, sa do të jetë nevoja para kryeministrit derisa të kem një përgjigje...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Çausi! Deputetja Valentina Bunjaku, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. A është Valentina? S'është! Deputeti Çoçaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Zoti Çoçaj, doni ta bëni pyetjen?

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar nënkryetar!

Unë do ta shtyj për seancën e ardhshme, shpresoj që ministri do të jetë këtu në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë po e lexoj këtë pyetje, sepse është relevante edhe nëse nuk është ministri këtu, por besoj që e dëgjon, mbi të më shumë është dhe përgjegjësi gjithëinstitucionale sa u përket mekanizmave të sigurisë.

Çështja ka të bëjë me përdorimin e drogave në ambientin e shkollave, i cili është një problem tejet shqetësues kohët e fundit. Kjo dukuri e përdorimit të narkotikëve nga ana e të rinjve ka shënuar rritje dramatike të abuzimit me substanca narkotike në shkolla dhe afër tyre. Të rinjtë janë grupmoshat, të cilët rrezikojnë të bien në grackën e dilerëve të drogës dhe krimit të organizuar. Pyetja ka qenë: çka po bëjnë autoritetet kompetente që bien në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme në evidentimin e faktorëve të rrezikut, që rrezikojnë fëmijët tanë, nxënësit, të rinjtë, si dhe masat që parandalojnë dhe luftojnë këtë dukuri negative?

E kisha lutur ministrin ta dëgjojë, e kisha lutur edhe Qeverinë, edhe organet e tjera kompetente, sepse shifrat janë alarmante, janë shqetësuese dhe, mbi të gjitha ky abuzim që po ndodh me rininë tonë, po ndodh para syve të të gjithë neve dhe pa asnjë veprim konkret të luftimit të kësaj dukurie negative, qoftë me masa parandaluese, qoftë edukative, por mbi të gjitha është kompetencë e organeve të drejtësisë. Kështu që është më shumë lutje, thirrje se sa kërkesë imediate e përgjegjësisë, raportit deputet-ministër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë zoti Zemaj, pyetje për ministrin Skender Reçica.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Ministri qenka i pranishëm. Zoti ministër, çështja ka të bëjë për Ligjin mbi skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili rregullon pensionin bazik të moshës, pensionin kontributpagues të moshës, e tjerë.

Një ndër pikat e ligjit janë kriteret dhe procedurat administrative për njohjen e së drejtës në pensionim. Në kuadër të kësaj kemi një shprehje të logjikës përfituese, apo ta quaj diskriminim që bëhet ndaj kategorive të veçanta, të cilat ishin përjashtuar nga puna në kohën e regjimit serb të viteve të '90-ta dhe të cilat janë akoma edhe më të ndëshkuar për arsye të mospërgjegjësisë institucionale të rregullimit të skemave pensionale. Shqetësimi im konsiston nga përjashtimi nga kjo e drejtë e përfitimit të pensionit të kontributdhënësve të zyrtarëve policorë, të cilët nuk kishin pranuar të punojnë nën masa të dhunshme dhe janë përjashtuar nga puna në mënyrë të dhunshme. Pyetja është: çka po bëni ju si ministri kompetente? A keni plan konkret për ta



zgjdhur këtë çështje? Nëse po, atëherë kur do ta bëni dhe cili është afati kohor i zgjidhjes së këtij problemi?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Reçica, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Zemaj,

Faleminderit për pyetjen tuaj. Çështja e pensionistëve në përgjithësi, por edhe e kategorive të veçanta, siç është rasti me ata të përjashtuar nga puna në kohën e regjimit serb në vitet e '90-ta, në këtë rast zyrtarët policor. Është temë shumë e rëndësishme dhe si nga thellimi i mandatit, jemi duke e trajtuar me përkushtim shumë të lartë.

Së pari, ju njoftoj se Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti 118 përcakton kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës. Kriteri bazë për realizimin e këtij pensioni është mosha 65 vjeç dhe stazhi pensional 15 vjet i përcaktuar sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011/2 24/83, Gazeta zyrtare KSAK nr. 26/83, para datës 1 janar 1999.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si bartëse e këtij procesi është e detyruar që të zbatojë dispozitat ligjore, ashtu siç përcakton qartë ligjin në fuqi për skemat pensionale të financuara nga shteti. Bazuar në këto dispozita dhe pyetjes suaj, zyrtarët policorë nuk janë përcaktuar si kategori përjashtuese, të cilët nuk i kanë plotësuar 15 vjet stazh pensional dhe me këtë rast nuk mund të jenë përfitues sipas këtij ligji. Për më tej, çdo person i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit çrregullon skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk ka të drejtë në pension, përkatësisht në pensionin kontributpagues të moshës.

Se kemi krijuar një sistem të ashtuquajtur pensional me shumë ligje të veçanta, mbi 25 skema të ndryshme pensionale, me kategori dhe lloje të përfitimeve të ndryshme e që të gjitha këto të paguara nga buxheti i shteti, kjo tanimë është konstatuar nga të gjithë ne. Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar në sistemin pensional, e cila çdo vit pothuajse po shkon duke u rënduar, me iniciativa të reja për përfshirjen në skema pensionale kemi konstatuar se kemi një legjislacion jo të harmonizuar, një buxhet jo të qëndrueshëm dhe mbi të gjitha një pabarazi sociale.

E drejta sociale si koncept duhet t'i trajtojë njëjtë të gjithë qytetarët, kategoritë sociale të cilat janë të ndikuara nga ndonjë risk eventual. Prandaj, ne si ministri tanimë kemi filluar përgatitjen e reformës pensionale dhe invalidor, përkatësisht reformën në mbrojtjen sociale në përgjithësi. Me këtë reformë ne synojmë ta krijojmë një kornizë të përgjithshme dhe të qëndrueshme të sistemit pensional dhe invalidor, duke e harmonizuar kornizën ligjore aktuale, ngritjen e kapaciteteve

institucionale, njerëzore dhe teknologjike. Ky proces synon të ketë ndikim në rritjen e barazisë ndërmjet kategorive të ndryshme të përfituesve në aspektin e përfshirjes sociale dhe stabilitetit financiar.

Qëllimi është që të krijojmë një sistem pensional dhe invalidor, që është i qëndrueshëm...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Zemaj?

ARMEND ZEMAJ: Ministër!

Unë e kuptoj çështjen që është pak komplekse, por unë po kërkoj përgjigje në angazhimin tuaj për një kategori të veçantë. Afër e keni edhe ministrin e Financave, pa dashur ta implikoj në këtë proces. Unë po flas për një kategori njerëzish të cilët kanë qenë zyrtarë policorë dhe në kohët më të vështira për vendin kanë dalë në anën e popullit shqiptar të diskriminuar dhe të dhunuar nga regjimi okupator. Janë përjashtuar nga puna, nuk e kanë pranuar sistemin okupues dhe ata nuk janë përfitues të pensionit kontributpagues, ndërsa ata që kanë punuar dhe kanë dalë e kanë punuar nën masat e dhunshme janë përfitues të pensionit kontributpagues. Dhe, kjo është përgjigja që duhet të marrim nga ministria juaj.

KRYESUESI: Zoti Reçica, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, deputet Zemaj!

Po e sqaroj edhe një herë.

Ministria e Punës është duke e zbatuar ligjin në fuqi, që ka të bëjë me skemat pensionale të financuara nga shteti dhe në këtë situatë ne jemi të obliguar t'i zbatojmë dispozitat e këtij ligji.

Me tërë respektin, për të gjitha kategoritë të cilat kanë qenë të përjashtuara në vitet e '90-ta, në këtë rast zyrtarët policorë, mu për këtë arsye jo vetëm për këtë kategori të zyrtarëve policorë, por edhe të tjerët, nuk janë të përfshirë dhe nuk ka mundësi të përfshihen. Në bazë të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, na ka detyruar që të mendojmë për një reformë të sistemit pensional, me ç'rast do të krijojmë një barazi për të gjitha shtresat e prekura dhe të gjitha shtresat që kanë derdhur kontribut për vitet e kaluara që ne sot jemi këtu.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Reçica! Zonja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për zëvendëskryeministrin Bexhet Pacolli.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti kryesues Haliti!

Ndoshta, për hir të aktualitetit të kësaj pyetjeje, meqë zoti Pacolli nuk është këtu, do ta lexoj pyetjen. Shpresoj që ai do të më përgjigjet në njërin prej seancave.

Fjala është për fushatën agresive të Serbisë së fundmi për tërheqjen e njohjeve ndaj shtetit të Kosovës, si dhe veprimet e shtetit serb përfshirë këtu ndalimin e sportistëve kosovarë që të marrin pjesë në gara. Rasti i fundit i ndalesës që i është bërë edhe artistes Eliza Hoxha dhe shumë të rinjve që kanë shkuar në një ekspozitë në Beograd për ta përfaqësuar shtetin e Kosovës.

Desha të kërkoj një sqarim nga ministri i Jashtëm në këtë rast çfarë po bën Ministria e Jashtme për të penguar këtë fushatë të egër të shteti serb, e cila së fundmi është mobilizuar shumë. Serbia e ka filluar një fushatë lobuese për tërheqjen e njohjeve të Republikës së Kosovës nga shtete, të cilat tashmë e kanë njohur Republikën e Kosovës, ndonëse kemi pasur deklarime të qarta nga këto shtete. Besoj që ministri do të na sqarojë në ndonjërin prej seancave këtë pyetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Deliu! E keni edhe një pyetje për zotin ministër Rikalo. Ministri s'është këtu.

BLERTA DELIU-KODRA: Atëherë, po e lexoj edhe këtë pyetje. Shpresoj që ministri do të na përgjigjet. Nuk e kam parë një kohë të gjatë në seancë. Fjala është për ditët e fundit në disa prej komunave të Kosovës ka pasur reshje të mëdha, të cilat kanë shkatërruar një pjesë të madhe të kulturave bujqësore. Dëme të shumta nga breshëri ka pasur në fshatra të shumta të komunës së Skenderajt, Drenasit dhe Istogut.

Në komunat përkatëse, ndonëse është premtuar nga qeverisja lokale që do t'u ofrohet ndihmë banorëve, është thënë se nuk ka buxhet të mjaftueshëm. Besoj shumë që ministri Rikalo do të jetë në njërin prej seancave për të sqaruar se a do të ketë mundësi Ministria e Bujqësisë t'u dalë në ndihmë këtyre banorëve të këtyre fshatrave, të cilët kanë pasur dëme të mëdha ditëve të fundit.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lutfi Zharku, pyetje për ministrin Lekaj. Zoti Zharku, dëshironi ta bëni pyetjen?

LUTFI ZHARKU: Nënkryetar, kur të vijë ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Ministri s'qenka këtu.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë desha t'i bëj pyetje ministrit lidhur me menaxhimin, identifikimin, klasifikimin dhe trajtimin e mbetjeve nga produktet medicinale në institucionet shëndetësore publike dhe private.

Si trajtohen, si menaxhohen, si klasifikohen dhe si asgjësohen këto mbeturina nga produktet medicinale, të cilat radhiten në grupin e mbeturinave organike, që janë bukur të rrezikshme për mjedisin, për shëndetin në përgjithësi të qytetarëve, por edhe të cilat kontaminojnë tokën aty ku depërtojnë e që nuk mund të rikultivohet dhe mbetet e afektuar për 50 vitet të tëra.

Kërkoj që ministrat të jenë të pranishëm kur të zgjedhurit e popullit u adresojnë çështje të tilla të rëndësishme, jo vetëm për ministrin e Shëndetësisë, por për të gjithë anëtarët e Kabinetit qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rugova! Zonja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zonja Bajrami s'qenka këtu. Zonja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Meqenëse, ministri nuk është këtu i pranishëm, unë pyetjen po e lë për herën tjetër kur ai është këtu në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Siç e dini, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit. Pyetjet janë shteruar. Deputetët që s'kanë qenë këtu, as deputeti, as ministri, nuk i kam thirrur, se s'ka pasur edhe hapësirë kohore.

Para se të kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, ju lus që t'i bini ziles që të vijnë deputetët për ta votuar procesverbalin. Para se të kalojmë në pikën e tretë në emër të Qeverisë, respektivisht kryeministrit Haradinaj, zoti Reçica e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kolegë ministër,

Më lejoni që në emër të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, me mirëkuptim të kërkoj që të tërhiqet lënda projekt-platforma për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve e proceduar në Kuvend më 23 prill 2018. Krejt kjo bëhet në mënyrë që t'i japim kohë dhe hapësirë ndërtimit të një konsensusi sa më të gjerë nacional dhe vazhdimit të konsultimeve të mëtejshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është çështje e Qeverisë. Ne e kemi pritur sot të kemi debat, sidoqoftë Qeveria ka vendosur. Është e drejtë edhe me Rregullore që propozuesi mund ta tërheqë kurdo çështjen që e ka ngrehur.

Zoti Simiq e ka kërkuar fjalën lidhur me një çështje të grupit parlamentar.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani Vladin kabinetu,

Uvažene kolege narodni poslanici,

Pre nego što predložimo i usvojimo današnji dnevni red Parlamentarna grupa Srpske liste predlaže da se izmena i dopuna Zakona o verskim slobodama danas povuče iz procesa glasanja, dakle ne da se povuče iz procedura i da se vrati Vladi, već da se povuče sa današnje procedure glasanja, zato što postoji puno nejasnoća i potrebno je još konsultacija, kako bi ovako vitalan zakon za verske zajednice bio optimalan i prihvatljiv za sve.

Pozivan sve poslaničke grupe i naravno poslanike, da podrže naš predlog da se ovaj zakon povuče iz procesa glasanja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Është një kërkesë, do të thosha dhe mendoj krejt e paarsyeshme, por sidoqoftë ne duhet ta diskutojmë, është mocion për ta shtyrë për një mbledhje tjetër. Është e mundur, por për ta kthyer në Qeveri dhe për ta tërhequr, mendoj se nuk kemi as të drejtë e as mundësi ta bëjmë këtë.

Sidoqoftë, nëse dëshirojnë përfaqësuesit e partive politike të deklarohen për këtë çështje, e keni fjalën. Është paraqitur zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Për rend dite e pata. Dy pikat që janë të propozuara për interpelancë, në mungesë të kryeministrit, në emër të LDK-së kërkojmë që të zhvendosen në seancën e radhës. Pa praninë e kryeministrit nuk mendoj se interpelancat do të kenë ndonjë efekt të shqyrtimit të tyre në seancë plenare. Për këtë çështje e pata fjalën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dy mocione janë. Zonja Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Desha t'i bëj pyetje Listës serbe për çfarë paqartësish po flasin, për shkak se kemi punuar me muaj të tërë në këtë projektligj dhe jemi munduar në maksimum që të punojmë në të e të për afrohem me të gjitha amendamentet që kanë ardhur, me të gjitha propozimet. Nuk kuptoj çfarë paqartësish.

KRYESUESI: S'mund ta marr rolin e tyre, por ata kanë vërejtje që nuk i kanë shqyrtuar disa çështje dhe duan të bëjnë disa amendamente shtesë. Besoj që ne mund t'ua miratojmë këtë kërkesë të tyre, nuk na prish punë diçka, as si Parlament, as si vend, por sidoqoftë është e juaja që të vendosni.

Zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sa u përket interpelancave, pajtohem me zotin Zemaj. Besoj se siç kemi diskutuar dje, kryeministri do të jetë këtu të premtën. Është edhe një interpelancë e mbetur dhe besoj se edhe me këto dyja do të duhej bashkërisht të trijat të vendosen në rend dite për të premtën. Ma merr mendja që edhe kjo seancë do të vazhdojë sot e ndoshta edhe nesër.

Dhe e dyta, për sa i përket kërkesës së Listës serbe, ju e dini që nuk janë vetëm disa muaj, por vite që kemi diskutuar dhe është punuar në Ligjin për liritë fetare. Tashmë jemi para përfundimit dhe unë besoj që përkushtimi i secilit grup parlamentar do të duhej të ishte që të kalojë ky ligj dhe nëse sot kemi dyshime për kalimin e këtij ligji, duke pasur parasysh që bazuar në Kushtetutë i kërkon shumicën e kualifikuar, unë nuk shoh asgjë të keqe që ta shtyjme sipas kërkesës për një nga seancat e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje, jeni paraqitur.

DUDA BALJE: Faleminderit!

Unë si kryetare e grupit për të Drejtat e Njeriut, ne e kemi pasur këtë ligj në komision dhe shumë moti kemi punuar. Lista serbe ka pasur përfaqësuese zonjën Miljana dhe ka pasur 14 amendamente. Ne kemi punuar shumë, i kemi dhënë hapësirë sa kemi pasur mundësi lidhur me ligjin, kemi votuar për ligjin në tërësi në komision me shumicë votash dhe e kemi përgatitur ligjin për leximin e dytë sot këtu në seancë.

Lista serbe ka votuar kundër në komision, ata kanë pasur arsyen e vet. Tash nëse në seancë mendohet se mund ta ftojme prapë në komision, në rregull. Ne si komision kemi përfunduar me këtë punë.

KRYESUESI: Faleminderit! Sasha Milosavleviq, urdhëro!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Što se tiče interpelacije u vezi premijera mi se slažemo sa kolegom Zemajem da se to odloži za petak, pošto premijer nije tu.

A što se tiče zakona o verskoj slobodi, samo tražimo da bude odložen za neku od narednih sednica, zbog toga što mi smo usaglasili stavove oko nekih amandmana u ovom zakonu kao Srpska lista, a svi dobro znate, kolege poslanici, da ovaj zakon ne može da prođe bez podrške poslanika Srpske liste. Mi želimo da se ovaj zakon usvoji, ali kažem vam, potrebno nam je još malo vremena da usaglasimo stavove oko nekih amandmana, koji su se menjali iz dana u dan i da ne otvaram temu o tome sada. Samo bih vas zamolio da ovu tačku dnevnog reda odložimo za neku od narednih sednica kako bi usaglasili stavove oko tih amandmana i usvojili ovaj zakon,

ukoliko dođe do dogovora sa Srpskom listom i ostalih političkih partija u ovom Parlamentu. Hvala!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë mendoj që juve duhet ta keni një hapësirë kohore. Ne nuk mund ta vendosim, u nekoj drugoj sednici, siç po thoni ju, por neve na duhet një hapësirë e përshtatshme kohore, për të cilën grupi juaj i bën amendamentet dhe ato amendamente shqyrtohen në seancë.

Besoj që edhe komisioni do të jetë dakord, qoftë komisioni i ligjeve, qoftë të tjerët, që të veprojmë kështu për shkak të asaj që nuk dëshirojmë që të kemi polarizime tani për këtë çështje. Besimet janë çështje individuale të secilit dhe besoj që duhet ta bëjmë si problem ta kalojmë sa me më shumë pajtueshmëri, do të thosha, nga të gjithë, nga të gjitha komunitetet fetare, po edhe të gjithë deputetët që janë në Kuvendin e Kosovës.

Memli, e kërkove prapë fjalën? Zonja Haxhiu, ju e keni kërkuar fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, zoti kryesues!

Për dy çështje, e para për interpelancën. Lidhur me situatën në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës, që është thirrur nga Albin Kurti, i cili është deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Ne nuk pajtohemi që ta mbajmë pa qenë kryeministri i vendit këtu.

Është thënë që të premtën dhe natyrisht vazhdojmë të premtën, në qoftë se i njëjti do të përgjigjet kësaj interpelance.

Sa i përket kërkesës së Listës serbe për largim nga rendi i ditës të Projektligjit për liritë fetare, e përmendi edhe zonja Bogujevci që është edhe anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, muaj të tërë kanë punuar Komisioni për të Drejtat e Njeriut lidhur me këtë projektligj, janë bërë shumë amendamente dhe në të gjitha takimet kanë qenë përfaqësuesit e Listës Serbe, pra në grupe punuese dhe këtu po propozohet që të shtyhet, mirëpo pavarësisht se sa kohë i jepet këtij komisioni, e tha edhe kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, zonja Duda Balje, sërish ne do të ballafaqohemi me situatën të tilla, ku Lista serbe për interesat e tyre të dëmshme, do ta bllokojnë Ligjin për liritë fetare.

Prandaj, ne konsiderojmë që nuk ka asnjë arsye që ky projektligj të tërhiqet nga rendi i ditës dhe jemi që i njëjti të mbetet ashtu siç është paraparë në seancën e Kuvendit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Shala.

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Më intereson që për këtë çështje, domethënë për çështjen e Projektligjit për liritë fetare të dimë qëndrimin e Qeverisë. Në emër të grupit parlamentar ua rikujtoj që ky është një ligj që u takon fushave, që Kushtetuta jonë i quan “me rëndësi vitale” dhe që implikon komunitetet, që do të thotë më shqip, pa votën e tyre ky ligj nuk mund të miratohet. Domethënë, duhet ta kemi parasysh, nëse refuzimi jepet apriori si tani, para se të trajtohet, dihet edhe çfarë do të jetë rezultati.

Nëse ne na intereson që ligjin ta miratojmë dhe ua rikujtoj që e drejtë, ose e padrejtë, kjo është pjesë e kërkesës së procesit të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO duhet ta shohim me kujdes, por besoj që në këtë rast qëndrimi i Qeverisë si sponsor i ligjit, i Zyrës së Kryeministrit, i cilitdo përfaqësues, është tepër i rëndësishëm.

Ne si grup parlamentar nuk kemi ndonjë kundërshtim, që të punojmë edhe pak dhe të tentojmë të harmonizojmë qëndrimet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Nitaj.

**MUHARREM NITAJ:** Zoti nënkryetar i Kuvendit,

Besoj që Kujtimi i dha disa sqarime, të cilat nuk ka nevojë t’i përsëris. Çështja është shumë e thjeshtë. Nëse duam që ky ligj të kalojë, atëherë duhet të jemi fleksibil dhe t’i japim pak hapësirë Listës Serbe, në mënyrë që ajo ta japë dakordimin e vet.

Jam 100% dakord me juve, që ata duhet ta japin një kornizë kohore, se sa kohë u duhet. Nuk besoj se është në rregull, për shembull, që ata të thonë në ndonjë prej seancave të ardhshme, se kjo “në një prej seancave të ardhshme” mund të jetë edhe në disa muajt e ardhshëm, por të kërkojnë një afat kohor, në mënyrë që ne të mos mbetemi më peng i votës dhe ta kalojmë këtë ligj me shumë rëndësi.

Ndërkaq, sa u përket interpelancave unë mendoj që s’kemi nevojë fare të diskutojmë. Ka pasur një dakordim që ato të shtyhen për ditën e premte. Kemi një informatë që kryeministri do të jetë ditën e premte këtu dhe të trajtohen në ditën e caktuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sherifi.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj që këtu në kërkesën e zoti Simiq, deshëm apo s’deshëm, u tha këtu edhe nga kolegët tjerë, duhet ta kemi parasysh faktin se ky është një mocion dhe edhe nëse nuk e miratojmë duhet të fillojmë vetëm kur të vijë ajo pikë e rendit të ditës vetëm të flasim e të debatojmë për ligjin, mirëpo nuk do të arrijmë ta kalojmë, për arsye të cilat u thanë deri më tani. Duhet pasur parasysh



këtë fakt dhe atëherë është mirë të jepet edhe një afat kohor, qoftë një javë, dy javë apo në seancën e radhës, të hiqet nga kjo seancë dhe deri në seancën e radhës të kemi arritur një pajtueshmëri.

Nuk pashë këtu që u shtruan arsyet përmbajtjesore, më shumë ishin procedurale, kur të vijmë te aspektet përmbajtjesore do të shohim se cilat janë kërkesat, qoftë të pranueshme apo të papranueshme.

Unë flas në emër të Nismës, po që të jepet koha e kërkuar, nuk do të prishte punë.

Ndërsa për interpelanca tanimë është krijuar një rregull, i mirë apo i keq, kështu siç është, po që pa kryeministrin nuk po mbahen. Kështu që le të mbetet ashtu siç është krijuar, le të merren vesh me kryeministrin, kurdo që ai të jetë i gatshëm të vijë në seancë, po atë ditë të futen në rend të ditës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, kemi kuorum të mjaftueshëm, kemi 61 deputetë në sallë, 62.

Po e nxjerr në votim formal të dy çështjet.

Shtyrja e interpelancës së kryeministrit për ditën e premtë. A ka dikush kundër? Nuk ka. Konsideroj që miratohet.

Shtyrja e përkohshme deri në vendimin tjetër të Kryesisë, respektivisht të komisionit përkatës për çështjen e ngritur nga zoti Rikallo që të shtyhet për seancën e ardhshme ose të dytën më së largëti, miratimi i Ligjit për fetë.

A ka dikush kundër? Veç një votë është kundër. Miratohet.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 27 prill dhe 3 e 18 maj 2018? A ka dikush vërejtje? Po zonja Teuta, a keni vërejtje?

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit! Ligji për liritë fetare, i cili ka kaluar çdo procedurë...

**KRYESUESI:** Jo, jo, ndalu, e kemi kaluar, kemi votuar. Jo herën tjetër, kur ta miratojmë.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më datën 27 prill dhe 3 e 18 maj 2018.

Teuta, më vjen keq, po unë nuk mund të rikthehem në rend të ditës, është dashur të qëndrosh në sallë e të kërkosh fjalën. Ti erdhe me vrap. Jo, jo, të ndalet fjala, për atë punë unë jam këtu.

Shkojmë në pauzë deri në orën 15:30.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Faleminderit!

Mendoj që është koha të fillojë seanca.

Po kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës**

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projekt-kodin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Më vjen pak keq që një prej projekteve më të rëndësishme të mia po e prezantoj para kaq pak deputetëve, po besoj që na bashkëngjiten.

Pa dyshim se është momenti i veçantë për mua si ministër i Drejtësisë që sot ta prezantoj para jush për miratim në lexim të parë Projekt-kodin Penal, një prej akteve më të rëndësishme legjislative, jo vetëm për ne si institucione, por edhe për vetë sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Sot pushteti ynë, në fakt, është pak juridik i njohur ndërkombëtarisht për çfarë kanë meritë të gjithë pa përjashtim, Kosova ka nevojë të përmbyllë një kapitull të rëndësishëm, e që është

nevoja për forcimin e një doktrine të një shteti të fortë dhe funksional, formula e të cilit qëndron në sundimin e ligjit si e vetmja bazë dhe pa alternativë në legjitimitetin e pushtetit, e normave të pranuar nga shoqëria dhe barazisë kuptimplote mes qytetarëve të Republikës sonë.

Prandaj, për ne gjeneratë e politikanëve që bartin pushtetin e deleguar nga qytetarët, qofshin legjislativi apo ekzekutiv, është detyrë për të mundur një bazë të tillë ligjore që fuqizon sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Përcaktimi për drejtësi penale nuk është përcaktim i lehtë, sepse drejtësia është edhe shpërblim, po edhe ndëshkim.

Debatet që përpiqen të definojnë se ku fillon liria dhe deri ku ajo ndeshet me përgjegjësinë, janë debate me pasione të mëdha që kanë përcjellë shoqëri të ndryshme si në rrafshin politik, juridik dhe atë filozofik.

Megjithatë, ky bëhet e lehtë kur kemi orientime të qarta në kohë dhe hapësirë dhe kur bazohemi në kritere të definuara.

Të nderuar deputetë,  
Hartimi i këtij kodi është bërë pikërisht mbi këto dy aspekte.

Në rrafshin e kritereve të definuara dhe orientimeve të qarta, jemi përpjekur dhe ia kemi arritur të prodhojmë një Kod Penal bashkëkohor që jep karakter të mirëfilltë të sistemit të drejtësisë, që është në përputhje të plotë me standarde të Bashkimit Evropian, që synon mbrojtjen e jetës, pronës dhe lirisë së qytetarit, që rrit sigurinë juridike të qytetarëve, që mundëson luftim efikas të korrupsionit dhe krimit të organizuar, që mundëson efikasitet të punës së organeve të pavarura të zbatimit të ligjit dhe që i jep filozofinë e mirëfilltë shtetit ligjor.

Jam i bindur se me ndryshimet e propozuara po vendosim bashkërisht tiparet e një drejtësie që i mundëson Republikës sonë klasifikimin si shtet që ka të sigurt zhvillimin, progresin dhe të ardhmen brenda një rendi kushtetues, si garanci e drejtpërdrejtë për qytetarët tanë.

Meqenëse hartimi i politikave legjislative të drejtësisë, respektivisht politikave penale të nivelit shtetëror janë përgjegjësi e ministrisë që unë e drejtoj, me sinjeritetin më të madh po ju them se nga ditët e para të punës time, duke pasur parasysh nevojën që politika penale të rishikohen për të adresuar sfidat e ndryshme të identifikuar nga zbatimi i ligjeve, domosdoshmëria e avancimit të standardeve të politikave penale si dhe harmonizimin e tyre me praktika më të mira ndërkombëtare, personalisht i kam marrë dhe i kam ndjekur me vëmendje dhe jam angazhuar me të gjitha ekipet punuese në hartimin dhe përpilimin e këtij projekt-kodi.

Duke e marrë për shkas nga fenomene të ndryshme, si dhuna në familje, vrasjet me motive të ndryshme, si dhe për aspektet që tashmë i kemi bërë të njohura për publikun, që lidhen me luftën e kundër korrupsionit dhe veprave që lidhen si keqpërdorimi i pozitës zyrtare, marrja ose dhënia e ryshfetit apo krimit të organizuar, vepra që lidhen me terrorizëm, kemi propozuar rishikimin e neneve që sot janë para jush për miratim.

Të nderuar deputetë,

Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës është hartuar në përputhje me standardet evropiane. I konfirmuar tashmë si përmbajtje edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë, edhe nga partnerët tanë zhvillimorë, si Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID dhe si e tillë shënon një hap përpara në reformimin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i këtij kodi është shprehje e respektimit dhe një konglomerat i pjesëmarrjes nga shoqëria civile, komunitetit të juristëve, sociologëve dhe grupeve të ndryshme. Po ashtu edhe nga kategori të caktuara të shoqërisë sonë, sepse e them me përgjegjësi të plotë se hartimi i tij është një nga proceset më demokratike, profesionale dhe gjithëpërfshirëse që ka karakterizuar ndonjë ligj në Republikën tonë.

Për muaj të tërë, përveç institucioneve të fushës së drejtësisë, kjo përbërje e gjerë e kanë shqyrtuar dhe kanë shkëmbyer ide mbi ndryshimin e 100 neneve të këtij kodi. Në rrafshin e politikës publike që përfaqësojmë ne si institucione kanë qenë tri parime themelore që kanë diktuar punën në hartimin e këtyre ndryshimeve.

E para, përcaktimi i qartë për sundim të mirë të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

E dyta, fleksibilitet më i madh në punë të organeve të pavarura të zbatimit të ligjit, dhe

E treta, mbrojtje, promovim dhe avancim i të drejtave të njeriut.

Kompletimi i këtij kodi praqet hap jashtëzakonisht të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Republikën tonë, që të mundësojmë punë më efikase në zbatimin më rigoroz të standardeve të drejtësisë si dhe intensifikimin e përpjekjeve tona si institucione në një dimension tërësisht të ri, që në mes të tjerash, përveç që siguron sundim efikas të ligjit për qytetarët tanë, forcon dhe garanton perspektivën evropiane të Republikës sonë.

Në rrafshin konkret segmentet kryesore të rishikuara në Kodin Penal janë si në vijim:

Në vepra që hyjnë në kuadër të krimit të organizuar dhe të korrupsionit janë rishikuar dhe hartuar 19 nene, për të mundësuar kështu ndjekje efektive të aktiviteteve kriminale që ndodhin në kontekstin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Këto nene mbulojnë një serë aktivitetes, nga kontrabandimi, deri te mashtrimi dhe prodhimi i produkteve të dëmshme si dhe ripërcaktimin e veprave penale të korrupsionit, keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar.

Marrjen dhe dhënien e ryshfetit, mashtrimin në detyrë, duke u dhënë një përgjigje të fuqishme kërkesave për parandalim të veprave korruptive në nivelin e ushtrimit të detyrës zyrtare.

Ndryshimet po ashtu kanë rritur afatet e parashkrimit për këto vepra, duke ofruar kështu një avancim dhe vendosmëri për t'u ofruar zgjidhje edhe për këto probleme që shpeshherë më të drejtë kanë qenë subjekt i kritikës si nga ju, të dashur deputetë, ashtu edhe nga shoqëria civile.

Po ashtu në kuadër të përmbushjes së Agjendës së Reformave Evropiane, ku është rekomanduar hartimi i politikës së suspendimit të zyrtarëve të lartë publikë në rast të ngritjes së aktakuzës, ne kemi hartuar një koncept-dokument, rekomandimet e të cilit po ashtu janë të përfshira në këtë kod.

Rrjedhimisht janë propozuar amendamente të reja që i ndalojnë personit zyrtar ushtrimin e funksionit në administratën publike apo në shërbim publik deri në 10 vjet nga aktgjykimi dënues.

Kjo dispozitë parasheh që kur zyrtari publik të dënohet për vepër penale të korrupsionit, atij t'i ndalohet ushtrimi i funksionit në shërbimin publik deri në 10 vjet.

Dënimet për vepra penale që ndërlidhen me korrupsion, kudo që ka pasur mundësi, janë rritur dhe janë bërë komulative, në vend se atyre alternative. Këto masa janë përkushtim konkret yni për mbrojtjen e integritetit të institucioneve tona për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në mënyrë të vazhdueshme dhe të pakompromis.

Ashpërsimi i dënimeve për këto vepra është mirëpritura dhe është në funksion të parandalimit të fenomeneve shqetësuese që kanë qenë të përhapura në shoqërinë tonë dhe të cilat pa dyshim që duhet t'u japim fund.

Janë prezantuar ndryshme konkrete që ndërlidhen me aspektin e shmangies nga tatimi, shmangies nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, veprave penale që lidhen me produkte me akcizë, veprave penale të pastrimit të parave, veprave penale për keqpërdorim të subvencioneve dhe donacioneve, trajtimi i të cilave do t'u japin një dimension tjetër përpjekjeve institucionale që ndërlidhen me to.

Gjithashtu janë hartuar nene të reja që trajtojnë mbrojtjen e grave dhe dhunën brenda marrëdhënies familjare si dhe në kuadër të ngacmimit seksual.

Të nderuar deputetë,

Po ashtu janë rritur edhe dënimet për kryesit e veprave penale të përfshira në vepra penale të trafikimit në njerëz për shfrytëzim seksual dhe janë rritur dënimet për veprat penale kundër fëmijëve dhe viktimave të cënueshme.

Një kontest i ri dhe i nevojshëm, përkatësisht vepra që ndërlidhen me parandalimin e luftimit të terrorizmit, po ashtu janë hartuar dhe ndryshuar mbi 20 nene që kanë të bëjnë me terrorizmin, duke qenë në pajtim të plotë me direktivat e fundit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare që ndërlidhen me fushën e financimit të terrorizmit, në atë mënyrë që të spastrojë rrugën për ndjekje penale të atyre që janë përfshirë në këto aktivitete.

Të nderuar deputetë,

Në fund konsideroj se ky akt, me të gjitha analizat, komentet, gjithëpërfshirjen dhe transparencën që e kanë karakterizuar, paraqet akt të konsoliduar dhe progresiv që, në njërën anë, adreson zgjidhjen e shumë problemeve konkrete, me të cilat përballet shoqëria jonë, ndërsa në anën tjetër, shënon një progres të lartë në sistemin tonë të drejtësisë.

Prandaj, si ministër i Drejtësisë kërkoj mbështetjen tuaj të plotë në miratimin në parim të këtij kodit, sepse miratimi i tij është rruga e fuqizimit të sundimit të ligjit, procesit integruar me Bashkimin Evropian dhe vulos lëvizjen e lirë të qytetarëve si dhe, me e rëndësishmja u mundëson qytetarëve tanë mbrojtje dhe siguri juridike.

Jam i bindur se vota juaj për këto ndryshme do të mbahet në mend si referencë e përkushtimit tuaj të mirëfilltë për një shtet ligjor e funksional, që është kërkesë dhe plotësim i aspiratave politike, civile, juridike për të gjithë qytetarët e Republikës sonë pa dallim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër Tahiri!

Tani ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Albulena Haxhiu, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Para se të dal te rekomandimi i komisionit, po të dëgjohet ministri ta merr mendja që pas miratimi të këtij Kodi Penal në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nuk do të ketë më zyrtarë që keqpërdorin detyrën zyrtare.

Po natyrisht që për çështje që lidhen me këtë unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar pastaj, kur të më vijë radha.

Tani po flas vetëm për rekomandimin e Komisionit për Legjislacion.

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 21. 5. 2018 e shqyrtoi Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### Re k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës numër 06 L-074.

Pra, në emër të Komisionit për Legjislacion ne kërkojmë që i njëjti të përkrahet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së, zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

**KORAB SEJDIU:** Të nderuar qytetarë,

Kolegë të nderuar,

Ministër, mirë bëre që e bëre një kritikë, veç duhet të ta kthej e të them që duhet të çohemi e t'ju flasim për së dyti kur po ju shohim Kabinetin qeveritar, se jeni bërë jabanxhi këtu, po kritikë me vend, në dy anët.

Sa i përket Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës, është e vërtetë që edhe mua m' u hidh të lëviz nga vendi kur foli ministri, shpresojmë që do t'i adresojë këto probleme të mëdha me të cilat po ballafaqohet shoqëria jonë, po shpresoj që edhe njerëzit që e zbatojnë këtë kod, kurdo që aprovohet, fillojnë ta kryejnë punën e tyre, po sido qoftë, në parim grupi ynë parlamentar e përkrah këtë projekt-kod. Natyrisht kritikën dhe propozimet tona për përmirësim do t'i japim në komision dhe në grupe punuese, por edhe nëpërmjet amendamenteve të ndryshme.

Mirëpo, duhet theksuar një çështje të rëndësishme, sepse ka ardhur një kërkesë për trajtim me urgjencë të këtij projekt-kodi. Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka ky projekt-kod, normalisht do të shndërrohet në Kod Penal, veçanërisht në ndërlidhje me të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, unë besoj që kërkesa për trajtim kaq të shpejtë, ndoshta më të shpejtë është në rregull, po trajtimi i këtij projekt-kodi brenda dy javësh siç është propozuar një herë, nuk besoj që është i arsyeshëm, sepse vërtet kërkohet që edhe ne ta nënshtrojmë këtë projekt-kod ndaj një mbikëqyrjeje dhe ndaj një shqyrtimi serioz, që natyrisht merr kohë, duke e pasur parasysh faktin që është goxha voluminoz.

Kështu që kërkojmë mirëkuptim që edhe ne t'ia bëjmë, si të themi, punën e duhur edhe t'i japim seriozitetin e duhur këtij projekt-kodi, me ç'rast sot e votojmë në parim, dhe natyrisht nëse ka diçka që dëshirojmë ta përmirësojmë, e besoj që ka disa pika, atëherë i propozojmë në vendet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, zoti Haliti!

Të nderuar ministra,

Ministër Tahiri, ministër Hamza,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Edhe në komision e kemi shqyrtuar Kodin Penal të sponsoruar nga Ministria e Drejtësisë, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës, të njëjtën kohë edhe si grup parlamentar e kemi shqyrtuar dhe konsiderojmë që në parim ky kod i plotëson të gjitha kushtet për të shkuar tutje.

Kurse, e tha edhe ministri, e shpjegoi shumë mirë që ka shumë çështje që adresohen për herë të parë me këtë Kod Penal. Vlen të theksohet që mbi të gjitha u bë edhe një unifikim i plotësim-ndryshimeve të mëhershme që kanë ndodhur edhe në vitin 2004, po edhe më vonë dhe mendoj që është një ndër aktet më të mira që ndikojnë në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar në vend.

Andaj, ne si deputetë të Partisë Demokratike, po edhe si deputetë në përgjithësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës do t'i japim vërejtjet apo sugjerimet tona nëpërmjet amendamenteve ndërmjet dy leximeve, do të punojmë dhe si komision nëpërmjet grupit punues, por edhe si deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, edhe një herë!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe më lejoni që fillimisht t'i them disa sqarime lidhur me kërkesat që ky projekt-kod të trajtohet me procedura të përshpejtuara.

Unë pajtohem plotësisht me deputetin Sejdiu, kur thotë që ky është një ndër projektligjet apo ligjet më të rëndësishme të Republikës së Kosovës, andaj edhe gjatë trajtimit të tij duhet të kemi si komision kohë të mjaftueshme për ta trajtuar në mënyrë që t'i eliminojmë të gjitha pengesat, të cilat janë në këtë draft-kod penal.

Edhe duke marrë parasysh faktin që edhe në Komision për Legjislacion atë ditë ka qenë debati që shumë prej neneve të këtij draft-kodi kanë gabime gjuhësore, të cilat pastaj i japin krejt kuptim ndryshe një neni të caktuar apo shumë neneve të caktuara përbrenda këtij dokumenti.



Por, edhe atë ditë kur e kemi trajtuar në Komision për Legjislacion ka qenë i pranishëm ministri i Drejtësisë aty dhe na është thënë që kanë probleme me përkthyesit, andaj edhe neve na mbetet si Komision për Legjislacion që kudo që kemi gabime apo hasim në gabime që e ndryshojnë komplet kuptimin e një neni, duhet të ndërhyjmë me amendamente, sepse s'kemi mundësi tjetër.

Na është thënë që ky Kod Penal duhet trajtuar në mënyrë të përsheptuar për shkak se lidhet me liberalizimin e vizave, nuk di edhe sa dokumente të tjera do të na dalin tash rrugës që po lidhen me liberalizimin e vizave. Mirëpo unë do të mundohem që brenda kësaj periudhe të trajtoj disa nga problemet që kanë të bëjnë me këtë dokument.

Së pari dëgjova me vëmendje ministrin e Drejtësisë, edhe në kohën kur ky dokument është proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës kam menduar apo si grup parlamentar, në fakt, kemi menduar që ka më shumë ndryshime, por që ajo çfarë kemi bërë ne është që e kemi bërë një analizë lidhur me kodin që është në fuqi, pra Kodin Penal që është në fuqi me këtë draft-kod që na është sjellë.

Ministri i Drejtësisë tha që ka pasur ndërhyrje në 100 nene, mirëpo unë sinqerisht e ftoj ministrin e Drejtësisë që të na tregojë një nga një se cilat janë ato 100 ndryshime, për faktin se neve po na dalin vetëm 30. Besoni që unë e kam analizuar kodin që është në fuqi me draftin që na është propozuar dhe s'po dalin më shumë se 30.

Këtu përfshihen edhe plotësime, në fakt riformulime të neneve. Unë e kuptoj që në disa kapituj të veprave penale, si vepra penale kundër jetës dhe trupit, ka pasur avancim dhe këtë e mbështetim fuqishëm, por unë po flas specifikisht për rastet e keqpërdorimeve kundër detyrës zyrtare, mirëpo do të ndalem më vonë te ato. Ministria e Drejtësisë nuk ka ndërhyrë në nenet që janë në fuqi, domethënë që kanë qenë konfuzë për institucionet e drejtësisë dhe që kanë lënë hapësirë interpretimi, por edhe nene që kanë qenë gabimisht të riformuluara. Për shembull, në nenin 1 të këtij draft-kodi thuhet se mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk mund të realizohet pa dhunën penalo-juridike. Nuk e di që ndonjëri prej deputetëve këtu apo ministri e kupton këtë riformulim, për shkak se shprehja “dhunë penalo-juridike” nuk është adekuate, sepse s'ka dhunë penalo-juridike në kuptimin e këtij neni.

Pastaj për çështjen e shqiptimit të një dënimi më të lehtë janë përdorur fjalë të ndryshme, si për shembull në paragrafin 3 të nenit 12, përdoret fjala që “kryerësi mund të dënohet më lehtë”, ndërsa në paragrafin 3 të nenit 13 përdoret termi që “kryerësi mund të dënohet më butë”, pak më poshtë thuhet “mund të zbutet”. Pra do të duhej që të kishim një standard në të gjitha nenet kur e kemi kuptimin e njëjtë, domethënë për adresime varësisht se si është situata. Pastaj, te neni 70 nënparagrafi 3.11. si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimeve parashihet edhe

keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar. Pra, gjykata mund ta zbusë dënimin nëse e sheh që ka keqardhje të shfaqur nga personi i dënuar.

Besoni që kjo shumë herë po keqpërdoret nga institucionet e drejtësisë, për shembull dhe sidomos në rastet e dhunës ndaj grave për të cilat nënkryetarja jonë zonja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku do të flasë më tepër, por pikërisht kjo rrethanë po merret parasysh që pastaj kryerësve të veprave penale, sidomos për vrasjet ndaj grave, gjyqtari po thotë që është penduar apo ka shfaqur keqardhje që e ka vrarë gruan. Pra, unë besoj që ne nuk duhet të lejojmë riformulime të tilla, të cilat padrejtësisht dhe për shkak të mentalitetit patriarkal po keqpërdoren nga institucionet e drejtësisë. Po ndalem edhe te neni 62, paragrafi 3, që e përmendi edhe ministri i Drejtësisë, thuhet që “gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksioneve të shërbimeve publike prej një deri në dhjetë vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat e kapitullit 33”, pra që lidhet me korrupsionin zyrtar dhe veprat kundër detyrës zyrtare.

Problemin që ne e kemi në Kosovë është se të korruptuarit s’po dënohen dhe çka të bëjmë ne që t’i dënojmë të korruptuarit, ata të cilët kanë krijuar pasuri të pajustificueshme? Unë po e kuptoj, në rregull, sa i përket Kodit Penal është në rregull, pas dënimit 1 deri 10 vjet gjykata mund ta ndalojë që ta mbajë një post publik zyrtarin e korruptuar, por qysh t’ia bëjmë që t’i çojmë në burg këta që e kanë keqpërdorur pasurinë publike. Vetëm mendoni se kush nga zyrtarët e lartë, ndonëse kanë krijuar sot pasuri të pajustificueshme është duke e vuajtur dënimin me burg po flas, të mos flasim për dënime qesharake me kusht apo me gjobë për rastet e korrupsionit, por kush nga zyrtarët e lartë sot është në burg për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtare? Pra, ne e kemi problemin që s’po dënohen dhe duhet ta adresojmë këtë problem. Ndonëse, natyrisht me riformulim të tillë sa i përket Kodit Penal, është në rregull.

Pastaj, parashkrimi. Ka pasur kritika nga shoqëria civile këtu, janë ngritur vitet sa i përket parashkrimit, por nga shoqëria civile ka pasur kritika që kjo po duket si tendencë e amnistisë së prokurorëve, të cilët nuk e kanë guximin që të merren me rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, e përfundojnë me raste të parashkrimit të veprave penale kundër korrupsionit, gjyqtarëve, prokurorëve. Dhe, mendoj që në qoftë se mbetet kështu siç e ka propozuar Ministria e Drejtësisë, atëherë duhet ta kemi edhe një mekanizëm tjetër kur parashkruhen veprat penale, sidomos këto të korrupsionit, gjyqtarëve, prokurorëve, atëherë ata duhet të japin përgjegjësi, pse i është parashkruar vepra penale? Për shkak se është e qartë, vepra penale të korrupsionit parashkruhen qëllimshëm, domethënë i lënë aty, s’i prekin për shkak se nuk guxojnë, thjesht për shkak se sistemi i drejtësisë është i kapur dhe ka shumë probleme në këtë drejtim.

Edhe një herë, mendoj që Kosova nuk mund ta luftojë korrupsionin kështu. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit bëhet vetëm atëherë kur ekziston vullneti politik. Ne si grup parlamentar nuk kemi parë vullnet politik nga Qeveria aktuale për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Unë pak më herët e mora një përfundim të Kryesisë së Kuvendit, ku thuhet që ngarkohet Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia

paraqesë raportin. Është fjala për Projektligjin për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme. Pra, kjo është nismë e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe do të jetë si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të Komisionit për Legjislacion, përkatësisht në javën e ardhshme dhe unë besoj që ky është projektligji i cili përnjëmend i çon në burg politikanët apo zyrtarët e korruptuar, sepse barra e provës vendoset te personi i dyshuar dhe jo te prokurori, sepse rregullimi aktual ka dështuar dhe meqë ka dështuar për vite me radhë, sidomos këto vitet pas shpalljes së pavarësisë, andaj ne duhet të bëjmë mekanizma të tjerë që kanë për qëllim luftimin efikas të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Pra, kjo është nisma e cila përnjëmend e lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin. Po ashtu, është kërkesë e shoqërisë civile që të parashihet edhe një vepër penale që ka të bëjë me mashtrimin në prokurimin publik. Unë kam dëgjuar që edhe Ministrisë së Drejtësisë i ka shkuar kjo kërkesë, mirëpo këtu nuk është paraparë si vepër e veçantë penale. Po ashtu, neni 92 thotë “konfiskimi i instrumentalitetit”. Nuk e di çka keni dashur të thoni, ministër, ju lutem na njoftoni për shkak se për mua është goxha e paqartë, nuk e kuptoj se çka keni menduar. Në parim, si grup parlamentar, meqë nuk kam shumë minuta, sepse ka edhe shumë çështje tjera, por do t’i mbulojnë deputetët tjerë të Vetëvendosjes, ne do ta përkrahim, mirëpo natyrisht gjatë fazave të grupeve punuese do t’i adresojmë të gjitha shqetësimet dhe vërejtjet tona. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën për të sqaruar.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** E nderuar deputete Haxhiu, Unë më 13 prill e kam propozuar, është votuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës Projekt-kodi Penal dhe pse janë dashur tre muaj që të zvarritet ky proces dhe të mos diskutohet menjëherë në atë kohë kur ka ardhur, unë nuk e di, mirëpo me siguri është procedura e Kuvendit, Sekretaria e di pse ka ndodhur një gjë e tillë. Pra, po bëhen tash 3 muaj, më 13 të këtij muaji bëhen tre muaj që e kam dërguar në Kuvend dhe, tash së fundi, pra para tri javëve e kam dërguar një letër në të cilën kam kërkuar që të trajtohet me urgjencë, sepse nenet që i kemi trajtuar, që ndërlidhen me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë qenë të gjetura nga Raporti i Progresit i vitit 2016 dhe, rrjedhimisht, lidhen edhe me liberalizimin e vizave në Republikën e Kosovës.

Ka qenë kërkesë e Komisionit Evropian që këto të rishikohen. Pra, si ministër, kam qenë në kohë kur e kemi dërguar në Kuvend, mirëpo ndoshta për shkak të procedurave është vonuar dhe tre muaj nuk është diskutuar. Një pjesë e mirë e neneve që ju i përmendët, ato nuk janë prekur fare, pra qysh kanë qenë nga Kodi i kaluar dhe ne i kemi trajtuar të gjitha të gjeturat që dalin nga Raporti i Progresit dhe që kanë qenë edhe kërkesë e Bashkimit Evropian. Pa dyshim që pa miratimin e Kodit të Procedurës Penale, pa miratimin e Ligjit për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë, edhe kjo s’do të ketë kurrfarë vlere. Mirëpo, tash jemi duke punuar me intensitet të shtuar dhe shumë shpejt do ta përfundojmë Kodin e Procedurës Penale që do ta sjellim në Kuvend. Jam zotuar që në fillim të javës së ardhshme ta miratojmë në Qeveri

Projektligjin për konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe edhe projektligjet që do të vijjnë për deklarim të pasurisë dhe për Agjencinë Kundër Korrupsionit, unë besoj që do ta fuqizojnë, e kjo e tregon vullnetin tonë politik për fuqizimin dhe për krijimin e bazës ligjore në të njëjtën anë dhe fuqizimin e institucioneve që e zbatojnë ligjin në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Dhe, unë po them që do ta sjell edhe memorandumimin shpjegues, nuk e di pse nuk e keni marrë, pse s'e kanë sjellë, sepse janë rishikuar 100 nene, që është bërë në bashkëpunim edhe me ekspertë nga Komisioni Evropian, edhe nga USAID-i.

Pra, i kemi më shumë se 80 ekspertë që kanë punuar për pothuajse një vit në këtë Projekt-kod Penal që sot po e shqyrtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Bën, pasi po do replikë!

ALBULENA HAXHIU: Jo "bën se pasi po do", por bën për shkak se ma lejon Rregullorja e Kuvendit kur i referohet diskutimit apo emrin e deputetit.

KRYESUESI: Jo, Rregullorja s'ta lejon hiç. Në këtë rast nuk ta lejon!

ALBULENA HAXHIU: Rregullorja e lejon të replikoj, për atë arsye po e marr fjalën. Vetëm një sqarim, para se ky Projekt-kod t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit ka pasur akuza, duke thënë që deputetja Haxhiu po e vonon shqyrtimin e Projekt-kodit Penal dhe kjo nuk qëndron, dhe mirë që është edhe sekretari i Kuvendit këtu, për faktin se nuk e di se çka ka ndodhur që Projekt-kodi Penal në momentin kur është miratuar në Qeveri nuk u është shpërndarë deputetëve. E di që ka pasur një periudhë të gjatë, ndoshta dy javë e gjysmë apo tri, mirëpo nuk e di arsyen, ndoshta për shkak të përkthimeve apo shumëzimeve, nuk i di arsyet, është Sekretaria.

Në momentin kur jemi ngarkuar si komision, unë e kam ftuar dhe atë në mënyrë urgjente mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, janë këtu anëtarët e Komisionit. E kemi shqyrtuar të hënën, ndonëse mbledhjet e komisionit janë të martave, dhe për ta përshpejtuar e kemi shqyrtuar shumë më herët dhe tash është vonuar edhe në Kryesinë e Kuvendit për ta trajtuar sot këtu.

Edhe sa i përket Projektligjit për konfiskimin e pasurisë, ministër, nuk e di se çka përmban projektligji që ju e keni draftuar. Nuk e di. Mirëpo, nisma që e ka propozuar Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është e jashtëzakonshme, madje ne kemi pasur tri tryeza në raport me këtë projektligj, edhe nga shoqëria civile, edhe nga prokurorë dhe gjyqtarë, që kanë qenë të pranishëm, dhe të njëjtit e mbështesin këtë projektligj. Prandaj, unë u kam thënë edhe në komision mos u lodhni të bëni dokumente tjera, kur kjo është adekuate, por s'e di pse s'po ju përshtatet dhe nuk e di ku e keni problemin që po e bëni një tjetër projektligj që s'dihet se çka adreson. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, veç desha një sqarim. Ju kisha lutur që t'i respektojmë rregullat. Nuk është e thënë çdoherë të diskutohet, secili deputet i ka 10 minuta kohë për të diskutuar për ligjin, e ministri që ta prezantojë ligjin dhe të na lusë, kërkon që ta votojmë, ose të mos e votojmë ligjin. Unë nuk po e kuptoj pse duhet debatuar dhe të merremi me këso debatesh kot. Zoti ministër, e ke fjalën për kundër-replikë, dhe e mbyllim, më s'ka replika. Të gjithë diskutoni dhe në fund ministri le t'i mbledhë argumentet e veta dhe e merr fjalën derisa t'i kryejë.

Fjalën e ka ministri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar zonja deputete, Mua nuk më është tekur të bëj ligj, është në planin e punës, që e kam përgatitur para 9 muaj kur jam emëruar ministër i Drejtësisë. E kam pasur në plan hartimin e Projektligjit për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë, pra që mundëson efikasitet më të madh në konfiskimin e aseteve kriminale të fituara me vepër të paligjshme, ose me vepër penale. Kjo është në planin e punës. Kur i ke organizuar ato debate, është dashur të më thërrasësh edhe mua si ministër, që ta shprehja edhe perspektivën tonë, sepse për këtë projektligj unë kam kërkuar ndihmë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga Komisioni Evropian, nga ekspertë britanikë që e kanë bazën më të avancuar në Bashkimin Evropian, janë edhe pak ditë në BE, dhe ky nuk është thjesht produkt i ekspertëve tanë vendorë. I kemi marrë praktikat më të mira dhe unë po them e po zotohem që është në përputhje të plotë me gjithë legjislacionin penal që ne do ta sjellim gjatë këtij viti në Kuvendin e Kosovës.

Pra, është dashur të na thërrasësh edhe ne si ministri, qoftë Zyrën Ligjore...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Vazhdoja fjalën! A përfundove fjalën, ministër? Në rregull! Jo, e përfundoi. Fjalën e ka zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, ne në parim e mbështetim Projekt-kodin Penal. Natyrisht i mirëpresim të gjitha ndryshimet që janë propozuar, sidomos ato që kanë të bëjnë me shtrëngimin e masave për zyrtarët që e keqpërdorin pozitën e tyre zyrtare. Megjithatë, ministër, ndoshta do të ishte më mirë nëse projektligjet të cilat janë ngushtë të lidhura me njëra-tjetrën, sidomos Projektligji i Kodit Penal dhe ai i Procedurës Penale të procedoheshin në pako, sepse do të ishte më i lehtë edhe shqyrtimi pasi që, siç thashë, njëra e ndikon edhe tjetrën, por ne javën e kaluar më duket e miratuar një rezolutë, në të cilën një ndër rekomandimet kryesore është që të përshpejtohen ligjet që kanë të bëjnë me shtrëngimin e masave për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Unë shpresoj dhe ju bëj thirrje në këtë rast që t'i përmbaheni edhe asaj rezolute dhe sa më shpejt të na i procedoni dhe projektligjet, disa prej të cilave ju veç i përmendët tani, në mënyrë që korrupsionin ta bëjmë problem që ne si shoqëri duhet luftuar, e jo thjesht se atë po e na e kërkon Komisioni Evropian në këtë kohë për t'i liberalizuar vizat, por të jetë qëllimi ynë edhe si shoqëri, jo vetëm si Kuvend dhe institucione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë.

Të nderuar ministra,

Duke e ditur rëndësinë e Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës, ne jemi të interesuar që të del një projekt-kod dhe me angazhimin tonë në komisione vërtet ta nxjerrim një ligj i cili zbatohet në Republikën e Kosovës dhe më shumë sesa në hartimin e tij jemi të interesuar që të ketë zbatim në mënyrë që ligjet në Kosovë vërtet të fillojnë të implementohen ashtu si duhet dhe të mos lejojmë që vazhdimisht të flitet për moszbatim, e sidomos kur kemi të bëjmë me Kodin Penal.

Prandaj, ne e përkrahim në parim dhe do të punojmë që të bëhet një Kod Penal për Republikën e Kosovës, i cili vërtet do të jetë funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

MILAIM ZEKA: Jo, kryesues, unë nuk kam në emër të Nismës, por në emër tim personal, kur të më vijë radha.

KRYESUESI: Kur të vijë radha, në rregull! Lista serbe, s'është. Nga 6+, e do fjalën dikush? Zoti Kinolli, urdhëro!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar 6+ e kemi shqyrtuar Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe jemi të interesuar që ta mbështetim në parim, ndërsa kontributin tonë do të japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kam dy pyetje për ministrin e Drejtësisë. E para ka të bëjë me nenin 248 të Projekt-kodit Penal, që ka të bëjë me dhunën në familje. Nga kontaktet tona me përfaqësues të shoqërisë civile, por edhe me përfaqësues të Prokurorisë dhe të tjerë që merren çdo ditë me raste të dhunës në familje, përfshirë edhe ato që kanë rezultuar me vrasje, siç e përmendën disa nga kolegët, del që ka pakënaqësi të mëdha me mënyrën sesi është hartuar ky nen.

E para, për shkak se është shumë i ngushtë, ajo që kemi pritur është që të jetë një kapitull që merret me këtë stemë dhe jo vetëm një nen, i cili e definon dhunën në familje. Dhe, e dyta, që të jetë në përputhshmëri të plotë me Ligjin për parandalimin e dhunës në familje, gjë që nuk është. Për mua, në aspektin juridik është një shqetësim specifik, në definicion thotë që “kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda marrëdhënies familjare dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”. Përtej shqetësimit për dënimet me gjobë dhe praktikën e këqija që janë ndërtuar, në qoftë se dikush thotë që është penduar e tjera, kryesisht shkohet me këto dënime, shqetësimi themelor është te kjo pjesa ku thuhet “me qëllim të cenimit të dinjitetit”. Pra, patjetër duhet të dëshmohet nga viktimat në këtë rast, apo nga Prokuroria që ka pasur qëllim të caktuar për ta cenuar dinjitetin e tjetrit kur ka ndodhur dhuna. Tash kjo është njëfarë barre goxha e rëndë, edhe për prokurorin, sepse kur një person ushtron dhunë ndaj tjetrit brenda raportit familjar, tek e fundit, më aty nuk ka kurrfarë rëndësie qëllimi, e as arsyeje, sepse dhuna është e paarsyeshme. Nuk arsyetohet me një fjalë.

Kështu që duhet hequr komplet këtë pjesë, ku duhet të dëshmohet qëllimi për t’ia cenuar dinjitetin tjetrit. Ne i kemi parë edhe mendimet e Gjykatës Kushtetuese, kur e kanë interpretuar konceptin e dinjitetit të njeriut se çfarë koncepti i gjerë është ky. Kështu që me rëndësi këtu është të dëshmohet që ka ndodhur dhuna, e jo me çfarë qëllimi ka ndodhur, apo me çfarë arsye ka ndodhur, apo çka e ka shtyrë deri te ajo dhunë. Ato natyrisht mund të merren në raste të caktuara si rrethana lehtësuese, mirëpo jo si parakusht për të dëshmuar që personi i caktuar është fajtor që e ka kryer dhunën.

Kështu që ju lus që t’i merrni parasysh këto vërejtje, e unë shpresoj që do të bashkëpunojmë me Komisionin për Legjislacion, por dhe me përfaqësues të shoqatave për barazi gjinore që të mbetet, jo vetëm një nen, por ta kemi një kapitull të tërë që merret me rastet e dhunës në familje, gjë që do të ndihmojë dhe në reduktimin, por edhe në çrrënjosjen totale të fenomeneve të tilla negative dhe të tmerrshme në shoqërinë tonë.

E dyta, më intereson, sepse nuk arrita ta ndjek prezantimin tuaj nga fillimi, mirëpo duke ju dëgjuar tani në përgjigjen dhënë zonjës Haxhiu, kur thoni që këto kryesisht janë produkte të ekspertëve të huaj dhe jo vendorë, më intereson ta di sa ka qenë roli i gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me çështje penale në procesin e hartimit, dhe sidomos në draftin final, sepse nganjëherë janë në fillim të procesit, por në fund drafti final nuk është ajo në të cilin ata

kontribuojnë. Unë personalisht kam diskutuar me një sërë prej tyre dhe kanë vërejtje në dispozita të caktuara, sepse thonë që janë të paimplementueshme në praktikë dhe po flas këtu edhe për gjyqtarë të Gjykatës Supreme, të cilëve në fund u shkojnë rastet penale.

Kështu që më intereson sa kanë qenë të involvuar? Sa është dëgjuar zëri i tyre? Sepse, nganjëherë nga perspektiva e integritit evropian mund tingëllojë diçka shumë mirë, mund të marrim standarde që janë të avancuara, mirëpo, në anën tjetër, për punën e Gjyqësorit dhe të Prokurorisë sonë mund të jetë e vështirë të implementohet dhe në qoftë se jo, atëherë do të jetë me rëndësi që gjatë procedurës së shqyrtimit ndërmjet dy leximeve që të shqyrtohen këto shqetësime të tyre edhe nga Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A do në fund, a tash? Në rregull! Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar zonja Osmani,

Ju e dini që me Kodin e kaluar dhuna në familje s'ka qenë fare vepër penale dhe neni 248 ka qenë edhe përcaktim i grupit kryesor, grupit të madh punues. Ne e kemi pasur një grup punues që ka qenë grupi kryesor dhe disa nëngrupe tjera, dhe në këtë proces, të dal te pjesa e dytë, kanë qenë përfaqësues dhe të Këshillit Gjyqësor, edhe të Këshillit Prokurorial. Pra, ka qenë një proces gjithëpërfshirës, e kjo është bërë në fakt për shkak të numrit të madh të ekspertëve vendorë më shumë sesa ndërkombëtarë që edhe të vonohemi pak, për shkak të angazhimit të madh dhe që janë diskutuar këto 100 nene dhe është marrë kohë e tërë, pra rreth një vit, derisa kemi ardhur në përfundim me këtë draft që e kemi sot para jush.

Pra, unë s'kam pasur asnjë vërejtje, asnjë koment, as nga Këshilli Gjyqësor, as nga Këshilli Prokurorial, pavarësisht që para prezantimit në Qeveri kam pyetur edhe një herë, meqë kam pasur kritika dhe disa vërejtje nga shoqëria civile, sidomos te çështjet që i thatë edhe ju, që ndërlidhen me dhunën në familje. Mirëpo, jam i hapur që të diskutojmë prapë dhe t'i rishikojmë. Ajo çka është më e rëndësishme, nenet që ndërlidhen pra me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit ato të mbeten kështu siç janë, sepse është një dakordim i ekspertëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë që i kemi pas në proces. Të gjitha çështjet tjera ne mund t'i presim. Të them të drejtën, ekspertët lokalë kanë qenë pak kundër rritjes së dënimit që kemi shkuar, e kam bërë propozimin sot para jush, jam bindur më shumë nga argumentet e ekspertëve ndërkombëtarë që i kemi pasur në këtë rast, pra në këto grupe punuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, Vjosa Osmani!

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Te rasti i nenit 248 nuk ishte komenti për mospjesëmarrje, kryesisht ishte te vërejtjet që janë bërë nga shoqatat për barazi gjinore dhe jo nga Këshilli Gjyqësor apo Prokurorial.



Mirëpo, kërkesa ime është kjo, meqenëse ju jeni përfaqësues i koalicionit, që të siguroheni, jo nëpërmjet ndërhyrjes dhe siç mund të interpretohet, por meqenëse e mbuloni këtë dikaster, të siguroheni që të ketë përkrahje edhe nga koalicioni qeverisës për ndryshime në nenin 248, sepse besoj që po pajtoheni edhe ju që është absurde që të vendoset një prag kaq i lartë i përcaktimit të qëllimit të personit që ka ushtruar dhunë dhe të merren parasysht gjatë shqyrtimit në Komisionin për Legjislacion të gjitha vërejtjet, në mënyrë që ta kemi një kapitull si duhet për rastet e dhunës në familje. Unë nuk e krahasova me Kodin paraprak, por kjo nuk do të thotë që nuk duhet të kemi qëllime më të larta të mundshme për ta pasur një kapitull si duhet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

**LULJETA VESELAJ-GUTAJ:** Faleminderit, i nderur kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e kisha ndërmend ta marr fjalën, por gjatë diskutimeve me kolegë e pash që në Kodin e ri Penal nuk parashihet diçka që është shumë e rëndësishme dhe aty është mungesë e nenit për shpifje, sidomos shpifjeve dhe shtrembërimeve të qëllimshme të personave publikë, që bëhen nëpër institucione publike e në rastin tonë konkret, siç është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës patëm rastin e zotit Selmanaj, i cili gënjeu dhe manipuloi krejt opinionin publik kur foli për përbërjen e kabinetit të kryetarit të Kuvendit, për pagat e tyre.

E di që deputetit Selmanaj po i pengon transparenca e Kuvendit të Kosovës, sepse që prej ardhjes së zotit Veseli në këtë Kuvend ka shumë transparencë. Çdo tre muaj të gjitha shpenzimet, financat e Kuvendit, janë publike për qytetarët. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë më parë në kohën kur Kuvendi është udhëhequr nga LDK-ja e Driton Selmanajt.

Zotit Selmanaj po i pengon edhe ndalja e keqpërdorimeve nga Kuvendi, siç ka ndodhur në kohën e LDK-së me disa investime milionëshe fantome. Deputetit Selmanaj ia bëj me dije po ashtu, se pagat e këshilltarëve nuk i ka caktuar kryetari Veseli, por janë caktuar qysh nga koha kur është udhëhequr Kuvendi nga LDK-ja. Edhe numrin e këshilltarëve, ti e di mirë zoti Selmanaj, që nuk e cakton kryetari i Kuvendit, por kjo caktohet nga Kryesia e Kuvendit dhe aty nuk ka pasur asnjë kundërshtim kur janë paraqitur propozimet. Aty kanë qenë edhe përfaqësuesit e juaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe ata nuk kanë kundërshtuar.

Ne e kuptojmë frustrimin e deputetit Selmanaj, se i duhet pak fuqi në LDK dhe këtë fuqi nuk ka metodë tjetër që e merr.

**KRYESUESI:** Ju lutem, jemi me ligjin tash...

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Për Kodin Penal unë dhashë vërejtje, zoti nënkryetar, në Kodin Penal nuk po paraqitet ndëshkimi i shpifjeve publike që po bëhet, qoftë në Kuvendin e Kosovës, ose edhe në vendet tjera, edhe në medie e gjithkund tjetër.

KRYESUESI: Me kodin merru, të lutem!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Veç edhe një gjë, se deputeti zoti Selmanaj po ka nevojë për pak fuqi politike në LDK.

KRYESUESI: Mos na hapni tash... Zoti Selmanaj tash çohet dhe ky kërkon replikë.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Dhe, këtë fuqi po mundohet ta marrë duke e sharë zotin Veseli. Si deputet nuk i ka hije të manipulojë, sepse ka përgjegjësi publike. Fundja, jua rikujtoj, zoti Selmanaj, juve që po flisni për moral, ju ka përjashtuar USAID-i nga mbikëqyrja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, projekt ky sa ishit në shoqëri civile dhe kjo pikërisht është bërë për shkak të manipulimeve dhe dezinformimeve që keni bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj e ka fjalën për replikë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit! Po e shfrytëzoj një herë për replikë, më pas më vonë flas.

Po të reagonte në mëngjes, ndoshta dikush do ta merrte seriozisht, por ia ka shkruajtur dikush, i ka thënë hej më se na ka rënduar aq shumë edhe me forcën e argumentit, saqë duhet t'i thuash.

Tashti, njëzet herë ma përmendi emrin, veç le ta gjejë kjo deputete, le ta gjejë diku listën e këshilltarëve që sot kryetari Veseli e ka, le ta gjejë në publik kudo edhe le të na e ofrojë neve. A e dini pse nuk i bëjnë këto publike, sepse ata po ndërrohen shpesh. Janë disa që vijnë nga një muaj rrinë, nga tre muaj, kthehen, vijnë prapë, shkojnë prapë... realizojnë... madje, madje shkojnë edhe për qëllime arsimore-edukative, shkruan diku. Dhe, krejt këto unë kam provuar zyrtarisht të kërkoj sipas Ligjit mbi qasjen në dokumente publike, si deputet, i kam dërguar shefit të kabinetit të kryetarit, zëvendës shefit të kabinetit, kurrkush s' ishte i gatshëm të mi jep këto. U detyrova t'i marr krejt dika tjetër.

Tashti, është shumë e vërtetë që vendimi për rritjen e pagave kaq të mëdha të këshilltarëve nuk e ka marrë kryetari Veseli, e ka marrë kryetari Daci, por ai i ka pasur veç dy këshilltarë, jo pesëmbëdhjetë. Edhe në atë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Kundër-replikë, edhe të mos ju bëj be tash mos më shtini në këto, se pastaj... Në rregull, kundër replikë.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Fillimisht, në pjesën e ngritjes së çështjeve jashtë rendit të ditës unë kama kërkuar fjalën, por nuk më ka ardhur radha që ta ngre këtë çështje, të bëj replikë. Shfrytëzova rastin duke pasur diskutime me kolegë dhe duke kërkuar, duke bashkëbiseduar, se a ka nen që i dënon shpifjet publike që bëhen, më thanë: jo, as nuk ka pasur në Kodin e vjetër, as nuk ka në Kodin e ri. Kjo ishte arsyeja pse e mora fjalën dhe kërkoj nga zoti ministër që të parashohë diçka, që të ndërmerren masa për persona që bëjnë shpifje publike. Kaq!

KRYESUESI: Unë për veten time të mbështes 100% sa u përket shpifjeve publike edhe shpifjeve të gazetarëve, 100% të mbështes. 100% ke të drejtë.

Zonja Fatmire Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj, kryesues!

Arsyeja pse e mora fjalën në këtë pikë të rendit të ditës është që të shpreh bindjen e plotë, se jo vetëm shoqëria civile që ka qenë e brengosur për dhunën në familje dhe mos adresimin e duhur në legjislacionin ekzistues, po ashtu të shqetësuar kemi qenë edhe ne deputetët. Kështu që, më datë 8 dhe 15...

*(Debat në sallë)*

Kryesues, besoj që do t'i krijoni kushtet e punës, se në këtë mënyrë është e pamundur të vazhdoj.

KRYESUESI: Ju lutem, qetësi. Duhet respektuar njëri-tjetrin në diskutime. Miliaim, ulu se jemi duke diskutuar, tani po na... ulu.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ministri e ceku që është njëri ndër ligjet kryesore, por ministër nuk po duket ashtu, se interesimi shumë i vogël për të dëgjuar rreth kësaj teme.

Siç e ceka, përveç shoqërisë civile edhe ne si deputetë ishim të brengosur për dhunën në familje, prandaj më datat 8 dhe 15 kjo në seancë plenare është iniciuar një debat parlamentar lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional, ku Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka nxjerrë disa rekomandime, të cilat janë harmonizuar me të gjitha grupet parlamentare dhe siç u tha këtu, fillimisht është kërkuar që të bëhet rishikimi i ligjit, rishikimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe ndryshimi në Kodin Penal dhe të procedurës penale për veprën penale të dhunës në familje, si dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues për parandalimin dhe ndjekjen penale të dhunës në familje, përfshirë dëmshpërblimin për dëmet emocionale të viktimave të dhunës në familje dhe viktimave në baza gjinore, si dhe të zbatohet

në tërësi strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016-2020, sidomos nenet që kanë të bëjnë me riintegrimin e viktimave të dhunës në familje, si dhe rishikimi i këtyre dokumenteve për të reflektuar ndryshimet në legjislacionin konform pikave 1 dhe 2 të kësaj rezolute.

Janë edhe pesë pika tjera, por unë mendoj që këto që i ceka janë relevante për këtë diskutim sot. Pajtohem plotësisht me zonjën Osmani, e cila kërkoi që të kemi një kapitull të veçantë për dhunën në familje, si dhe për vërejtjen që dha për nenin, do të thotë për nenin 248. Prandaj, unë mendoj që nëse ministri kishte pasur mundësi të na specifikojë pak edhe për publikun më gjerë për ndryshimet konkrete, mirëpo ato çfarë ne tentojmë të ndryshojmë me siguri se do t'i dërgojmë amendamentet dhe do të bëjmë amendamentimin e kodit, si dhe ndryshimet nëpërmjet Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, hajde zoti ministër!

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** E nderuar zonja deputete, Ne këto kohët e fundit jemi tronditur si shoqëri edhe me disa fakte të rënda dhe vrasje brenda familjeve të ndryshme. Pra, me kodin aktual që është në fuqi, minimumi i vrasjes, minimumi është pesë vjet, ndërsa vrasja brenda familjeve nuk ka qenë rrethanë rënduese me këtë që është në fuqi. Me kodin e ri është rrethanë rënduese dhe minimumi i viteve që do të dënohen është 10 vjet, pra nuk është vetëm neni 248, ku trajtohen problemet, ose dhuna në familje.

Sërish po them, jam i hapur të diskutojmë edhe pjesë të tjera, mirëpo mos të preket struktura e këtij kodi, kështu si të tillë, siç e kemi sjellë në Kuvend. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radha është e Teuta Haxhiut.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, më në fund, kryetar, se me preferenca edhe ti po e jep fjalën, absolutisht. Herën tjetër kur ta kërkoj fjalën, e kam të drejtën të shprehem. Krejt është diçka tjetër, është mendimi dhe është e drejtë e imja personale.

Tani në këtë rast, normalisht, që po e diskutojmë Projekt-kodin Penal të Republikës së Kosovës. Unë duke dashur ta jap edhe mendimin tim, normal se gjërat edhe përsëriten ndonjëherë, por është shumë me rëndësi që t'i japim edhe sqarimet pse kërkojmë që në këtë projekt-kod të kemi edhe nenet që do ta rregullonin më mirë, sidomos dhunën në familje.

Unë nuk po e përmend se si është aktualisht në dispozita tek neni 48, por po e jap arsyetimin direkt, se si do të duhej të ishte. Pikërisht te pika 1 e nenit 248 do të duhej të ishte “çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë, ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual, ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre vjet”. Pika 1.2. e po këtij

neni do të duhej të ishte “marrëdhënia familjare për nevojat e kësaj dispozite është në përputhshmëri me përkufizimin në nenin 113 të këtij kodi” dhe pika 1.3. “dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike për nevojat e këtij kodi do të jetë e njëjtë, siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, në paragrafin 1.2. të Ligjit nr. 03/L-162 për mbrojtjen nga dhuna në familje, ose përkufizimi sipas Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Tani, po jap edhe arsyetimin pse.

E para, dhuna në familje është çfarëdo formë e dhunës, që ushtrohet nga anëtari i familjes kundër anëtarit tjetër të familjes. Pra, nuk mund të ushtrohet nga kushdo. Kryesi mund të jetë vetëm anëtari i familjes. Në Projekt-kodin Penal është tek neni 248, fillon kështu: “kushdo mund të jetë kryes, jo vetëm anëtari i familjes, bashkëshorti, bashkëshortja, prindi, fëmija, motra, e tjera...”, pra nuk do të duhej të ishte “kushdo”.

E dyta në arsyetim, “dhuna në familje shkaktohet nga çfarëdo dhune, përfshirë edhe atë seksuale” e kjo formë e dhunës nuk është përshkruar në dispozita që kërkohen të ndërrohen.

E treta, kjo vepër penale kryhet me veprim dhe me mosveprim. Me veprim: sulmi fizik, lëndimi trupor, e tjerë. Me mosveprim: lënia padore e obligimeve apo mospërbushja e detyrimeve që dalin nga ligji, e tjerë... nuk ushtrohet vetëm me qëllim të cenimit të dinjitetit të tjetrit. Kjo vepër mund të kryhet edhe me qëllime tjera, por edhe kur nuk ekziston qëllimi. Për shembull, vepra kryhet si pasojë e një varg veprimesh tjera nga mjetet dehëse, urrejtjes, xhelozisë, mosdurimi, e tjerë...

Dispozita aktuale e kufizon këtë vepër penale me qëllim që në këtë rast kufizohet edhe me formën e përgjegjësisë, e cila mund të kryhet vetëm me dashje. Prandaj, duhet të hiqet përkufizimi “me qëllim të cenimit të dinjitetit”.

Dhe e katërta, “kjo vepër penale kryhet vetëm nëse dhuna ushtrohet mbi anëtarin e familjes së kryesi”, prandaj përkufizimi i tanishëm, se brenda një marrëdhënieje familjare nuk është i qartë, është abstrakt dhe duhet të jetë si në propozimin që e përmenda më lartë.

Kodi Penal çdo herë përmban shpjegime për shprehjet në kod, kjo zakonisht për shprehjet që mund të ketë në shumë kuptime, janë të pa definuara qartë, janë terminologji shkencore apo janë shprehje që përdoren vetëm në ligj. Prandaj, për format e dhunës që janë përfshirë në këtë kod dhuna psikologjike dhe ekonomike është e nevojshme që në ligj të jepen sqarime, se çfarë domethënie kanë, pra për nevoja të vet ligjit. Që dhuna në familje si vepër e veçantë penale është obligim, që del nga Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, si dhe faktin që propozimi nuk ka qëllim të ndryshojë asgjë

konceptualisht, por vetëm formulimin gjuhësor, e që ky ndryshim do të jetë shumë më i qartë dhe në harmoni me kërkesat që dalin nga Konventa e Stambollit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Desha shkurt më tepër si deputet t'i sugjeroj ministrit të Drejtësisë për nja dy-tri gjëra të vockla, por që për mua kanë domethënie shumë të madhe. Nuk po flas për nenin që folën edhe Vjosa, edhe Teuta, 248 për dhunën në familje, që unë mendoj se është nga nenet më kryesore të Kodit Penal, por desha të koncentrohem te dy gjëra.

Kolegia Albulena Haxhiu e tha në fillim se, me shumë të drejtë ajo e tha por unë do e kthej mbrapshtë thënien e saj, tha se nuk ka vullnet politik. Unë mendoj se ka shumë vullnet politik këtu, por ka vullnet politik për t'ua futur atyre tjerëve që janë kundërshtarë politikë. Domethënë, vullneti politik këtu është ekstrem, që nëpërmjet vullnetit tim politik të mëshoj ty që je kundërshtari im politik. E qysh të mëshoj? Të mëshoj nëpërmjet prokurorëve, të mëshoj nëpërmjet hetuesve të korruptuar në Polici dhe besoj që ministri i Drejtësisë duhet ta shkruajë në zyrën e vet, unë mendoj ashtu, po të isha ministër do ta shkruaja thënien e vitit, që ka thënë ish-kryetari i Gjykatës që u lirua para disa ditësh, Mekaj, që tha se në Kosovë është ndërtuar një sistem prokurorial, që nëpërmjet një telefoni ta shkatërrojnë jetën, nëpërmjet një telefoni të hapin hetime... Këtu, zoti Ministër, keni kolegë tuaj ministra brenda Qeverisë që unë i njoh edhe i di nga ministrat më të ndershëm, që u kanë hapur hetime për gjëra që as në hava nuk i kanë imagjinuar, as s'kanë qenë fare të pranishëm, as nuk kanë qenë fare nënshkrues të ndonjë dokumenti, për të cilin janë duke u hetuar.

Krejt frika ime si deputet është kjo. Meqenëse kam eksperiencë me delegacionet e Kosovës dhe të Shqipërisë edhe të Maqedonisë, kur ulen përballë burokratëve të Brukselit, përballë përfaqësuesve të ambasadave perëndimore, bash bëhen si pula të lagëta, bash s'guxojnë hiç kurrfarë kundërshtimi me ua bë. Edhe unë e kam frikën se qysh e kanë gatuar kulaçin me Gjykatën Speciale, që ua kanë futur deputetëve sikur ato gogluçët kur ia fusin "quranit" në gojë Natën e Bajramit e pëlçet "qurani", ashtu janë duke bërë që për hir të gjoja nën rrogzin e liberalizimit të vizave, burokratët e Brukselit janë duke çuar lista kë ta dënojnë, kë të mos e dënojnë. Ne mund të pranojmë çfarëdo sugjerimi ndërkombëtar e vendor, që flet për respektimin e ligjit, për respektimin e procedurës së Kodit Penal, por ne nuk mund të na shesin fore burokratët e Brukselit e të na thonë që ne të bëhemi shtet diktatorial, që nëpërmjet parimeve se gjoja po e luftojmë korrupsionin, gjoja se po e luftojmë krimin e organizuar, hajde dënoni "peshqit e mëdhenj", hajde fute në listë filan deputetin, filan ministrin, filan politikanin, këtë e atë...

Me pas dashtë evropianët me e respektua ligjin dhe Kodin Penal minimum nja 50 zyrtarë të lartë të EULEX-it do të ishin dënuar deri sot e minimum nja 500 zyrtarë të lartë të UNMIK-ut, që kanë qenë njerëzit më të korruptuar. Edhe hajnia që është bërë në Dhomën e Policisë me të gjitha dëshmitë, është bërë në bashkëpunim me zyrtarë të lartë evropianë, të policisë evropiane. Prandaj, nuk kanë nevojë të na shesin neve pallavra këtu, e të na çojnë lista me i denigrua njerëzit, shumë mirë e tha zonja Veseli, këtu të bëjnë më së pari gjyq publik, kur ta bëjnë gjyqin publik nëpërmjet mercenarëve gazetarë, nëpërmjet njerëzve shantazherë, nëpërmjet njerëzve që veç hajt thotë të çohem këtu e të akuzoj një njeri, atëherë ti badihava shkon nëpër gjykata.

Zoti ministër, po të ishte Kosova anëtare e Këshillit të Evropës dhe po të ishte Kosova anëtare e Gjykatës së Strasburgut, po të kishin të drejtë qytetarët e Kosovës të bëjnë ankesa në Gjykatën e Strasburgut, i isha lutur Zotit çdo ditë me më paditë prokurorët e Kosovës, qoftë mua, qoftë ty, qoftë atë apo atë.

Prandaj, nuk është çështja këtu se ne s'kemi pasur ligje të mira e s'kemi ligje të mira, se krejt na i kanë sjellë "copy paste", ju vetë e thatë, çdo ligj e kemi punua në bashkëpunim me ekspertët evropianë. Po, këta ekspertët evropianë duhet ta dinë, se ligjet duhet të kenë një bazament, që i përshtatet vendit në të cilin zbatohet ai ligj, vendin për të cilin ne e punojmë atë ligj. Nuk mundesh ti në Londër të shesësh flija sikur pica. Këta po na sjellin neve sallatë të gatuar edhe po të thotë gëlltite. Pse? Në daçi ta merrni liberalizimin e vizave, në daçi ta bëni këtë... Prandaj, shqetësimi im është që të mos bisedojnë këta me neve sikur me qenë ne fëmijë të klasës së parë fillore, se ne veç ulemi para tyre dhe u themi: "yes, please, I understand". Yes, please, hiç don't worry... s'ka problem! Jo, ka shumë problem, sepse problemet po vijnë pasi po i aprovojmë budallallëqet e tyre.

Prandaj, bëj thirrje edhe si deputet, ata që janë ekspertë të fushës juridike, që ta kemi mirë parasysh se çfarë po votojmë, çfarë ndryshimesh po bëjmë dhe çfarë Kodi Penal po sjellim në fuqi.

Këto ishin, zoti ministër, ato shqetësimet e mija. Edhe një herë bëj thirrje që të koncentrohemi, sidomos te të drejtat e femrave - një, të drejtat e fëmijëve - dy dhe te të drejtat e pleqve - tre. Faleminderit, ministër!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vërtet po shpresoj se do të diskutojmë për Projekt-kodin Penal dhe e kam së paku një interesim të jashtëzakonshëm që të diskutojmë për Projekt-kodin. Janë edhe këto temat tjera, sigurisht se do ta kenë vendin dhe kohën në tema të caktuara. Nuk përjashtoj asnjë mundësi, mirëpo kjo është një çështje tjetër.

I dëgjova me kujdes edhe kolegët, ka gjëra të ndryshme që janë shumë të mira, propozime të mira, ka vërejtje të mira. E dëgjova edhe ekspozenë e ministrit. Natyrisht, që ministri duhet si çdo ministër tjetër ta ndjejë veten krenar, por unë po i them se s'kemi për ta quajtur "Kodi Penal i Tahirit, i Abelard Tahirit", se Kodi Penal është i Kosovës. Por, përpjekja për ta bërë një kod penal të mirë është për mua si thelbi i të së drejtës materiale penale, një punë e jashtëzakonshme. Prandaj, unë mendoj se krejt kolegët dhe koleget do të koncentrohen në tekstin që e kemi përpara.

U thanë disa vërejtje, me të cilat pajtohem, domethënë vërejtje logjike dhe përmbajtjesore, që i përmendi edhe zonja Osmani, që janë të drejta, zonja Haxhiu i përmendi po ashtu. Kishte edhe vërejtje anësore, që kanë të bëjnë me kodin, mirëpo ndoshta nuk e kanë vendin këtu sot, por duhet të diskutohen.

Në komision unë kam abstenuar nga votimi për arsyet që i kam pasur edhe përmbajtjesore, po edhe gjuhësore. Shumë shpesh problemet gjuhësore merren si probleme të dorës së dytë, të tretë. Në të vërtetë, nuk ka ligj pa gjuhë, sepse ligji shkruhet vetëm me gjuhë. Nëse gjuha nuk është e saktë, e qartë, nuk kemi ligj, sepse ligji duhet të jetë i kuptueshëm, i saktë dhe i qartë që të mund të zbatohet. Unë e dëgjova edhe kërkesën që "të zbatohen, të implementohen ligjet", vërtetë ne kemi të bëjmë me një qark të veprimeve që e përmban çdo ligj, zbatimi nuk është vetëm çështje e vullnetit politik, mandej vullneti politik është një çështje tjetër.

Prandaj, unë po them kam vërejtjet për të cilat kam abstenuar. Natyrisht jam që projekt-kodi, kodi të kalojë sa më shpejt, po jo me këtë shpejtësi, sepse është ligji themelor material penal. Ka të bëjë me secilin prej neve në kohë dhe në rrethana të caktuara, po edhe me krejt njerëzit e tjerë.

Unë kam vërejtjet e mia, për shembull, e përmendi zonja Haxhiu tha, në nenin 92 fjala "instrumentalitet". Merreni, ju lutem, këtu e keni krejt nga një telefon të mençur, futeni në Google dhe përktheni e këqyrni çka ju del. Ky është përkthimi që i është bërë ligjit me Google, ky është problemi. Po, përkthimi është me Google, merrni futeni fjalën "instrumentaliti" prej anglishtes dhe del fjala "dobi", e me të vërtetë nuk e ka atë kuptim hiç, po do të duhej të ishte e tillë.

Këtë po e marr si shembull për të treguar që e kemi një problem edhe te përkthimi, ky ligj duhet të zbatohet në Kosovë edhe në gjuhën serbe, edhe në gjuhën angleze.

Po kemi edhe çështje të tjera, zoti ministër, sigurisht do t'i japim në formë të amendamenteve. Unë e kam vetëm një frikë se numri i amendamenteve në këtë projekt-kod do të jetë shumë i madh, këtu është dashur të kihet kujdes para se të sillej, të hiqen ato që të mos bëhen për gjëra



krejt teknike, krejt të thjeshta amendamente, po të bëhen amendamente përmbajtjesore që e plotësojnë ligjin.

Për shembull, kemi paragrafin 4, të nenit 3, lexoni edhe analizoni vetë dhe do ta shihni që është në kundërshtim me normën juridike. Nuk po dua t'i lodh kolegët e koleget këtu që është i pakuptueshëm. Ose keni, për shembull, gjëra të tilla në ligj, merrni nenin 5, thotë: “Kryesit të veprës penale mund t'i mohohen ose kufizohen të drejtat”. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk mohohet e drejta, po kufizohet e drejta. Këto janë gjëra që i duken dikujt të vogla, po dikush të të thotë nuk ke të drejtë, dhe ta kufizoj të drejtën, ato bëhen vetëm me vendim të gjykatës, janë dy gjëra të ndryshme, nuk duken të jenë gjëra të mëdha, po nesër ky nen duhet të zbatohet dhe cili gjykatës, me cilin ligj në Kosovë ka të drejtë dikujt t'ia mohojë një të drejtë, kjo është çështja. Ose, për shembull, thotë: “Respektimin e dinjitetit njerëzor të tij apo të saj në pajtim me të drejtën ndërkombëtare”. Të drejtën ndërkombëtare ne e kemi të përfshirë në legjislacionin dhe Kushtetutën tonë. Atëherë duhet të jetë: “Me Kushtetutën dhe ligjet tona”, sepse ky është Kodi Penal për Republikën e Kosovës.

E drejta ndërkombëtare, krejt normat e të drejtës ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut janë të përfshira këtu. Unë po them se ka edhe çështje të tjera në gjuhën serbe, serbokroate apo boshnjake, si të doni thoni, që nuk kanë përputhje me këtë.

Me këtë kod deshëm apo nuk deshëm do të trajtohen qytetarët, do të punojnë gjykatat dhe prokuroritë dhe do të zbatohet mbi njerëzit, edhe nëse dikush thotë nuk po zbatohet, ai është një qark shumë i madh që përfshin veprime të ndryshme, nuk ka të bëjë as me vullnetin, nuk ka të bëjë as me gjuhën, nuk ka të bëjë as me përkthimin, po ka të bëjë me një qark të ndryshëm të veprimeve.

Ne duhet mbajtur në mend. Një nga rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe vërejtjet e Avokatit të Popullit, mendoj që e dini, është mosharmonizimi i legjislacionit vendor. Kjo s'ka të bëjë me mua, s'ka të bëjë as me ministrin Tahiri, ministri Tahiri është tash momentalisht, vjen një ministër tjetër, ne e kemi problemin e harmonizimit, edhe gjuhësor, edhe përmbajtësor dhe në çfarëdo mënyre të legjislacionit tonë, sepse janë normat me të cilat ne duhet të jetojmë dhe me të cilat rregullohen sjelljet tona të përditshme apo edhe të rastësishme.

Këto janë ato vërejtjet, ka edhe të tjera, nuk po dua t'ju marr kohën, që mua më kanë bërë të abstenoj, sepse shpejtësia e trajtimit të 440 neneve ka qenë jashtëzakonisht e madhe.

Ky është ligji themelor, pajtohem me zotin Korab Sejdiu që nuk mund të trajtohet për një kohë kaq të shkurtër.

Ne e kemi Kodin Penal të vitit 2013, në pesë vjet ne e ndryshojmë Kodin Penal, kjo nuk është shpeshësia me të cilin ndryshon ligji themelor penal në një vend. Prandaj, ne duhet të punojmë më mirë, më gjatë, për disa muaj, po të kemi diçka që e mbajmë për më shumë vjet.

Sigurisht unë kam edhe vërejtje të tjera, do të përpiqem vërejtjen kryesore t'i paraqes si amendamente, po e kisha lutur përsëri edhe Kuvendin, sekretarinë, edhe Qeverinë që të kenë kujdes në këtë drejtim gjatë hartimit të legjislacionit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti deputet,  
Të thuhet se është përkthyer në Google translate është ta mohosh punën e atyre 50 ekspertëve vendorë që kanë punuar për një vit në këtë projektligj.

Pra, mund të kemi mospajtime me nene të caktuara. Mirëpo në këtë projektligj kanë punuar 50 ekspertë vendorë: prokurorë, gjyqtarë, pjesëtarë të policisë, ekspertë financiarë, Zyra ligjore e Ministrisë së Drejtësisë, pra ka qenë një proces gjithëpërfshirës.

Një prej problemeve më të mëdha që e kam në Ministri të Drejtësisë është përkthimi në gjuhën serbe, e kam thënë edhe në komision, po e them edhe tani. Ne pavarësisht kontraktimeve nga jashtë, nuk kemi arritur kualitetin e duhur asnjëherë në përkthime në gjuhën serbe. E kam marrë edhe si vërejtje prej deputetëve të Listës serbe dhe është shqetësim imi, shpresoj që do ta zgjidhim këtë problem, sepse tash më funksionojnë edhe gjykatat, edhe prokuroria edhe në komunat veriore të Kosovës dhe pa dyshim që duhet një përkthim i qartë dhe të mos devijojë gjuha serbe në asnjë rrethanë.

Mirëpo, mos e mohoni punën e 50 ekspertëve vendorë: policë, prokurorë, gjyqtarë, ekspertë financiarë nga Ministria e Drejtësisë që kanë punuar për një vit në këtë projekt-kod. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Samiu e ka kërkuar prapë fjalën.

SAMI KURTESHI: O, zoti ministër, në krejt në fjalën time nuk kishte asnjë moment, bile asnjë përpjekje të mohimit të punës, edhe kjo nuk është çështja a po mohoj, a s'po mohoj, çështja është e disa fakteve që ju mund t'i verifikoni tash, menjëherë. Unë e kuptoj se mendësia jakobine është domethënë nëse nuk ke argumente, mandej bën përpjekje të degradimit moral të personit. Unë nuk e bëra atë përpjekje.

Përpjekja ime është të tregoj që puna që është bërë nuk është...nuk po dëgjoj, ka dikush diçka?

*(Ndërhyrje nga salla)*

Puna që po bëhet është e pakujdesshme, ne do të jetojmë me këto norma edhe kur të shkoni ju, edhe kur të jemi ne.

Prandaj, nuk ka këtu mohim të punës, këtu ka kërkesë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë me vëmendje e kam përcjellë edhe e kam lexuar sa kam pasur mundësi Projektligjin e Kodit Penal dhe normalisht e përkrah këtë projektligj dhe më vjen mirë, jam mirënjohës ndaj ministrit dhe ekipit i cili ka punuar, për shkak që kam vërejtur një risi, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për neve. Fakti i parashikimit të masave rënduese në raste kur kanë të bëjnë me elementin etnik apo me përfshirjen e rasteve kur kanë të bëjnë me komunitetet.

Më vjen mirë, për shkak që ne ballafaqohemi akoma me uzurpime, me deklarime inferiore raciste dhe besoj që ky projekt-kod do të ketë një masë, e cila vërtet do t'i parandalojë këto veprime dhe unë shpresoj dhe besoj fuqishëm që do të jetë një promovim shumë i madh në publik, sepse duhet ta kuptojë secili qytetar që ka masë kushdo qoftë ai që përdor veprime, të tilla të cilat e kanë elementin etnik.

Unë do të jap kontributin tim në mes të dy shqyrtimeve, megjithatë vetë fakti i orientimit të këtij projektligji, duke e mbrojtur secilin edhe mbi bazën etnike, na bën të njohemi mirë.

Andaj, më lejoni të komplimentoj qasjen e ministrit dhe ministrisë si politikë dhe besoj fuqishëm që vërtet këto masa të jenë edhe në përdorim dhe të kemi raste kur ndërmerren veprime.

Në praktikë, besoj që shumica e dini, kam reaguar në raste kur zyrtarë publikë kanë dalë me deklarata, zyrtarë që sot ushtrojnë pozita publike dhe kanë pasur deklarata me element racist dhe zyrtarët e tillë kanë kaluar vetëm me një masë vërejtje dhe nuk ka pasur masa ndëshkuese, e cila ka mundur të ishte shembull për raste të tjera.

Andaj, shpresoj që ky projektligj ta ketë fuqinë dhe të jetë i implementueshëm. Faleminderit edhe një herë, ministër! Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Ministër,

Realisht kur diskutohet për Kodin Penal të një shteti, mendoj që debati duhet të jetë më adekuat dhe më konkret, mbi të gjitha shumë serioz, sepse ka të bëjë me një ndër shtyllat kryesore të sistemit të drejtësisë të atij vendi.

Është e vërtetë që Kuvendit i ka munguar pjesa e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së implementimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale prej vitit 2013 dhe sigurisht nga ajo që kemi dëgjuar nga ju, si ministër i ri i këtij dikasteri dhe pretendimet tuaja për të avancuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Ashtu siç e theksuat edhe në fjalën tuaj, ato që më shumë i kemi dëgjuar edhe nëpërmjet debateve publike, por edhe pasqyrimin të tendencës suaj për të paraqitur një politikë, e cila do të reformonte apo do të avanconte sistemin e drejtësisë në vend.

Ne para vete e kemi Kodin Penal, i quajtur Kodi Penal i Ri i Kosovës, por që realisht ne e kemi një Kod Penal në fuqi, i cili është vlerësuar në të kaluarën si një ndër ligjet më të avancuara në rajon sa i përket kodit të një shteti.

Ju edhe e potencuat që në këto ndryshime kanë punuar më shumë se 50 ekspertë, unë e vlerësoj punën e tyre, sigurisht dhe mbikëqyrjen tuaj, por edhe harmonizimin me politika që ju dëshironi të paraqitni apo edhe që është ambicie normale e një mazhorance, por sot do t'i bëj 3-4 pyetje, të cilat mendoj do të duhej të ishin me përgjigje në rast të miratimit apo kërkesës për përkrahje në parim të këtij kodi apo projekt-kodi.

Cila dispozitë e kodit ka qenë pengesë për luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit në Republikën e Kosovës?

Cila dispozitë e ka theksuar që gjykata të parashkruajë raste të cilat kanë qenë pjesë e ndjekjes së hetimit dhe e ndalesës së grupeve kriminale të organizuara dhe të cilat janë mbyllur me parashkrim? Duke përfshirë këtu edhe misionin, kompetencën ekzekutive të EULEX-it, por që kanë punuar me Kodin Penal të Kosovës.

Cila dispozitë e Kodit Penal ka qenë pengesë e luftimit dhe dënimit, apo edhe hetimit të deklaratave publike të dëshmitarëve okularë për vrasjet për motive politike?

Andaj, zoti ministër, këto 3-4 pyetje, qoftë edhe ajo për dhunën në familje, cila dispozitë ka qenë pengesë? Apo për mbrojtjen e njerëzve që kanë qenë nën mbrojtjen nga dhuna në familje?

Këto 3-4 pyetje më shumë ndoshta do të duhej t'u parashtroheshin gjyqësorit dhe atyre që kanë punuar në këtë projekt-kod, për të na treguar se cilat dispozita kanë qenë pengesë që Kosova sot të mos jetë në tabelë për mosluftim të krimit të organizuar dhe të korrupsionit?

Besoj që këto do të duhej të ishin pasqyra më e mirë e ndryshimeve dhe kërkesa për avancim të sistemit të drejtësisë në vend.

Unë mendoj që problemi nuk është te kodi, nuk është te ndryshimet ligjore, problemi është te individët që janë bartës të përgjegjësive të sistemit të drejtësisë, duke filluar nga Prokuroria dhe nga gjykatat dhe pjesa që ne e quajmë ‘ndikimi politik’ në çfarëdo forme që interferohet apo tentohet që të shikohet në atë formë.

Ne vetë dje e kishim një lajm, kur thuhet: “Vendimet e gjyqësorit nuk respektohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës” dhe ku është pengesa e Kodit Penal dhe e Kodit të Procedurës Penale?

Këto pyetje besoj që do të duhej të kishin përgjigje dhe pasqyrim, sepse ne po kalojmë në atë stadin e replikave individuale dhe kërkesave edhe aty ku çdo individ, çdo deputet mund ta shohë sundimin e ligjit dhe të rendin në Republikën e Kosovës nga këndvështrimi personal.

Qoftë edhe atë që ne po e shohim në raport me komunitetin ndërkombëtar, si pjesë ekzekutive, sidomos në fushën e sundimit dhe të rendit të ligjit në vend.

Andaj, deklarativisht unë jep përkrahje, në parim, edhe atyre ndryshimeve që ju i keni propozuar, sidomos pjesa që ka të bëjë me largimin e zyrtarëve të lartë që janë nën akuza apo që janë të ndjekur në çfarëdo forme dhe janë pjesë të institucioneve të Republikës së Kosovës, në tërësi, pa përjashtim, por duke ruajtur pavarësinë institucionale dhe logjikën vepruese, mbi të gjitha mbrojtjen e ligjshmërisë, sepse sigurisht ne parafranojmë që pa një vendim të formës së prerë, shpeshherë kemi thënë që askush më nuk mund të paragjykohet se është i dënuar.

Por të mos i japim kahe dhe dyshime, mbi të gjitha shpresë, të mos e quaj të rrejshme, por e cila po na krijon apo po na nxjerr në raporte konfliktuoze dhe me bashkësinë ndërkombëtare pa pasur nevojë duke tentuar që ne të dalim përmbi shembuj që kanë praktikën më të mira ndërkombëtare sa i përket sundimit të rendit dhe ligjit.

Kështu që unë besoj që ne edhe si Kuvend, por edhe ju si bartës të Ministrisë së Drejtësisë mendoj që duhet të krijojmë atë që e kam theksuar edhe më parë, edhe në deklaratimet publike, një rishikim funksional të sistemit të drejtësisë në tërësi dhe të vijmë deri te një përfundim komplet i ngritjeve të kapaciteteve dhe infrastrukturës edhe ligjore, edhe njerëzore, sidomos për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin në Republikën e Kosovës. Sepse pjesa tjetër që po ndërlidhet me atakimet publike, edhe përdorimet apo keqpërdorimet qoftë nga individë dhe nga struktura politike, po duket që po bartet nga një derë në derën tjetër.

Kohë më parë e kishim aferën “Pronto”, sot ishte afera “Pronto” e një subjekti tjetër politik, nesër sigurisht që do të jetë afera “Pronto” e ndonjë subjekti tjetër politik, por drejtësia nuk do të funksionojë dhe nuk do ta japë fjalën e vet.

Këto janë ato që unë mendoj që duhet të jenë pjesë e debatit të këtij Kuvendi, e sidomos e Komisionit përgjegjës Funkcional, të Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti deputet, Rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit e kemi lansuar më 9 mars dhe jam shumë i bindur që do të arrijmë ta përfundojmë deri në fund të vitit të ardhshëm. Shpresojmë që rekomandimet e këtij rishikimi do të arrijmë t’i zbatojmë.

Sa u përket pyetjeve që i ngrite, pa dyshim që nuk kemi pasur dispozita ligjore të cilat kanë penguar edhe një angazhim më të madh edhe të agjencive që zbatojnë ligjin në luftë kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Mirëpo, edhe ne, nëse e miratojmë sot, besoj që do ta miratojmë Kodin Penal, nëse nuk e miratojmë Kodin e Procedurës Penale, Projektligjin për konfiskim të pasurisë së pajustificueshme, Projektligjin për sinjalizuesit apo kallëzuesit, Projektligjin për deklarimin e pasurisë, Projektligjin për mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsion, unë nuk besoj që do të arrijmë efektin.

Në anën tjetër, po ashtu nëse nuk vazhdojmë t’i përkrahim agjencitë ligjzbatues në rritjen e stafit të tyre, ne vetëm në këtë vit do t’i shtojmë pushtetit gjyqësor edhe 40 gjyqtarë të rinj. Aktualisht Kosova ka 399 gjyqtarë dhe gjatë këtij viti do të shtohen edhe 40 të rinj.

Unë besoj që edhe ato 300 vende të reja në kuadër të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial për vitin 2018 do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit në luftë kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Pra, në njërin anë, përkrahja financiare për këto agjenci dhe, në anën tjetër, plotësim-ndryshimi i këtyre politikave jam i bindur që do të arrijmë me efikasitet më të madh ta luftojmë krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe të arrijmë t’i konfiskojmë asetet, të cilat janë fituar në mënyrë të paligjshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Blerta Deliu, nëse është e gatshme.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

I nderuar ministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta një pjesë të vogël të argumenteve, sepse një numër i madh i tyre u thanë, por mendoj që projekt-kodi është njëri prej projektligjeve më të rëndësishme që hyjnë në kuadër të përmbushjes së reformave të procesit të integritetit evropian.

Reforma, të cilat janë bërë brenda projekt-kodit, por edhe ndryshimet që kanë ardhur me këtë projekt-kod kanë të bëjnë kryesisht me sigurinë, me rendin politik në Kosovë, e sidomos me luftimin e krimit të organizuar, të korrupsionit dhe të terrorizmit.

Dokumenti u tha edhe më herët që është kërkuar në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane, me qëllim të avancimit të luftimit të krimit të organizuar, të korrupsionit si dhe të vetë terrorizmit.

Ndryshimet në këtë projekt-kod, por edhe në projektligjet e pakos së gjyqësorit kanë qenë kërkesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, po ashtu një numër i madh i tyre janë kërkuar edhe në Raportin për vendin, por edhe në Agjendën e Reformave Evropiane.

E kur jemi këtu do të përmend vetëm dispozitat që kanë të bëjnë kryesisht me të akuzuarit apo të dënuarit për vepra korruptive, të cilat ndryshe që janë bërë në këtë projekt-kod natyrisht që do të jenë hap lehtësues për luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit, por gjithsesi edhe për fuqizimin e sundimit të ligjit, si njëri prej kriterëve kryesore për një shtet demokratik dhe shtet prosperues në rrugëtimin e tij evropian.

Po ashtu, si deputete e Parlamentit natyrisht që më vjen tepër mirë që një nen i veçantë për herë të parë sanksionon çështjen e dhunës, jo dhunës seksuale, se u përmend dhuna seksuale, por çështjet e rasteve të dhunës në familje, ku sanksionet do të arrijnë deri në tre vjet.

Po e përmend këtë se nëse i shohim statistikën e vitit 2017, janë gjithsej 1196 raste të dhunës në familje, të raportuara, por çka ndodh me ato raste të cilat nuk janë të raportuara, sepse statistikën jo gjithmonë i raportojnë të gjitha rastet. Prej tyre janë të proceduara në prokurori 1134 raste, prandaj besoj shumë që ndryshimet të cilat do të vijnë me këtë projekt-kod do t'i trajtojnë edhe këto raste, sepse kemi pasur edhe raste të vrasjeve si pasojë e dhunës në familje, të cilat jemi munduar t'i adresojmë në seancat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lus ministrin e Drejtësisë që të jetë i vëmendshëm karshi mekanizmave implementues të këtij projekt-kodi, në mënyrë që ky projekt-kod të arrijë të prekë shumë segmente, të cilat do t'i

trajtojë me shumë seriozitet dhe natyrisht dua të përgëzoj ministrin për punën e mirë dhe për koordinimin ndërinstitucional që ka pasur me të gjithë aktorët.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Adem Mikullovc i ka fjalën. Nuk është, atëherë zonja Time Kadrijaj.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Është e vërtetë që është një projektligj i rëndësisë së veçantë dhe është pritur që do të silltet këtu në Kuvend, po mua po më befasojnë disa deputetë, duke i ditur procedurat parlamentare që sot po i adresohen ministrit, duke i thënë pse s'e ke bërë këtë ndryshim ose këtë ndryshim ose pse s'është kështu? Unë rikujtoj se më ky projektligj nuk është i Qeverisë, po është i Parlamentit të Kosovës dhe deputetët janë ata që mund t'i ndryshojnë të gjitha ato çka sot po i thonë.

Për shembull, ju i dini procedura administrative, sidomos tash ky do të jetë në dorën e Komisionit për Legjislacion dhe si procedurë është organizimi i dëgjimit publik, ku do të ftohen edhe ekspertë të ndryshëm, edhe njerëz që do të merren edhe me implementimin e këtij ligji, por edhe përfaqësues nga shoqëria civile, ata japin mendime dhe amendamentet e tyre, po njëkohësisht edhe deputetët që nuk janë anëtarë të komisionit kanë të drejtë të amendamentojnë ndonjë kërkesë ose ndonjë amendament në Kodin Penal dhe në mënyrë që të bëhet një ligj sa më i mirë, sa më i zbatueshëm dhe jo sot t'i drejtohem ministrit se pse është kështu, apo pse s'është bërë kështu? Është në dorën e deputetëve, atëherë gjithsecili ta kalojmë me praktikën e mirë. Secili deputetë që folët, le të bëjë amendamente, le t'i dërgojë në Komisionin për Legjislacion, organizohet dëgjimi publik, të gjitha ato vërejtje që mendohet që janë të mira le të përfshihen, janë të mirëseardhura për t'u përfshirë, për të qenë ky një ligj sa më i mirë dhe i implementueshëm, dhe mendoj që sot s'kemi nevojë që për ato tjerat t'i adresohemi Qeverisë, sepse në momentin që projektligji ka ardhur në Kuvendin e Kosovës është projektligj i deputetëve dhe i Kuvendit të Kosovës. Është në dorën e deputetëve për amendamentim dhe për rregullim të këtij projektligji, ashtu siç po mendojmë ne. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

**KORAB SEJDIU:** Përshëndetje edhe një herë, tash në emrin personal.

Të ndërlidhem me një diskutim më herët lidhur me kriminalizimin e shpifjes, ata pak imunitet që na ka mbetur neve si deputet në fakt e mbulon atë që e themi këtu, dhe së dyti e vërteta gjithmonë është mbrojtje ligjore ndaj shpifjes, pretendimeve për shpifje.

Por, sa i përket Kodit Penal, unë më herët u referova për nevojën për kohë pak më shumë, ose jo për trajtim të përshpejtuar të Projekt-kodit Penal dhe arsyeja është se në fakt po kemi ankesa goxha të mëdha në Komisionin për Legjislacion për kualitetin e ligjeve që po na vijnë, e kjo ndërlidhet edhe me atë që u përmend më herët, do të thotë sa janë përkthimet e duhura, që i



kuptojmë kufizimet që i ka edhe ministria, mirëpo në rastin konkret, duke pasur parasysh se e kemi një ligj, me të cilin përcaktohen veprat që shoqëria jonë i cilëson si të tilla, që nuk mund të kalojnë pa sanksionim penalo-juridik, atëherë kujdesi duhet të jetë më tepër i shtuar edhe në përkthimin, ose gjuhën që përdoret, që të jetë e njëjtë në dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, pasi gjasat janë që edhe të pandehurit pastaj të kërkojnë që, si të themi, të aplikohet cilado, gjuha serbe ose shqipe, varësisht cila është më e favorshme për ta.

Por, sidoqoftë duke pasur parasysh këtë balancë edhe që po kërkohet këtu në njërën anë ndërmjet dëshirës e vullnetit për t'i luftuar elementet kriminale në vendin tonë, qoftë korrupsioni, apo diçka tjetër, në të njëjtën kohë në anën tjetër e kemi shqetësimin tonë, ose dëshirën dhe vullnetin tonë për respektimin e plotë të drejtave të njeriut. Kështu që ne duhet të kemi kujdes të veçantë për t'i trajtuar këto dyja, veçanërisht duke pasur parasysh rrethanat e Kosovës, pra faktin që normat, të cilat i kanë përcaktuar për shembull për prokurorët, po i shtojnë ata që shpeshherë që të ngrenë aktakuza ndoshta edhe të pabazuara, vetëm e vetëm që të mbërrihet norma dhe të them të drejtën sot u përmend për shembull çështja e të gjitha këtyre gjërave pse s'po bëhet mjaft për ta zbatuar Kodin, ne gjithmonë duhet të mundohemi që edhe ligjet t'i përmirësojmë, do të thotë ky kod shkon në atë drejtim, por besoj ndoshta edhe kritikant nuk janë të drejtuara në drejtimin e duhur për ankesën e zbatimit, pasi ato janë përgjegjësi e organeve tjera. Por, për ne si Parlament, ne duhet të kemi shumë kujdes që ta gjejmë balancën e duhur ndërmjet ofrimit të mjeteve të punës për ata, të cilët do ta zbatojnë këtë kod, pra që të luftohet korrupsioni, të luftohen dukuritë negative të shoqërisë sonë, por në anën tjetër të kemi shumë kujdes që në një shoqëri sikur tek ne, ku për shembull ndoshta mbi 90% e aktakuzave kalojnë, as nuk shqyrtohen në seancën e parë dhe të dytë nga gjykatat, edhe pse e kanë obligim ligjor që ndoshta edhe do ta diskutojmë kur të vijë Kodi i Procedurës Penale dhe natyrisht personat me apo pa bazë futen në procese 2-3-vjeçare dhe është shumë shqetësuese kur shkon një person dhe ndoshta edhe i shkatërrohet jeta, karriera e kështu me radhë, edhe pse aktakuza është ngrehur pa bazë.

Kështu që unë prapë them që duhet të kemi shumë kujdes kur e trajtojmë këtë kod dhe shpresoj që t'ia japim kohën e duhur vetvetes që t'ia japim shqyrtimin e merituar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

I nderur ministër i Drejtësisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht mendoj që përpara agjendës evropiane që ne duhet të bëjmë reforma në sistemin tonë të drejtësisë është interesi i qytetarëve, interesi i këtij vendi dhe të ardhmes të tij që ta kemi një sistem të drejtësisë, i cili është efikas dhe i drejtë dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve tanë.

Dhe, pastaj sigurisht që kur të kemi sistem të drejtësisë, ne në fakt do ta kemi një shtet të drejtë, shtet juridik atëherë agjenda jonë evropiane as që do vihet në diskutim, do të vijë vetvetiu.

Pasi në disa debate dhe në disa diskutime të mëhershme kam paraqitur disa prej shqetësimeve që ndërlidhen me Kodin Penal, do t'i paraqes edhe këto, por edhe do t'i paraqes edhe si amendamente por t'ia bërë ministrin me dije sa u përket këtyre amendamenteve dhe vetë hartuesit të këtij Kodi Penal, që e konsideroj një prej dokumenteve më të rëndësishme, pas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pra, kërkoj rritjen e masave ndëshkimore për falsifikuesit dhe kontrabanduesit e barnave dhe të pajisjeve mjekësore; rritjen e masave ndëshkimore për të gjithë ata persona që tregtojnë produkte të dëmshme ushqimore me të cilët edhe krijohet rrezikshmëria e lartë. Ne kemi debatuar këtu në Kuvend për produktet e mishit, të cilat janë futur në Kosovë, të cilat s'e kanë plotësuar asnjë kriter dhe tani është radha që me Kod Penal ne të paraqesim masa ndëshkimore të rritura për atë, sepse deri më tani praktika e njeh që ata që kanë tregtuar produkte të dëmshme ushqimore nuk janë ndëshkuar, sepse të gjitha rastet e tyre pothuajse janë parashkruar për shkak se masa ndëshkimore ka qenë shumë e ulët, prej tre muaj e deri në 3 vjet maksimum, dhe të gjithë, edhe falsifikuesit, edhe kontrabanduesit e barnave dhe pajisjeve mjekësore, deri më tani janë të pandëshkueshëm nga ligji, sepse pothuajse në 95% të rasteve lëndët e tyre janë parashkruar dhe tani kërkoj që kjo të rritet me Kodin Penal, që pastaj të mos kemi parashkrime të këtyre rasteve, sepse dëmtimi i shëndetit për qytetarët e Republikës sonë është i madh.

Çështja tjetër që kërkoj të jetë me rëndësi ose të jetë pjesë e këtij Kodi Penal, gjithashtu është kurdisja e ndeshjeve sportive. Për shkak se në hartimin e Ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe dukuritë tjera negative ne kemi pasur vështirësi, sepse nuk kemi pasur ku t'i marrim masat ndëshkimore, sepse kurdisja në Kodin e kaluar Penal nuk ka qenë e paraparë si vepër penale. Dhe, në këtë rast kërkoj që vërtet të ketë një diskutim më të gjerë publik, jo vetëm për këtë çështje, por sepse mund të ndodhë prapë që të harrohet edhe ndonjë dukuri tjetër devijuese në shoqërinë tonë dhe të mos jetë e paraqitur gjithsesi ajo pastaj në Kodin Penal. Pra, duke pasur parasysh që e kemi bërë një ligj të mirë për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive tjera negative në ngjarje sportive, të cilit i kanë paraprirë edhe në Kodin e kaluar Penal paraqitja apo veprat penale të huliganizmit, mendoj që tash kjo veç mund ta plotësojë në këtë sferë.

Ne në këto ditë kemi diskutuar edhe për të drejtat e punëtorëve, edhe për shkeljen e të drejtave të punëtorëve. Gjithsesi më motivon edhe më shumë një mesazh i një mikut tim, i cili punon si kamerier në njërin prej kafeneve të Prishtinës, po e kursej prej emrit, i cili më tha: "Shikoje, e kam postuar në Facebook çka më ka ndodhur realisht. Kam punuar 72 muaj, kam shkuar ta nxjerr Trustin, sepse më duhet më vizë, e kur e nxjerr Trustin më del që pronari im ka paguar vetëm 4 muaj në Trust për mua. Çka të bëj tutje?". Domethënë, mospagesa e tatimit dhe e Trustit

për punëtorët është vepër penale, por ajo nuk ndëshkohet. Dhe, kërkoj që edhe te mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, e në veçanti shkelja e të drejtave të punëtorëve, aty ku mohohet e drejta e realizimit të tyre, nën një, dhe nën dy, kur rrezikohet shëndeti i punëtorëve në punë, kjo duhet të përfshihet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Dhe, për të folur shkurt dhe të mos e zgjas më tutje, do të duhej ta bënim një debat të thellë pa akuza ndërmjet vete sa i përket shpifjes. Kodin e kaluar Penal e kemi hequr dhe e kemi hequr për shkak të trysnisë së medias. A duam ta futim shpifjen si vepër penale, apo jo? A duam ta lëmë dikë që ta vazhdojë në vazhdimësi të shpifje dhe të mos ndiejë kurrfarë përgjegjësie, sepse përveç ne si politikanë e deputetë që jemi të atakuar nga shpifja, edhe vetë pronarët e medieve kanë filluar pastaj ndërmjet tyre të shpifin për njëri-tjetrin. Do të ishte tash edhe në interes, sepse kur e kanë parë që pa një vepër penale të shpifjes, edhe ata ndërmjet tyre po shahen e po shpifin, unë besoj që tani edhe ata pak e shikojnë këtë çështje si më të rëndësishme. Unë e di se disa veç një vit po ta parashohin dënimin për shpifje, dikujt do t'i ishin dashur 200 vjet për t'i kryer dënimet, sepse aq shumë shpifin dhe janë të pandalshëm në ato shpifjet që i bëjnë. Mendoj që para së gjithash duhet ta diskutojmë edhe në komisionin parlamentar, por edhe vetë si deputetë pa atakime politike, por në interes të asaj që vërtet të dominojë dhe të fitojnë e vërteta dhe e drejta. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** Zoti Haxhiu, ti merresh me sport dhe me mjekësi njëkohësisht, të dyja bashkë, por pak i ke lexuar këto besoj. Të gjitha këto që i përmende janë të përfshira edhe në Kodin aktual Penal, edhe në këtë të riun, vetëm ndeshjet sportive, pra kjo është risi në kodin e ri që do të përfshihet, kurdisja pra. Ndërsa, të gjitha këto tjera çka i përmende, të mos i listoj, ato janë edhe në Kodin aktual, ngritja e dënimeve i prek edhe ato, edhe kontrabandimin, edhe çështjet tjera që i ceke ti. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Haxhiu, kundër-replikë!

**BEKIM HAXHIU:** Jo, unë e përgëzoj ministrin për punën që e kanë bërë. Nuk është në kuptimin e asaj një replikë, apo kundër-replikë. E di që janë, për atë e thashë janë parashkruar rastet, sepse ndëshkimet kanë qenë të vogla dhe domethënë në vazhdimësi kam kërkuar rritjen e këtyre masave ndëshkimore për ata të cilët e dëmtojnë shëndetin, duke tregtuar produkte të dëmshme ushqimore dhe ata që kanë futur në treg dhe kanë falsifikuar barna dhe kanë bërë kontrabandimin e barnave. Kjo ka qenë në vazhdimësi një prej shqetësimeve të mia të vazhdueshme në ngritjen e problemeve në shëndetësi dhe shfrytëzoi rastin, i nderuar ministër, që t'i parashkruani edhe kompetencat e prokurorëve dhe gjykatësve të odave të profesionistëve shëndetësorë, sepse ka mbetur e paqartë me Ligjin e odave të profesionistëve shëndetësorë parashihen prokurorët dhe

gjykatësit, por që duhet të harmonizohet apo të rregullohet çështja e kompetencave tyre me këtë legjislacion. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Mikullovc i ka fjalën.

**ADEM MIKULLOVCI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dua të them, e ju e dini që nuk jam jurist, e shfletova materialin dhe u mundova të marrë vesh sipas logjikës disa gjëra, po shkurt nuk më pëlqeu fort se këtij Projekt-kodi s'po i vjen era shqip.

Mendoj që është dashur të mbështeten ata ekspertët e juaj, zoti Abelard, pak edhe me kanun, pak edhe në traditën e pleqnarëve. Pleqëria jonë i ka zgjidhur konfliktet që s'ka ditur as një jurist t'i zgjidhë, posaçërisht u ndala në dhunën familjare.

Të kuptohemi, për dhunën familjare, ky ligj nuk mund të aplikohet si në Angli, në Amerikë, e me ata tjerët atje. Ne jemi tjetër dhe duhet t'u tregojmë që jemi tjerë. Ta marr veç një shembull, sipas këtij kanuni, sipas këtij ligji, këtij Kodi, nëse gruaja e padit burrin, e burri shkon dy vjet në burg, e kur kthehet prej burgu, a e pret ajo grua në shtëpi? Hajt, më tregoni!

Mandej, le të flasim ata çka të duan, pa i rrahur fëmijët, fëmija nuk bëhet "terbie", badihava më flitni ju mua për dhunën në familje. Mandej, unë këtu e përkrah plotësisht Milaim Zekën, mendoj që pak tepër po mundohemi të bëhemi anglezë, siç thotë ajo fjala popullore "më katolik se Papa".

Nuk po i vjen era shqip, e kjo më ka penguar, të jua them të drejtën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bilall Sherifi.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Tamam besova që Kamishi i mori titujt e portaleve, se krejt atë fyerje e pati për të ardhur në fund te shpifja dhe t'i marrë titujt e portaleve, e kur doli baca Adem Mikullovc, e mundi Kamishin për tituj, por ministër, ju e dini që në komision, e kemi pasur rastin edhe në Grup Punues, edhe në komision, që të bashkëbisedojmë me ju për këtë ligj dhe besoj që vërejtjet që i kemi thënë në komision vazhdojnë të qëndrojnë, por jo në esencë. Mendoj që Projekt-kodi Penal nuk është ligj i cili e merr shumë parasysh as hapësirën, as kulturën e vendit tonë, as mentalitetin. Është kryesisht një ligj i cili është dhe duhet gjithsesi t'i përshtatet ambicies sonë për rrugëtimin tonë drejt integritimeve euroatlantike, drejt integritimeve në Bashkimin Evropian.

Pra, është një ligj për të cilin nuk kemi nevojë shumë që të diskutojmë se çka duhet të pranojmë dhe çka nuk duhet të pranojmë. Çka është e pranueshme për shoqërinë tonë dhe çka nuk është e pranueshme? Nuk është njëjtë sikur ta zëmë Ligji për tregtinë e brendshme, ku ti ligjin ua

përshtat nevojave të ekonomisë, apo për tregtinë e jashtme, ku gjithsesi duhet t'ia përshtatësh ekonomisë tënde. Janë ligje të natyrave tjera. Ky është një ligj që kryesisht ka përmasa universale. Veprat penale në një shtet demokratik, të cilat parashihen me këtë Projekt-kod Penal, janë të njëjta si në Zvicër, si në Gjermani, terrorizmi ndiqet si në Gjermani, si në Kosovë. Korrupsioni, krimi i organizuar duhet të ndiqet si në Gjermani, si në Kosovë. Pra, në aspektin e rregullimit të ligjit për të ndjekur, apo për t'i sanksionuar të gjitha këto dukuri negative kriminale, mendoj dhe besoj që këtu nuk kemi dallime nga ata dhe prandaj nuk ka gjë të keqe nëse dispozitat e tilla edhe të jenë përkthyer. Asgjë të keqe nuk ka.

Ideja është, a kemi arritur që ato dispozita, qoftë nëpërmjet atyre grupeve punuese me 50 ekspertë, qoftë me gjuhëtarët, lektorët te ministria, që t'ia përshtatin natyrës së gjuhës shqipe. Jo, a kemi arritur t'i përkthejmë mirë, por a kemi arritur t'ia përshtatim natyrës së gjuhës. Këtu mendoj që ka pasur nevojë dhe konsideroj që ende ka nevojë që të punohet më tepër. Disa shprehje, të cilat në gjuhën angleze e kanë një kuptim më të thjeshtë, por në gjuhën tonë shpeshherë nevojitet, apo edhe anasjelltas, për të thënë të njëjtën gjë të përdorësh më shumë se një, ose dy fjalë, shpeshherë ndoshta edhe dy-tri fjalë për ta nxjerrë idenë se çka tenton të rregullojë ligji, sepse ta kemi parasysh që ky ligj nesër do të jetë në duart e prokurorëve dhe të avokatëve dhe për të cilët përballë do ta kenë një gjykatës. Nëse ndryshe kuptohet nga prokurori një dispozitë, ndryshe interpretohet për faktin se kuptohet ndryshe edhe interpretohet ndryshe nga një avokat, atëherë shtrohet pyetja cili do të jetë interpretimi i gjykatësit, një interpretim krejt i tretë i asaj dispozite?

Pra, edhe në komision ju kam thënë, edhe tani po ju them, le të angazhojmë gjuhëtarë të mirë tani, në këtë fazën që na ka mbetur që ligji t'ia përshtatet gjuhës, të cilën nesër do ta kuptojnë njëjtë sikur prokurori, sikur avokati, sikur gjykatësi, sepse ky është trekëndëshi, i cili do të punojë me këtë ligj, por puna e mirë apo puna e keqe që mund të bëhet si produkt i këtij ligji do të bjerë pastaj në shpinë, në kurriz të atyre që, edhe pse mund të jenë shkelës të ligjit, Kushtetuta gjithsesi që ua garanton të drejtën për një gjyq të drejtë dhe fer. Pra, kuptojeni dhe besoj që ashtu e keni kuptuar edhe në komision, edhe ju si ministër, por edhe Qeveria, këtë insistimin tonë si një përpjekje që ta bëjmë një ligj të mirë. Të mos kemi nevojë pas një viti apo pas dy vjetëve nëpër sallat e gjykatave të vijmë në përfundim që kemi vështirësi në implementim për shkak të mënyrës sesi është shkruar, për shkak të përshtatjes së dobët të gjuhës në të cilën do të zbatohet nesër.

Ndërsa, sa i përket pastaj përshtatjes edhe në gjuhën serbe, të cilën e kanë ngrehur edhe kolegët nga komuniteti serb, besoj për atë duhet të ngrihen kapacitete, vetë keni thënë, edhe Kuvendi, edhe ministria, duhet t'ia ngrenë kapacitetet, sepse në fazën në të cilën po hyjmë shumë ligje do të kenë nevojë të përshtatën dhe në këtë drejtim duhet të punohet më shumë. Kështu që unë ju pata thënë, po e përsëris edhe një herë, sikur ligji të mos i kishte këto lëshime, këto vërejtje në aspektin ideologjik, apo në aspektin përmbajtjesor, nuk do të kishim shumë vërejtje, s'besoj

asnjë nga grupet parlamentare, sepse të gjithë jemi në një zë, të gjitha grupet parlamentare të 120 deputetëve në rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian. Pra, rrjedhimisht, nuk kemi asnjë problem me veprat penale, të cilat i sanksionon dhe mënyrën se si ky Projekt-kod pretendon t'i ndjekë.

Unë uroj dhe insistoq që para se ligji të marrë formë të prerë dhe të hyjë në fuqi spektri gjuhësor, i cili shpeshherë pastaj ndikon edhe në përmbajtjen e ligjit, sidomos në momentin kur ai interpretohet, të jetë i njëjtë, si për avokatin, si për prokurorin, si për gjykatësin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Replikë, zoti Adem Mikullovc!

**ADEM MIKULLOVCI:** Faleminderit!

Të lutem, zoti Bilall, ki kujdes kur diskuton, mos ma përmend emrin, mos më fut në bela me hallkun, se unë s'e pata ndërmend ta mund askënd, e po del ky po ma zë pritën, po më bën "kahre". Përndryshe, zoti ministër Abelard, derisa të mbështeteni në ligjet ndërkombëtare, kurrë ligj të hairit për Kosovën s'keni për të bërë.

**KRYESUESI:** Kundër-replikë, Bilalli!

**BILALL SHERIFI:** Jo, veç t'i kërkoj falje bacës Adem, nuk ishte qëllimi që ta fus konflikt me Kamishin. Jo, kërkoj falje!

**KRYESUESI:** Zonja Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ju ministra,

Përshëndetje për ju kolegë deputetë,

Të gjithë bashkë sot po e diskutojmë në parim Projektligjin ose projektin më të madh mendoj legjislativ, për sistemin e drejtësisë në vend dhe kisha dashur ta përgëzoj ministrin, si dhe gjithë stafin e tij që kanë punuar në ndryshimin e mbi 100 neneve në një projektligj, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për çdo shtet, mirëpo veçanërisht për ne në këtë fazë si shtet është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Jo të gjithë i takojmë sferës juridike këtu, mirëpo edhe nëse me fjalor juridik nuk i paraqesim kërkesat tona, mendoj që këto kanë për t'u kuptuar drejt se çka kemi nevojë ne si deputetë për të parë ndryshime dhe mirë që e kemi ministrin të pranishëm dhe gjithmonë ka qenë transparent, non stop prej fillimit të punës së tij. Unë e përgëzoj edhe si deputete, edhe si bashkëpartiake, sepse brenda grupit parlamentar kur kemi nevojë për sqarime është jashtëzakonisht i gatshëm të bashkëpunojë me ne.

I nderuar ministër,

Për të qenë kontinuve, para disa ditësh ne e patëm një ngjarje jashtëzakonisht makabër që na trishtoi të gjithëve, domethënë vrasja e fëmijës edhe unë nuk do të hyj në asnjë nen tjetër. Duke ju përgëzuar që keni vendosur për herë të parë ta vëni si nen të veçantë, ta trajtoni dhunën në familje, unë e ripërsëris, po e them edhe një herë, dhe do të jem kontinuve në kërkesat që mendoj se është dënim shumë i vogël. Po e përsëris, pra ju përgëzoj që e keni vendosur për herë të parë si nen të veçantë, që ta trajtoni dhunën në familje.

Mirëpo, edhe unë si kolegët e mi, që të kursehem prej një amendamenti, nëse keni durim të më sqaroni konkretisht. Për shembull, tek vrasjet makabre të fëmijëve, si do të penalizohen ata njerëz kur s'janë recidivistë. Unë e dëgjova shumë mirë kur i dhatë sqarimin një deputeti te rastet e dhunës në familje, por mua po më intereson tek rasti i fëmijëve. A ka mundësi të ndryshohet këtu, të ketë të veçantë, sepse megjithatë konsideroj se vrasjet e qëllimta nga njerëz që nuk kanë vepra recidive të mëhershme, por e bëjnë me vetëdije, qysh trajtohen? A është mjaftueshëm? A ndryshon? A është rritur dënimi prej kodit të vjetër? Faleminderit shumë!

Njëkohësisht, edhe një herë po e ripërsëris, unë të falënderoj që na ke sqaruar me një fjalor shumë të thjeshtë, i kemi kuptuar të gjithë ndryshimet që kanë ndodhur. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Po, ministri e ka një sqarim shtesë.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** E nderuara zonja deputete, E thash edhe më herët, vrasjet në familje me kodin aktual nuk kanë qenë rrethanë rënduese dhe minimumi i pragut ka qenë 5 vjet dënimi për vrasje, ndërsa tani vrasja në familje me projekt-kodin që e kemi propozuar është rrethanë rënduese, që minimumi është 10 vjet.

Me projekt-kodin aktual ne e kemi dënimin që është deri në 40 vjet burg, ndërsa me propozimin e ri kemi dënimin e përjetshëm, që do e bëjmë. Dhe, këtu varësisht pastaj është çështje e gjyqtarit si e vendos se si do ta trajtojë, rrethanat, procesin si ka ardhur deri aty e të gjitha këto çështje tjera, që besoj se nuk më takon mua të komentoj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

**MUHARREM NITAJ:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Unë do të jem shumë i shkurtër.

Është hequr shpifja nga Kodi Penal. U fol sot për shpifjen. E mora fjalën sa për të ju sugjeruar që të mos e hapim këtë temë, këtë materie, dhe ta konsiderojmë kapitull të mbyllur.

Zoti ministër i Drejtësisë, Kam përshtypjen që duhet të jepni njëfarë lloj sqarimi për këtë çështje, thjesht për ta mbyllur debatin. Zoti nënkryetar i Kuvendit, ministri i Drejtësisë është i pranishëm në sallë, por kam përshtypjen se nuk po e dëgjon fare se çfarë po i kërkojmë.

Ministër, po e përsëris edhe një herë. Shpifja është hequr nga Kodi Penal. U përmend këtu që njëfarë lloj mundësie, qoftë edhe teorike për t'u rikthyer. Unë besoj se ky kapitull në stadin e zhvillimit të medias dhe të lirisë së shprehjes, që e kemi në Kosovë, do të duhej të konsiderohej kapitull i mbyllur. Thjesht, sa për ta mbyllur debatin për këtë çështje, do të kërkoja prej jush një sqarim për këtë çështje – për shpifjen dhe gjasat që të kthehet. Ishalla të mos kthehet! Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po më vjen mirë që një përfaqësues i medieve e ka parë çfarë ka mbështetur përpara, bashkë me shumë deputetë që janë këtu dhe që s'janë.

Unë mendoj para se ta përfundoj kam për obligim që në emër të administratës të ju njoftoj për procedurat, meqenëse u ngrit çështja dhe me kërkesë të administratës po ashtu, procedurat e sjelljes së ligjit dhe shqyrtimit të tij.

Një sqarim shtesë, po them, sa u përket procedurave të Projektligjit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës është kërkesë e administratës dhe unë vendosa t'ua plotësoj, që të ju sqaroj të gjithëve për procedurat që janë ndjekur gjatë shqyrtimit të projektligjit, projekt-kodit, tash po e quani kod. Kod e ligj...

Projektligji, Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës është proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 18 prill 2018. Në shkresën përcjellëse të Qeverisë nuk theksohet se duhet të procedohet me prioritet. Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës më 19 prill 2018 është dërguar për shumëzim. Gjatë periudhës 19 prill - 4 maj 2018 shërbimi i shumëzimit ka pasur 34 materiale (projektligje, raporte, rekomandime, e tjera). Në total janë shumëzuar 292 020 faqe. Për të shumëzuar për seanca plenare të caktuara, për mbledhjen e komisioneve plenare dhe për mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit.

Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës i ka 634 faqe që shumëzohet në 160 kopje, për të cilin është dashur 4-5 ditë për shumëzim. Administrata e Kuvendit nuk ka pasur të drejtë ta ndërpresë shumëzimin e materialeve tjera për seancat plenare të caktuara për mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe për mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit. Projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës më 4 maj 2018 u është shpërndarë deputetëve. Ministri i Drejtësisë nëpërmjet kryeministrit më 16 maj 2018 ka kërkuar nga Kuvendi që të përshpejtohet shqyrtimi i nismës ligjore të Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni Funkcional për Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2018 i ka shqyrtuar në parim dhe e ka paraqitur raportin.



Ky është historiku i shkurtër i procedimit të projekt-kodit dhe tani nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjalën e ka kërkuar kryetarja e Komisionit Funkcional dhe unë besoj se i takon fjala, para se ta marrë ministri.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Duke qenë se Komisioni për Legjislacion është i ngarkuar për ta shqyrtuar këtë Projekt-kod, sepse nuk do të flas për tema që u diskutuan këtu, për shkak se e kam përfunduar fjalën time. Por, u mundova që t'i përcjell me vëmendje të gjitha diskutimet e deputetëve të Kuvendit.

Ajo çfarë po ndodh është që ndonëse ne po kemi kritika në shumë projektligje si deputetë të Kuvendit, tani kur po kalon në parim një projektligj, në këtë rast edhe nëse kalon Kodi Penal, ne nuk po bëjmë amendamente. Pra, si deputetë nuk po procedohen amendamentet në komisionet funksionale.

Andaj, duke pasur parasysh faktin që shumë prej deputetëve të Kuvendit që morën fjalën, me përjashtim ata që kërkuan që shpifja të bëhet vepër penale, sepse natyrisht kjo është njëfarë regresi edhe me 'acquis communautaire', për shkak se vendet e Bashkimit Evropian nuk e kanë shpifjen vepër penale, pra është çështje civile. Mirëpo, të tjerat unë besoj se janë jashtëzakonisht të rëndësishme, sidomos sa i përket veprës penale të dhunës në familje.

Ka pasur një përpjekje të ndërmjetësuesve që në Ligjin për ndërmjetësim dhuna në familje të ndërmjetësohet. Komisioni për Legjislacion nuk e ka lejuar këtë. Pra, kanë kërkuar që, në qoftë se ka pasur dhunë në familje ndërmjetësuesi të ketë mundësinë ta pajtojë bashkëshortin dhe bashkëshorten. Kjo nuk është pranuar nga Komisioni për Legjislacion. Shumë shpejt ai projektligj do të vijë edhe këtu para jush. Mirëpo, unë i ftoj deputetët e Kuvendit, grupet parlamentare, që t'i adresojnë amendamentet në Komisionin për Legjislacion dhe për sa kohë ne nuk kemi kërkesë nga Qeveria për ta përshpejtuar këtë projekt-kod ne do të mundohemi që brenda afatit, siç e kemi paraparë me Rregulloren e punës së Kuvendit ta trajtojmë me seriozitet edhe të gjitha amendamentet e deputetëve, grupeve parlamentare, por edhe shoqërisë civile dhe institucioneve tjera të drejtësisë.

Andaj edhe një herë, brenda afatit dyjavësh ju lutem që t'i dërgoni të gjitha amendamentet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj se Komisioni për Legjislacion duhet t'i ketë 23 anëtarë dhe jo 11 dhe të shqyrtohet në komision, të debatohet në komision dhe jo në krejt Parlamentin për secilën çështje të flitet. Sidoqoftë, debati ka qenë i mirëseardhur. Nuk e di kush sa ka kuptuar nga gjithë ky debat. Besoj që ministri do të kërkojë që ne ta mbështesim dhe ta votojmë projekt-kodin. Fjalën e keni, zoti ministër!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Dua të ju falënderoj paraprakisht për mbështetjen!

Shoh një vullnet dhe një disponim që ta përkrahni këtë projekt-kod, ndërsa sa i përket çështjes që ngriti edhe zoti Nitaj, çështjes së shpifjeve, që tashmë besoj se është debat i mbyllur në vitin 2013, kur ka qenë si debat dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të trajtohen çështje të tilla, sepse vërtet paraqesin regres për Republikën e Kosovës.

Unë ju falënderoj edhe një herë të gjithëve. Jam i gatshëm që së bashku me komisionin, me deputetët tjerë nen për nen të gjitha këto 100 nene që i kemi rishikuar t'i rishikojmë edhe një herë. Mirëpo, ajo që është më e rëndësishmja, nenet që ndërlidhen me luftën kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit ato të mos preken, të mbeten ashtu siç janë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Veç desha edhe unë të bëj një pyetje. A jemi të obliguar ta zbatojmë projekt-kodin apo projekt-ligjin? Mirë, mirë, me Kushtetutë a jemi të obliguar me e zbatua kodin apo ligjin? Projekt-kod, tash e miratojmë kodin. Qytetarët a e zbatojnë kodin apo ligjin, sipas Kushtetutës, po them? Nuk ka kurrgjë të kodifikuar këtu. Ademi tha “thoni shqip”, veç e mbështeta idenë e zotit Mikullovc.

S’paskemi kuorum të mjaftueshëm, por po i shqyrtojmë kështu me radhë, pastaj edhe pak dhe e ndërpresim, nesër vazhdojmë prapë.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiar jobankare, gjegjësisht gjatë zbatimit të tij në praktikë janë hasur disa pengesa dhe vështirësi të natyrës administrative, procedurale dhe kushtetuese në zbatim të tij për institucionet mikrofinanciare.

Duke zbatuar këtë kornizë ligjore është parë e domosdoshme të ketë adresime më të qarta ligjore, si dhe adoptime sidomos në harmonizimin me standardet ndërkombëtare, si dhe harmonizimin

me ligjet tjera aplikative në vend e që kanë të bëjnë me përcaktimin e tregut relevant dhe organizimin adekuat të institucioneve mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Rrjedhimisht në funksion të përmbushjes së objektivave të Bankës Qendrore në ngritjen, zhvillimin dhe implementimin e infrastrukturës së cilësisë, me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të industrisë mikrofinanciare dhe jobankare, si dhe duka marrë parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 14 mars 2013 mbi shpalljen e pavlefshme të neneve 95, 90, 95 pika 1.6. 110, 111, 116 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat e institucionit mikrofinanciar dhe institucionet financiare jobankare, është paraqitur nevoja për hartimin e këtij projektligji, me anë të cilit njëkohësisht fuqizohet kreu i dytë i Ligjit nr. 04/L-093.

Andaj, si i tillë ky projektligj i ri, përveç tjerash, do ta rregullojë edhe fushën e institucioneve mikrofinanciare, të cilat bien ndesh me të drejtat dhe liritë e asociimit. Qëllimi kryesor i këtij projektligji ndërlidhet me objektivat e Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili ka për qëllim të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil.

Andaj, siç u theksua dhe më lartë, ndikimi dhe arsyeshmëria e hartimit të këtij projektligji i referohet avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore, si dhe evitimit të zbrazësive aktuale ligjore.

Ministria e Financave me këtë projektligj adreson qartë një varg kriteresh që duhet përmbushur për t'u licencuar një institucion mikrofinanciar apo institucion financiar jobankar, por që është më e rëndësishmja e vendos një kontroll e mbikëqyrje më të rreptë nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Siç e paraqita më lartë, nëpërmjet këtij projektligji janë dhënë edhe norma detyruese lidhur me nivelin e nevojshëm të qeverisjes në varësi të institucioneve duke përcaktuar kështu përbërjen e bordit të drejtorëve, kryeshefin ekzekutiv dhe minimumin e komiteteve përkatëse për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Më tej, ky projektligj përcakton shkaqet e administrimit zyrtar, si dhe kompetencat dhe detyrat nën administrim zyrtar duke përcaktuar dhe mundësitë e përfundimit të administrimit zyrtar, me qëllim të rikthimit të një qeverisjeje e cila siguron që biznesi i institucionit do të realizohet në mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë.

Pres diskutime të vlefshme nga ju, deputetë të nderuar. Pres kontribut në kuadër të komisioneve funksionale të Kuvendit dhe pastaj besoj se do të kemi një ligj, i cili e rregullon dhe e përmirëson këtë lëmi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! E ftoj kryetarin e Komisioni Funksional, zotin Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë raportin e komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Projektligji është si rezultat i shpalljes së pavlefshme të neneve 90, 95, 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 12 prill 2013, ku specifikisht janë shfuqizuar dispozitat që kanë rregulluar fushëveprimin e punës së institucioneve mikrofinanciare.

Projektligji për institucione të tilla rregullon çështjen e licencimit, veprimtarisë dhe mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Në bazë të këtij projektligji institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare licencohen nga BQK-ja. Për t'u regjistruar ato duhet fillimisht duhet të jenë të regjistruara si persona juridikë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë, ndërsa institucionet financiare jobankare duhet të jenë të regjistruara si shoqëri tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Sa u përket institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare ekzistuese, sipas nenit 43 parashihet që pas hyrjes në fuqi të ligjit ato do të funksionojnë me statutin e njëjtë dhe se licenca ekzistuese do të konvertohet në licencë të re të lëshuar nga BQK në pajtim me këtë ligj. Së këndejmi, me këtë draft-ligj siç është propozuar do të kemi dy lloje të institucioneve mikrofinanciare: ato që do të regjistrohen si shoqëri tregtare, institucionet mikrofinanciare me status të OJQ-ve ekzistuese dhe të cilat do të vazhdojnë veprimtarinë si deri më tani. Për ne kjo ka qenë problematike, sepse me këtë projektligj nuk rregullohet fare çështja e trajtimit të kapitalit, ose suficitit të akumuluar nga institucionet mikrofinanciare OJQ dhe nuk rregullohet çështja e pagesës së obligimeve tatimore, që institucionet tjera i rregullojnë.

Nisur nga kjo pikë ne në komision kemi filluar ndërtimin e grupeve punuese. Më duhet të njoftoj Kuvendin, që sot ne kemi mbajtur një takim të përbashkët edhe me Komisionin për Administratë Publike, sepse pjesa rregullimit të institucioneve mikrofinanciare OJQ është pjesë edhe e Ligjit të OJQ-ve. Për fatin e mirë, të dy ligjet, edhe Ligji i OJQ-ve, edhe Ligji i institucioneve mikrofinanciare janë duke u shqyrtuar në këtë periudhë në Kuvend dhe të dy ndryshimet mund të ndodhin paralelisht në të dy ligjet.

Ne po presim në ditët në vijim të konsultohemi bashkë dhe të marrim raportet e shkruara, edhe nga BQK-ja, edhe nga asociacioni i institucioneve mikrofinanciare, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile për të draftuar zgjidhjen përfundimtare, që i jep fund veprimit të deritanishëm, pra ekzistencës së mikrofinancave OJQ, pa paguar kontribute fiskale në Buxhetin e Republikës. Natyrisht, ligji nuk lejon që OJQ-të e ardhshme të veprojnë në kuadër të mikrofinancave. Besoj që në javët në vijim, bashkë me grupin punues të Komisionit për Administratë Publike do të paraqesim amendamente edhe për këtë ligj, por edhe për Ligjin për OJQ-të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë fjalën. Zoti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë dua të flas vetëm për çështjen që ka të bëjë me organizatat mikrofinanciare të regjistruara si OJQ.

Mendoj që kjo ka qenë pjesa më keq e organizuar në Kosovë dhe më keq funksionale që ka qenë prej se është vendosur UNMIK-u në Kosovë. Çfarë është bërë me këto institucione mikrofinanciare të regjistruara si OJQ, të cilat janë diku nja 16 apo 17 në Kosovë, përfshirë KEP-i FINC-a e shumë e shumë të tjera? Shumica e njerëzve në Kosovë nuk e dinë që ato nuk janë banka fare. Ato kanë shkëlur edhe rregulloret e UNMIK-ut, të cilat në atë kohë i kanë limituar që të mos japin kredi me vlera më shumë se 2 000 marka e që më pas u përkthye në vlera jo më shumë se 1 000 euro. Cila ka qenë, ose cila është logjika e organizatave mikrofinanciare? Është ideja që njerëzit të cilët nuk kanë asnjë kusht minimal për të marrë kredi prej bankave komerciale, atëherë t'u drejtohen organizatave mikrofinanciare, të regjistruara si OJQ për të marrë ndonjë kredi, e cila thënë kushtimisht “fukarenjtë” me i bë më pak fukarenj. Që i bie, me i marrë 2 000 marka, me e ble një bagëti, ose disa dele dhe me qumështin që shesin ta paguajnë atë kredi.

Dhe, ideja më pas cila është? Ato mikrofinanca kamatën që e marrin nga njerëzit ta rritin numrin e përfituesve, por jo të akumulojnë kapital privat, sepse OJQ-ja në parim nuk ka pronar. OJQ-ja është e anëtarësisë, nuk ka pronar privat. Dhe, çfarë ka ndodhur në Kosovë? Organizata të tilla të regjistruara si OJQ kanë dhënë kredi në vlera me qindra e mijëra euro ndoshta, po them për një person, sepse milionë mund të kapin për shumë persona, dhe me kamata. Çfarë kamata? Jo një e deri në 3% që kanë pasur obligim me Rregulloren e UNMIK-ut, po kanë dhënë deri në kamata 30%. Dhe, sot ne akoma s'kemi arritur ta rregullojmë këtë çështje.

Çfarë kemi bërë? Ata kanë vazhduar të funksionojnë, unë kam informata që vetëm një anëtar i një bordi, siç është KEP-i, ose FINC-a, merr deri në 15 000 euro mëditje kur të vijë në Kosovë, në takim të bordit të drejtorëve që ata e kanë brenda një organizate. Dhe, ne kur e trajtonim shpeshherë Ligjin për OJQ-të, na vinin disa përfaqësues të OJQ-ve që nuk kishin para për autobusë të vijnë e të diskutojnë për Ligjin për OJQ, ata na vinin me xhipa të tipave më të rinj, që i bie se ne diçka kemi huq në proces këtu. I kemi lënë... Çka ka qenë edhe një element tjetër? I kemi lejuar të regjistrohen me status të përfituesit publik, të cilët në fakt u kanë bërë konkurrencë jolojale bankave, sepse kanë qenë të liruara prej shumë tatimeve, të cilat bankat komerciale operojnë në Kosovë dhe kanë obligime që të paguajnë tatime. Dhe, ne i kemi lënë deri sot.

Mendoj që është koha kur duhet një debat goxha shumë i gjerë dhe për t'i dhënë përgjigje çka duhet të bëjmë me këto mikrofinanca, çka duhet të bëjmë me kapitalin që e kanë ato. Nuk ka

asnjë mundësi, që kapitali i tillë të transformohet në kapital privat. Nuk mundet kurrkush OJQ-në me e transferua statusin e tij në një subjekt tjetër. Parimet universale për lirinë e asocimit e thonë kështu: Në momentin kur një organizatë vendos të shuhet të gjithë kapitalin që ka, përfshi këtu edhe karriget, edhe ulëset, edhe lapsat kimikë, duhet t'ua shpërndajë organizatave që kanë misionin e njëjtë, gjithmonë në funksion të përfitimit publik, absolutisht jo individual.

Në Kosovë operojnë shumica e këtyre organizatave, madje kam informata që disa prej tyre veç tashmë e kanë transformuar edhe në subjektivitetin e tyre, se si e kanë bërë nuk e di, duhet hetuar këtu edhe prokuroria, sepse disa prej tyre tash kanë filluar, nuk po funksionojnë si OJQ, po si shoqëri aksionare, përkundër që Gjykata Kushtetuese i ka ndaluar këto, janë nja dy prej tyre, unë emrat sot s'po i përmend, po besoj që në trajtimin e mëtutjeshëm s'kemi qare pa i angazhuar këtu edhe Prokurorinë e shtetit, sepse unë e di, kemi pasur lobim të madh edhe në kohën kur trajtohej më herët edhe nga institucione shumë të rëndësishme ndërkombëtare, sepse FINCA e ka bazën në Uashington, KEP-i ka bazën në Uashington. Edhe tashti, a do të mund t'i rezistojmë ne atij lloj presioni? Unë mendoj që duhet ta bëjmë këtë.

Shumica e njerëzve këtu thonë, po t'i shohim shembujt në rajon. Nuk ka shembujt në rajon, përpos në Bosnjë që kanë funksionuar vetëm dy organizata mikrofinanciare, nuk ka, sepse këto janë shembujt tipikë të vendeve të varfra. Këto janë shembujt të Kamboxhias, Shri-Lankës, Uzbekistanit, në vendet ku njerëzit nuk kanë pasur potencial as një kredi ta marrin në bankat komerciale, sepse s'kanë plotësuar asnjë kusht, të gjithë të papunë, asnjë element i cili banka komerciale ia mundëson me pas qasje. Atëherë çka? Ka dalë një ide që të provojmë të funksionojmë për qëllime bamirësie. Ka pasur edhe ide që kapitalin që e kanë marrë t'u kthehet donatorëve, sepse këto organizata kur kanë filluar, kanë marrë donacion nga USAID-i, por donacioni në parim është i pakthyeshem. Ai jepet për një qëllim të caktuar dhe qëllimi vazhdon të funksionojë. Por në Kosovë kemi krijuar mundësi që ata ta keqpërdorin, të punojnë në kundërshtim me çdo parim të rregullt dhe tash jemi në një situatë kur ne duhet dhënë zgjidhje. Zgjidhja nuk është krejtësisht e lehtë, është goxha komplekse, sepse edhe t'i merret kapitali sot, shteti...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: A u bënë tamam...

DRITON SELMANAJ: Sepse shteti, edhe nëse mendon që t'i marrë ato para për qëllime bamirësie, është goxha problem edhe kjo.

Prandaj, neve na duhet një konsensus ndoshta edhe politik brenda vetë Kuvendit të Kosovës që këtë çështje të mos e referojmë në Gjykatën Kushtetuese, sepse kushdo që e referon, nesër do ta fitojë, sepse askush nuk ka të drejtë kapitalin e OJQ-ve ta marrë, ta nxjerrë në tender, ta shesë

ose ta drejtojë me qëllime qoftë për të drejtat e grave, qoftë për jetimore, qoftë për këto e këto, sepse mund të thirren për raste të tilla. Neve na duhet një konsensus politik që t'i japim një zgjidhje atipike, sepse s'ka shembuj të tillë, duhet parë Kamboxhian ose Sri-Lankën si e kanë bërë, që s'po besoj që janë shembuj të mirë dhe në kapitalin e tillë ta vëmë në funksion të qëllimeve të mira për këtë shoqëri.

Nëse i lëmë ato të funksionojnë kështu, jemi duke e shkelur Ligjin për bankat, jemi duke e shkelur edhe Ligjin për OJQ-të, ligjet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë këtu edhe Kushtetutën e Kosovës.

Sepse qëllimi për përfitim publik e cenon rëndë cenimin për përfitim privat, nuk shkojnë këto të dyja bashkë, janë krejtësisht antagonistë me njëra-tjetrën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Safete Hëdergjonaj e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe si grup do të përkrahim rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për miratim në lexim të parë, po mendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është që ky projektligj ka nevojë të përmirësohet dhe ne do të japim kontributin tonë në procedura të mëtejme në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që të gjitha mikrofinancat të kenë rregulla të njëjta të licencimit, të funksionimit dhe të mbikëqyrjes së tyre, ashtu që këto institucione të kontribuojnë në stabilitetin e sistemit financiar si dhe të jenë në shërbim të klientëve të tyre.

Që nga viti 2012, kur Gjykata Kushtetuese i ka shfuqizuar disa nene të Ligjit për bankat të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, çdo tentativë për të rregulluar mënyrën e funksionimit, mbikëqyrjes dhe veprimtarinë e mikrofinancave është përcjellë me reagime të shumta qoftë nga organizatat joqeveritare, deputetët dhe institucione të caktuara, të cilët në një farë mënyre janë bërë edhe pengesë për hartimin dhe miratimin e këtij ligji.

Unë përgëzoj Qeverinë që më në fund e ka sjellë në Kuvend këtë projektligj, mirëpo edhe me këtë draft nuk zgjidhet problemi i mikrofinancave, të cilat janë të regjistruara si OJQ dhe kanë statusin e beneficuar, realizojnë profit dhe nuk i paguajnë tatim shtetit, sepse e kanë statusin e organizatës joqeveritare jofitimprurëse, që është e rregulluar me Ligjin për lirinë e asociimit të organizatave joqeveritare.

Meqenëse në Kuvend i kemi të dy projektligjet, në të njëjtën kohë, atë të lirisë së asociimit të OJQ-ve dhe Projektligjin për institucionet mikrofinanciare, nëpërmjet këtyre dy ligjeve ne duhet të vendosim se cili do të jetë roli i institucioneve mikrofinanciare në sistemin financiar nëse dum të kemi sistem financiar të qëndrueshëm dhe të integruar.

Institucionet mikrofinanciare të formuara si OJQ me qëllim bamirësie janë marrë me aktivitete financiare, aktivitetet e tyre kanë qenë të përziera me aktivitete të tjera ekonomike dhe joekonomike dhe si të tilla kanë krijuar profit.

Unë nuk e kuptoj si u është dhënë licenca për të vepruar OJQ-ve nga Ministria e Administratës Publike, ku këto kanë raportuar, kur është vërejtur se këto organizata joqeveritare kanë rrëshqitur nga qëllimi i bamirësisë, për të cilin edhe janë themeluar.

Mikrofinancat si OJQ janë formuar për qëllime bamirësie, e në fakt, kanë krijuar profit, nuk kanë paguar tatim, u kanë dhënë kredi një shtrese të varfër të shoqërisë tonë, me kamata tejet të larta. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës, e cila i mbikëqyr këto institucione mikrofinanciare, kamatat për mjetet e marra nga këto shtresa të varfra kanë qenë 21%, që kanë pësuar pak rënie në krahasim me të kaluarën që kanë qenë deri në 31%, në vitet e mëparshme.

Shtrohet pyetja tani a duhet lejuar edhe më tutje të veprohet kështu, apo të gjendet zgjidhja? Unë mendoj se duhet të gjendet zgjidhja, duke mos i dëmtuar këto institucione, por duke e futur në sistem fushëveprimtarinë e tyre njëjtë sikur të gjitha institucionet e tjera financiare.

Projektligji që na është ofruar për institucionet mikrofinanciare nuk ka përfshirë institucionet mikrofinanciare, të cilat janë të regjistruara si OJQ, por edhe nuk theksohet se cili nen rregullon institucionet mikrofinanciare, të cilat nuk janë OJQ dhe cili rregullon ato të cilat janë OJQ.

Nëse mbeten edhe më tutje mikrofinancat si OJQ, të cilat krijojnë profit dhe nuk paguajnë tatim dhe mikrofinancat e tjera, të cilat kryejnë të njëjtin veprimtari dhe paguajnë tatim, ne po lejojmë konkurrencë jo të barabartë dhe mendoj se kështu nuk i kontribuojmë mbajtjes së një sistemi stabil financiar, të cilin e ka si qëllim projektligji, të cilin në fakt e kemi në shqyrtim.

Në projektligjin që na është ofruar krijohet infrastruktura ligjore që ka të bëjë me rregullimin e fushës së operimit të mikrofinancave, duke përcaktuar aktivitetet që mund t'i kryejnë institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare si dhe masat ndëshkuese që Banka Qendrore mund të ndërmarrë për këto institucione, për drejtorët, menaxherët e lartë dhe personat, të cilët kanë përqindje interesi në këto institucione.

Mendoj se në këtë projektligj duhet të bëhen përmirësime edhe te përkufizimet, po ashtu edhe te nenet e caktuara të këtij projektligji. Për shembull, në nenin 4, ku Banka Qendrore është i vetmi institucion, i cili bën licencimin e mikrofinancave, atëherë duhet menduar se si do të bëhet



licencimi i këtyre mikrofinancave që nuk janë OJQ dhe si do të bëhet licencimi i atyre të cilët janë OJQ me status të benificuar.

Unë po shpresoj se do të gjejmë një zgjidhje dhe nuk do të vijë te pozicioni i tillë që licencimi të bëhet për këto dy institucione, të cilat veprojnë në forma të ndryshme, njëra është me status të benificuar, e ka statusin e bamirësisë dhe luan rol tjetër dhe, tjetri është mikrofinancë, institucion financiar, i regjistruar në Ministrinë e Tregtisë si person juridik dhe funksionon në formën e mikrofinancës.

“Personat që kërkojnë të licencohen duhen të jenë të regjistruar si shoqëri tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë”, thuhet në projektligj, e çka me ato që janë të licencuara dhe janë jashtë sistemit të funksionimit të mikrofinancës si të tillë.

Unë kam vërejtje edhe te kërkesa për licencim, te neni 7 i projektligjit, te neni 8, paragrafi 2.4 është i pakuptimtë, pastaj te neni 2.7.

Duhet të qartësohet neni 10 te aktivitet e tjera të lejuara të institucioneve mikrofinanciare, paragrafi 2 të analizohet arsyeshmëria e rritjes së shumës maksimale të një kredie deri në 50 mijë euro, duhet të analizohet arsyeshmëri e rritjes së kësaj shume dhe jepet mundësia që Banka Qendrore ta krijojë mundësinë edhe për një rritje tjetër, por nuk përkufizohet deri ku mund të shkojë Banka Qendrore në lejimin e rritjes së kësaj shume, ku mund t'i japin si kredi institucionet mikrofinanciare.

Duhet të qartësohet paragrafi 3.3, ku flitet për huazimin dhe vendosjen e fondeve në tregjet dhe institucione dhe paragrafi 5.2 që ka të bëjë me lëshimin e parasë elektronike.

Duhet të rregullohet neni 13 i ligjit, neni 20 që ka të bëjë me kapitalin minimal për themelimin, ku jepet shuma prej 200 mijë eurove për të pasur kapitalin minimal, mirëpo jepet mundësia prapë te Banka Qendrore për të lëvizur nga kjo shumë, për çka duhet të analizohet dhe të përcaktohet qartësisht se në cilat raste mund të lejojë rritjen e kapitalit minimal për themelimin e këtyre institucioneve.

Dhe neni 27 po ashtu duhet të rregullohet, sepse ka të bëjë me shkelje, dënime dhe masa të përmirësimit, që diferenca në mes të shumave të cilat janë dhënë për dënime ndoshta duhet analizuar më me seriozitet, në mënyrë që të bëhen edhe disa plotësime në këto nene.

Mendoj që duhet të adresojmë çështjen e mikrofinancave OJQ, pasi në Kuvend i kemi të dy projektligjet që rregullojnë themelimin, funksionimin, fushëveprimtarinë, mbikëqyrjen e këtyre institucioneve, pra projektligjet që i përmenda më lart. Përndryshe ne kemi liruar edhe më tutje të vazhdohet me anarki në këto institucione që nuk është në interes të vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i dëgjova me kujdes kolegët, po ashtu zotin Selmanaj, edhe zoti Selmanaj edhe unë kemi një konflikt interesi në këtë rast për dy arsye të ndryshme, po ato nuk po i tregoj.

Unë mendoj se ajo që e tha zoti Selmanaj qëndron. Ky ligj, megjithatë nuk e ka zgjidhur një çështje themelore. Ne e kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, ai vendim i Gjykatës Kushtetuese në pikën 2 thotë: “se këto nene, që i përmendi edhe ministri po edhe të tjerët, nuk janë në përputhje me nenin 10, nenin 44, dhe nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Kjo çështje ende nuk është rregulluar, është fjala jo për të gjitha institucionet, po për ato institucione që me të vërtetë një kohë e kanë dhe ende janë duke e keqpërdorur, një ambiguitet që dikush e ka gjetur ose janë përpjekur ta gjejnë, në të vërtetë kemi të bëjmë me keqpërdorim të ligjit, me keqpërdorim të mundësisë së veprimit edhe për përfitime thjesht personale, edhe ndoshta në momente të caktuara dhe për shpëlarje të parave.

Unë mendoj se Ministria e Financave, si sponsor i këtij ligji, domosdo duhet ta qartësojë gjendjen e OJQ-ve që sot ende, në një farë forme ose në formë tjetër, japin kredi. Kjo është e palejueshme, ne kemi sisteme të tjera ku OJQ-të e tilla, si institucione mikrofinanciare jobankare ndoshta veprojnë, ato janë treguar si raste të suksesshme, mostra të suksesshme në vende me varfëri të skajshme, natyrisht që edhe atje nuk kanë kaluar më së miri, edhe atje kanë pasur shkelje të ndryshme të mëdha, mirëpo e kemi një gjendje tjetër, ato kryesisht kanë ndodhur në Azinë Juglindore, ka pasur përpjekje edhe me Amerikën Jugore, mirëpo me më pak sukses, sepse siç duket, legjislacioni është më i rregulluar. Në Azinë Juglindore, sidomos në Indi, në Bangladesh, në Sri-Lankë si i përmendi, ka pasur raste të tilla, kemi raste të ndjekjes ligjore tash të këtyre OJQ-ve që kanë vepruar në atë mënyrë, atje kemi natyrisht shuma shumë më të mëdha.

Unë mendoj se Ministria e Financave e ka për detyrë që këtë ligj vërtet ta sjellë në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, një, edhe të ndërpritet praktika që është duke vazhduar ende në Kosovë me OJQ-të, që nuk dihet a janë banka, a janë sisteme financiare, apo çka janë, po më së pakti janë OJQ, edhe ato kanë një qëllim fisnik, edhe ato nuk i shkojnë qëllimit fisnik, po i shkojnë qëllimit të përfitimit privat të grupeve, të klaneve krejt kush është i përzier, nuk ka ndonjë rëndësi, mirëpo nuk i shkojnë mbrapa, nuk e përcjellin qëllimin fisnik për çka krijohet një organizatë joqeveritare me qëllim të përfitimit publik të përbashkët.

Për të mos e lënë të paqartë çështjen, zoti Selmanaj nuk ka konflikt interesi, as unë s’kam konflikt interesi, në një periudhë të caktuar unë e kam dërguar ligjin e parë në Gjykatën Kushtetuese, edhe kjo ka qenë kërkesë e organizatave, unë po them, të mirëfillta joqeveritare që nuk kanë punuar për përfitim privat. Gjykata Kushtetuese ka vendosur ashti siç ka vendosur, mirëpo fatkeqësisht kjo gjendje nuk është rregulluar ende. Faleminderit!

KRYESUESI: Mbase këto të tjerat nuk kanë punuar, Sami, po e dimë të gjithë kush ka punuar, kush s'ka punuar. Unë e kam një problem, a është dhënë në përputhje me një rregull atëherë e drejta e tyre dhe a e merr përsipër shteti dëmshpërblimin në qoftë se është dhënë në përputhje me një rregull të caktuar, a merr përgjegjësinë shteti për t'i dëmshpërblyer këta kur t'u thotë 'shkoni te shtëpia'. Ky është një problem që duhet pasur parasysh, ku të lihen të gjithë ata njerëz që punojnë aty?

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Në fakt, e kuptova në fund zotin Sami, i cili besoj në aspektin metaforik e tha. Unë kam qenë njëri prej organizatave, që e kam dërguar nëpërmjet Avokatit të Popullit në Gjykatë Kushtetuese, veç një sekondë. Edhe në atë kohë askush nuk besonte që ka organizata qëllimmira që donë ta mbrojnë një status të organizatave joqeveritare që kanë qëllimin për të përfituar publiku. Unë kur lexoja në atë kohë që themeluesi i parë i mikrofinancave të tilla ka qenë në Bangladesh dhe në vitin 2006 ky person ka marrë Çmim Nobel për bamirësi, në Kosovë shihja që dikush po pasurohet në kurriz të fukarenjve dhe kjo nuk...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Të gjitha bankat pasurohen në kurriz të qytetarëve, po lërin ato se nuk jemi në komunizëm, t'i vendosim sendet qysh duhet me ligj.

DRITON SELMANAJ: Po, më ndalet që dy herë në gjysmë, nuk jam duke folur kundër PDK-së, jam duke folur për mikrofinanca.

KRYESUESI: Unë nuk po e ndal, po regjia.

DRITON SELMANAJ: Zoti Haliti, kam përshtypje që s'po kuptohet qartë çka është organizimi ose ç'është liria e asociimit, nuk ka të bëjë kjo as me kapitalizëm, as me socializëm, kjo ka të bëjë me lirinë e asociimit që ka deklarata dhe konventa ndërkombëtare që e rregullojnë këtë çështje.

Nuk mundet dikush me status të përfituesit publik të bëjë kapital për vete, nuk mundet në asnjë mënyrë, është e ndaluar, ky është ligj. Nuk ka OJQ-ja pronar, nuk është biznes privat, mund të mos e kuptosh konceptin e shoqërisë civile që është krejt legjitime, sepse kemi ndërruar sisteme. Kjo nuk është shembull për sisteme socialiste ose të kaluara, kjo është formë e organizimit të ri.

Prandaj, çka po dua të them është që jemi në një situatë kur shteti s'ka vepruar, ka lejuar të shkelen ligjet, kemi shkelur rregullore të UNMIK-ut dhe vazhdojmë ta shkelim Ligjin për bankat

edhe sot dhe sot duhet o ta kërkojmë përgjegjësinë, o të ndalet kjo formë e funksionimit arbitrar në kurriz të fukarenjve të Kosovës.

**KRYESUESI:** Ky është mentalitet komunist për mua, mentalitet i shoqërive të kaluara. Unë kam pasur përvojë me shoqërinë civile dhe më kanë thirrur pikërisht për këtë çështje. Unë e di që shumica, po them shumica e shoqërisë civile kanë keqpërdorur, nuk po them kush e si, se nuk i di. Po përderisa kanë qenë me mijëra shoqëri civile, organizata të shoqërisë civile të paraqitura në Kosovë, ka diçka. Thotë populli: “Ku ka tym, ka edhe zjarr”. Për atë po them që ne jemi përfaqësues edhe të popullit që i mbrojmë interesat e tij, po edhe interesat e shtetit duhet parë. Kushdo që bie ndesh me ligjin, duhet dhënë llogari, a është apo s’është kjo çështje që duhet të merremi ne dhe a mund të veprojmë në përputhje me atë që ka dashur të realizojë dikush tjetër më herët, e ne sot këtu në Kuvend, unë nuk e di, po një gjë e di.

Shumica e këtyre ndërmarrjeve të Kosovës që kanë shkuar në Arbitrazh, kanë humbur. Nuk e di dikush a mund ta çojë, kjo ishte pyetja ime, a mund ta çojë shtetin, Ministrinë e Financave a Qeverinë në arbitrazh për një vendim, i cili ia pamundëson fushëveprimin e lejuar më herët, e para.

E dyta, cila është përgjegjësia jonë publike, në qoftë se ne, nuk e di sa vetë janë të punësuar në këto mikrofinanca, unë as nuk i di, as s’i njoh, as nuk e di kush është drejtor, as kush është pronar, por nuk e di sa fitojnë dhe nuk e di a e kanë të ligjshme, ministri e di më mirë dhe besoj që do të na sqarojë.

Driton Selmanaj e ka fjalën.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, zoti Haliti!

Nuk kemi mijëra shoqëri civile, e kemi veç një shoqëri civile, ato janë organizata të shoqërisë civile, mund të ketë edhe organizim tjetër. Shoqëria civile nënkupton tërë shoqërinë e Kosovës. Po prandaj kemi dallime konceptuale, ju thashë unë. Jemi gjeneratë krejtësisht ndryshe, s’je duke e kuptuar konceptin e shoqërisë civile. Kosova ka veç një shoqëri civile.

I kemi organizatat, edhe një grup i cili është i regjistruar mbledhet atje për të mbrojtur një lloj të bletës, një lloj të fluturës, është pjesë e shoqërisë civile.

Edhe nëse nuk janë të regjistruar si OJQ, edhe nëse dikush organizohet për ta mbrojtur një lloj të drurit diku, ajo është pjesë e organizimit të shoqërisë civile, po është një shoqëri civile.

Organizata janë të tjera, që i kemi 8 mijë në Kosovë, dikush po thotë janë shumë, jo, jo Sllovenia i ka 30 mijë, nuk janë shumë.

Ne jemi duke folur për një...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Atëherë a është shoqëri civile TMK-ja e Policia, pra, pasi nuk qenkan, mirë është puna! Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke falënderuar të gjithë diskutuesit e gjertanishëm, besoj që ka nevojë për disa sqarime.

Është hera e tretë që tentohet të rregullohet një çështje që nuk është e thjeshtë dhe është goxha komplekse. Është çështje e trashëguar prej kohës kur Kosova është qeverisur mbi bazën e rregulloreve të UNMIK-ut.

Viteve të fundit asnjë institucion mikrofinanciar nuk e ka marrë regjistrimin nëse nuk ka qenë shoqëri aksionare, po flasim për një gjendje faktike, e cila ka ndodhur në kohën e UNMIK-ut.

Sa i përket çështjes së kapitalit, është punë e kryer, është e padiskutueshme. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është vendim, i cili nuk e lejon transferin e kapitalit prej një institucioni mikrofinanciar, që e ka statusin e OJQ-së, në një institucion mikrofinanciar që e ka statusin e shoqërisë aksionare.

Brenda institucioneve mikrofinanciare ka institucione mikrofinanciare me status të shoqërisë aksionare dhe me status të OJQ-së. OJQ-të janë themeluar mbi bazën e Rregullores së UNMIK-ut dhe është bazë legale mbi të cilën kanë vepruar.

Sa i përket ekzaminimit, mbikëqyrjes, këto janë të rregulluara, janë të rregulluara me rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, edhe sa i përket përcjelljes së shpëlarjes së parave janë të obliguara të raportojnë, edhe sa u përket çështjeve të tjera të qeverisjes.

Është goxha interesant që Gjykata Kushtetuese i ka shfuqizuar veç disa nene të ligjit, jo krejt ligjin.

Është interesat që ankesat kanë shkuar prej OJQ-ve, që janë mijëra, ndoshta pesë mijë, ndoshta gjashtë mijë, tepër shumë, që nuk punojnë dhe nuk janë pjesë në sektorin financiar. Jo nuk është e mira, se krejt qëllimi ka qenë t'i mbrojnë burimet e veta të financimit, kjo ka qenë. Kjo është çështje që nuk diskutohet, është punë e kryer.

Sa i përket statusit të këtyre institucioneve, një pjesë e madhe e tyre e kanë statusin e shoqërive aksionare. Ka ardhur në mandatin e kaluar, në legjislaturën e kaluar ka ardhur një draft në

Kuvendin e Kosovës, ka qëndruar në Komisionin për Buxhet dhe Financa me vjet, janë krijuar grupet punuese dhe nuk është adresuar kjo çështje.

Pasi Banka Qendrore nuk ka të drejtë të jetë sponsorizuese e ligjeve, ligjet kryesore i sponsorizon nëpërmjet Ministrisë së Financave, por Ministria e Financave duhet ta ketë pëlqimin e Bankës Qendrore për ligjet që i ekzekuton, i monitoron dhe i mbikëqyr Banka Qendrore. Ka ardhur drafti, është një draft, unë edhe në paraqitjen time të parë i luta deputetët për kontributin e tyre, nuk është çështje krejt e lehtë që të adresohet. Kapitali i krijuar i këtyre institucioneve i ka veç dy mundësi: ose të shpërndahet për qëllime bamirëse për të cilat është themeluar dhe e ka statusin OJQ, ose t'i kthehet donatorit.

Unë mendoj që për Kosovën është shumë më e pranueshme, shumë më e drejtë që kapitali të shpërndahet për qëllimet për të cilat është themeluar institucioni mikrofinanciar. A ka institucione mikrofinanciare në regjion? Ka! Ka në Kosovë, ka në Mal të Zi, në Bosnjë, ka në Shqipëri. A është pjesëmarrja e tyre e madhe në kuadër të sektorit financiar? Është shumë e vogël, shumë simbolike. Në Kosovë është veç 3% e totalit. A punojnë mijëra njerëz këtu? Punojnë mijëra njerëz? A i kanë mijëra klientë? I kanë mijëra klientë. Prandaj, po flasim për një situatë kur e kemi një konkurrencë të padrejtë, të pabarabartë, kur disa prej tyre paguajnë tatime e disa prej tyre s'paguajnë tatime. Qëllimi është që ta rregullojmë këtë sektor, të krijojmë konkurrencë lojale, kush do të punojë në sektorin financiar, të regjistrohet si shoqëri aksionare, t'i paguajë tatimet, të jetë e mbikëqyrur dhe të ekzistojë në treg.

Kush do të mbetet OJQ, mbetet OJQ, e ka statusin e organizatës joprofitabile, por nuk regjistrohesh si organizatë joprofitabile edhe të realizosh fitim, sepse tek e fundit a është dividendë apo kthehet nëpërmjet rrogave të larta, ky është dallim pak i vogël. Prandaj, unë po i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës, ne do të jemi në dispozicion të plotë, edhe Banka Qendrore e ka obligim të jetë në dispozicion të plotë të të gjitha komisioneve dhe grupeve punuese që ne ta adresojmë këtë çështje që nuk është e lehtë për t'u adresuar, është goxha komplekse dhe paralelisht kërkon që dy ligjet të trajtohen, edhe Ligji për institucionet mikrofinanciare, edhe Ligji për OJQ-të. Të mos të lejohet që një OJQ të jetë në një sektor ku realizon profit, mirëpo në të njëjtën kohë, ne e kemi një situatë të prodhuar, e kemi një gjendje faktike, të cilën duhet adresuar. Këto ekzistojnë. A duam të marrim vendim t'i nxjerrim 1 000 veta prej pune? A duam të marrim vendim ata klientë që kanë realizuar kredi çka të bëjnë? Prandaj, unë besoj që ka një zgjidhje, drafti është një draft, ka mundësi të përmirësohet, prandaj pres dhe e vlerësoj kontributin e secilit deputet veç e veç dhe jam i bindur që kësaj radhe ne do ta bëjmë një zgjidhje, gjithmonë duke e marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili është i padiskutueshëm. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Unë po kërkoj, por replika zakonisht merret menjëherë, unë jua jap fjalën nuk është problem, veç mendoj që është një qasje krejtësisht e gabueshme. Domethënë, keqpërdorim i madh nga ministri. Në fakt, më ktheu 5-6 vjet më herët. Të njëjtën gjë ma thoshin edhe Ahmet Shala dhe disa të tjerë, më thoshin kështu: “Po pse Driton, çka ka lidhje organizata jote me mikrofinanca që ti po e dërgon atje?”. Po ne e kemi mbrojtur sektorin, sepse po të lejojmë që dikush ta transformojë subjektivitetin e vet juridik, ajo bëhej precedent. Secila organizatë nesër, jo mikrofinanciare, por që e ka statusin e OJQ-së, nesër mund ta ndërronte statusin, të bëhej kapital privat, ta shndërrojë, mundte edhe një organizatë tjetër, edhe organizata ime.

Ne nuk dëshironim që precedentë të tillë të rrezikshëm, që janë të ndaluar me konventa ndërkombëtare, të aplikohen në Kosovë. Kjo i bie qysh, po thoni ju, të mbrohen, apo s’ munda të ju kuptoj si duhet. Unë e kam dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese edhe për privilegjet e deputetëve, por cili ka qenë interesi im atëherë? Po interesi publik. Ky ka qenë roli im në atë kohë. Provoni të besoni dhe që të kuptoni që ka njerëz në këtë vend që interesohen edhe për interesin e këtij vendi, për interesin publik. Të abuzohet, të thuash që keni pasur qëllime të caktuara, meskine, e kështu, mos ju lutem, mos se ky është më tepër se gabim të mendohet kështu. Madje-madje na janë ofruar edhe mundësi për t’u korrumpuar, veç ta tërheqim lëndën, sepse juve s’ju prek kjo çështje. Kemi thënë, more duam të vendosim rend në këtë vend, duam të bëjmë sistem në këtë vend, duam të mbrojmë parime në këtë vend, e nëse mendoni që këtu s’ka njerëz që mbrojnë parime, më vjen keq po unë s’jam pjesë e juaja.

KRYESUESI: Unë jam për ligje, e jo për parime shumë. Zoti Bedri Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë besoj që është humbje kohe të diskutojmë rreth çështjes së kapitalit të OJQ-ve. Është vendim i Gjykatës Kushtetuese dhe është punë e kryer, dhe nuk e di pse është jashtëzakonisht mirë që gjithkush ta shfrytëzojë të drejtën e vet ligjore e kushtetuese për të ngrehur çështjen në Gjykatë Kushtetuese e gjithkund. Është shumë korrekte, mirëpo kurrë s’e kuptoj pse dikush pa nevojë ia kthen shigjetat vetes, kur s’është pjesë as e çështjeve të caktuara.

KRYESUESI: Fjalën e ka Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit!

Kryesues, e di që jemi shumë pak, por nuk jemi veç dy deputetë, jemi pak më shumë se dy deputetë, e shumë pak jemi. Faleminderit!

E para, mua po më bie me falënderime shpeshherë, por edhe kësaj radhe dua ta falënderoj Qeverinë. Pse dua ta falënderoj ministrin, edhe ata që e kanë iniciuar? Së paku, e kanë sjellë një ligj, i cili e ndërpret një gjendje dhe vazhdon me një gjendje çfarë duhet. Krejt problemi ka për të

qenë me statusin ekzistues të atyre OJQ-ve. Po të kishim vazhduar këtu, ministri tha diçka për të cilën nuk ka pasur drejtë, t'ua ndalojë licencën për të aplikuar me Ligjin ekzistues që është, edhe si OJQ, ka pasur të drejtë, por tash e tutje nuk ka të drejtë. Dhe për këtë të falënderoj ministër, sepse kemi kaluar prej fazës së hulumtimeve, debateve, rekomandimeve në diçka shumë konkrete.

Pra, ky ligj na mundëson ta ndërpresim, ta bëjmë një prerje tash e tutje. E vetmja dilemë që edhe unë kam, edhe grupi ynë parlamentar e ka, çka do të bëhet me ata, të cilin e kanë statusin e institucioneve mikrofinanciare jobankare, OJQ? Edhe sa do të vlejë ai status, deri kur do të vlejë? Dhe, çfarë do të jenë aktet nënligjore në të ardhmen?

Në analizimin e dytë, ose gjatë draftimit për leximin e dytë duhet dhënë këtë kontribut. Domethënë, kontributi ynë dhe i krejt shoqërisë është çfarë do të jetë statusi i atyre ekzistuese që janë institucione mikrofinanciare joqeveritare dhe çfarë do të jetë transferimi i tyre dhe deri kur? A ka një afat? Kurse, që rregullojmë diçka me këtë ligj, nuk ka dilemë. Jo vetëm në aplikimin për të ardhmen, por edhe një pjesë e kontrollit është avancuar në kuptim të kësaj gjendje. Duke mos harruar se ne po kalojmë prej një ekstremi në ekstrem tjetër, këto institucione mikrofinanciare nuk e kryejnë vetëm shërbimin e kredisë. Kanë edhe produkte tjera, është lizingu, janë konsultimet, konsulenca, gjithçka tjetër për prona dhe kanë shërbime tjera, të cilat në botë janë shumë të avancuara dhe kryhen nëpërmjet institucioneve të ngjashme. Ne nuk guxojmë të mendojmë që duhet krejtësisht të shuhet, sepse janë shërbime shumë më të drejtpërdrejta, më të shkurtra, më efikase se bankat. Pra, ne mund të bëjmë diçka, por prishim punë në shërbimet tjera, në produktet tjera.

Këtu para vetes e kam edhe një hulumtim parlamentar. Hulumtimi parlamentar është bërë në vitin 2016. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ky Parlament e kanë dhënë një kontribut të madh, rekomandimet i kemi këtu në hulumtimin parlamentar. Pra, Parlamenti i Kosovës na ka dhënë disa rekomandime, por Qeveria dhe ministri i Financave, ose ata që e kanë iniciuar, kanë vendosur për ta ndërmarrë një hap konkret. Krejt orientimi ynë duhet të jetë çka me statusin e institucioneve mikrofinanciare ekzistuese? Deri kur do ta kenë atë status dhe elementet tjera që mund të kontribuojnë?

Unë e kuptoj këtë ndjeshmëri, sepse është prej ligjeve që është debatuar më së shumti. Çuditërisht është një fushë shumë e ngushtë, por është bërë debat i madh, qoftë i shoqërisë civile, medieve, i Gjykatës Kushtetuese, i hulumtimeve shkencore, rivalitet, gjithçka, konfliktet e interesave, kanë qenë të pranishme, por tash e kemi të qartë. Dhe duke parë që Qeveria e ka të qartë, ministri e ka të qartë, e ka marrë një vendim, e keni ligjin përpara, së paku e bëni një ndërprerje edhe vazhdojmë ua ndalim rrugën disa mundësive të reja që kanë mundur të keqpërdoren. Tash e kemi më lehtë.



Duke e pasur parasysh, ju kisha lutur ministër, edhe në Komisionin për Buxhet edhe Financa që ta jepni kontributin tuaj lidhur me aktet nënligjore. Ndoshta disa nga ato i kemi në fuqi, por janë shumë me rëndësi se sa ligji, aktet nënligjore. Duke e parë që Dritoni po ka qejf shumë të flasë, po ia përmend emrin, por pasi të flasin edhe të gjitha grupet parlamentare, Driton ta japim fjalën e mundësinë për të folur shumë, dhe jemi lodhur prej interpelancave e debateve, kjo nuk është interpelancë e as debat parlamentar, por kemi të bëjmë me një ligj dhe Rregullorja e parasheh që duhet shkuar me njëfarë rregulli. E kanë fjalët grupet parlamentare, ministri, komisioni i fushës, e pastaj edhe deputetët. E di që është fushë e ndjeshme, por Driton ta mundësoj, sa herë të duash ta përmend emrin, veç njëfarë rendi ta kryejmë.

Po ashtu, po ju lajmëroj që bashkë me zonjën Safete Hadërgjonaj jemi në një grup punues, Komisioni për Buxhet dhe Financa, që e kemi bërë për ta parë implementimin dhe zbatimin e ligjit ekzistues çfarë është. Domethënë, komplet edhe si institucion, edhe si Parlament, jemi duke punuar në këtë aspekt. Por, Qeveria na e ka sjellë të gatshëm, e kemi një mundësi, shfrytëzoheni këtë mundësi, lërnini hulumtimet dhe rekomandimet, por të bëjmë diçka më konkrete. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, kryesues!

Nuk është hera e parë që nuk na e jep fjalën kur na vjen rendi, shpresoj që herëve tjera nuk do të ndodhë kjo. Në fakt, edhe debati devijoi pak, iku krejt prej temës se secili po mundohet tash të dalë më mbrojtës i konceptit të mbrojtjes së bamirësisë se tjetri. Ministri e mban mend sa herë kemi diskutuar për këtë çështje në kohën kur keni qenë guvernator. Të gjitha këto i kemi diskutuar qysh përnjëmend kanë devijuar prej konceptit të mikrofinancës, dhe kjo është për keqardhje. Mua më vjen shumë keq për një ide që ka qenë jashtëzakonisht e mirë. Muhamet Jonus, themelues i mikrofinancave, e ka fituar çmimin Nobel për Paqe, as për bamirësi jo, por për paqe, sepse ideja ka qenë njëmend për ta luftuar varfërinë, e duke e luftuar varfërinë e duke rritur vendet e punës, të krijohet paqe.

Në Kosovë është devijuar e para prej konceptit dhe është devijuar duke shfrytëzuar hapësira të vogla ligjore, se as ligji nuk ka qenë i keq. Problemi ka qenë se janë keqpërdorur dhe këtu nuk kanë reaguar mandej institucionet përgjegjëse, nuk është vetëm një. Banka Qendrore e ka pjesën e vetë të fajit, e cila nuk e ka kontrolluar mjaftueshëm nivelin e kamatave, sepse OJQ-të kanë pasur të drejtë edhe të ushtrojnë aktivitete të tilla, por gjithmonë thuhet për aktivitetet ekonomike që krijojnë të hyra, ata duhet që këto shërbime t'i ofrojnë nën vlerën e tregut, sepse s'krijojnë fitim dhe në këtë mënyrë ato i kanë bërë edhe konkurrencë jo të ndershme, institucionet tjera që e kanë pasur statusin e bizneset dhe kanë paguar tatime. Po tashmë kjo është e kaluar. Mënyra qysh keni propozuar për ta zgjidhur problemin unë nuk mendoj se e zgjidh, sepse nuk është e drejtë tani, për shkak se nuk kemi arrit t'i parandaloni, e besa edhe t'i dënioni ato institucione që e

kanë shkelur ligjin, ose kanë keqpërdorur, tani t'i dënojmë të tjerat që duan ndoshta ta ushtrojnë të njëjtin aktivitet në mënyrë të ndershme, sepse tani po u ndalohej një aktivitet i tillë të gjitha organizatave joqeveritare që duan të bëjnë.

Sepse, nëse lexohet drejtë neni 6, paragrafi 2, më nuk i lejon OJQ-të të ushtrojnë, sepse thotë “personat që kërkojnë të licencohen për të zhvilluar veprimtari të institucioneve financiare jobankare duhet të jenë të regjistruara si shoqëri tregtare në ministrinë përkatëse”. Pra, nuk lejon më ta kenë statusin e OJQ-së dhe kjo mendoj që nuk është e drejtë. Unë jam dakord dhe duhet patjetër të gjejmë një zgjidhje për ato organizata që kanë krijuar kapital si mikrofinanca, e çka duhet të bëjnë ato me këtë kapital.

Ministri e dha si një nga propozimet që t'i kthehet donatorit, por nuk besoj se as kjo është zgjidhje, sepse kjo shumë tashmë është dhjetëfishuar dhe donacioni zakonisht është donacion, nuk kthehet mbrapa. Tash, çka duhet të bëjnë këto organizata me kapitalin e krijuar, unë mendoj që fillimisht ky debat duhet të bëhet brenda këtyre vetë institucioneve, e për fat të keq ato asnjëherë nuk e kanë pasur një debat të tillë. Dhe, qëllimin e kanë devijuar, pra përfitimi i publikut nuk është aq i ngushtë sa të jetë vetëm përfitim, as i punëtorëve, ju me të drejtë thatë që pagat e tyre kanë qenë tejet të larta dhe kjo devidenta më shumë është shpërndarë në formë të pagave, por prapë as kjo nuk e rregullon, megjithatë është tregu i lirë dhe ata mund t'i japin edhe arsyet, sepse i kanë rregulluar pagat e tilla.

Por, nuk besoj se ky debat duhet të bëhet tani dhe nuk do të mund të rregullohet me këtë ligj, sepse është diçka që i përket së kaluarës dhe duhet me një vendim të veçantë, dhe prapë po them që ky diskutim duhet të bëhet edhe brenda vetë organizatave mikrofinanciare që e kanë statusin e OJQ-ve, jo ato që e kanë biznes, sepse edhe unë pajtohem dhe mendoj që numri i tyre është i vogël. Duhet të ketë hala më shumë biznese të tilla që japin kredi me shuma të vogla. E, këtu tash unë e kam një vërejtje edhe te neni 10. Pra, po flasim për organizata mikrofinanciare, që nënkupton që aktivitetet e tyre financiare janë të kufizuara, por mendoj që shuma e lejuar është ende e madhe, është 50 000 dhe prapë këto u bëjnë konkurrencë bankave, sepse 50 mijë ti mund të shkosh t'i marrësh edhe në bankë.

Ideja e mikroinancave ka qenë që të shpërndahen, të jepet si formë kredie shuma për të cilat bankat nuk kanë leverdi, nuk kanë interes të japin, pra me 500 euro, me 1 000 euro dhe dikur maksimumi ka qenë 5 000 euro, tash ka shkuar duke u rritur dhe është bërë 50 000 euro.

Dhe, kjo prapë e cenon konceptin e mikrofinancës. Unë mendoj se kjo shumë duhet të ulet dhe duhet të ulet drastikisht. Maksimumi mendoj që duhet t'u lejohet është 10 000 euro, se përndryshe janë bankat ato që lëshojnë kredi. Dhe, po ashtu unë pajtohem me zonjën Hadërgjonaj që duhet edhe të specifikohen aktivitetet tjera që u lejohen këtyre, sidomos mikroinancave. Sepse, ato themelohen me qëllimin e dhënies së kredive. Tash nëse bëjnë edhe

aktivitete tjera, transaksione tjera, ato prapë shndërrohen në banka dhe po përzihet koncepti i mikrofinancave dhe i bankave.

Dhe, diçka tjetër sa u përket atyre organizatave që e kanë statusin e OJQ-ve dhe kanë status të përfitimit publik dhe që ushtrojnë aktivitete tjera. Mendoj që këtë temë duhet ta trajtojë Kuvendi, sepse nuk janë të vetmet organizatat mikro-financiare. Ne e kemi edhe një numër tejet të madh të organizatave joqeveritare që kryejnë aktivitete të ndryshme, e që natyrisht u nënshtrohen edhe ligjeve tjera, por që shumë shpesh e kanë keqpërdorur sidomos statusin e beneficionit publik.

Ne e kemi një varg universiteteve që po ashtu janë të regjistruara si OJQ, kurse tarifën e regjistrimit e kanë tejet të lartë dhe profesorët që japin mësim në këto universitete e kanë pagën ta zëmë sa dyfishi i presidentit të shtetit dhe ato përfitojnë nga lirimi në taksa, sepse janë të regjistruar si OJQ dhe nuk paguajnë tatim mbi vlerën e shtuar, apo tatime të tjera prej të cilave janë të liruara. Pra, ne duhet të debatojmë për këtë çështje, për OJQ-të, të cilat, për fat të keq, po e shtrembërojnë konceptin e OJQ-ve, po i shfrytëzojnë edhe disa hapësira jo shumë të mëdha të vogla ligjore, por shpeshherë edhe po i shkelin ato në kurriz të interesit të gjerë, interesit të përgjithshëm dhe çdoherë duke përfituar vetëm një numër i vogël i njerëzve, e duhet ta themi se ky numër i njerëzve fillimisht ka ardhur nga jashtë, pra është një numër i ndërkombëtarëve që e kanë importuar te ne këtë koncept, por që këtu ka devijuar ende më shumë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë në emër të Nismës mund të them që gjatë dy leximeve do të përpiqemi ta japim kontributin tonë që ligjin ta rregullojmë ashtu siç është më së miri. Ndërsa, për këto ligjëratat që i dëgjuam nuk kam çka i shtoj, nuk dua të bëhem pjesë e këtij debati, jo pse nuk kam çka të them, por se duke pasur parasysh që ky treg nuk është se u zbuluar sot, por paska ekzistuar me vite të tëra, besa edhe me dekada, dhe është Qeveria e katërt nën regjimin e të cilave funksionojnë këto kështu dhe nuk është ndërmarrë asnjë masë.

Prandaj, mendoj që është mirë që të ndalemi te ajo që u tha, ta rregullojmë nga sot e tutje dhe të shohim se çka të bëjmë me kapitalin, të cilin e kanë rregulluar ato institucione në mënyrë të paligjshme, e për të gjitha ato tjerat mendoj që janë organet tjera përgjegjëse. Nëse është bërë shkelje e ligjit, nëse është përfituar në mënyrë të paligjshme, janë Prokuroria, janë gjykatat që duhet të merren me këtë. Ligji paska qenë i qartë. Nuk është lejuar të jepen kredi me shumë më të mëdha se kaq, dividendat që kanë përkthyer në paga, nëse aty ka shkelje të ligjeve në fuqi, apo ligjit që ka rregulluar, le të merren organet e zbatimit të ligjit, si është bërë zakon t'i quajmë policinë, prokurorinë, gjykatat, domethënë organet që e bëjnë zbatimin e ligjit dhe të vazhdojmë më tej.

Ne gjatë dy leximeve, prej të parit në të dytin, pastaj të gjitha partitë jemi të përfaqësuara në komisione dhe do të duhet të përpiqemi që nëpërmjet amendamenteve ta rregullojmë këtë fushë, ta rregullojmë këtë çështje për të cilën së paku tani e kemi si materie në tavolinat tona. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Korab Sejdiu.

**KORAB SEJDIU:** Përshëndetje!

Nuk besoj që mund të flasim për projektligjin, i cili është para nesh, pa u kthyer pak në histori në vitin 2012, kur në bashkëkryerje besoj edhe miqtë tanë ndërkombëtarë, edhe atëherë Ministria e Financave si sponsorizuese, por edhe ky Kuvend, e nxorën një ligj që mund të themi me fjalët më të buta nuk ka qenë i hartuar në mënyrën më të duhur dhe kishte lënë hapësirë goxha të madhe edhe për keqinterpretime, por edhe për mostrajtim të duhur të disa çështjeve. Dhe, duke pasur parasysh që mikrofinancat si fushë, po i lë anash për një moment institucionet financiare jobankare, si fushë është zbuluar për t'u dhënë qasje në kredi atyre që në mungesë të mikrofinancave nuk do të kishin qasje. Ky trajtim kaq jo i duhur e la këtë hapësirë që pastaj tek ne siç është zakon për çdo çështje të ditës u paraqitën edhe 10 -15 000 ekspertë, edhe pse ka shumë pak ekspertë që vërtet e kanë studiuar këtë çështje në thellësi, aq më tepër kur bëhet fjalë për një sektor të veçantë të mikrofinancave që u përmendën këtu më herët, që janë të organizuara si organizata joqeveritare të llojit fondacion, dhe çka ndodhi është që u mor përpara ky ligj dhe vazhdoi si të themi hedhja e informatave në skenë.

Një pjesë e madhe e këtyre informatave ishin të vërteta, një pjesë edhe më e madhe e tyre ishin thjesht pretendime ose informata të pasakta dhe pastaj treni e vazhdoi rrugën e vetë derisa erdhën te vendimi i famshëm i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa neneve të Ligjit për bankat, kur në më pak se dy faqe e trajtoi këtë çështje jashtëzakonisht në mënyrë sipërfaqësore. Ma merr mendja që personi i cili e ka hartuar këtë, nuk e ka kuptuar fort sektorin për të cilin ka shkruar, dhe doli një vendim.

Tash unë e kam shkruar një punim për nevojën ekstreme që nga 2013, kur ka dalë ky vendim, për të qenë ky sektor i mbuluar me ligj. E që në mungesë të ligjit, Banka Qendrore e ka mbuluar disi sektorin, por ajo ka qenë e pamjaftueshme. Unë e mirëpres faktin që ligji ka ardhur këtu. Tash, fakti që është ligji këtu është një hap i madh, por nuk është hapi që mjafton. Unë besoj dhe thërras edhe Komisionin Funkcional që të inkorporojë në procedurë të shqyrtimit të këtij ligji sa më shumë njerëz që vërtet e njohin këtë lëmi, përfshi këtu Ministrinë e Financave dhe Banën Qendrore, organizatat joqeveritare që janë në sektorin e mikrofinancave, shoqërinë civile e cila ka qenë jashtëzakonisht aktive gjatë procedurës së sfidimit të ligjit paraprak, me qëllim që ta trajtojmë sektorin e mikrofinancave dhe të institucioneve financiare jobankare në mënyrë të duhur me këtë ligj.

Mbi të gjitha, të vendosim a po dëshirojmë të trajtojmë çështjen që unë besoj se do të ishte më mirë e trajtuar ndaras nga ky ligj, çka të bëhet me OJQ-të të cilat e kryejnë këtë veprimtari, si dëshirojmë t'i adresojmë. Unë nuk besoj se është vendi në këtë ligj që të adresohet e ardhmja e tyre. Më e rëndësishmja është që ky ligj, që del prej këtij Kuvendi dhe nënshkruhet nga presidenti, të jetë i hartuar në mënyrën më të mirë dhe të duhur të mundshme, dhe që kemi kapacitet. Edhe pse, s'jam anëtar i Komisionit Funkcional e vë veten në dispozicion, nëse u nevojitet çfarëdo ndihme nga ana ime. Shumë prej nesh kemi qenë edhe gjatë specializimeve të ndryshme kemi informata lidhur me këtë dhe jemi të gatshëm të kontribuojmë. Kemi qenë të përfshirë, siç u përmend me herët, edhe në fazën paraprake kur është sfiduar ligji i kaluar, ose ligji aktual që i ka disa pjesë të shfuqizuara.

Besoj që nëse vërtet e shqyrtojmë në mënyrë të duhur dhe i selektojmë informatat e sakta dhe të vërteta, nga ato që mundësisht do të fillojnë të vijnë sërish edhe tash, do të kemi mundësi të hartojmë një ligj që vërtet adreson këtë fushë në mënyrë të duhur. Nuk besoj se është dashur të qëndrojmë kaq gjatë i pambuluar në aspektin ligjor, po ashtu nuk besoj se është interesi i Bankës Qendrore që ta mbulojë këtë sferë vetëm me Rregullore të Bankës Qendrore, sepse është e nevojshme që të ketë ligj. Natyrisht, në aspektin teknik besoj se ky ligj i ka disa çështje që duhet t'i adresojmë, për shembull, pash se njëri prej tyre është neni 37.4, ku thotë “brenda 12 muajve të likuidohet...”, duke pasur parasysh që disa prej këtyre institucioneve lëshojnë kredi pak më afatgjate se 12 muaj do të ishte problematike që të likuidohen në 12 muaj. Ndoshta të shqyrtohet mundësia që të zgjatet ky afat, ose neni 13 që flet për investimin e mikrofinancave në institucione tjera financiare. Të trajtohet edhe këtu çështja se a lejohet, jo transferimi i kapitalit, por komercializimi në njëfarë mënyre i një pjese të kapitalit, duke investuar mikrofinancat në institucionet tjera financiare.

Pra, këto janë çështje të politikave tona që dëshirojmë t'i hedhim në letër dhe t'i trajtojmë, por janë të rëndësishme që të trajtohen. Nuk guxojmë të lejojmë që ky ligj të dalë prej dyerve të këtij Kuvendi as me një hapësirë të mundshme për keqpërdorim e as ndonjë mënyrë që të cenohet ajo që garantohet me Kushtetutë, po edhe me Ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Ju lus që me çdo kusht të punojmë sa më shumë që të mos përfundojmë sërish në Gjykatën Kushtetuese, sepse “kuku” çfarë na del prej aty pastaj.

Ju përgëzoj për prurjen e ligjit dhe shpresoj në bashkëpunim për realizimin e një drafti final që e meriton ky sektor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu është i fundit prej diskutuesve.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, deputetja Shqipe Pantina e paraqiti pozicionin e Partisë Socialdemokrate.

Unë dua pak të flas prej përvojës në sektorin financiar dhe mbi zhvillimet që kanë ndodhur në sektorin financiar tre-katër vitet e fundit. Besoj që shumë prej jush edhe e dini se një numër i madh i bankave komerciale më nuk kreditojnë nën shumën prej 10 000 eurove. Pra, një numër i madh i bankave komerciale kanë marrë vendime me të cilat nuk japin financim për një numër të madh të bizneseve të vogla, të fermerëve dhe mikrobizneseve.

Në përpilimin e ligjeve të tilla duhet të kemi parasysh, besoj unë, dy gjëra. E para, është të kuptojmë se cila është struktura ekonomike dhe çfarë lloj institucionesh financiare i duhen kësaj republike, në mënyrë që bizneset të kalojnë nëpër një cikël të rritjes. Pra, nuk është logjika që të mirëmbajmë biznese të mesme e të vogla, por është logjika që t'i rrisim ato. Në këtë drejtim dua të potencoj edhe një kërkesë që i kam bërë deputetes Safete Hadërgjonaj, që edhe unë si nënkryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik të jem i ftuar kur të bëhen diskutimet për Ligjin për mikrofinanca, sepse mendoj që përveç Komisionit për Buxhet dhe Financa në ligje të tilla duhet të jetë i involvuar edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, meqë ka implikime të drejtpërdrejta në strukturën ekonomike dhe në mendësinë ekonomike, si dhe në ligjet tjera që sillen në Kuvend.

Në anën tjetër, ndonëse ligji është një hap përpara, mendoj se duhet të trajtohet edhe pak dhe ne si Parti Socialdemokrate do të sjellim propozime nëpërmjet amendamenteve. Gjithashtu, dua të theksoj që ky diskutimi rreth pagave, rreth benefiteve që i kanë institucionet mikrofinanciare, për shkak se janë OJQ. E pra, duhet t'i kanalizojnë disi të hyrat që i gjenerojnë dhe dallimin ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, duhet trajtuar me seriozitet, për shkak se po krijojnë një lloj disbalanci edhe në aspektin e stafit apo njerëzve në industrinë financiare. Tash ka nisur të bëhet më interesante me qenë pjesë e menaxhmentin në mikrofinanca, sesa pjesë e menaxhmentin në një bankë komerciale. E për një ekonomi e cila tenton të krijojë strukturë më të ndërlikuar financiare me një fond sovran. për shembull, apo të themi me një bursë rajonale, e cila do të ishte interesante të diskutohet, do të jetë jashtëzakonisht vështirë që të gjenden kuadro që duan të dalin nga mikrofinancat në sektorë më të mëdhenj financiarë, për shkak se e kemi këtë lloj të menaxhimit të institucioneve mikrofinanciare.

Po e them këtë, sepse besoj që duhet edhe një çik guxim politik për të ndërmarrë një veprim të vështirë e që ndoshta ky vendimi i Gjykatës Kushtetuese e problematizon, por duhet marrë një vendim me të cilin sigurohemi që secili institucion financiar i shërben tragetit të caktuar dhe të pridefinuar. Pra, institucionet mikrofinanciare një tragetit ekonomik, ose një sektori ekonomik të cilin tashmë nuk e servisojnë bankat. Po ju them, që ka banka që kanë marrë vendim që të mos servisojnë klientë deri në shumën prej 10 000 eurosh dhe ka biznese që nuk kanë nevojë për më shumë likuiditet në fazat në të cilat ndodhen.

Rrjedhimisht, mendoj se ky ligj duhet të kalojë edhe në komisionet tjera, siç është Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe komisionet tjera, të cilat ndërlidhen me këtë sektor në industrinë financiare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Keni diskutuar të gjithë. Zoti Hamza, e keni fjalën, po qe se doni të na lusni ndonjë send. Atëherë, konsideroj se debati rreth kësaj çështjeje... Po, ti mund të flasësh, unë ta lejoj, por Rregullorja s'ta lejon. Zoti Abdixhiku, e ke fjalën. S'ta lejon Rregullorja, sipas këtyre letrave.

ZOTI ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë fola në fillim si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, tash kam të drejtë të flas si deputet, apo jo?

Shumë shkurt, se s'po dua të marr kohë, t'i bëj disa qartësime.

Pra përtej kësaj, është prej rasteve të rralla kur të gjithë pajtohem. Pra, të gjithë u pajtuam rreth problemit të OJQ-ve. Është prej rasteve të rralla, kur s'dimë çka të bëjmë tutje. Sinqerisht po ju them, sepse rasti i OJQ-ve mikrofinanciare është rast sui generis i Kosovës. Veç Kosova ka pasur UNMIK dhe veç Kosova ka mundur të krijojë OJQ që lëshojnë kredi që bëjnë fitim e s'paguajnë tatim. Kjo gjendje ka vazhduar për 20 vjet.

Si legjislacion, pas 20 vjetëve tash duhet të merremi me një gjendje, ku këto biznese janë bërë të mëdha. I kanë 130 milionë euro kapital, portfolio. Pra, ne tash duhet të merremi me një çështje të re të krijuar dhe, mos u habitni, gjithë veprimtarinë e kanë në bazë ligjore të plotë. Ne sot i pyetëm ato institucione, sepse sot patëm takim, i pyetëm dhe na thanë, edhe BQK-ja na e konfirmoi, se nuk ka vakum ligjor për operimin e tyre. Pra, ato operojnë brenda ligjeve ekzistuese të Kosovës.

Janë dy probleme që duhet trajtuar.

Problemi i parë është rreth tatimit të tyre. Sot na thanë që disa prej tyre kanë hequr në baza vullnetare të drejtën e përfituesit publik, pra kjo është çështje më e lehtë që e bëjnë. Ata janë të gatshëm të mbajnë kapitalin, të operojnë me këtë kapital dhe të paguajnë tatim. Pra, kjo nuk është problem.

E dyta, që është më e rëndësishme, është problemi i pronësisë. Kush është pronar i këtyre bizneseve? Paratë që kanë dhënë donacione nuk mund t'i kthejmë, sepse donatorët s'po i pranojnë, sepse u bën telashe në ligjet e tyre respektive si pjesë e shpëlarjes së parasë. Pra, paratë s'mund t'i kthejmë tek donatorët. Na kanë mbetur paratë në Kosovë, nuk kanë pronar dhe bëhet fjalë për një kapital të shtuar mbi misionin humanitar dhe vlera e këtij kapitali është 30 milionë euro. Pra, bëhet fjalë për 30 milionë euro. Të kujt janë 30 milionë euro? Jo për 70 milionë kredi,

sepse këto kanë edhe obligime ndaj institucioneve financiare, kanë obligime ndaj Bankës Botërore që merr kredi e... domethënë janë obligime të tilla.

Pra, si të zgjidhet?

Unë si komision, ju thashë që sot e kemi bërë një grup punues, ju ftoj të gjithë deputetëve që keni ide të vini në atë grup punues, t'i jepni idetë tuaja. Janë disa interesa që duhet t'i kemi parasysh, i pari është i Kosovës. Ligji i tanishëm nuk e zgjidh problemin e OJQ-ve që operojnë, nuk i jep zgjidhje problemit aktual, pra i parandalon të rejtat të regjistroheshin, por ne i kemi edhe tetë OJQ mikrofinanciare që janë në Kosovë.

E dyta, po kemi vërejtje të mëdha prej OJQ-ve. OJQ-të tjera po na thonë që shteti s'bën t'u tregojë OJQ-ve ku t'i çojnë paratë, sepse është rregull kushtetuese e drejta e asociimit. Pra, kemi edhe një prizëm tjetër, të OJQ-ve, jashtë vullnetit tonë të lirë.

Dhe e treta e jo më pak e rëndësishme, janë me mijëra punëtorë, apo jo, në këto institucione. Ne nuk mund t'i qesim në rrugë këta njerëz.

Prandaj, njëri prej propozimeve që na erdhi sot është i Bankës Qendrore të Kosovës, të cilin e diskutuam edhe me institucione mikrofinanciare edhe me organizatat e shoqërisë civile. Pati një përafrim. Njëra prej ideve është shitja e pasurive të institucioneve mikrofinanciare nëpërmjet një ankandi publik. Pra, shitet pasuria e tyre, krijohet një fond. Ky fond kalon nën menaxhimin e një OJQ-je për bamirësi. Domethënë, pas është në diskrecion të OJQ-ve ku duan t'i qojnë këto para. Preferenca jonë kishte me qenë, le të themi një spital diku ta ndërtojmë, ose për shërbime të tilla, por është vendim i tyre sipas të së drejtës së asociimit, që Kushtetuta ia kalon.

Dhe pjesa tjetër më pas, "no how" i mbetur mund të komercializohet dhe të operojë si biznes i ri. Kjo është njëra prej zgjidhjeve që mund të pranohet prej të gjithëve.

Prandaj, edhe një herë po them, ju ftoj që të jepni ide. Është prej rasteve të rralla, ku idetë janë të mirëseardhura dhe po në takimin e ardhshëm ju ftoj edhe anëtarët tjerë të komisioneve të jepni ide konkrete, po që janë në përputhshmëri edhe me pretendimet e mikrofinancave, të OJQ-ve dhe të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan, prapë dëshiron? Atëherë, Dardan Sejdiu e ka një fjalë.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues, për këtë mirëkuptim!

Në fakt, unë mendoj që ekziston edhe një rrezik të cilin duhet ta kemi parasysh kur flasim për 8 mikrofinancat që i përmende, Lumir. Dhe, rreziku është çka nëse këto mikrofinancat si OJQ që janë, ndalin kreditimin? Në çfarë skenari funksionojmë atëherë? Pra, ndalin operimin në



kredidhënie dhe kjo ka implikime të drejtpërdrejta edhe në... si të them, harxhimin e mjeteve që i kanë në dispozicion, po e banalizoj, në strukturën ekonomike dhe në strukturën e kredidhënies.

Unë çfarë po them, është që jemi të gatshëm ne si PSD, unë përkatësisht si anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik vi në secilën tryezë, në secilin takim që thërrisni ju si komision dhe ta trajtojmë temën e këtyre tetë mikrofinancave, se tashmë tema e mikrofinancave të reja po qartësohet. Por, ta trajtojmë këtë portfolio prej 130 milionë eurove apo sa është sot, në mënyrë të duhur, në mënyrë që të mos na zbehet e të mos na mbetet zero.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Lumiri ka kundër-replikë.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Tash, sa për qartësim, në propozimin që u shtrua e i cili po trajtohet, ekziston një periudhë transitore në të cilën BQK-ja luan rolin e facilitatorit të transformimit të këtyre OJQ-ve. Pra, nuk janë këto në vullnet të lirë të veprojnë si të duan, por ka një periudhë transitore, në të cilën BQK-ja ruan rolin e saj mbikëqyrës dhe nuk lejon të ndodhin keqpërdorime të tilla.

Pra, po flasim edhe për një rol të shtuar të inspektuar të BQK-së, por edhe për një zgjidhje përfundimtare. Edhe një herë po them, nuk është lehtë. Jeni të ftuar të gjithë në takimin e ardhshëm. Të gjithë jeni të ftuar, secili deputet që ka vullnet të japë ide, është i ftuar të japë ide. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zonja Hadërgjonaj, veç shkurt të lutem, se edhe Pali po dëshiron ta prezantojë ligjin.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit që më në fund ma dhe edhe një herë fjalën!

Është e vërtetë që sot kemi debatuar shumë në këtë çështje dhe disa diskutime që po bëhen këtu janë pjesë e punës së komisionit dhe të gjithë deputetëve që e njohin këtë lëmi dhe japin kontribut pozitiv në drejtim të zgjidhjes. Ne kemi interesim që ta zgjidhim këtë problem.

Unë desha t'i theksoj tri çështje. Asnjëherë, asnjë OJQ, nuk e ka ngritur problemin që disa OJQ, mikrofinanca nuk po luajnë rolin e bamiësisë, por po kryejnë aktivitete financiare dhe po krijojnë fitim, deri në vitin 2012 kur ka ardhur ligji në Kuvend. Asnjë OJQ prej vitit 2012 nuk është preokupuar pse këto institucione po vazhdojnë në të njëjtën mënyrë ta rrisin fitimin e vet, ta rrisin profitin dhe nuk paguajnë asnjë tatim shtetit. Asnjërit nuk i ka interesuar më, as atyre që e kanë çuar në Gjykatën Kushtetuese.

Dhe e treta që dua ta them, është... deputeti pak më përpara tha “unë kur kam bërë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese kanë dashur të më korruptojnë...”. Unë dua ta pyes deputetin, a e ka

denoncuar atë njeri, se ai vepron ende, sot është duke vepruar sigurisht, a e ka denoncuar në gjykata këtë person i cili ka dashur ta korruptojë? Dhe, nëse nuk e ka denoncuar unë ftoj organet e drejtësisë që të merren me këtë problematikë, se kush është ai njeri që ka dashur ta korruptojë në momentin kur ka kërkuar në Gjykatën Kushtetuese për t'u anuluar ligji.

Këto janë çështje të cilat duhet të zgjidhen dhe janë çështje ku duhet të veprojnë organet e drejtësisë. Nuk ka këtu njerëz që duan të të korruptojnë dhe të mbesin prapë në sistem, të funksionojnë dhe të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Thënë të drejtën, atë çka desha ta them e tha edhe Safetja. Pikërisht, e kisha fjalën për atë deputetin i cili është tentuar të korruptohet dhe desha pikërisht këtë pyetje t'ia bëj. A je korruptuar apo e ke denoncuar atë person që ka dashur të të korruptojë, sepse ne e kemi plot gojën antikorrupsion e vlera, ndërsa vet nuk jemi të gatshëm asnjëherë të denoncojmë raste të tilla.

Kryesues, do të ishte mirë ta përmbylim ngadalë dhe të shkojmë, sepse kemi agjërime dhe duhet të shkojmë të bëjmë iftar.

KRYESUESI: Faleminderit! Abdullah Hoti e ka kërkuar fjalën.

ABDULLAH HOTI: Kryesues, unë mendova se mbaroi diskutimi për këtë çështje me fjalën e deputetit Abdixhiku si folës i rregullt, si deputet. Por, tash ju e hapët prapë bisedën edhe pak.

Po çuditëm me kolegët e mi nga PDK-ja, çfarë halli kanë me Dritonin sot? Prej mëngjesit e kanë gjithë kohën me Dritonin. Nuk foli asnjëra për ligjin, po e kanë hallin... Çfarë ke thënë Driton kështu, prej mëngjesit... Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Sinqerisht, unë s'kam hall me kurrkënd, veç nëse një deputet deklarohet në këtë seancë dhe thotë, se iks-gjykatësi ka dashur të më korruptojë dhe nuk tregon se si ka ecur procedura, a e ka denoncuar, për mendimin tim ai deputet duhet të merret në pyetje dhe thjesht, ai të dënohet për këtë veprim që nuk e ka paralajmëruar. Nuk kemi asnjë hall me asnjërin, as me Dritonin, as me asnjë deputet tjetër, por bollni më me spekulime dhe me gënjeshtër dhe të krijoni opinion të rrejshëm te qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nëse ka dashur të të korruptojë dikush, thuaja emrin e mbiemrin këtu midis Parlamentit, le ta dinë të gjithë. Ju nuk hezitoni asnjëherë t'i quani njerëzit hajna e kriminelë, pa pasur asnjë bazë, ndërsa tani e ke bazën, dikush ka tentuar të të korruptojë dhe nuk guxon t'ia përmendësh emrin! Mos u bëni frikacakë! Thuaje me emër e mbiemër: iksi a ipsiloni ka dashur të më korruptojë. Kaq!

KRYESUESI: Zoti Selmanaj, ka kërkuar replikë. Veç, shiko se ndoshta na ka marrë uria.

DRITON SELMANAJ: Në fakt, tashti me dashtë me iu përgjigj Ganes kështu si duhet, ishte dashur ta imitohet Bacin Adem, dje, sepse kam përshtypjen që ose s'keni vëmendje, ose s'jeni duke më kuptuar.

Kush tha, more, që gjykatësi ka dashur të më korruptuar? A jeni more në terezi çfarë jeni duke folur?

Unë thashë, "madje, nga të tillët" që i bie ata që e kanë humbur rastin kanë ofruar që ne ta tërheqim lëndën, e të mos merremi me këtë temë. Po të isha korruptuar unë, do ta kishim humbur rastin, do ta kisha tërhequr prej Gjykatës Kushtetuese, por e kemi fituar rastin dhe ndihem krenar për këtë. Nuk janë shqiptarë ata, s'janë pjesë e sistemit ata.

Prandaj unë po them, çka je duke folur ti, as s'po më dëgjon, as... çka po të vjen kështu... a din... po kujdes, more, se je e zgjedhur, të dëgjon dikush!

KRYESUESI: Hajde, kundër-replikë Ganja, dhe e kryem.

GANIMETE MULSIU: Faleminderit shumë!

Unë jam shumë e vëmendshme për atë që thash. Trego kush është ai person që t'u ka lutur ta tërheqësh rastin. Trego, thuaje me emër e mbiemër, nëse ke guxim. Thuaje, mos u friko, thuaje me emër e mbiemër. Thjesht, çka të ka ofruar, cila ka qenë oferta e tij që ti ta tërheqësh, përndryshe s'ke pasur arsye ta tërheqësh. Thuaje! Mos ngurro ta thuash atë, sepse vetëm kur t'i themi gjërat hapur ne mund ta ndreqim një sistem në këtë vend, përndryshe do të mbetemi gjithmonë vetëm duke diskutuar kështu me njëri-tjetrin dhe ata atje e bëjnë punën qysh kanë qejf vetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që debati është shteruar. Tani këto pas... Kujtim, a dëshiron të diskutosh apo e mbyllim. Hajde, se...

E mbyllim për sonte, e lëmë... Nesër, a doni në 11:00, a në 10:00? Atëherë në orën 10:00.

*E mërkurë, më 6 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Po fillojmë seancën, ata që kanë fjetur më shumë, besoj që vijnë ndërkohë.

Kemi disa projektligje që kanë nga 2-3 nene, të cilat duhet t'i hyjnë procesit të ndryshimit. Prandaj, besoj që do t'i kalojmë sa më shpejt që është e mundur.

### **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-179 për transportin rrugor**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam nderin që të prezantoj pakon e projektligjeve në fushën e transportit tokësor me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe legjislacionin e BE-së.

Me hyrje në fuqi të Ligjit numër 05/L-087 për kundërvajtje, përcaktohet se dispozita për kundërvajtje, të cilat nuk janë në pajtim me këtë ligj duhet të harmonizohen.

Ju njoftoj se Ministria e Infrastrukturës ka përgatitur pakon e ligjeve për harmonizim me këtë ligj si vijon:

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-179 për transportin rrugor, duhet të ndryshohen dy nene, neni 74 dhe neni 76, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe direktivat e BE-së.

Prandaj, ju lus deputetë të nderuar që të aprovoni apo, nëse keni ndonjë sugjerim, mes leximit të parë dhe të dytë mund ta përmirësojmë. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, z. Myfera Shinik.)*

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër!

Ftoj zëvendëskryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, zotin Dardan Sejdiu, të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e komisionit. Urdhëro, Dardan!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe të tjera që i ka ky komision, i ka shumë për shkak se janë tetë ministri që duhet t'i mbikëqyrë ky komision.

E kemi shqyrtuar projektligjin në fjalë, si komision e kemi aprovuar dhe jemi dakord me ecjen tutje të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Prej Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ligji mbi transportin rrugor që është në fuqi ka kundërthënie disa nene dhe zbrazëtira të shumta që lënë hapësira për interpretime të ndryshme, duke u bërë pengesë e zbatimit të ligjit.

Për këtë arsye në pjesën e parë të vitit 2017 është hartuar Ligji i ri për transportin rrugor, i cili besoj, ministër, se ju është prezantuar nga zyrtarët e ministrisë pas marrjes së mandatit nga ana juaj.

Përveç tjerash, ligji i ri ose plotësim-ndryshimi i ligjit aktual duhet të bëhet edhe me qëllim të harmonizimit legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian, në mënyrë që sektori i transportit rrugor të përgatitet për një konkurrencë dhe integrim në tregun e Bashkimit Evropian.

Për këtë arsye konsiderojmë se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor është i mangët dhe nuk jep kahe të zgjidhjes së disa çështjeve shumë me rëndësi në këtë sektor.

Natyrisht e kuptoj që ju mund të keni qasje të ndryshme ndaj problemeve të caktuara, por mosadresim i asnjë prej këtyre dëshmon mungesën e çfarëdo qasjeje.

Vetëm shkurt po përmend disa nga çështjet, të cilat duhet të ishin adresuar në ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji apo në Ligjin e ri për transportin rrugor.

E para është procesi i licencimit të operatorëve në transportin rrugor si dhe ushtrimin të së drejtës për operim brenda dhe jashtë vendit. Në këtë aspekt duhet të thjeshtohet procedura aktuale administrative e licencimit dhe të vazhdohet me lehtësira të ndryshme për hyrje të operatorëve të rinj në treg.

Kjo do të bëhej nëpërmjet eliminimit të disa llojeve të licencave dhe lejeve, siç është rasti i transportit vendor të mallrave dhe zgjatjes së afatit deri në 10 vjet të atyre licencave që konsiderohen të nevojshme të mbahen, siç janë licencat për stacione të autobusëve dhe terminale.

Në veçanti ligji duhet të rirregullojë çështjen e rendeve të udhëtimit të operatorëve të transportit, duke e bartur kompetencën e hartimit dhe propozimit të tyre te shoqatat e transportit të udhëtarëve apo të një trupi jashtë ministrisë, në mënyrë që ky proces të konsiderohet pronë e operatorëve.

Kjo qasje do të mundësonte që ministria të mos jetë palë në këtë proces, kurse do të rritet transparenca në përcaktimin e rendeve të udhëtimit.

Luftimi i ekonomisë joformale do të duhej të ishte një nga fushat e rirregullimit ligjor.

Aktualisht ekzistojnë transportues të shumtë ilegalë që veprojnë mes qyteteve të ndryshme.

Përkundër aktiviteteve të shumta të ndërmarra në bashkëpunim edhe me policinë e Kosovës, kjo dukuri nuk është luftuar sa duhet, në mungesë të kompetencave të duhura të Inspektoratit të transportit rrugor dhe ndarjes së saktë të përgjegjësi midis komunave dhe ministrisë.

Në fund çështje me rëndësi, e cila nuk është rregulluar aktualisht, e që është kërkesë edhe e Bashkimit Evropian, është implementimi i tahogرافit digjital. Prandaj, së paku kjo çështje është dashur të përfshihet në ndryshimin dhe plotësimin e projektligjit të propozuar. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Grupi Parlamentar i PDK-së, shefi i grupit, Memli Krasniqi e ka fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Siç u tha edhe në prezantimin e ministrit, sot jo vetëm ligji në fjalë për plotësim- ndryshimin e Ligjit për transportin rrugor, po gjashtë ligje në përgjithësi janë pjesë e një pakoje që ministria i

ka sjellë dhe që i kemi shqyrtuar edhe në grup parlamentar, por edhe në komision dhe që kanë të bëjnë me një çështje të rëndësishme që ndërlidhet me harmonizimin e ligjeve ekzistuese me Ligjin për kundërvajtje.

Pa dyshim se në një fazë të ardhshme mund të ketë nevojë për të bërë plotësim dhe ndryshim të çështjeve dhe dispozitave që rregullojnë këto fusha.

Por në këtë moment është konsideruar si e rëndësishme harmonizimi me Ligjin ekzistues për kundërvajtje, po ashtu edhe me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, të cilat ky ligj për kundërvajtje tashmë i ka marrë parasysh. Andaj, në këtë kuadër ne e mbështesim si grup parlamentar që të procedohet tutje edhe Projektligji për ndryshim-plotësimin e Ligjit për transportin rrugor, por edhe projektligjet e tjera, për të cilat do të diskutojmë në vijim. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, deputeti Sami Kurteshi e ka fjalën.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Ne i kemi marrë këto gjashtë ligjet që kanë të bëjnë me transportin në përgjithësi dhe me rregullimin e dokumenteve.

Një pjesë të tyre i kemi shqyrtuar, ajo që është vërejtur në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë përveç të hekurudhat e Kosovës, kemi të bëjmë me harmonizimin e Ligjit për kundërvajtje, edhe diçka që vërehet është vetëm dallimi në shumat e gjobave që janë ulur ose janë rritur.

Unë e kam një pyetje krejt të sinqertë për ministrin: vërtet a janë krejt këto harmonizime, krejt këto ndryshime në dobi të sigurisë së njeriut në rrugët dhe hekurudhat e Kosovës?

Në kuptimin e sigurisë, ne megjithatë bëjmë pjesë ndër vendet me numrin më të madh të fatkeqësive në rrugë që përfundojnë me fatalitet.

Ne kemi edhe ngritjen e disa gjobave për transportin rrugor, sidomos për automjetet e vogla dhe të mëdha, do të thotë janë rritur gjobat, a është bërë ndonjë analizë sa ka ndikuar rritja e gjobave ose shtrëngimi i masave për të rritur sigurinë në rrugë?

Unë mendoj se ky do të ishte thelbi i krejt këtyre ligjeve, i krejt këtyre ndryshimeve që bëhen, natyrisht që këto janë të domosdoshme, si e dëgjuam edhe kolegun Zharku, do të thotë ka edhe çështje të tjera që duhet të ndryshohen, tash për tash është bërë një harmonizim vetëm me Ligjin

për kundërvajtje, me sa i kam parë unë ndryshimet. Mirëpo, cilat janë analizat që janë bërë edhe në Ministrinë e Infrastrukturës për rritjen e sigurisë së njeriut në rrugët e Kosovës.

Përndryshe nuk ka ndonjë arsye të mos përkrahen këto, ky është një ndryshim i mirë, vetëm na tregoni a janë të mjaftueshme dhe cilat janë ato pjesë që mbeten për t'u rritur siguria. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka ministri, urdhëroni ministër Pal Lekaj!

MINISTRI PAL LEKAJ: Së pari, ju falënderoj, deputetë, për kontributin tuaj.

Por më lejoni që të them që ky ligj vetëm e bën harmonizimin e Ligjit për kundërvajtje me kriteret e Bashkimit Evropian dhe nuk është as më shumë e as më pak.

Por sa i përket sigurisë, mendoj që kemi ngecur mjaft, pajtoj plotësisht që nuk kemi krijuar standarde që do të ndikonin pozitivisht në sigurinë e qytetarëve. Duke filluar nga ndërtimi i rrugëve, duke filluar nga shenjëzimi, nga ndriçimi, nga masat dhe nga gjrobat.

Prandaj, ne jemi të interesuar qetësisht që në këtë të ndikojmë dhe me ligje të përcaktohen, e sidomos prioritet të jetë jeta e qytetarëve, siguria, sepse me të vërtetë rrugët janë bërë vdekjeprurëse dhe mendoj që nuk është diçka e mirë dhe nuk pranohet as nga unë si ministër, por as nga Ministria e Infrastrukturës. Jemi në përpjekje të ndryshimeve rrënjësore sa u përket standardeve që kanë ndikim në jetën e qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministër, faleminderit!

Grupi Parlamentar PSD, nuk ka.

Grupi Parlamentar AAK, shefi i grupit, Ahmet Isufi, urdhëroni!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Kjo pako ligjore që është sjellë në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës paraqet një ndryshim, që do të ndodhin pikërisht në bazën ligjore, e cila duhet të rregullohet dhe sidomos në angazhimet tona si grup parlamentar, e sidomos në komisionin adekuat do të punohet që të bëhet harmonizimi i ligjeve me standardet e legjislacionit të BE-së, po ashtu edhe një rëndësi e veçantë i jepet edhe lekturimit, për shkak se shpeshherë po kemi amendamente, të cilat kanë të bëjnë edhe me ndonjë fjalë, e cila veç po i rëndon ligjet në amendamentim.

Prandaj, kujdesi i shtuar duhet të jetë në komisione, në mënyrë që të bëhen ligje, të cilat nuk ka nevojë pastaj përsëri t'i rikthejmë për plotësim dhe ndryshim. Faleminderit!



KRYESUESJA: Faleminderit! Lista serbe, nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar Nisma, Milaim Zeka, urdhëroni!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Edhe ne si grup parlamentar i japim mbështetje absolute këtij ligji.

I vetmi sugjerim është edhe një herë që të angazhoheni personalisht si ministër që të rregulloni sinjalizimin, të krijoni siguri dhe unë mendoj që shpëtimi i njerëzve, kam lexuar pak statistika, në proporcion me numrin e popullsisë vdekshmërinë në aksidentet rrugore në Kosovë e kemi shumë të lartë.

Sidomos tash në zezonin kur vijnë mërgimtarët, e që për fatin e keq unë i kam kritikuar edhe publikisht që shumica prej tyre nuk i respektojnë rregullat e komunikacionit në atë masë që i respektojnë në vendet prej nga vijnë, sepse atje janë ligjet shumë të rrepta.

Por ndoshta do ishte një ide e mirë që ministria juaj të shpallë një tender, pasi para po kemi bajagi shumë dhe të vendosë kamera nëpër autostradë, nëpër rrugë, kamera që njerëzit të ndëshkohen për shkak të tejkalimit të shpejtësisë.

Kështu që ne japim mbështetje këtij ligji.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Grupi Parlamentar “6+” nuk ka. Danush Ademi, urdhëro!

DANUSH ADEMI: Faleminderit!

Edhe Grupi 6+ e përkrah këtë projektligj, sepse tash jemi në sezonin e pushimeve dhe mendoj që ministri duhet të mendojë edhe për komunën e Ferizajt që sa më shpejt të kemi kyçje në autostradë, sepse nga tri orë në këtë sezon presim në rrugë për të hyrë në qytet.

Unë mendoj që, i nderuar ministër, sa më shpejt duhet të mendoni për kyçje në autostradë, sepse e di, është dashur të fillojë projekti dhe nuk di për çka ka ngecur.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sali Zyba.

SALI ZYBA: Përshëndetje, të pranishëm,

Të dashur qytetarë, po i referohem fjalës së ministrit, sepse e arsyetoi këtë sponsorizim të këtij ligji, përkundër Kabinetit qeveritar që mungon, përkundër neglizhencës që po ia bën këtij Kuvendi, përkundër se mazhoranca nuk i ka numrat, ndërsa sponsorizon kësi ligjesh, për të cilat kërkon mbështetje të opozitës.

Është shqetësuese kjo formë e sponsorizimit. Unë personalisht nuk e përkrah këtë ligj, me arsyetimin që e dha ministri, se tha po e standardizojmë me ligjet e Bashkimit Evropian.

Ky ligj vetëm në tri nene ndryshon, kryesisht te gjobat, me arsyetimin që po harmonizohet me një Ligj për kundërvajtje, për mua ky arsyetim është shqetësues.

E kam pyetjen për ministrin: çka u standardizua, cila normë ose cila rritje ekonomike ose cili nivel i pagave, qoftë të punësuarve në nivel publik, qoftë privat, u rrit me Bashkimin Evropian që arsyetimi të përdorej te ky ligj?

Prandaj, me kësi forme, të dyfishohen, në njërën prej neneve ka qenë gjoba, po e zëmë 25 euro, është bërë 50, aty ku ka qenë 500, është bërë 1000. Ky dyfishim në këtë ligj me standarde evropiane nuk duhet të krahasohem, nëse e quajmë vetëm harmonizim, për arsye të harmonizimit mes ligjeve është diçka tjetër. Me standarde evropiane, të lutem, ministër, referoju diku normës ekonomike, rritjeve, për të mundur të krahasohemi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Ministër, a e doni fjalën? Faleminderit! Nuk ka kuorum për votim. Vazhdojmë me pikën tjetër:

### **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, ministër Pal Lekaj!

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme duhet të ndryshohet një nen, neni 58, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe direktivat e BE-së.

Të gjitha procedurat janë kryer, komisioni e ka dhënë vlerësimin dhe nëse mendoni që të bëj edhe memorandum shpjegues, mund ta bëj, por po e shoh që nuk ka nevojë dhe ju mes leximit të parë dhe leximit të dytë mund të amendamenti, të propozoni dhe ne jemi këtu për të ndryshuar pozitivisht.

Ju jeni Parlamenti, ju vendosni. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesuese!

Komisionit për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj të vitit 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme dhe vendosi të rekomandojë miratimin në parim të këtij projektligji.

Ministri e përmendi që është vetëm një nen që duhet të harmonizohet me direktivat e Bashkimit Evropian.

Po e shfrytëzoj rastin që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të shpreh mbështetjen për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetare!

Kolegë deputetë,

Ministra,

I nderuar ministër,

Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për Ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme. Në realitet, çështjet kryesore edhe aty është dashur të rirregullohen çështjet administrative për licencimin e transportuesve të mallrave të rrezikshme, është një çështje posaçërisht me rëndësi që Komisioni Ndërmnistror që ka 10 deri 15 anëtarë nuk ka punuar as në kohën time, nuk është duke punuar as tash, s'ka punuar as më herët. Ka mungesë të kapaciteteve për kontrollin e kësaj fushe, si në Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, agjencitë e tjera që janë përfshira, kështu që duhet të bëhet një rregullim ligjor i atij komisioni ndërmnistror, pavarësisht pse niveli nuk është ministror, po është në nivelin e zëvendësministrave. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Sveçla.

XHELAL SVEÇLA: I nderuar kryesues,

Të nderuar qytetarë,

Tashmë është thënë se ky plotësim-ndryshim i ligjit ka të bëjë me harmonizimin e tij me Ligjin për kundërvajtje, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017.

Qëndrimi ynë është që Qeveria e pakicës t'i bëjë votat për votim të parë dhe pastaj ne do të propozojmë ndryshimet e nevojshme mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin tokësor me mallra të rrezikshme dhe kontributin tonë do ta japim në komision, duke i pasur vërejtjet dhe sugjerimet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Meqë është mandati im i parë në Kuvend, ende po mundohem t'i kuptoj këto rregullat e lojës, shtypjen e pullës kur i vjen rendi grupit parlamentar, kështu që kërkoj mirëkuptim prej jush dhe prej kolegëve tjerë deputetë.

Sa i përket ligjit në fjalë, mendoj që edhe si anëtar i komisionit, por edhe duke e pasur parasysh si të them motivimin për amendamentimin e këtij ligji, mendoj që duhet të ecim përpara dhe rrjedhimisht ne si Grup Parlamentar i Partisë Socialdemokrate e përkrahim në lexim të parë, amendamentet do t'i sjellim në lexim të dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Edhe ne e përkrahim, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli!

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndes të gjithë,

AKR-ja e përkrah këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur për të diskutuar. Propozuesi, Qeveria, a e dëshiron fjalën? Jo! Atëherë presim që bashkë me të gjitha ligjet e tjera, projektligjet t'i votojmë së bashku. Unë dëshiroj t'i thërras deputetët që të paktën në procesin e votimit të jenë në sallë.

## **10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Lekaj, e keni fjalën!

**MINISTRI PAL LEKAJ:** Faleminderit, kryesues!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, duhet të ndryshohen 25 nene: neni 14, 50, 55, 56, 69, 72, 73, 92, 154, 157, 188, 210, 211, 216, 231, 233, 235, 245, 249, 250, 255, 259 dhe tri nene që sqarojnë që disa gjopa që do të ndryshohen. Ato ndryshohen në tërë ligjin bazik, e krejt këto ndryshime bëhen me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe direktivat e BE-së. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Sala Berisha-Shala që ta arsyetojë raportin e komisionit.

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, ministra!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë, dhe

Ju të pranishëm

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2018 e shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për rregullat e trafikut rrugor dhe vjen para seancës me këtë rekomandim: Të miratohet në parim ky projektligj për plotësim dhe ndryshim, siç e përmendi edhe ministri që ka të bëjë me ndryshimin e 25 neneve, që ka të bëjë me harmonizimin me Ligjin për kundërvajtje dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Në të njëjtën kohë, e shfrytëzoj rastin që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të shprehim mbështetjen tonë në lidhje me këtë projektligj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nuk është problemi se Dardani më herët e pati mirë nëse e shtypni apo jo butonin, po vërtet është ngarkesë e madhe të shihet në sallë kush do të flasë, e kush s'do, kush kujt ia përmendi emrin, kujt jo. Më e mira e së mirës është që grupet parlamentare ta bëjnë renditjen e diskutuesve për secilën pikë dhe me letër t'i sjellin, e të mos hidhërohen në kryesuesin e seancës dhe gjithçka të

shkojë më mirë, sesa t'i lihet përgjegjësia pastaj kryesuesit të seancës, sepse në renditje ndonjëherë është anëtari i grupit parlamentar dhe kryetari i grupit parlamentar. Nuk di a t'ia jap fjalën kryetarit apo anëtarit, meqenëse ne duhet ta zbatojmë renditjen. Pra, nëse ju e bëni renditjen e kësaj gjithmonë, ne jemi të detyruar që ta zbatojmë vendimin e grupeve parlamentare.

Zoti Lutfi Zharku e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të nderuar,

Ministra,

Pavarësisht që ligji është që një vit në fuqi, implementimi apo zbatimi fillestar ka qenë jashtëzakonisht i mirë. Kemi pasur një rënie të aksidenteve dhe rritje të gjobave të ndryshme në trafik, megjithatë posaçërisht sivjet ndihet një dobësi, apo ndihet një ulje e zbatimit të ligjit, kështu që me gjithë nevojën për harmonizim ligjor të këtyre kundërvajtjeve, besoj se është dashur të vërtetohet apo thjesht të analizohen gjobat që i kemi, nëse janë duke ndikuar në mënyrë të duhur, apo ka nevojë për ndryshim të tyre, për shkak se po flasim për gjobat që i kemi në trafikun rrugor, e për të cilat ka pas një debat të madh në kohën kur janë aprovuar, natyrisht implementimi i tyre si duket po çalon pa fajin e Ministrisë së Infrastrukturës, në këtë rast, por të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga PDK-ja nuk është paraqitur askush. Lëvizja Vetëvendosje, zoti Sali Zyba.

SALI ZYBA: Këtë ligj dhe ligjet tjera që kanë ardhur në formën e pakos sot, por të cilin po e shqyrtojmë veç e veç, për ne si Lëvizje Vetëvendosje shqetësimi është i njëjtë. Sponsorizuesi nuk është serioz as në trajtimin e ligjeve, e kërkon aprovimin me këtë pakicë që e ka të pranishme në Kuvend dhe Qeverisë si mazhorancë.

Andaj, kam pak shqetësimin për ministrin, sepse edhe parafolësi e përmendi se qysh Ligji për kundërvajtje ka një vit që është në funksion, apo në aprovim mund ta quaj, por nuk është prioritet apo shqetësim, meqenëse po flasim për trafikun rrugor, për ligjin, pra ka ndryshime vetëm në vlera e në sasi, kryesisht te gjobat. Për ministrin është një shqetësim, sepse ka disa akse rrugore, po e specifikoj, po e përmend në veçanti aksin rrugor në magjistralen Ferizaj-Kaçanik, në rastin e aksidentit për policët me fatalitet që ndodhi aksidenti, nuk ka pasur kompani për mbikëqyrje dhe për mirëmbajtje rrugore. Andaj, prioritet kanë këto shërbime për qytetarët që t'i parandalojë fatkeqësitë në trafik, ndërsa për këto gjoba në këtë mënyrë të sponsorizimit nuk është shumë e ngutshme dhe në fakt duhet të jenë me prioritet disa gjëra të tjera në shërbime për qytetarët.

Prandaj, specifikoj edhe diçka, kjo vlen për kryesuesin, në momentin kur e keni ndërprerë dje seancën, në sallë kanë qenë të pranishëm 32 deputetë, ndërsa të nënshkruar kanë qenë 112 në

mbarëvajtje gjoja të procesit të Kuvendit. Prandaj, ky është shqetësimi ynë si Lëvizje Vetëvendosje, ndërsa unë në shenjë proteste do ta bojkotoj për një orë këtë seancë për faktin se këtu nuk është e pranishme mazhoranca. Duket qesharake, por do të bindeni më vonë.

KRYESUESI: E drejta e jotja! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Si nënkryetar apo zëvendëskryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e kam pasur mundësinë të kaloj nëpër këtë pako ligjore dhe e kam parë dhe arsyetimin e ministrisë në lidhje me harmonizimin me Ligjin për kundërvajtje dhe mendoj që është detyrë e jona që ta përfundojmë një proces të tillë, i cili është ndoshta si duket kështu teknik, por e ka një rëndësi sa i përket ligjeve, të cilat po i trajtojmë si pako.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Socialdemokrate do ta përkrahim në lexim të parë dhe do të sjellim amendamente për leximin e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Ne e dëgjuam edhe arsyetimin e ministrit. Meqenëse kjo është një pako e ligjeve, të cilat i ka sjellë ministri në këtë rast dhe që kanë të bëjnë me harmonizim me ligje të tjera dhe me direktivat e BE-së, ne si Grup Parlamentar e kemi përkrahur, do ta përkrahim dhe do ta votojmë, dhe i ftojme edhe deputetët e tjerë që ta përkrahin dhe ta votojnë, sepse në çdo interpelancë apo në debatet që po thërrasim ne po kërkojmë, meqë kemi ligje të paharmonizuara, ligje të paimplementueshme dhe në këtë rast nëse e kemi të bëjmë me ligjet që nuk janë të harmonizuara, normalisht që duhet ta kemi përkrahjen e gjithë deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe Nisma i jep përkrahje projektligjit në fjalë dhe shpresoj që brenda dy leximeve do ta japim kontributin tonë për përmirësimin nëse ka ndonjë hapësirë për ta përmirësuar ligjin më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli, urdhëro!

ISLAM PACOLLI: AKR-ja e përkrah, duke shpresuar që kjo do të jetë në të mirë të qytetarëve dhe prandaj ne jemi për.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lekaj, e dëshironi fjalën pas diskutimeve? Jo! Në rregull! Atëherë, edhe kjo mbetet të votohet kur kemi kuorumin e duhur.

### **11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferë**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Pas prezantimit të projektligjit pastaj e hapim debatin për deputetët. Zoti Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës, e keni fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferë, duhet të ndryshohen nëntë nene: neni 11, 42, 44, 48, 49, 50, 51, 53, 128 me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe direktivat e BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e komisionit funksional, kryetarja e komisionit, zonja Sala Berisha-Shala, e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar edhe këtë projektligj në një mbledhje ku është shqyrtuar pakoja e këtyre ligjeve dhe kërkojmë që ta mbështetni. Në të njëjtën kohë, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar nëpërmjet anëtarëve të vet dhe i jep mbështetje këtij ligji, ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Po, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për patentë shoferë. Ndryshimet e kërkuara korrespondojnë nga hyrja në fuqi e Ligjit për kundërvajtje dhe e cila duhet të harmonizohet edhe me këto tri ligje, të cilat sot janë në procedurë kuvendore. Ne japim përkrahjen në parim, eventualisht shqetësimet tona i kemi shprehur edhe më herët nëpërmjet institucionit të dikasterit përkatës, por edhe ato që kanë ardhur nga Policia e Republikës së Kosovës. Kështu që harmonizimi duhet të jetë pak më i shpejtë, ndoshta edhe



komisioni këtu duhet të jetë më proaktiv, sepse ka pengesa edhe në procedurën kundërvajtëse në implementimin e saj nga gjykatat e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën, në emër të grupit parlamentar.

DARDAN SEJDIU: Edhe një herë, kjo pako e ligjeve është trajtuar si pako dhe në frymën e harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe si Grup Parlamentar i japim përkrahje në lexim të parë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë projektligj dhe po ashtu kontributin do ta japim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fatmire Kollçaku, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

Të drejtën të jua them, më tepër edhe në emrin tim personal, desha ta ngre një shqetësim, meqenëse nuk flasim çdo ditë për trafikun, për sigurinë në rrugë, e sidomos për patentë shoferë.

Këtu po flasim për gjoba, por kryesisht po fokusohemi në ato pas aksidentit, pas asaj çfarë po ndodh, por çfarë po bëjmë sa u përket kriterëve për marrjen e patentë shoferit? Këtu po flas shumë e shqetësuar për shkak se çdo ditë në trafik po ballafaqohemi sidomos me të rinjtë, të cilët vijnë deri të patentë shoferi në mënyrë shumë të lehtë, nuk ndiqet pjesa teorike që është obligative për një të ri, i cili i vijon orët vetëm me makinë, por pjesën teorike nuk e obligon askush ta ndjekë. Besoj që aty duhet të futen leksione ku do të pasqyrohen aksidentet që të ballafaqohen me pasojat e aksidenteve. Do të thotë, unë jam për atë që të ashpërsohen kriteret shumë dhe aty të harmonizohemi, ta shikojmë si merret një patentë shofer për shembull në Norvegji, ku kam rast që kam familjarë, cilat janë kriteret edhe si mund të arrihet deri te patentë shoferi? Vërtet, është një moment, meqenëse nuk flasim çdo ditë për këtë temë, është një shqetësim i madh si bëhen tejkalimet në autostradë, ku nuk kanë durim për të pritur, dhe tejkalimet bëhen në anën e kundërt. Çdo ditë jemi të rrezikuar dhe çdo ditë duhet të kesh fat për të arritur shëndosh e mirë në një destinacion ku ke filluar, ku je nisur dhe ku do të arrish, sepse sidomos të rinjtë nuk kanë frikë fare, sepse kriteret për marrjen e patentës janë shumë të lehta.

Ne fokusohemi te gjobat, gjithmonë bëjmë rritjen e pagesës për patentë, e problemi është qysh ta rritim pagesën për patentë shoferë, por jo si ta bëjmë preventivën. Do të thotë, si ta bëjmë që

kriteret për marrjet janë aq të ashpra sa që një shofer kur të pajisjet me atë patentë të jetë vërtet i aftë që të kyçet në komunikacion.

Këto janë shqetësime dhe e shfrytëzova rastin, meqenëse e kemi këtu ministrin, por i kemi edhe të gjithë pronarët e auto-shkollave, të cilët fare nuk i japim rëndësi pjesës teorike, e kjo duhet të jetë obligative për secilin që dëshiron të pajiset me patentë shoferi, që ta vijojë edhe pjesën teorike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albert Kinolli, nga Grupi Parlamentar 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar 6+ e ka shqyrtuar këtë Projektligj për patentë shoferë dhe duke pasur parasysh që këto projektligje vijnë në pako dhe duhet të gjejnë harmonizim dhe duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre projektligjeve ne duhet t'i japim në parim përkrahje e do ta mbështetim, ndërsa kontributin tonë do ta japim nëpërmjet përfaqësueses sonë në komisionin përkatës ndërmjet dy leximeve për amendamentim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Nisma i jep përkrahje ligjit në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Praktika e diskutimeve të ligjeve, e projektligjeve pa i votuar nuk po më duket që është një praktikë e mirë dhe mendoj që tejkalimi kështu i shpejtë i tyre krijon një lloj boshllëku dhe unë vetëm shkurt po dua ta pyes ministrin Lekaj, i cili është këtu i pranishëm: Ku janë ata 72 numra, të cilët me arrogancë i paraqiste nëpër medie që t'i votojmë këto ligje dhe të vazhdojmë më tutje? Jo vetëm të shkojmë kështu shkel e shko, për dhjetë minuta, domethënë pesë minuta ligje me rëndësi që janë për shtetin. Derisa nuk i keni numrat, ju po vazhdoni me u varë nga partitë, të cilat kurrfarë obligimi nuk kanë që të vazhdojnë të ju mbajnë edhe më tutje në një qeverisje të keqe.

Prandaj, arroganca juaj nëpër medie, të cilën e keni shprehur para disa ditëve me 72 numra është mirë që t'i tregoni opinionit ku janë ata 72 numra dhe kah po vijnë ata 72 numra në këtë Kuvend.

E jo vetëm të flitet dhe të krijohet amulli me një arrogancë të paparë, e cila nuk i ka hije një politikani të pjekur. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Doktor, kështu e kemi pasur gjithmonë, nuk është hera e parë. Është leximi i parë, zakonisht flasin kryetarët e grupeve parlamentare dhe koha për shqyrtim është nëpër komisione, por mirë është që deputetët të jenë në sallë që t'i votojmë. Mirë e ke. Dakord jam! Zoti Pacolli e ka fjalën.

**ISLAM PACOLLI:** Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që është një temë e rëndësishme, e cila është për të mirën e qytetarit. Mendoj që këtu çdonjëri që mundohet ta japë kontributin, shpresoj në të mirën e qytetarit, e jo për ngjyra politike.

Unë e dëgjova edhe debatin, e pastaj edhe jam njëri nga ata në katër shtete e kam marrë lejen për vozitje që nga fillimi. Mendoj që nuk është e rëndësishme personi a duhet ta ndjekë kursin, atë pjesën juridike, sa është e rëndësishme se me të vërtetë varet nga njeriu është i gatshëm për të mësuar dhe ta përgatisë atë tekst për dhënien e provimit, sepse ka shumë njerëz që janë në punë, studiojnë dhe sigurisht ndoshta nuk kanë kohë. Natyrisht është e rëndësishme të nxjerrim rregulla në komunikacion. Aty është e rëndësishme për edukim, duke filluar varet se çfarë shkelje bëjnë të ligjit, aty pasojnë edhe ndëshkimet, pastaj varet çfarë veturash vozitin. Nëse janë vetura që me të vërtetë nuk i plotësojnë kushtet për komunikacion, ato duhet të shqyrtohen. Është e rëndësishme se kjo e bën shumë reduktimin e aksidenteve që po ndodhin. Sigurisht që kjo është e rëndësishme, mendoj që ministri e ka parasysh dhe besoj që do ta shqyrtojë, përndryshe nëse dikush është i aftë dhe nuk shkon t'i ndjekë ato kurse, mendoj që pak ka rëndësi.

Ajo çka është e rëndësishme është që të respektohen rregullat e komunikacionit. Dhe, sigurisht që Policia e ka për detyrë që ata që i thyjnë ato, varet edhe prej shkallës së thyerjes së ligjit, pastaj edhe ndëshkimi shkon ashtu, por të mos jenë të paprekshëm ata të cilët janë në komunikacion, sepse aty fillon edukimi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

**KORAB SEJDIU:** Përshëndetje!

Pasi veç ministri është këtu, desha ta ngre një çështje që është shumë e rëndësishme, sepse tek patentë shoferët, veçanërisht te qytetarët tanë që kanë patentë shoferë jashtë vendit dhe synojnë t'i përkthejnë ato këtu, fatkeqësisht u merret, u konfiskohet patentë shoferi nga vendi i origjinës, për shembull Gjermania, Franca, apo diku tjetër, dhe kjo u nxjerr probleme të jashtëzakonshme.

Do të duhej të shikohej mundësia që në këtë rast me këtë projektligj, ose edhe në rastet tjera me ndonjë udhëzim, ose thjesht t'u thuhet zyrtarëve tanë që të mos e bëjnë një veprim të tillë, sepse

problemi me të cilin ballafaqohen qytetarët tanë pastaj po është jashtëzakonisht i madh, sepse duhet dhënë arsytetime pse po u konfiskohet patenta e shoferit në një vend tjetër kur kërkohet ta nxjerrin tjetrën si zëvendësim. Kështu që ju kisha lutur ministër, nëse mund ta adresoni këtë, do të kishte qenë jashtëzakonisht e dobishme për një numër shumë të madh të bashkatdhetarëve tanë që dëshirojnë ta kenë edhe patentë shoferin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti ministër, e dëshironi fjalën? Jo!

## **12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120**

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin, zotin Palë Lekaj, që para deputetëve të Kuvendit që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, fjala është e juaja.

MINISTRI PALË LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120. Duhet të ndryshohen dy nene, neni 23 dhe 24, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe direktiva të BE-së.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesit të Komisionit FunkSIONAL, zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 16 maj 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për rrugë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

- Të miratohet në parim Projektligji për plotësim dhe ndryshim për rrugë

Të njëjtën kohë edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës i japim mbështetje këtij projektligji. Kontributin tonë do të vazhdojmë ta japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës që nga Pavarësia e saj i ka kushtuar rëndësi të posaçme zgjerimit të rrjetit rrugor dhe rehabilitimit të atij ekzistues, si në nivelin nacional ashtu dhe në atë lokal. Kështu, pothuajse të gjitha investimet publike janë përqendruar në rrugë.

Përkundër rezultateve në infrastrukturën fizike është për brengosje ngecja në infrastrukturën ligjore, që do të mundësonte shfrytëzim efikas dhe ruajtje të rrjetit rrugor. Njëjtë sikurse në Ligjin mbi transportin rrugor edhe Ligji për rrugë është hartuar në pjesën e parë të vitit të kaluar dhe i njëjti është i gatshëm në sirtarët e ministrisë, po për habi, ministri nuk e ka parë të udhës që ta sjellë në Kuvend të njëjtin apo ta hartojë që nga fillimi projektligjin e ri.

Për këtë arsye, konsiderojmë se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë është i mangët dhe nuk adreson asnjë nga vështirësitë, me të cilat përballet ministria në këtë fushë.

Po filloj me shfrytëzimin e brezit rrugor dhe ruajtjen e brezit mbrojtës. Përkundër lehtësimeve të mëdha ligjore që janë bërë, sa u përket kyçjeve në rrugët nacionale dhe rajonale, kjo çështje duhet të forcohet edhe me kompetenca më të mëdha të Inspektoratit në mënyrë që të ruhet brezi mbrojtës dhe i njëjti mos të shfrytëzohet në mënyrë ilegale. Aktualisht, kompetencat e Inspektoratit janë reduktuar në dhënien e vërejtjes me shkrim ndaj cilitdo person, fizik apo juridik, që bën kyçje ilegale në rrugë dhe përcjellja në gjykatë në rast të mosrespektimit të saj, pasi që ligji në fuqi nuk e definon në mënyrë të saktë të drejtën e Inspektoratit për marrjen e masave preventive, ndalimin e punës, konfiskimin e pajimeve, si dhe implementimin me forcë të vendimeve të saj, në praktikë shfaqin hezitime dhe subjektivizëm në zbatimin e ligjit.

Në këtë kontekst po e përmend edhe mundësinë e ndërtimit të kyçjeve të reja në Autostradën Ibrahim Rugova. Siç e dini, kërkesa e Komunës së Mamushës që disa vjet për kyçje në autostradë, përderisa unë jam kritikuar nga kryetari i komunës së Mamushës për pamundësi të aprovimit të kyçjes në mungesë të rregullativës ligjore, ju po u premtoni kyçje kurse nuk e sillni ligjin për këtë çështje.

Ne duhet të krijojmë zgjidhje ligjore për kyçje të reja, qoftë me kërkesë të institucioneve publike apo zonave të ndryshme industriale. Në lidhje me kyçjet në autostradë më duhet të theksoj se edhe vendimin e Komisionit Ndërministror për dy kyçje të reja në Autostradën Arbën Xhaferi

për komunën e Vitisë dhe Ferizajt. Ju keni obligim ligjor, ministër, ta respektoni apo anuloni vendimin e tillë e jo t'i mbani pezull qytetarët me deklarata sikur të fushatave elektorale.

Çështje tjetër me rëndësi është kompensimi i dëmeve në rast të aksidenteve, për shkak të mospajësimit fizik gjatë kryerjes së punimeve në rrugë apo mosmirëmbajtjes së duhur të rrugëve nacionale dhe rajonale. Përkundër asaj se ligji aktual përcakton në mënyrë të përgjithësuar përgjegjësinë e kompanisë që kryen punët në rrugë dhe atyre për mirëmbajtje, që në rast se aksidenti shkaktohet nga mospajësimi apo mosmirëmbajtja e duhur e rrugëve në praktikë deri më tash nuk kemi raste që ndonjë kompani ka kompensuar ndonjë dëm, kurse ka kërkesa të shumta për këtë çështje, të drejtuara ministrisë.

Kjo çështje duhet të normohet në mënyrë të saktë dhe të krijohen mekanizma ligjorë, që nëpërmjet dhënies së polisës së sigurimit me rastin e nënshkrimit të kontratës qytetarët e dëmtuar të mund t'i drejtohen ministrisë në rast se kompania e kontraktuar nga ministria nuk e kompenson dëmin.

Në ligjin aktual nuk është e rregulluar në mënyrë të duhur kategorizimi, planifikimi, projektimi, ndërtimi, rekonstruimi, sinjalizimi dhe mirëmbajtja, si dhe strategjia e zhvillimit të rrugëve publike. Po ashtu, ekziston një konflikt i dispozitave me Ligjin e ndërtimit, në veçanti sa u përket lejeve për autostradë, pasi që të dy ministritë, e Infrastrukturës dhe ajo e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor janë kompetente për lëshimin e lejes së ndërtimit. Ligji i ri duhet të përcaktojë edhe strukturën e re organizative të departamentit të menaxhimit të rrugëve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zonja Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120.

Sigurisht që shumë vërejtje që i përmendi edhe përfaqësuesi i LDK-së qëndrojnë, mirëpo duke pasur parasysh që të gjitha këto projektligje janë të sponsorizuara nga Qeveria dhe meqë rregullisht Qeveria e pakicës po thotë se mund të qeverisë, atëherë besojmë se ky është momenti kur kjo qeveri e pakicës ta konfirmojë nëse e kanë aftësinë të kalojnë nismat e veta. Madje, unë këtu ftoj edhe subjektet tjera opozitare që t'i bashkohen këtij qëndrimi politik, pra që të mos lejojnë që me votën e tyre t'i ndihmojmë qeverisë së pakicës.

Po ashtu, me që zoti Lekaj është këtu në këtë seancë, po është goxha e vështirë që ta takojmë dhe shpesh edhe kemi proceduar pyetje parlamentare, për të cilat nuk na është dhënë përgjigje, dhe ishte një vendim skandaloz i Qeverisë Haradinaj, ku janë dhënë 53 milionë euro

Behtel&Enkës. Andaj, a po e merr mundin që me dhënë përgjegjësi këtu në foltoren e Kuvendit për këtë vendim skandaloz, duke qenë se je ministër i Infrastrukturës.

Besojmë që është tepër e rëndësishme që kjo qeveri të pengohet për faktin se vendimet e kësaj qeverie çdo ditë po bëhen më të këqija, prandaj edhe situata është jashtëzakonisht serioze, andaj edhe në këtë drejtim nevojitet një angazhim i opozitës për t'i ndalur të këqijat e kësaj qeverie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu, në emër të PSD-së.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe një herë po e them, që ndryshimet që duhet t'i pësojnë ligjet që janë sjellë sot këtu si pjesë e një pakoje për t'u harmonizuar me Ligjin për kundërvajtje do t'i sjellim në amendamente. Në parim do ta përkrahim projektligjin.

KRYESUESI: Zoti Isufi e ka fjalën, në emër të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Projektligjet që janë sjellë për ndryshim dhe plotësim nga Ministria e Infrastrukturës janë projektligje që janë gjetur në ministri, e që e përgëzoj ministrin për këtë pako ligjore që e ka sjellë për t'i plotësuar dhe ndryshuar këto ligje, sepse duhet të perfeksionohen dhe të bëhen sa më të mira. Ndërsa, i ftoj të gjithë deputetët që t'i votojnë, sepse këto janë ligje të Kosovës, janë të qytetarëve të cilët duhet të shërbehen me këto ligje dhe të zbatohen nga ana e Qeverisë, prandaj nuk janë ligje të dikujt veçantë, por janë ligje që e bëjnë funksional shtetin e Kosovës.

Prandaj, konsideroj se edhe për vendimet të cilat merren në këtë Qeveri janë si pasojë e disa neglizhencave që kanë ndodhur në qeveritë e kaluara dhe po detyrohen edhe ministrat edhe Qeveria të bëjnë përmirësimin e gabimeve të tjerëve, prandaj keni parasysh angazhimin e kësaj Qeverie për përmirësimin e jetës së qytetarëve he obligimet që ka para ligjit e Kushtetutës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues! Edhe nisma i mbështet projektligjet.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Zoti Lekaj, dëshironi ta thoni ndonjë fjalë? Jo. Faleminderit!

Zoti Mikullvci e ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Unë, në parim po them. Nuk e di sa është në rregull kështu, vetëm përfaqësuesit e grupeve parlamentare me dhënë mendimin për projektligjet e ne deputetët tjerë të heshtim. Edhe ne kemi vërejtje, eh. Më së pari këtë desha ta them. Dhe, në parim po them këtë që po frikohem se shumë shpejt po kalojmë, po i marrim këto projektligje, veç po marrim përgjegjësi për të punuar në të ardhmen e s'po punojmë kurrgjë hiç. Këtë desha ta them.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mikullovc, e dini që për çdo çështje secili deputet, në qoftë se nuk vendos seanca ndryshe, ka të drejtë të diskutojë 10 minuta. Unë s'mund t'ia përgatis letrat kurrkujt. Faleminderit!

### **13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Palë Lekaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Lekaj, e keni fjalën.

PALË LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-063 për Hekurudhat e Kosovës duhet të ndryshohet vetëm një nen, neni 143, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje dhe direktiva të BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është e kryetarit të Komisionit Funkcional, zonjës Sala Berisha-Shala, që ta arsyetojë raportin e Komisionit. Zonja Shala-Berisha, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje ministra!

Kolegë të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 16 maj 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Hekurudhat e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

**R e k o m a n d i m**

- Të miratohet në parim projektligji në fjalë.



Këtu po vërehet një fenomen, se deputetët e rinj zakonisht shprehën ato dyshimet e veta. Ende nuk e kanë mësuar Rregulloren e Kuvendit. Kanë të drejtë të diskutojnë edhe në lexim të parë, kanë të drejtë të bëjnë amendamente edhe gjatë fazës së amendamentimit, prandaj në cilësinë e kryetares së komisionit i ftoj të gjithë ata deputetë, që kanë diçka vërejtje a sugjerime t'i ofrojnë komisionit në fjalë.

Të njëjtën kohë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dua të shpreh mbështetjen në këtë projektligj dhe i ftoj të gjithë kolegët e mi, që ta mbështesin këtë projektligj, sepse kjo pako ligjore është ligje të Kosovës dhe të gjithë duhet të kontribuojmë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet Parlamentare, nuk është paraqitur askush. Zoti Ramadani, nga Lëvizja Vetëvendosje.

VALON RAMADANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Duke qenë se ky plotësim-ndryshim i ligjit ka të bëjë me harmonizimin e këtij ligji me Ligjin për kundërvajtje, ne do të propozojmë ndryshimet e nevojshme ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi në emër të Grupit Parlamentar Nisma. Zoti Sherifi, e kini fjalën.

BILALL SHERIFI: Po, faleminderit, kryesues!

Nisma po ashtu e jep përkrahjen në parim projektligjit në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Kemi pikën e 14-të, për të cilën Qeveria nuk ka autorizuar askënd. Kemi pritur që do të vijë Abelard Tahiri, por ai nuk qenka i autorizuar për këtë ligj, prandaj unë e heq prej rendit të ditës për seancën e ardhshme, ose gjatë kësaj seance, në qoftë se vjen dikush i autorizuar nga Qeveria për këtë ligj.

#### **14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike**

Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Duke pasur parasysh faktin që ky projektligj ka kohë që është proceduar në Komisionin për Legjislacion dhe për shkak se ka qenë problematik në përmbajtje, ne e kemi shqyrtuar dhe kemi rekomanduar që të mos përkrahet. Prandaj, unë nuk besoj se ka ndonjë kuptim që ta shtyjmë këtë pikë, por besoj se Kuvendi duhet të vendosë në përputhje me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, në të cilin kanë vendosur që për këtë projektligj të votohet kundër, të gjithë anëtarët e Komisionit për Legjislacion.

Pra, nëse më lejohet po vazhdoj me arsyetimin e vendimit të Komisionit për Legjislacion.

Qeveria e ka ditur që ky projektligj është në rend dite dhe në qoftë se do të kishte interes do të caktonte ndonjërin prej ministrave, por as nuk ka kërkuar që të tërhiqet, prandaj edhe nuk kemi arsye që ta shtyjme.

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 15.05.2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-030 për aktet juridike dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

#### R e k o m a n d i m

- Të mos miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-030 për aktet juridike.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 15.05.2018 e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar.

Komisioni vlerësoi se projektligji është tërësisht i panevojshëm dhe nuk adreson qëllimin për të cilin është propozuar, për më tepër bie në kundërshtim me Kushtetutën, ose ripërsërit çështje tashmë që janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje të tjera dhe ndërhyr në fushëveprimin e ligjeve tjera.

Miratimi i tij dhe hyrja në fuqi e këtij projektligji mbirregullon apo mbivendos fushëveprimin e institucioneve në nxjerrjen e akteve juridike. Dispozitat e këtij projektligji paraqesin dispozita konkurruese mbi të njëjtin objekt, i cili është rregulluar tashmë. Neni 1 i projektligjit thekson, qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i llojeve dhe hierarkisë së akteve juridike si dhe përcaktimi i parimeve dhe standardeve për hartimin, nxjerrjen, miratimin, konsolidimin, korrigjimin dhe publikimin e akteve juridike. Mirëpo, hierarkinë e akteve juridike në Republikën e Kosovës e rregullon Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 16, 17 dhe 19. Po ashtu edhe hierarkia e akteve juridike është trajtuar edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, rasti nr. KO 95/13, ndërsa çështje tjera si parimet, standardet, miratimi, konsolidimi, publikimi, janë rregulluar me legjislacion pozitiv. Zakonisht, parimet dhe standardet e hartimit janë rregulla procedurale, të cilat përshkruhen në manuale, doracakë apo udhëzime, direktiva apo rregulla të unifikuara.

Në memorandumun shpjegues të këtij projektligji rreth arsyeshmërisë për nxjerrjen e ligjit thuhet se në disa shtete nuk ekziston një ligj i tillë dhe shumë nga këto çështje janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me legjislacion tjetër, kurse në shumicën e shteteve të tranzicionit nga sistemi socialist ekziston ky ligj, por nuk jepet asnjë e dhënë se në cilin shtet ka një ligj të tillë.

Sipas një hulumtimi parlamentar të realizuar pikërisht për këtë çështje në vitin 2013 nga Drejtoria për Hulumtime e Kuvendit të Kosovës ka rezultuar se asnjë shtet në Bashkimin Evropian nuk e ka një ligj të tillë, rreth 22 shtete të cilat janë përfshirë si raste studimi, qoftë ato me demokraci të konsoliduar, shtete socialiste apo në tranzicion, nuk e kishin një ligj të tillë në fuqi.

Sipas këtij hulumtimi shtetet kishin akte që rregullonin parimet e hartimit dhe nxjerrjes së akteve juridike, sepse hierarkia rregullohet me Kushtetutë dhe legjislacion.

Neni 2 i projektligjit që rregullon fushëveprimin inderalia thekson se dispozitat e këtij ligji zbatohen nga të gjitha institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal. Me asnjë dispozitë të legjislacionit pozitiv në Kosovë nuk rregullohen apo përkufizohen institucionet publike, por vetëm institucionet shtetërore, Ligji për administratën shtetërore dhe shumë ligje tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve shtetërore, qoftë agjenci ekzekutive, institucione të pavarura dhe të tjera.

Shumë institucione publike nuk kanë fushëveprim nxjerrjen e akteve normative me karakter rregullues. Pastaj, probleme ka në nenin 3, por po mundohem që ta shkurtoj fjalimin për faktin se nuk premtan koha, pastaj problemi është me nenin 4, është kundërthënës, është kundërkushtetues. Pastaj, neni 4.1.3, që flet për transparencën e akteve juridike, thuhet që transparenca aktet juridike hartohen në mënyrë të hapur gjithëpërfshirëse dhe njëkohësisht adresojnë komentet dhe sugjerimet nga publiku dhe palët e interesuara. Ky parim mund të sendërtohet tek miratimi i ligjeve apo amendamenteve kushtetuese, por si është e mundur që ky parim të respektohet kur nxirret një vendim i Qeverisë, një dekret i presidentit... A e thërret presidenti publikun për ta shqyrtuar atë dekret apo Qeveria një vendim të saj? Pra, është komplet e pazbatueshme. Ose, Policia, AKI-a, Forca e Sigurisë, Departamentet emergjente, inspektoratet, agjencitë e pavarura... pastaj kemi problem edhe me nenin 5, sepse është shumë i panevojshëm dhe nuk përmban asnjë dispozitë normative. Me nenin 6 po ashtu, komplet neni 7, 8, 9, 10, pra pothuajse të gjitha nenet në këtë projektligj janë kundërthënëse, janë kundër Kushtetutës, janë kundër ligjeve tjera pozitive.

Andaj, asnjë çështje nuk rregullohet me këtë projektligj dhe po ashtu më duhet të them se është shkruar në mënyrën më joprofesionale. Sinqerisht, unë nuk e di se kush nga Qeveria e ka hartuar, sepse është sponsorizuar nga Zyra e kryeministrit, prandaj edhe në komision e kemi vendosur që ky projektligj të mos miratohet dhe i kemi rekomanduar seancës që të mos e përkrah këtë projektligj. Në qoftë se, do të lind nevoja për rregullimin e konsolidimit të akteve juridike sigurisht që Komisioni për Legjislacion shpreh gatishmëri që të punojë dhe ndihmojë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk e kam nxjerrë në shqyrtim, meqenëse Qeveria nuk është këtu, ata kanë të drejtë ta tërheqin, në qoftë se duan edhe kanë të drejtë ta paraqesin. Nëse vijnë për ta paraqitur mirë, nëse jo prapë shëndosh.

Por, dua të ju paralajmëroj tani, që në ora 15:30 është votimi i ligjeve që kemi miratuar në lexim të parë. Kanë kohë të gjithë deputetët kudo që janë të vijnë. Të gjithë deputetët të cilët pa arsye nuk janë për të votuar, autorizoj Administratën e Kuvendit që t'u hiqen mëditjet. Nuk ka këtu parti, këtu ka Parlament. Kush nuk është e ka mëditjen të hequr.

### **15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz**

Komisioni Funkcional për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, nuk qenka këtu. A e zëvendëson dikush Dautin? Jo! Atëherë, ne nuk e dimë kush e prezanton ligjin! Kush e prezanton? Ti, a? Zonja Ganimete Musliu e prezanton në vend të Dautit.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Komisioni Parlamentar ka shqyrtuar Projektligjin për Komplexin Memorial “Adem Jashari”. Në parim e kemi mbështetur të gjithë. Gjithashtu, ka formuar edhe grupin unifikues, ose thjesht gjithëpërfshirës, ku të gjithë anëtarët e këtij komisioni janë pjesë e grupit punues për shqyrtimin dhe draftimin e këtij projektligji.

Ne i kemi dhënë mbështetje unanime, prandaj ftoj edhe kolegët deputetë që ta mbështetin. Është një ligj që rregullon çështjen e Komplexit Memorial “Adem Jashari” dhe shpresoj shumë që në të ardhmen do të na ndihmojë që Kompleksi Memorial “Adem Jashari” të mos jetë më në gjendjen siç ka qenë deri më tani.

Edhe në emër të Grupit Parlamentar i japim mbështetje këtij projektligji dhe i ftoj kolegët deputetë që ta votojnë në leximin e parë dhe gjithashtu nëse dikush ka për të shtuar diçka në mes të dy leximeve, janë të mirëseardhur që të sjellin propozimet e tyre ose amendamentet e tyre në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

LDK-ja e mirëpret Ligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe do ta përkrahë atë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep mbështetje këtij projektligji. Konsideroj që është një nga ligjet që do të duhej të miratohej qysh në legjislaturën e parë, me qëllim të ruajtjes dhe konservimit të shtëpive muze, por në veçanti për tërë kompleksin memorial, investime që do të duhej të bëheshin nga institucionet tona qendrore dhe lokale për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”.

Në projektligjin për buxhetin kam dorëzuar edhe amendamente për të investuar në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe tani kur kjo fushë rregullohet me akt ligjor, me ligj të veçantë, mendoj që do të shërbejë në veçanti që Kompleksi Memorial “Adem Jashari” të ketë tretmanin e duhur në aspektin ligjor dhe përgjegjësisë institucionale, sepse me këtë projektligj adresohen edhe përgjegjësitë sa i përket Kompleksit Memorial “Adem Jashari”.

Prandaj, sponsorizuesin e ligjit e falënderoj që e ka sjellë në Kuvend dhe besoj që kontributin tonë do ta japim gjatë shqyrtimit të tij në komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, Shemsi Syla e ka fjalën.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne i përshëndesim punimet që janë bërë në krijimin e këtij ligji dhe normalisht që kemi dëshirë që të bëjmë një ligj në një normë sa më të mirë për kompleksin që është i shenjtë dhe që ka refleksionin gjithëkombëtar.

Megjithatë ne konstatojmë se ky ligj ka mangësitë e veta dhe më shumë i përngjanë asaj që është krijuar pak a shumë prej një presioni publik, i cili ka qenë aktual me muaj të tërë për moskujdesin e kompleksit dhe normalisht që ne mendojmë se duhet të kompletohet, duhet të pasurohet dhe thjesht duhet të dihet se ku e ka efektin dhe çka duhet të bëjmë ne me krijimin e këtij ligji, sa do t’i përmbahemi dhe sa do ta përmbushë misionin për një ngjarje, e cila për ne është e shenjtë, një ngjarje e cila reflekton vlerën më të çmuar sublime.

Kemi vërejtje në nenet 5, 11 dhe 13, ku mendojmë që në aprovimin përfundimtar të ligjit të punohet në këto tri nene dhe njëkohësisht mendojmë se mungon diçka që është më esenciale në këtë ligj.

Përderisa është punuar shumë që të dihet infrastruktura, të dihet sipërfaqja, të dihet se si bëhen manifestimet, mandej shpronësimet e tjera, e tjera, nuk është vënë në thelb një çështje me rëndësi se ku mund të jetë qëllimi i krijimit të këtij ligji dhe ku është qëllimi i krijimit të normave për ta mirëmbajtur këtë kompleks.

Nuk përmendet askund se aty do të jetë një muze, aty do të jetë një vend, ku do të kenë mësim kombëtar, moral e njerëzor, ku rinia jonë, po edhe të gjithë vizituesit do të jenë në atë kompleks të marrin diçka dhe të ruajnë diçka. Domethënë ka disa mangësi, të cilat në vazhdimësi do t'i paraqesim dhe do të ndikojmë që të jetë një ligj vërtet që përfaqëson dhe që ngërthen gjithë materien aq të rëndësishme komplekse të një vendi, i cili reflekton vlerat më kulmore të historisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Çausi, në emër të PSDK-së.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Social Demokrate e mbështet këtë projektligj, por përtej bazës së nevojshme ligjore, shpresojmë që trajtimi i këtij memoriali të ketë cilësinë e pritur dhe urgjencën, në të cilën gjendet, shpresojmë të trajtohet pak më ndryshe nga institucionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj të shumëpritur për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit dhe do të votojmë pro edhe në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi një replikë të zonjës Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Zoti nënkryetar,

Më shumë si sqarim kisha dashur të merret, se sa si replikë.

Desha që vetëm t'i adresohem fjalimit të zotit Sylja që tha se ka ardhur ky ligj në formë të shpejtuar, ndoshta për shkak të presionit mediatik që është bërë për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”.

Për informimin e zotit Sylja, po dhe për gjithë opinion e gjerë, absolutisht ndoshta mund të themi që është tejzgatur periudha kohore e trajtimit të këtij ligji, sepse që ta ruajmë kontinuitetin, ky ligj është miratuar në leximin e parë edhe në legjislaturën e kaluar, por për shkak të shkuarjes në zgjedhjet e parakohshme, normalisht ju e dini që të gjitha ligjet që mbeten në procedurë, kthehen në pikën zero. Tani është hera e dytë që vjen në lexim të parë në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Kështu që nuk është bërë ligji shpejt e shpejt për shkak të presionit medial, po përkundrazi është tejzgatur periudha kohore e shqyrtimit të këtij ligji dhe të aprovimit.

Unë e ftoj zotin Sylja dhe të gjithë deputetët që çdo sugjerim ose çdo amendament që ata e shohin që mund të kontribuojë në këtë ligj, ta dërgojnë në komision brenda afatit kohor dhe rregullave legjislative. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne i bashkohemi asaj që u tha deri më tash se ky ligj është shumë i rëndësishëm, bile është vonuar, por të gjithë e dimë që nuk është vonuar me qëllim, por për shkak të asaj që u tha edhe nga kolegja Musliu. Besojmë që tanimë është momenti i fundit që ky ligj vërtet duhet të kalojë në lexim të parë dhe të dytë dhe të fillojë të gjejë veprim në vend, atje, që të mirëmbahet dhe të zhvillohet edhe më tej Kompleksi Memorial “Adem Jashari”,

Për rëndësinë dhe rolin e saj nuk kemi çka i tregojmë njëri-tjetrit, të gjithë e dimë këtë, besa jo vetëm ne këtu, po e dinë gjithë shqiptarët, madje edhe përtej kombit shqiptar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Fillimisht dëshiroj të falënderoj kolegen time të nderuar, zonjën Ganimete Musliu, për informacionin të cilën e dha dhe për paqartësitë e deritashme.

Ndërsa sa i përket Projektligjit në fjalë, projektligj i shumëpritur dhe i mirëpritur, besoj për të gjithë.

Ne në parim e përkrahim projektligjin dhe kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që këto ligje, edhe pse janë të stërvonuara, janë të mirëseardhura.

U kisha bërë thirrje të gjithëve që të jenë syçelë dhe të gjitha elementet e nevojshme që janë t'i përkrahim dhe të futen mirë, të renditen në lista pastaj që mos kenë devijime. Ne duhet krenuar për një kompleks të tillë dhe duhet ta përkrahim fuqishëm jo vetëm këtë, por të gjitha, edhe të tjerat.

Pasi që duke i falënderuar të gjithë këta, ne sot jemi këtu, e ngremë zërin në Parlamentin e Republikës së Kosovës lirshëm dhe natyrisht duhet të ndihemi krenarë dhe e përkrahim fuqishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka kërkuar fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk dua ta marr fjalën për këtë projektligj, po për çështje procedurale.

Pak më herët ju deklaruat se gjithë ata që nuk vijnë në orën 15:00-15:30 për votim kërkonin nga sekretaria që të marrë masa.

KRYESUESI: I ndalet fjala, është jashtë rendit të ditës.

Unë e kam deklaruar dhe i përmbahem asaj, jo, jo, mos na trego për të drejtat e njeriut, pashë Zotin. Nuk kemi kohë të të dëgjojmë ty, përrallat e tua, pashë Zotin le, le, rri aty!

Vazhdojmë me pikën tjetër.

*(Polemikë nga salla)*

Ankohu në Gjykatën Kushtetuese, kam të drejtë.

### **17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare**

*(Polemikë)*

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.



E ftoj kryetaren e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Besa Baftiu, për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit me rekomandime. Zonja Baftiu, e keni fjalën!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit numër 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare.

Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit ishte që të vlerësohet zbatueshmëria e këtij ligji dhe të evidentohen vështirësitë dhe mangësitë e këtij ligji.

Grupi punues i ka zhvilluar disa takime me institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe ka vizituar disa qendra ofruese të shërbimeve sociale dhe familjare. Gjatë periudhës mbikëqyrëse komisioni bashkëpunoi edhe me UNICEF-in dhe CONF-in.

Gjatë procesit mbikëqyrës grupi punues evidentoi disa mangësi të zbatimit të këtij ligji, e posaçërisht procesi i decentralizimit të kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal nuk ka qenë i suksesshëm dhe nuk është përcjellë me buxhet të mjaftueshëm. Gjithashtu qendrat e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare kanë vështirësi në ofrimin e shërbimeve për qytetarët në nevojë dhe nuk kanë financim të qëndrueshëm.

Familjet strehuese paguajnë shumë pak dhe shërbimet e tyre për fëmijët me nevojë më shumë i bëjnë në mënyrë vullnetare se sa për pagesën simbolike që u bëhet. Vërehet moskoordinimi dhe mosbashkëpunimi në mes të ministrisë dhe komunave, qendrave për punë sociale dhe qendrave strehuese që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Duke u mbështetur në këto të gjetura, komisioni në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018 miratoi raportin me rekomandime dhe Kuvendit i propozon për miratim rekomandimet si në vijim:

## REKOMANDIME

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të hartojë një ligj të ri për shërbime sociale dhe familjare, një ligj të integruar, të avancuar dhe me kompetenca të qarta për institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

2. Të krijohet grant specifik për shërbime sociale dhe familjare, apo shuma e cila ndahet nga granti i përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare të rriten nga 4 milionë në 8 milionë euro.

Raporti i fundit i progresit për Kosovën rekomandon qartë se Ligji për financat e pushtetit lokal duhet të ndryshohet dhe të përfshijë një grant specifik për shërbimet sociale për të siguruar transparencën në buxhet dhe në nivel minimal të mbështetjes për shërbimet sociale dhe familjare në nivel komunal.

3. Komunat të ndajnë buxhet dhe të krijojnë mundësi që brenda komunave të tyre të ofrohen shërbime sociale dhe familjare sipas standardeve.

4. Të rritet bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe komunave në koordinimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

5. Të përgatitet kostoja për njësi, klient, për lloje të shërbimeve sociale dhe kosto e standardeve minimale.

6. Të bëhet kompensim adekuat i stafit të qendrave të punës sociale për punën jashtë orarit, për kujdestari, të bëhet pagesa në rrezikshmëri në punë dhe të kompensohen për shpenzime shtesë që personeli i ka kur merret me personat në nevojë.

7. Të ofrohen objekte të përshtatshme për qendra për punë sociale që i përmbushin standardet në bazë të qasjes, planifikimit hapësinor dhe higjienës. Qendra për Punës Sociale duhet të pajiset me salla pritëse, qendra për ndihmë, objekte rekreative dhe strehimore për njerëzit në nevojë.

8. Të rritet numri i objekteve ku do të ofrohen shërbime riintegruese për viktime të trafikimit, viktime të dhunës në familje, viktime të abuzimit me narkotik, lypsarë, të keqtrajtuarit, të moshuarit pa përkujdesje familjare.

9. Të bëhet vlerësimi i performansës së stafit të qendrave për punë sociale nëpërmjet vlerësimeve të rregullta, licencimit, rilicencimi sipas nevojës.

Operacionalizimi i standardeve profesionale për punëtorë socialë dhe menaxherë të shërbimeve sociale, në të cilat kryhet rishikimi i kompetencave dhe shkathtësive të punëtorëve socialë.

10. Brenda qendrave për punës sociale të krijohen shërbime të veçanta dhe programe riintegrimi për fëmijët, viktime të abuzimit me narkotik.

11. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale të bëjë një organizim më të mirë të njësisë së inspektimit të shërbimeve sociale dhe kjo njësi të ketë kapacitet të plotë inspektues.

12. Të krijohet një fond i veçantë për situata emergjente, në mënyrë që stafi i qendrave për punë sociale të jetë në gjendje t'i përgjigjet rasteve të vështira dhe të mund të menaxhojë rreziqet e menjëhershme të personave me nevojë.

13. Të rritet numri i familjeve strehuese dhe të ofrohet mbështetje për familjet kujdestare dhe kujdesi me bazë në familje për fëmijët e braktisur dhe fëmijët pa kujdes prindëror. Të rritet shuma e pagesës për këto familje.

14. Të rritet numri i OJQ-ve të licencuara, të bëhet inkurajimi i OJQ-ve me bazë në komunitet për të aplikuar për licencim dhe sigurimi i disponueshmërisë së shërbimeve në të gjitha rajonet gjeografike të Kosovës.

15. Të ofrohet financim i qëndrueshëm nëpërmjet kontratave të rregullta për OJQ-të, ofruese të shërbimeve sociale dhe familjare.

16. Të rritet bashkëpunimi mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, komunave, qendrave për punë sociale dhe OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare sa më cilësore.

Ju ftoj që t'i votoni këto rekomandime. Faleminderit!

Nënkryetar, nëse më lejohej që edhe në emër të grupit të paraqes qëndrimin.

KRYESUESI: Po, vazhdo!

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Atëherë, Grupi Parlamentar i Partisë Social Demokrate e përkrah raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe u bëjmë kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Qeverisë që t'i kenë parasysht këto rekomandime gjatë hartimit të ligjit të ri. Rekomandime, të cilat janë përmendur edhe në Raportin e progresit të vitit 2016 dhe të vitit 2017, siç është rasti me ndarjen e një granti specifik për shërbime sociale.

Unë e di se këtu Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka bërë kërkesë për një grant të tillë specifik, mirëpo këtu duhet të ndërhyjë edhe Qeveria, meqenëse kjo nuk është kompetencë vetëm e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar e përkrahim këtë raport të mbikëqyrjes së Ligjit për shërbime sociale dhe familjare si dhe kërkojmë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'i ketë parasysh këto rekomandime.

I ftojme deputetët që të votojnë këtë raport. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Haxhi Avdyli e ka fjalën.

**HAXHI AVDYLI:** Të nderuar deputetë,

Së pari dua të përgëzoj anëtarët e këtij komisioni që kanë bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe për ofrimin e një raporti të detajuar për gjendjen në këtë sektor.

Nga ky raport kanë dalë shumë probleme të zbatueshmërisë së ligjit, por edhe sfidat me të cilët ne duhet të ballafaqohemi, sepse ne si shoqëri tregojmë pjekuri dhe tregojmë një pjekuri si shtet me mënyrën se si i trajtojmë pjesët e shoqërisë më vulnerable, ato të cilat janë në shërbime sociale dhe kanë nevojë për përkrahjen e dorës së shtetit.

Disa nga sfidat të cilat i përmendi edhe kryetarja e komisionit janë sfida të cilat shpeshherë duke u munduar për qëllime më të mira, po japin efekte jo aq të pritura, një prej tyre është decentralizimi i kompetencave.

Decentralizimi i kompetencave për qendrat e punëve sociale nuk ka sjellë efektin e vet, sepse këto qendra kanë kaluar në përgjegjësi komunale, por nuk janë përcjellë edhe me përkrahje financiare, e si pasojë e kësaj efektet e krijimit apo të ofrimit të shërbimeve sociale janë më të mangëta dhe nuk po e përcjellin atë që duhet ta kenë, sepse e dimë që në komuna prioritet nuk është ndonjëherë ajo e shërbimeve sociale, janë prioritet të tjera infrastrukturore.

Prandaj, mendoj që duhet të gjenden modalitete që ne ta shtojmë garantin për shërbime sociale nga buxheti, duke rritur fondin për shërbime sociale nga 4 milionë në 8 milionë, siç ka propozuar komisioni.

Fondet e tanishme, të cilat i ndan Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk janë fonde të mjaftueshme dhe të njëjtën kohë edhe buxheti komunal është ende i ulët dhe si pasojë e kësaj, i kemi këto ngecje.

Një prej ngecjeve kryesore është që stafi i qendrave për punë sociale është i destimuluar, sepse nuk është duke marrë përkrahje financiare, nuk po mbulohen kostot edhe të shpenzimeve të tyre, edhe për qëllime të punës, duke i vizituar rastet sociale, nuk po kompensohen këta persona, të cilët po bëjnë një punë shumë të madhe, shpeshherë në bazë vullnetare dhe nga buxheti i tyre.

Qendrat për punë sociale e kanë një staf të mangët, kanë nevoja shumë të mëdha për rritjen e numrit të punëtorëve dhe, në këtë drejtim, ndoshta edhe ministria, edhe ministri pasi është këtu do të duhej që ta shtojë përkrahjen edhe për rritjen e stafit e punëtorëve, por edhe përkrahjen e stafit ekzistues, të cilët do të duhej të stimulohen për një punë sa më të mirë dhe një jetë sa më të dinjitetshme të vetë stafit të qendrave për punë sociale

Infrastruktura në këto qendra për punë sociale nuk është e mirë, kanë nevojë për përkrahje edhe për rindërtime, për hapësira më të mira dhe, në këtë drejtim edhe këtu duhet të shikojë komuna apo ministria që ta bëjnë një rishikim të gjendjes të këtyre qendrave për punë sociale që t'i krijohet mundësi edhe stafit, por edhe personave të cilët vijnë në këto qendra për të marrë ndihmë të merituar.

Një çështje, e cila sot ka dalë nga ky raport dhe që duhet ta kthejmë vëmendjen është te familjet strehuese.

Fatmirësisht në Kosovë janë shumë familje, janë lajmëruar familje strehuese, të cilat janë duke marrë barrën e rritjes së fëmijëve dhe duke u dhënë përveç shtëpisë, këto familje po japin edhe dashuri, po e hapin familjen, po ua hapin zemrën këtyre fëmijëve dhe këta fëmijë po e gjejnë familjen e tyre të dytë që nuk është biologjike, po është një familje, e gjejnë veten aty dhe rriten si të gjithë fëmijët normalë në botë. Dhe, stimulimi i këtyre familjeve strehuese me 150 euro është shumë i mangët. 150 euro për një fëmijë, të cilin do ta mbanim në qendra apo në jetimore do të na kushtonte shumë më shumë, por edhe efekti i rritjes së këtyre fëmijëve në jetimore dallon shumë nga ajo familje, në të cilën rriten këta fëmijë dhe e gjejnë familjen e tyre dhe e krijojnë një personalitet shumë më të qëndrueshëm sesa personalitetet që rriten në jetimore dhe nuk e kanë një jetë normale, apo një fëmijëri normale.

Prandaj, ne duhet ta kthejmë vëmendjen dhe ky raport i detajuar na ka kthyer vëmendjen nga këto probleme dhe prandaj ne i bëjmë apel edhe ministrit, i cili është këtu, edhe organeve tjera vendimmarrëse që t'i kthejnë sytë nga qendrat për punë sociale, ta kthejnë vëmendjen edhe më të madhe për këto probleme, të cilat kanë dalë nga ky raport dhe të mundësojnë një shërbim social edhe më të madh. Një prej formave për të dhënë shërbime sociale dhe më adekuate, që në botë gjithkund janë duke e aprovuar, apo duke e miratuar, është edhe OJQ. Ka shumë nga OJQ-të, për shembull nga qyteti im, Prizreni, aty e kemi një numër të madh të OJQ-ve, të cilat edhe i kam vizituar dhe e bëjnë një punë të mrekullueshme. E bëjnë një punë të përkujdesjes për grupet vulnerable, si për autizëm, për personat me aftësi të ndryshme të kufizuara, por nuk e kanë vëmendjen, nuk i kanë kushtet, nuk e kanë buxhetin e duhur dhe në këtë drejtim nëse ne u ndihmojmë këtyre shoqatave, në të njëjtën kohë ne po u ndihmojmë këtyre grupeve, të cilat janë vulnerable dhe të lëna në harresë nga shoqëria.

Prandaj, të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Shpresoj që do ta shtoni vëmendjen. Vëmendja ndaj shtresave sociale është kur kjo kthehet edhe me vëmendje financiare dhe këtu bëhet fjalë për shtresat me aftësi të kufizuara dhe në këtë mënyrë do të ndihmoni që këto familje të mos e ndiejnë vetëm dhimbjen që në familjet e tyre e kanë një person me aftësi të kufizuara, por në të njëjtën kohë të ndihmoni edhe që të ballafaqohet kjo familje me këto probleme.

Për fund, zoti kryesues, unë ju kisha bërë ftesë që nëse keni mundësi të ndikoni që t'u ndalet mëditja edhe atyre të cilët sot do të duhej të raportonin për këto ligje, të cilët nuk ishin këtu, e nëse vazhdoni që të përmendni ndaljen e mëditjeve, atëherë keni për t'ia ndalë edhe punën këtij Kuvendi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Për të bërë punë, se për mua mos ejani hiç. Edhe unë mund të mos vij, por ne jemi për të kryer punë. Nuk ka Parlament në botë që toleron të mos vijnë deputetët, Qeverisë ne s'mund t'ia ndalojmë. Mund të mos ia miratojmë buxhetin kur ta sjellin në rishikim, i dënojmë një muaj ditë, i lëmë pa rroga. Aq kemi mundësi ne, jo më shumë.

Në emër të Grupit Parlamentar, zonja Flora Brovina e ka fjalën.

**FLORA BROVINA:** Faleminderit, nënkryetar!

Po flasim për një ligj shumë të rëndësishëm, sepse me këtë ligj mbrohet një pjesë e madhe e atyre që kanë mungesa dhe nevoja sociale të mëdha. Ligji për shërbimin social dhe familjar ka krijuar mundësi që këtë shërbim ta fitojë një pjesë e popullatës në Kosovë. Ligji i inkurajon pjesëmarrësit e komunitetit dhe zhvillimin e iniciativave për aktivitete të komunitetit që lidhen me mbrojtjen sociale.

Por, personalisht nuk jam e kënaqur me shërbimet e ofruara deri tani, duke filluar prej kohës së pasluftës dhe tani. Edhe pse e kemi ligjin, ky nuk zbatohet plotësisht, sepse ka shumë sfida. Sfidat fillojnë kryesisht ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, pra edhe pas decentralizimit të kompetencave nuk është bërë përgatitja e duhur dhe e mirë që të ketë kompetenca të mjaftueshme në të gjitha nivelet sipas asaj që u takon. Decentralizimi nuk është funksionalizuar dhe nuk është planifikuar mirë ekzekutimi i këtij decentralizimi, pra i Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare. Buxheti ka qenë një mungesë shumë e madhe për ofrimin e shërbimit dhe nevojave që ka zbatimi i këtij ligji. Gjithashtu, siç thashë, decentralizimi i shumicës së shërbimeve ka kaluar në kompetencat komunale, por nuk është përcjellë buxheti dhe në mungesë të buxhetit, ky ndryshim ka qenë jofunksional.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndan disa fonde për blerjen e shërbimeve, por këto nuk kanë qenë mjete të mjaftueshme dhe nuk janë koordinuar me nivelin lokal. Përqindja e buxhetit

në komuna, të cilat gjithashtu ndajnë mjete për shërbimet sociale dhe familjare ka qenë një diskrecion vetëm i autoriteteve komunale dhe nuk ka pasur koordinim me Ministrinë e Çështjeve Sociale. Ndërkaq, në listën e prioriteteve ka qenë prioriteti i fundit. Qendrat për punë dhe mirëqenie sociale në nivelin qendror nuk marrim financim të drejtpërdrejtë nga ministria, por as nga donatorët dhe organizatat joqeveritare. Mungesa e fondeve të këtyre qendrave ka shkaktuar që ato të gjenden gati në pozitë të njëjtë me shërbyesit që i ofrojnë këto shërbime. Pra, ka mungesa të mëdha dhe nuk kompensohen për punën e kryer jashtë orarit, kushte të pamjaftueshme të punës, nuk ofrohen ushqime të mjaftueshme për njerëzit që janë me nevoja dhe kanë nevojë për një dorë të fuqishme të Qeverisë në përgjithësi, por edhe të Ministrisë së Mirëqenies Sociale. Mungojnë hapësirat dhe renovimi i këtyre hapësirave. OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare nuk kanë buxhet të qëndrueshëm financiar, e në këtë mënyrë ato ndonjëherë nuk mund të ofrojnë shërbime çfarë nevojitet.

Edhe pse organizatat joqeveritare janë ndër organizatat e para që filluan shërbimet sociale, ndoshta edhe para se të formohet Ministria e Mirëqenies Sociale, qysh para 18-19 vjetësh, shumë nga to në kohë të fundit për shkak të mosmirëkuptimit, qoftë në nivelin komunal, sidomos pas decentralizimit, hasën në probleme të shumta. Unë do ta përmendja një rënë ndër ndoshta më të suksesshmet dhe e cila duhet të shërbente si shembull, që u mbyllën pas 18 vjet punë vullnetare, e jo në përkrahje vetëm të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, përkrahje më shumë morale, u mbyllën si Qendra për Rehabilitimin e Nënës dhe Fëmijës, por me qindra e mijëra fëmijë gjetën strehë dhe u rehabilituan, edhe pse ishte marrëveshja me Ministrinë që ndihmat nga kjo qendër në çfarëdo mënyre qoftë në rehabilitimin e personave që kanë nevojë, si për shembull viktimat e dhunës në familje, problemeve tjera sociale, qoftë si lypës, ose fëmijë të mbetur pa prindër. Ndarja e mjeteve për familjet strehuese është shumë e vogël, 150 euro sa ka qenë dhe plus më duket 20 euro është shtuar në kohë të fundit, është e pamjaftueshme për këto familje që duhet të kujdesen për fëmijët. Madje, ndodh që familjet e varfra janë ato që kërkojnë fëmijë për t'i strehuar dhe nuk ia dalin. Kjo është edhe nga përvoja ime personale që kam hasur në këto familje dhe fëmijët e tillë janë trajtuar në Qendrën për Rehabilitimin e Nënës dhe Fëmijës.

Njësia e monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve sociale në Departamentin w Politikave Sociale dhe Familjare ka vetëm tre anëtarë. Është një numër shumë i pamjaftueshëm për t'ia dalë monitorimit. Ne e kemi monitoruar si komision dhe nga Partia Demokratike kemi qenë aktivë në pjesëmarrjen e monitorimit në tri komuna: Mitrovicë, Ferizaj dhe Prishtinë. Rekomandimet dalin nga ky monitorim dhe besoj që do të zbatohen, sidomos aq sa u tha nga kryetarja shtimi i buxhetit, por edhe monitorimi i kësaj politike, politikës mbrojtjes sociale dhe shërbimeve sociale, fuqizimi i qendrave sociale. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja Brovina! Fjalën e ka zonja Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Edhe unë si përfaqësuese e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kam qenë pjesë e grupit punues, i cili i hartuar këto rekomandime dhe normalisht që do t'i ftoj të gjithë deputetët që t'i votojnë rekomandimet, të cilat besoj që pastaj do të jenë obligative për Qeverinë, sepse pika e parë - kërkesa për miratimin e një ligji të ri, i cili do t'i qartësojë shumë më qartë kompetencat e nivelit qendror dhe atij lokal, sepse siç po shihet ligji në pjesën më të madhe nuk zbatohet për shkak të mungesës së buxhetit, do të thotë mungesa e një financimi të qëndrueshëm u pamundëson qendrave për punë sociale që ta kryejnë punën e vet, fillimisht për shkak të mungesës së stafit, pastaj për shkak të mungesës së infrastrukturës. Kanë mungesa edhe në vetura, gjë që me të vërtetë është shumë e pakuptimtë, pasi pjesën më të madhe të punës duhet ta kryejnë në terren.

Të gjitha ankesat kanë qenë të drejtuara për mungesën e kushteve të punës, si dhe të stafit, sepse numri i punëtorëve është shumë i vogël, ndërsa oferta, shërbimet që duhet të ofrojnë dhe që ofrojnë është në disproporcion me stafin që disponojnë dhe normalisht që nuk arrijnë që t'i kryejnë të gjitha shërbimet, sepse shërbimet që ofrojnë janë deri te familja, deri te shtëpia e njerëzve që janë nevojtarë për këto shërbime dhe në të shumtën e rasteve ofrimi i këtyre shërbimeve pamundësohet për shkak të mungesës së kushteve dhe mungesës së buxhetit. Pothuajse pjesa më e madhe është thënë dhe nuk dua të përsëris. Është mirë që deputetët ta lexojnë me vëmendje këtë dokument që e ka sjellë këtu Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e në veçanti më vjen mirë që ministri është i pranishëm, i cili besoj që do t'i marrë shumë seriozisht këto rekomandime dhe ne si komision pastaj, pas një kohe të caktuar, do të shikojmë se çfarë është bërë në zbatimin e këtyre rekomandimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju të PSD-së e keni kryer, tash e ka fjalën Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së. Regjia, fjalën zonjës Time Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Unë dua t'i përgëzoj të gjithë anëtarët e komisionit që e kemi bërë një punë të mirë, duke e ditur që vërtet është një kategori e ndjeshme e vendit tonë, dhe pikërisht kjo ka qenë arsyeja ndoshta që e kemi zgjedhur Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare për monitorim, në mënyrë që ne si anëtarë të komisionit ta shohim se në fakt sa po zbatohet ky ligj dhe sa po implementohet në praktikë, duke e ditur që i përfshin këto kategori.

Vizitat i kemi filluar në nivelin qendror dhe në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke i marrë ato sfidat me të cilat ballafaqohen, pastaj kemi vizituar edhe komuna të ndryshme, po ashtu qendra sociale, të cilat i kanë treguar të gjitha ato vështirësitë që i kanë në zbatim të këtij ligji. Jemi munduar t'i vizitojmë edhe disa strehimore, duke i parë ato kushtet që vërtet nuk janë të mira, dhe më pas bashkarish me anëtarët e komisionit e kemi bërë hartimin e këtij raporti me rekomandime. Pas hartimit të këtij ligji është bërë shumë, por prapë nuk është në nivelin e duhur



gjithë ajo çka është arritur. Gjatë punës e kemi parë që ka të arritura në zbatimin e këtij ligji, por njëkohësisht ka dhe probleme dhe sfida me të cilën ballafaqohen aktorët, qoftë punëtorët socialë, e qoftë ato strehimore, njerëzit që po punojnë nëpër strehimore, sepse mungon buxheti i mjaftueshëm.

Është thënë që është bërë mirë që është bërë decentralizimi, por me decentralizim, qendrat për punë sociale në nivel të komunave e kanë një buxhet të vogël, buxhet i cili nuk është i mjaftueshëm dhe kërkojnë mjete shtesë, në mënyrë që ata të mund ta kryejnë punën e vet si duhet. Kanë dalë shumë konkluzione dhe në bazë të këtyre konkluzioneve janë hartuar edhe rekomandimet. Ju e dini që në këto ditët e fundit kemi pas debate dhe interpelanca, për shembull ka qenë për Ligjin e punës, për të drejtat e punëtorëve dhe gjithmonë janë përsëritur ato. Deputetët e kanë të drejtën e monitorimit të ligjit dhe të gjitha këto rekomandime që kanë dalë janë rekomandime që e obligojnë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale t'i zbatojë dhe ta shohë se ku janë problemet, si dhe ta mbikëqyrë zbatimin e të gjitha këtyre rekomandimeve.

Ministri e ka obligim sa herë që thirret nga anëtarët e komisionit të vijë të na raportojë, por edhe ne si anëtarë të komisionit, duke e ditur dhe duke i pasur këto rekomandime, ndoshta ministri duhet të thirret në seanca të veçanta për të raportuar kryesisht për monitorim të ligjit dhe për zbatimin e këtyre rekomandimeve që kanë dalë nga ky raport i monitorimit. Nuk dua t'i përsëris ato që i thanë kolegët e mi, anëtarë të komisionit, por edhe ne si Aleancë e përkrahim këtë raport, i përkrahim rekomandimet dhe kërkesa është që të implementohen këto rekomandime. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Nisma Socialdemokrate i mbështet rekomandimet e këtij raporti dhe kërkojmë që vërtet të ndahen edhe më shumë mjete, sa është e nevojshme që këto rekomandime pastaj të mund të zbatohen dhe t'i japin rezultatet e tyre. Ndërsa, sa u përket polemikave rreth mëditjeve, vërtet këtu kemi hapësirë që pikërisht në këtë fazë që jemi duke punuar, ta punojmë Rregulloren, apo të përpiqemi ta rregullojmë më mirë këtë, sepse vërtet është bërë zakon që pjesëmarrja në seancë përfundon me nënshkrimin e deputetëve. Natyrisht, kjo nuk i jep të drejtë askujt pastaj që ta marrë në dorë dhe të kërkojë masa, të cilat nuk janë mirë të sanksionuara, mirëpo edhe kjo “veç eja nënshkruaju dhe dil” nuk është zgjidhje.

Pra, Rregullorja në këtë çështje ka mangësi, dhe kryesuesi e kryetari natyrisht kanë të drejtë të kërkojnë që të hiqen mëditjet, por Administrata e di që këtë udhëzim nuk mund ta zbatojë. Pra, edhe kryesuesi dhe deputeti kanë të drejtë të thonë çka të duan, por Administrata do të veprojë vetëm në bazë të asaj se çka i thotë Rregullorja. Kështu që nuk kemi nevojë të hyjmë në polemika me njëri-tjetrin ke të drejtë të thuash, a s'ke të drejtë të thuash. Njerëzve këtu,

kolegëve, ua merr mendja që duhet të thonë diçka, qoftë në karrigen e kryesuesit, qoftë në karrigen e deputetit, por ata të cilët pastaj duhet ta zbatojnë atë vendim, atë kërkesë, do të duhej ta mbështetin në një nen të Rregullores dhe jo në fjalën e thënë, qoftë të kryetarit, qoftë të kryesuesit. Prandaj, them që nuk kemi nevojë t'i acarojmë debatet këtu, qysh tha edhe zoti deputeti Haxhiu i LDK-së, edhe për ministrat, të cilët madje kanë edhe ligje këtu e nuk vijnë, e do të duhej të parashihej një masë që së paku të mos u rritet rroga, nëse s'mund t'ua heqim mëditjet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

**NASER RUGOVA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

E përgëzoj Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, që konsideroj prek fokus-grupe dhe kategori të rëndësishme të shoqërisë kosovare.

Unë do të doja të kontribuoja me disa propozime konkrete, sepse konsideroj që kolegët, parafolësit, i elaboruan mirë nevojat, mangësitë, të metat, por edhe nevojën për mbështetjen buxhetore, edhe të dikasterit qeveritar, por edhe të kësaj fushe të rëndësishme. Konsideroj që një ligji të mirëfilltë që do të duhej të plotësohej dhe ndryshohej i mungon një zbatim më pragmatik, më konkret dhe një mbikëqyrje më rigorozë institucionale, decentralizim i plotë, por edhe koordinim i plotë ndërmjet nivelit qendror sa i takon punës së qendrave për shërbime sociale dhe familjare me ministrinë përkatëse, sepse nganjëherë ligjet po krijojnë vakume të caktuara të kompetencave dhe duhet të rregullohet me akte nënligjore, sepse ka të bëjë me masa konkrete profesionale, specifike, të cilat ndikojnë në jetën e atyre njerëzve, apo atyre fokus-grupeve vulnerable.

Nën tre, mbështetje e nevojshme buxhetore, rritje dhe avancim profesional të stafit të këtyre qendrave, sepse “long life learning” - mësimi gjatë tërë jetës, është i nevojshëm për stafin profesional të këtyre qendrave për përkujdesje sociale dhe familjare. Është e nevojshme që të ndajmë grante specifike, koordinim Qeveri -donatorë dhe rritje e buxhetit për 100%. Kjo do ta ndihmonte edhe ministrinë përkatëse të dikasterit që e udhëheq këtë fushë, por edhe qendrat në 6 qytete të mëdha të Kosovës dhe në të gjitha komunat e Kosovës dhe konsideroj që shumë çështje do të zgjidheshin me një rritje buxhetore në këtë përqindje. Konsideroj që është e nevojshme që të kemi strehimore që i plotësojnë nevojat dhe i përmbushin standardet optimale, pastaj objekte rekreative me ambient më miqësor për personat që trajtohen në këto qendra, masa konkrete të risocializimit të këtyre personave në jetën normale dhe krijimi i mundësisë së punësimit të këtyre personave, të cilët do të largoheshin pastaj nga barra e shoqërisë së institucioneve dhe do ta shtendosnin edhe buxhetin dhe mjete të mëdha buxhetore që shteti obligohet t'i ndajë për përkujdesje për këta persona, apo grupe shoqërore.

Inspektim dhe monitorim konkret dhe institucional të këtyre institucioneve.

Dhe, krejt në fund, ndërgjegjja e një shoqërie në vendet me demokraci të zhvilluar matet me përkujdesjen e një shoqërie apo një shteti dhe çfarë tregon ai shtet ndaj këtyre grupeve apo kategorive shoqërore në nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Reçica e ka fjalën, sepse e kapërcyem pas kryetarëve të grupeve parlamentare, është dashur të flasë ministri.

MINISTRI SKENDER REÇICA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Në veçanti të nderuar anëtarë të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fillimisht më lejoni të ju falënderoj për punën e bërë gjatë këtyre muajve lidhur në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-017 për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-017 për shërbimet sociale dhe familjare.

Është një raport i punuar mirë dhe që përmban gjëra reale me të cilat ballafaqohemi ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në këtë raport, komisioni ka paraqitur takime të shpeshta me të gjithë aktorët dhe ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale kemi qenë shumë bashkëpunues me komisionin. Siç jeni në njohuri, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Republikën e Kosovës dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare, pa dallim. Është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, hartimin e legjislacionit, standardeve, planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për popullatën e Kosovës, si dhe siguron zbatimin e duhur nga komunat dhe organizatave të tjera, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Ligji për shërbimet sociale dhe familjare përcakton qartë rolin dhe përgjegjësitë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare të nivelit qendror, të nivelit lokal, si dhe përcakton rolin e sektorit joqeveritar në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Ky ligj përveç përgjegjësisve rregullon edhe disa çështje të caktuara, që kanë të bëjnë me kategoritë e qytetarëve në nevojë sociale, siç është strehimi familjar për fëmijët pa kujdes prindëror, adoptimin e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, strehimin rezidencial për persona të moshuar pa përkujdesje familjare, strehimin rezidencial për persona me aftësi të kufizuara mendore (ngecje në zhvillim mendor), mbrojtjen e fëmijëve kryerës të veprave penale pa përgjegjësi penale, mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve me sjellje asociale, e tjera.

Me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të shërbimeve sociale Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka arritur të licencojë mbi 800 punëtorë socialë dhe 25 organizata joqeveritare si ofrues të shërbimeve sociale familjare, si dhe ka aprovuar 22 standarde për shërbime sociale dhe familjare. Sfidë kryesore e këtyre shërbimeve sociale mbetet mbështetja e grupeve të cenueshme

në Kosovë, për shkak të mungesës së një modeli të qëndrueshëm të financimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

Decentralizimi i shërbimeve sociale nga niveli qendror në komuna nuk ka arritur të sigurojë mbështetje të mjaftueshme financiare dhe të ndërlidhet në të njëjtën kohë me planifikimin e buxhetit sipas dispozitave të Ligjit për financat e pushtetit lokal. Mungesa e grandit specifik për financimin e shërbimeve në nivel komunal ka rezultuar në paqartësi lidhur me buxhetin komunal në dispozicion për shërbimet sociale, familjare dhe burime të pamjaftueshme për financimin e shërbimeve sociale.

Ligji për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 përcakton se kompetencë vetjake e komunave është që të bëjnë ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cenueshmit, strehimi familjar, përkujdesja për fëmijë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, ndërsa financimi për këto shërbime duhet të bëhet nga grandit i përgjithshëm dhe që mund të plotësohet nga të hyrat vetanake të komunave.

Ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale në programin qeverisës dhe në strategjinë sektoriale kemi paraparë që të krijohet një financim i qëndrueshëm për shërbimet sociale në nivel komunal nëpërmjet përcaktimit të një formule të qartë të financimit apo krijimit të një grandit specifik për shërbimet sociale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duke u bazuar në strategjinë sektoriale 2018 - 2022 dhe planin e veprimit 2018 - 2020 ka ndërmarrë veprime dhe vendime konkrete në mbështetjen e kategorive sociale dhe avancimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Nga janari 2018 është ngritur vlera e pagesës së asistencës sociale për 20% dhe për çdo familje përfituese në skemën e ndihmës sociale, ndërsa duke parë se kemi numër gjithnjë e më të vogël të familjeve strehuese Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me rastin e 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ka nxjerrë vendim për ngritjen e pagesave për strehim familjar për fëmijët pa kujdes prindëror dhe me aftësi të kufizuara.

Të nderuar deputetë,

Ligji për shërbimet sociale dhe plotësim-ndryshimi i Ligjit të shërbimeve sociale janë duke u zbatuar, mirëpo si rezultat i ndryshimit të rrethanave në terren dhe decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare dhe me qëllim të avancimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas planit të punës së Qeverisë për vitin 2018 ka filluar në draftimin e koncept-dokumentit për rregullimin e fushës së shërbimeve sociale dhe familjare, i cili koncept-dokument është planifikuar të aprovohet gjatë muajit tetor, përkatësisht nëntor, të këtij viti. Ndërsa, në vitin 2019 do të vazhdohet me draftimin e ligjit të ri për shërbimet sociale.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se si ministri ne kemi vërejtur se njësitë inspektuese dhe monitoruese nuk kanë kapacitete të mjaftueshme, prandaj jemi duke ndryshuar rregulloren për ristrukturimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe krejt kjo me qëllim të funksionimit më të mirë dhe të ngritjes së kapaciteteve njerëzore.

Të nderuar deputetë,

Nga ajo që thash më lartë besoj që mund ta vëreni se rekomandimet e dala nga ky raport tanimë një pjesë e tyre ka filluar të zbatohet nga ana e nivelit qendror, në këtë rast nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Unë duke marrë për bazë këtë raport dhe rekomandimet që dalin nga ky raport, u bëj ftesë të gjithë partnerëve socialë, të gjithë kryetarëve të komunave, që të na shërbejë ky raport dhe këto rekomandime për të shtuar përkushtimin tonë dhe për të rritur efikasitetin në ofrim të shërbimeve sociale për qytetarët tanë, shërbime këto aq jetike për këtë kategori të qytetarëve. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Fjalën e ka prej Grupit Parlamentar LDK, Mirjeta Kalludra. Urdhëroni!

**MIRJETA KALLUDRA:** Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po shqyrtojmë raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Në kuadër të shumë debateve dhe diskutimeve që janë zhvilluar nëpër seanca të ndryshme, është theksuar se përveç punës së shqyrtimit të projektligjeve dhe debateve parlamentare duhet që Kuvendi, Komisioni të përkushtohet më tepër në monitorimin e punës së Qeverisë, respektivisht ministrave, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, në këtë rast në zbatimin e legjisllacionit.

Shfrytëzoj rastin ta falënderoj Komisionin për Shëndetësi për punën e tyre që kanë bërë në monitorimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare, një ligj i një rëndësie shumë të veçantë, i cili ka për qëllim të rregullojë ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet që janë në nevojë, për ato familje që nuk kanë përkrahje të mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e tyre. Pra, në bazë të asaj që është prezantuar në këtë raport komisioni, respektivisht grupi punues, ka realizuar vizita dhe takime nëpër terren dhe institucione, qendra për punë sociale, si dhe OJQ, të cilat ofrojnë shërbime sociale familjare për personat dhe familjet në nevojë. Nëpërmjet këtyre vizitave kemi vërejtur se komisioni ka identifikuar në mënyrë shumë të mirë nivelin e zbatimit të këtij ligji, si dhe nevojës për të avancuar më tepër këto shërbime nga ana e institucioneve në mënyrë që t'u dalim në ndihmë sa më shumë personave dhe familjeve në nevojë.

Sipas këtij raporti, sfidat kryesore për ofrimin e shërbimeve sociale është financimi jo i qëndrueshëm, mungesa e stafit (si në numër edhe të përgatitur në mënyrë profesionale) dhe në këtë rast profesionalizmi i stafit për ofrimin e shërbimeve.

Po ashtu, edhe në raportin e progresit apo siç po quhet tash raporti i vendit i Komisionit Evropian i ka kushtuar një vëmendje shërbimeve sociale familjare, i cili ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me këto shërbime. Pra, sipas këtij raporti tek përfshirja dhe mbrojtja sociale Kosova duhet të sigurojë që komunat të kenë resurse të mjaftueshme për të ofruar shërbime sociale, që janë në përgjegjësinë e tyre. Ka konstatuar se ka pasur pak progres në përfshirjen sociale të fëmijëve dhe familjeve rome dhe ashkalinj. Kosova duhet të sigurojë që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të ndjekin shkolla publike bashkë me moshatarët e tyre.

Sipas këtij raporti tek mbrojtja sociale, që prej vitit 2009 fondet e mirëqenies sociale janë ndarë nëpërmjet grandit të përgjithshëm, pa ndonjë llokim në lidhje me buxhetin lokal të disponueshëm për shërbime sociale. Në këtë raport i është kushtuar vëmendje mungesës së grandit të përgjithshëm për shërbime sociale, ku ka theksuar se duhet të parashihen në projektligjin e ardhshëm për financimin e pushtetit lokal.

Edhe komisioni gjatë monitorimit ka konstatuar në mënyrë të qartë të arriturat e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare, i cili ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, ku janë krijuar edhe mekanizmat institucionalë për licencim të institucioneve dhe profesionalistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, janë krijuar edhe mekanizmat mbikëqyrës dhe kontrollues. Mirëpo, edhe përkundër këtyre të arriturave, Komisioni ka konstatuar se ka moszbatim të duhur të këtij ligji. Sipas tyre, njëra ndër pengesat kryesore në procesin e zbatimit të ligjit është decentralizimi i kompetencave, i cili është bërë pa u përgatitur mirë dhe pa një koordinim të mjaftueshëm të institucioneve.

Sfidë tjetër është identifikuar edhe mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për t'i mbuluar shërbimet e nevojshme për përfituesit dhe për funksionimin e përgjithshëm të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare. Sipas këtij raporti Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndanë disa fonde për blerjen e shërbimeve, por që nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë të koordinuara me nivelin lokal. Përqindja e buxhetit komunal e ndarë për shërbimet sociale dhe familjare është shumë e vogël. Deri më tani shërbimet sociale kanë qenë ndër të fundit në listën e prioriteteve të autoriteteve komunale gjatë procesit të planifikimit të buxhetit. Andaj, në bazë të këtyre konstatimeve komisioni e ka theksuar si të nevojshëm edhe plotësimin e këtyre dispozitave.

Edhe pse ka pasur progres në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, prapë mbetet shumë për t'u bërë në avancimin e shërbimeve sociale dhe familjare, andaj duhet adresuar sa më parë rekomandime që kanë dalë nga Komisioni për Shëndetësi pas mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare, me theks të veçantë adresimi me urgjencë të rekomandimeve

për të hartuar një ligj të ri për shërbime sociale dhe familjare, një ligj të integruar dhe të avancuar dhe me kompetenca të qarta, si për institucionet e nivelit qendror, po ashtu edhe atij lokal. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma. Urdhëro, Xhevahire!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që të përgëzoj koleget e mija për raportin shumë kualitativ dhe rekomandimet për të cilat kemi pasur nevojë në çështje sociale. Ka disa ditë që jam duke përgatitur një pyetje parlamentare, kështu që sot është edhe momenti në këtë raport, ministër, së bashku me kolegët e mi që diskutuam.

Unë do të shtoj disa vërejtje që lidhen me procedurat shumë burokratike të procesit të adoptimit të fëmijëve. Pra, qytetarë të nderuar, veçanërisht ju që ka muaj e vite që prisni të merrni një fëmijë si adoptues dhe kjo nuk ju bëhet e mundur për shkak të procedurave burokratike dhe të tejzgjatura. E dimë, secili nga ne deputetët ka hasur në familje të cilat na drejtohen për ndihmë, familje dhe qytetarë që kanë nevojë dhe vullnet të adoptojnë fëmijë, të cilëve jeta fatkeqësisht ua ka dedikuar një fat, që të rriten pra pa prindërit e tyre biologjikë dhe këta shprehin vullnetin e mirë dhe gjestin human që të marrin për adoptim dhe të pranojnë prindërimin për gjithë jetën.

Për mua si qytetare dhe deputete është një veprim shumë human, kur një fëmijë të cilit jeta ia servon, pra pa fajin e tij, një jetë pa familje, ta bëjë me familje dhe të rritet në ngrohtësinë familjare. Por, këtu nisë e përballet sfida tjetër, ku kthehet në dëshpërim i gjithë ky vullnet me hapin e parë. Pra, procedurat janë aq të vështira, që me gjithë vullnetin që të ketë një rregull dhe kriter për adoptim, mendoj se pak është e tepruar me burokraci dhe periudhë shumë e gjatë deri në momentin kur merret ky vendim.

Në shtetet tjera demokratike kjo procedurë zgjatë deri në gjashtë muaj, ndërsa tek ne edhe deri në dy e tri vjet. Ka foshnja që veç marrin një devijim nga pamundësia për kujdes, derisa të kenë fatin për të fituar një familje të re.

I nderuar ministër,

Meqenëse sot i dëgjuam edhe rekomandimet, unë kërkoj nga ju që edhe të vizitoni këto qendra dhe të marrim iniciativë, pra te ndryshimi i ligjit, që të bëhen këto vendime ku të përkrahim përsheptimin e procedurave, së paku tek punët sociale. Pra, kemi mundësi të bëjmë një dinamikë, sepse sigurojmë shumë familje dhe motivojmë familje tjera që të marrin iniciativa të tilla. Konsideroj që ne nuk jemi vend shumë i madh dhe me dy-tri telefonata kemi mundësi që të

heqim atë frikën, nëse mund ky proces të devijojë, pra që gjasat mund të jenë shumë të vogla për trafikim, sepse ne e njohim njëri-tjetrin më shpejt dhe ka mundësi që të verifikohet. Pra, ka mundësi të verifikohet dhe t'i shkurtojmë procedurat dhe t'ua mundësojmë këtyre njerëzve vullnetmirë që të bëhet adoptimi më i lehtë i këtyre fëmijëve.

Po ashtu, unë sigurisht se do të votoj me shumë dëshirë dhe do të ju përgëzoj edhe një herë për punën e mirë që kanë bërë koleget deputete. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! S'ka më diskutues. Adem Mikullovc, urdhëroni, e keni fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit!

Mua raporti më pëlqeu dhe është e qartë, edhe pse kanë punuar ekspertët e mjekësisë, njerëz që dinë, por mua më duket pak se është i idealizuar.

Memli Krasniqi tha para disa ditëve këtu një fjali shumë të mirë. Tha, mos nxirrni rezoluta të cilat Qeveria nuk ka mundësi t'i realizojë.

Ky raport ka kërkesa e rekomandime, të cilat është absolutisht e pamundur të realizohen për një vit, dy a tri vite. Unë do të përmend vetëm një rast, që për shembull, shkarazi përmendet, thotë: rehabilitimi i përdoruesve të narkotikëve... Shikoni, rehabilitimi i përdoruesve të narkotikëve është një humnerë pa fund. Kërkohen infrastruktura, kërkohen mjekë, kërkohen njerëz, kërkohen spitale, kërkohet... ekspertët. Nuk bëhet kjo veç me një fjali. Krejt buxheti i Kosovës, gjysma shkon për ta bërë një klinikë për rehabilitimin nga narkotikët dhe alkooli.

Po dua të them që është pak raport i idealizuar. Unë kisha pasur qejf krejt me qenë kështu, siç po shkruan, por kam frikë se është i idealizuar dhe ka vende për përmirësime, ta thjeshtësojmë nga pak. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet!

## **18. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017**

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Albulena Haxhiu, për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit të komisionit. Urdhëroni, Albulena.



ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zonja nënkryetare e Kuvendit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke vepruar në pajtim me nenin 72, paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018 shqyrtoi raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 dhe vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit që të miratohet raporti i punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017.

Megjithatë, më lejoni që t'i them disa prej çështjeve që janë diskutuar në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, të cilat janë të evidentuara edhe në këtë raport të Komisionit për Legjislacion.

E para, jemi njoftuar gjatë këtij raportimi që Agjencia Kundër Korrupsionit është duke bërë përpjekje përbrenda Ministrisë së Drejtësisë që të ndryshojë ligjet me të cilat edhe funksionon. Është Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, por po ashtu edhe Ligji për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë. Puna e këtij institucioni varet edhe nga monitorimi i strategjisë kundër korrupsionit dhe këtu më lejoni që ta shpreh shqetësimin tim lidhur me këtë dokument.

Sipas Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit thuhet që Qeveria i propozon Kuvendit strategjinë pesëvjeçare kundër korrupsionit, mirëpo ajo çfarë ka ndodhur në fakt është se Qeveria e Republikës së Kosovës e ka votuar në mbledhjen e saj këtë strategji dhe e ka shty në fuqi pa e prur fare në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, Qeveria Haradinaj ka shkelur edhe Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, i cili thekson se Kuvendi është institucioni i cili duhet ta miratojë këtë strategji. I bie njësoj, sikur Qeveria ligjin pa e sjellë në Kuvend ta shpallë, ose ta dekretojë, thënë më saktë. Prandaj, në emër të Komisionit unë i kam kërkuar Qeverisë Haradinaj që ta sjellë në Kuvend, e kanë sjellë në Kuvend pas reagimit tim, mirëpo çfarë ka ndodhur është se e kanë sjellë me vendimin për hyrje në fuqi pa e votuar Kuvendi. Prandaj edhe i kam kërkuar Qeverisë Haradinaj që ta shfuqizojë vendimin e paligjshëm dhe ta sjellë vendimin në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Në këtë mbledhje të komisionit drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit na ka njoftuar po ashtu, që shumë shpejt janë duke bërë përpjekje që të procedohet në Kuvend Ligji për sinjalizuesit. Janë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ligj për sinjalizuesit që është kërkesë e vazhdueshme e merr në raportin për vendit edhe të fundit që e patëm, po ashtu është kërkesë specifike edhe e Bashkimit Evropian, por përveç tjerash është jashtëzakonisht shumë i nevojshëm për Republikën e Kosovës, në mënyrë që të raportohet korrupsioni në agjenci, institucione apo kudo tjetër.

Gjithashtu, Agjencia Kundër Korrupsionit na ka njoftuar se ka zhvilluar hetime paraprake për 357 raste, ku 45 prej tyre janë bartur nga viti paraprak, kurse në vitin 2017 janë pranuar 312 raste. U tha, që 109 raste janë dërguar për kallëzim penal të përcjella në Prokurori dhe në Polici për procedim të mëtejshëm. 18 raste janë për shkelje administrative me kërkesë për fillim të

shkeljes së procedurës disiplinore, 92 raste janë mbyllur, 139 raste janë nën hetime, kurse janë trajtuar 85 informacione anonime.

Anëtarët e Komisionit për Legjislacion po ashtu, kanë dhënë kontributin e tyre në këtë raportim, ku u adresuan shqetësime që kishin të bënin me propozimin e anëtarëve të bordeve, që shumë prej propozimeve, sidomos këtyre të fundit, janë bërë me preferenca partiake, domethënë duke pyetur po ashtu edhe mundësinë që agjencia të ketë rol filtrimi para se të emërohen këta anëtarë nëpër borde. Po ashtu, është pyetur Agjencia Kundër Korrupsionit se a është menduar të vlerësohet gjendja e pasurisë së zyrtarëve të lartë përgjatë gjithë këtyre viteve, dhjetë vjetëve të themelimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke qenë se shumë prej zyrtarëve të lartë pasurinë që e marrin e kanë në shpërputhje me të ardhurat që i kanë. Prandaj, edhe kemi qenë të interesuar që të kuptojmë nëse është e mundur të bëhet një vlerësim i gjithë pasurisë së zyrtarëve të lartë. Po ashtu, problem është që shumë prej kallëzimeve penale që po i përpilon Agjencia Kundër Korrupsionit po hedhen poshtë nga Prokuroria.

Pra, siç duket po mungon një bashkëpunim ndërinstitucional. Tash së fundmi kemi kuptuar edhe problemet që i kanë prokuroritë me gjykatat, akuza dhe kundërakuza në këtë drejtim, në vend se të kishim një bashkëpunim ndërinstitucional për t'i luftuar veprimet korruptive.

Pra, këto janë disa nga çështjet që janë diskutuar në Komisionin për Legjislacion dhe anëtarët e komisionit kanë vendosur që t'i rekomandojnë seancës që të përkrahet ky raport. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryetare! Tani e ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, ta paraqesë raportin e komisionit lidhur me raportin vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017. Kush do ta marrë fjalën në emër të komisionit? Nëse nuk ka, fjalën e ka deputeti Nezir Çoçaj.

**NEZIR ÇOÇAJ:** Faleminderit, nënkryetare!

Edhe pse prita që fjalën ta kenë deputetët nga Lidhja Demokratike e Kosovës, por po shihet se kanë mbetur një numër i vogël e atyre aty, ne jemi më shumë dhe faleminderit që ma dhe mundësinë të flas i pari. Jo, s'po ju shkelen të drejtat.

Sido që të jetë, faleminderit nënkryetare e Kuvendit!

Gjatë analizës së raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 vërehet një dinamizëm i shtuar i punës së kësaj agjencie. Vërehet bashkëpunimi i shtuar dhe më serioz i agjencisë me institucionet tjera, që kanë përgjegjësi në zbatimin e Ligjeve për të parandaluar korrupsionin e në veçanti duhet theksuar bashkëpunimin me organet e hetuesisë, pra Policinë dhe Prokurorinë, si organe për procedime më të detajuara të lëndëve për dyshime në korrupsion.

Pasqyrimi i procedimeve në vitin 2017 prej 357 rasteve tregon angazhimin në rritje të punës së kësaj agjencie. Këto raste përfshijnë 109 informata dhe kallëzime penale për të cilat ka informacione kthyes nga prokuroria, se 89 kallëzime penale janë përcjellë në prokuroritë kompetente. 139 raste janë në procedurë të ekzaminimit, 17 raste të shkeljeve administrative nga të gjitha këto 92 raste janë të mbyllura.

Në të gjitha këto raste të paraqitura në raport shihet se ka zyrtarë publikë të të gjitha niveleve dhe pothuajse të të gjitha institucioneve të cilat dyshohen për veprime korruptive, keqpërdorim të pozitës zyrtare e veprime tjera të sanksionuara me ligj.

Të nderuar deputetë,

Raporti paraqet të dhëna statistikore lidhur me deklarin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë. Grupi Parlamentar i PDK-së shprehë shqetësim për faktin se 32 zyrtarë të lartë publikë nga Qeveria dhe 5 zyrtarë nga gjykatat nuk kanë deklaruar pasurinë. Rastet e mosdeklarimit të pasurisë sipas ligjit evidentohen edhe te zyrtarët të cilat kanë mbaruar funksionin apo janë shkarkuar nga funksioni, pra kemi 60 raste të tilla. Po ashtu, shqetësues është edhe fakti i mosdeklarimit të pasurisë brenda afatit ligjor i një numri të konsiderueshëm zyrtarësh të lartë publikë nga të gjitha institucionet publike e që numri i mosdeklarimit është 391.

Shqetësimi ka të bëjë me faktin, se deklarimi i pasurisë nga zyrtarë të lartë nuk mund të justifikohet me asnjë rrethanë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë. Veprimet e ndërmarra nga Agjencia për sensibilizimin e opinionit publik lidhur me raportimet për rastet korruptive dhe rastet tjera të kësaj natyre, si dhe për parandalimin e korrupsionit janë për t'u përshëndetur dhe më se të nevojshme në shoqërinë tonë.

Të nderuar deputetë,

Ky raport është i përgatitur mirë, i kompletuar dhe si i tillë, ju lus që ta votojmë.

Në fund do të kisha kërkuar nga agjencia si dhe nga ne të gjithë deputetët që të jemi efikas në rishikimin e ligjeve të fushës së parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Grupi Parlamentar i LDK-së, deputeti Korab Sejdiu e ka fjalën.

**KORAB SEJDIU:** Faleminderit, kryesuese!

Ky gabim teknik na e dha neve fjalën të dytë, përkundër insistimit që nuk e di çfarë arsye pati, po ne jse nuk ka dert, duhet të rritemi edhe pak për të marrë fjalën të parët pa gabime teknike.

Mirëpo, të kthehemi te raporti i Agjencisë Kundër Korrupsionit. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë raport, edhe pse, siç e tha edhe kryetarja e komisionit, kemi shqetësime të thella sa i përket kësaj agjencie jodomosdoshmërisht që ndërlidhet me punën e tyre, por me atë se nuk i ka veglat e mjaftueshme për t'i arritur synimet që i ka, pra nuk e ka kornizën ligjore të mjaftueshme. Shpeshherë lëndët të cilët ata i përgatisin mbetet në nivel të sirtarit të prokurorisë, mbeten në nivel të kallëzimeve penale dhe nuk shkojnë tutje. Kështu që një farë mënyre është një farë lloj tigri pa dhëmb dhe pa kthetra që, në shikim të parë duket shumë i rrezikshëm, mirëpo kur shqyrtohet tutje kapaciteti për t'i arritur synimet, mbetet shumë i kufizuar.

Ne në vazhdimësi kemi insistuar edhe si komision, po edhe si grup parlamentar insistojmë që të mbështetet kjo agjenci me të gjitha veglat e punës, përfshirë kornizën ligjore, por edhe mundësinë potenciale që të bëjë padi substituare edhe në procedura penale nëse prokurori nuk ngre aktakuza, atëherë të ketë mundësi edhe vetë agjencia të bëjë këtë.

Kështu që ne e përkrahim këtë raport si grup, mirëpo shpresojmë që të punohet pak më shumë që të ndihmohet në synimin e objektivave që i ka. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, Korab!

Ne shkojmë me rend, nuk ka qenë gabim teknik, me vonesë e keni shtypur butonin. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, zonja nënkryetare!

Po flas në emër të grupit tash.

Po filloj me vërejtjet tona sa i përket këtij raporti.

Së pari, më duhet të përmend faktin që ne nuk e kemi përkrahur në Komision për Legjislacion raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për shkak se edhe kësaj radhe nuk është evidentuar asnjë rast i zyrtarëve të lartë, të cilët janë dënuar me burgim për rastet e korrupsionit, qoftë për mosdeklarim të pasurisë, për konflikt interesi apo për deklarim të rremë të pasurisë.

Në faqen një të këtij raporti përmendet si e arritur raporti Transparency International, ku thuhet që Kosova është ngritur 10 vende, duke u renditur e 85-ta për vitin 2017.

Pra, konsiderohet si arritur pse ne qenkemi në vendin e 85-të, pra 10 vende më lartë, në fakt nuk është thënë gjysma tjetër e së vërtetës, pse është kështu? për faktin se edhe në raportin e Transpaerncy International është përmendur se kjo është si rezultat i ndryshimeve të bëra në përbërjen e KGJK-së, Ligjit për KGJK-në, data bazën për rastet e korrupsionit, por po ashtu edhe

raportimet e mediave dhe shoqërisë civile për rastet e korrupsionit dhe jo se Kosova ka luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Po ashtu, në faqen 7 të këtij raporti edhe vetë Agjencia Kundër Korrupsionit e ka pranuar se veprat penale të korrupsionit vazhdojnë të përbëjnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes, por njëkohësisht përbëjnë edhe vepra për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime.

Pra, siç e thashë edhe në fillim të fjalës sime, askund, në asnjë rresht të këtij raporti nuk thuhet apo nuk specifikohet që dikush nga zyrtarët e lartë ka marrë dënim me burgim, përveç se dënimet me gjoba, dënime me kusht. Pra dënimi me burgim i është zëvendësuar dënim me kusht dhe kjo është një farë stimulimi që zyrtarët e lartë të korruptohen në vazhdimësi. Për shkak se nëse një zyrtar të lartë e dënon me gjobë në qoftë se ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, në qoftë se ka fshehur pasurinë, nuk i kushton asgjë një zyrtari të pasur që të paguajë ta zëmë 2000 euro që është gjoba më e lartë, domethënë si sanksion nga prokuroria në rast të mos deklarimit të pasurisë ai vazhdon njësoj të veprojë, pra të mos e deklarojë pasurinë e tij.

Po ashtu një prej shqetësimeve tona ka të bëjë me pushimin e hetimeve dhe hedhen poshtë të rasteve që specifikohet në faqen 10 të këtij raporti.

Pra, thuhet që kallëzimeve penale të paraqitura nga AKK-ja u ka skaduar afati i ndjekjes penale dhe është bërë parashkrimi i veprës penale.

Merreni me mend, ne i kemi dëgjuar institucionet e drejtësisë që e kanë gojën plot luftim të krimit të organizuar dhe korrupsionit, por përveç që ne në vazhdimësi e kemi përmendur këtë si problem serioz që prokurorë, gjyqtarë të parashkruajnë rastet e korrupsionit, kjo është e paraparë edhe në raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Dhe, neve nuk na është thënë arsyeja pse janë parashkruar këto vepra penale, pra a është e interesuar Agjencia Kundër Korrupsionit të kuptojë arsyen e vërtetë, për shkak se unë besoj që në shumicën dërmuese të rasteve të parashkrimit lihen qëllimshëm që të parashkruhen, pikërisht se bëhet fjalë për zyrtarët e lartë, pra, jo është goxha problematike.

Po ashtu mbeten problem i theksuar rastet apo kallëzimet penale të Agjencisë Kundër Korrupsionit në prokurori.

Në disa takime e kam përmendur në vazhdimësi këtë çështje, ku janë ftuar prokurorët në Komisionin për Legjislacion në grupet punuese dhe janë pyetur pse po i hedhin poshtë kallëzimet penale të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ata thonë që kallëzimet penale që bëhen nga Agjencia Kundër Korrupsionit janë qesharake. Ne po ashtu kemi pyetur edhe drejtorin e agjencisë pse po

deklarohen kështu nga prokuroria, aty na është thënë që tashmë ka një bashkëpunim më të mirë, tashmë kallëzimet penale janë më cilësore, mirëpo pastaj kjo nuk po shprehet në raport, për shkak se nëse kallëzimet janë cilësore, atëherë duhet të kishim edhe dënime, apo problemi është këtu te prokuroria, e që unë besoj që problemi më i madh është prokuroria.

I përmenda edhe në fjalën time në emër të komisionit akuzat e Këshillit Prokurorial, kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, karshi Këshillit Gjyqësor nuk janë hiq të mira, për shkak se këto institucione përgjegjësinë e kanë ta luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe jo të akuzojnë njëri-tjetrin kush po i heton e kush s'po i heton zyrtarët e lartë. Ata që nuk kanë guxim t'i hetojnë zyrtarët e lartë, le ta lënë detyrën, ka prokurorë të tjerë të guximshëm që mund t'i hetojnë zyrtarët e lartë për aferat e tyre korruptive.

Pra, këtu u përmendën shumë çështje, shumë shifra, megjithatë ne si grup parlamentar nuk mund të votojmë një raport të tillë që nuk ka shifra që në Kosovë po luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni dhe për sa kohë jemi në situata të tilla, ne nuk mund të ndryshojmë qëndrim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Albulena! Fjalën e ka Shqipe Pantina, nga Grupi Parlamentar i PSD-së.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Pa dashur t'i përsërisim vërejtjet që u thanë nga disa prej grupeve parlamentare, megjithatë janë disa çështje që edhe nuk janë theksuar në raport, por unë do të doja t'i shtroja sa i takon punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kur ishte themeluar kjo agjenci ishte krijuar përshtypja se tashmë niveli i korrupsionit në Kosovë do të bie drastikisht, sepse agjencia, përveç që do ta luftonte krimin, e në fakt, në këtë pikë, pajtohem me zotin Korab Sejdiu se ka shumë pak kompetenca, por ajo do të punonte shumë në parandalimin e korrupsionit.

Mirëpo, për fat të keq, niveli i korrupsionit veç se është rritur, ai nuk po shënon rënie, dhe nga agjencia deri më tani nuk kemi parë ndonjë sukses të theksuar, domethënë ndonjë çështje që ata e kanë ngritur e që suksesshëm pastaj është ndjekur edhe nga gjyqësori, në rastet e krimit të organizuar dhe veçanërisht të korrupsionit.

Por, janë dy vërejtjet që unë dua t'i shtroj e që kanë të bëjnë direkt me punën e agjencisë.

Kjo agjenci është autoriteti i vetëm, i cili bën interpretimin e konfliktit të interesit.

Ka shumë raste kur agjencia, në fakt, nuk e ka bërë si duhet mënyrën e interpretimit dhe unë dua të përmend këtu një rast kur vetë Kuvendi është vënë në lajthitje për shkak të interpretimit të gabueshëm nga ana e agjencisë për një zyrtare, e cila dhe këtu po flas për një rast që ka të bëjë me Bordin e RTK-së, kur për të njëjtën rrethanë, për të njëjtat arsye Agjencia Kundër Korrupsion kishte dhënë vlerësim se personi për të cilin ishte dërguar çështja nuk kishte konflikt të interesit.

Dhe, e njëjta zyrtare që nuk dua t'ia përmend emrin tani, nuk u lejua të kandidonte për të njëjtën pozitë, sepse Zyra Ligjore e Kuvendit vlerësoi se kishte konflikt interesi.

Për më tepër, për të njëjtën arsye ky Kuvend e shkarkoi një person tjetër, sepse kishte konflikt interesi dhe unë nuk di nëse agjencia ka marrë masa ndaj këtyre zyrtarëve, sepse ka arsye për të besuar se qëllimisht zyrtarët që kanë përgatitur vlerësimin për konflikt interesi e kanë bërë qëllimshëm këtë devijim.

Pra, vlerësimin e kanë bërë në favor të personit, ani pse ishte e qartë se kishte konflikt interesi, siç u vërtetua më vonë nga vetë Kuvendi.

Çështja tjetër është te publikimi i formularëve për deklaram të pasurisë.

Ndonëse është gabim teknik dhe dua ta besoj se kjo bëhet si gabim teknik, por ka shumë raste dhe besoj u ka ndodhur edhe shumë nga kolegët deputetë këtu, kur shuma e deklaruar, sidomos paratë kesh që mbahen, janë keqpublikuar, çka do të thotë se ta zëmë nëse ndonjë zyrtar ka deklaruar se në xhirollogarinë e tij ka, të themi 1500 euro, shumë shpesh në formularët e publikuar nga Agjencia Kundër Korrupsion janë prezantuar si vlera milionëshe, pra janë shtuar disa zero. Pra, po them, mua personalisht më ka ndodhur kjo, kjo në dukje të parë është gabim teknik por të mos harrojmë se disa edhe kolegët deputetë, por edhe të tjerë, janë bërë tema mediale mu për këtë gabim teknik dhe shpeshherë është shumë e vështirë pastaj të shpërndahet demantimi i lajmit se sa lajmi fillestar që është dhënë.

Pra, agjencia duhet të ketë kujdes edhe në këto çështje teknike, sepse janë shumë të ndjeshme dhe pastaj bëhen tema të panevojshme edhe për publikun e gjerë.

Përndryshe, është po ashtu shqetësues fakti se numri i rasteve që ka ngritur Agjencia Kundër Korrupsion dhe kallëzime penale që ka bërë, në krahasim me numrin e padive pastaj të ngritura nga prokuroria është shqetësues, kështu që duhet parë ku është faji.

Është agjencia ajo që nuk i ka hartuar si duhet këto raste, nuk i ka argumentuar mjaftueshëm, apo faji qëndron te gjyqësori, i cili nuk ka vazhduar më tutje dhe i ka hedhur këto kallëzime si të pabaza.

Pra, në parim, raporti është në rregull, e paraqet punën e Agjencisë Kundër Korrupsion, por puna e kësaj agjencie nuk është e gjitha për t'u admiruar, për t'u vlerësuar dhe ka shumë çështje për të cilat agjencia duhet ta përmirësojë kualitetin e punës së vet dhe, mbi të gjitha, po ashtu duhet të jetë edhe më aktive jo vetëm në rastet e ngritjes së vetëdijes, bashkëpunimit me media, por sidomos në përmirësimin e mënyrës se si i harton kallëzimet penale dhe përcjellja e këtyre rasteve te gjyqësori. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Grupi Parlamentar AAK, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Është rregull që secila agjenci që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës në fund të një viti kalendarik të sjellë edhe raportin e punës.

Në këtë rast ne po shqyrtojmë raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 dhe ne do ta përkrahim.

Unë isha shumë optimiste kur raportoi kryetarja e komisionit që tha do ta përkrahim, thashë qenka raport tepër i mirë pasi po e përkrah Albulena, ne s'paskemi çfarë të mendojmë hiç, dhe ta përkrahim, po më dëshpëroi kur foli pastaj në emër të grupit parlamentar, kur tha nuk po e votoj, thashë sigurisht që paska gabime të mëdha.

Mendoj se në hartimin e radhës të gjitha ato vërejtje që u dhanë nga deputetët dhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion, agjencia duhet t'i ketë parasysh të gjitha ato vërejtje dhe normalisht që raporti të jetë më i kompletuar. Përndryshe, ne si Aleancë do ta përkrahim.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete!  
Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, e nderuar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht edhe zoti Nezir Çoçaj e tha fjalën e vet në kuadër të grupit parlamentar, ne edhe si Komision për Legjislacion e kemi shqyrtuar raportin, ky raport është shumë i qartë, tregon edhe për të arriturat që i ka bërë agjencia nga viti në vit, po në të njëjtë kohë edhe për sfidat që i ka kjo agjenci.

Ne duhet të kuptojmë që i kemi edhe katër ligje, një ligj e kemi miratuar në Kuvend, do të thotë për konfliktin e interesit, i kemi edhe katër ligje që lidhen direkt me Agjencinë Kundër Korrupsion, deklarimi i pasurisë që është, do të thotë na ka informuar edhe sponsoruesi,



Ministria e Drejtësisë, se janë nisur në drejtim të Kuvendit, Agjencia Kundër Korrupsion, mbrojtja e informatorëve dhe konfiskimi i pasurisë të fituar me veprë penale. Të gjitha këto ligje e forcojnë edhe rolin e agjencisë.

Kërkoj nga deputetë që të angazhohen, sepse ligjet do të jenë shumë shpejt në duar të deputetëve dhe ta forcojmë rolin e agjencisë.

Ne pikërisht si deputetë kemi pasur vërejtje, në të njëjtën kohë pse të ketë shumë kallëzime penale, a kanë qenë ato kallëzime penale vetëm njollosje të zyrtarëve publikë, apo kanë qenë kallëzime penale që kanë pasur elemente të kryerjes së veprave penale.

Kurse nga viti në vit agjencia është duke u profesionalizuar, kemi pyetur a ka nevojë të rritet stafi i zyrtarëve ligjorë, sepse nuk është mirë të kemi kallëzime penale pa elemente të kryerjes së veprës penale, kur të ka kallëzime penale, është mirë numri i tyre të përfundojë me aktakuzë, edhe me aktgjykime, jo vetëm të njollosim njerëzit dhe në fund të jetë në disproporcion numri i kallëzimeve penale me numrin e aktgjykimeve apo me numrin e aktakuzave.

Kemi ngritur shumë çështje si anëtarë të komisionit, të cilat na janë pohuar edhe nga kryeshefi i agjencisë që është duke punuar në Ligjin për agjencinë, sepse janë shumë çështje që janë shqetësuese për zyrtarët e lartë dhe për qytetarët.

Ne kemi ngritur çështjen e kriptovalutave, por në të njëjtën kohë na është thënë nga kryeshefi i agjencisë se ka zyrtarë të lartë që i janë drejtuar agjencisë si t'i deklarojnë kriptovalutat.

Kemi ngritur edhe raste të tjera si komision, të cilat tash janë duke u rregulluar, kemi kërkuar që të hiqet deklarimi i pasurisë për asamblistët e Kuvendeve Komunale të Republikës së Kosovës, kjo çështje të rregullohet me ligj, sepse konsiderojmë se është ngarkesë, është një numër shumë i madh. Po të njëjtën kohë të rritet numri i zyrtarëve të tjerë të lartë për deklarimin e pasurisë.

Andaj, mendoj që duhet të përkrahim këtë raport, është një raport shumë i qartë, i hartuar mirë, mirë e pasqyron gjendjen, po në të njëjtën kohë ne duhet ta kemi të qartë se agjencia nuk dënon, nuk nxjerr as aktakuzë, as aktgjykime, po bën kallëzime penale, bën hulumtime, bën hetime dhe për të gjitha fushat i ka sqaruar mirë në raport, duke përfshirë edhe prokurimin publik, edhe rastet e konfliktit të interesit, edhe rastet e korrupsionit dhe të gjitha rastet.

Andaj, unë mendoj që organet e tjera duhet të merren me këto çështje, në këtë rast prokuroria dhe gjyqësori.

Këtë raport kërkoj nga kolegët deputetë që ta përkrahim sot.

Kurse ne si Komision për Legjislacion të ngutemi pak me agjendën tonë, të mos bëjmë vetëm fjalë për Kuvendin apo pse nuk po mbledhem më shpesh.

I kemi 14 ligje, disa prej tyre i kemi kaluar, po nuk kanë ardhur ende për votim. I kemi 14 ligje në procesim, për shkak të shumë interpelancave apo debateve, të cilat konsideroj që jemi duke ua humbur kohën edhe qytetarëve, edhe agjendave të shtetit, sepse pa kaluar këto katër ligje: deklarimi i pasurisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, mbrojtja e informatorëve dhe konfiskimi i pasurisë, nuk mund të kemi liberalizim të vizave.

Andaj, ne nuk mund të kërkojmë nga të tjerët të na përkrahin pa i kryer detyrat tona, mendoj që edhe Qeveria duhet të jetë më dinamike, po edhe komisionet dhe t'i lëmë këto interpelanca pasi t'i kryejmë disa punë që i kemi më të rëndësishëm për institucionet dhe për shtetin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, deputet! Për replikë fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, zonja nënkryetare!

Vetëm të theksoj një fakt që shumë shpesh po akuzohet opozita që po thërret interpelanca në Kuvend. Nuk e kuptoj a është Kosova Republikë parlamentare, a është Kosova Republikë qeveritare apo presidenciale, sepse përnjëmend është goxha problematike kur dëgjon deputetë të Kuvendit që bëjnë thirrje që opozita të mos procedojë kërkesa për interpelanca. E për çka janë këto interpelanca, për Telekomin, për Trepçën, për KEK-in, domethënë për ndërmarrje publike që i ka shkatërruar Qeveria, edhe kjo aktuale, edhe qeveritë e kaluara.

Prandaj, ju lutem, mos kërkon diçka që as në ëndërr s'mund t'ju plotësohet. Pra, ne do të vazhdojmë me opozitë konstruktive përbrenda Kuvendit, sepse Qeveria aktuale, e cila edhe sot po mungon, po shpërfill Kuvendin e Republikës së Kosovës, po e shpërfill deputetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht edhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe projektligjet që i përmendi zoti Hajdar Beqa, veç të qartësohet. Asnjëri prej atyre katër projektligjeve nuk është proceduar në Komisionin për Legjislacion dhe unë besoj që komisioni është jashtëzakonisht duke punuar mirë, po problemi po është që seancat i kemi në kohën e mbledhjeve të komisionit, jemi detyruar, e di edhe zoti Beqa, ta shtyjmë disa herë mbledhjen e komisionit për shkak të agjendës së Kuvendit që po caktohen seancat kur po i tekton kryetarit të Kuvendit.

Prandaj, nuk është në rregull të akuzohet që nuk po punohet ose që të përshpejtohet puna, sepse besoj që edhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion, të tjerët janë këtu dhe e dëshmojnë këtë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Albulena! Për kundër-replikë fjalën e ka Hajdar Beqa. Urdhëro, një minutë i ke!

HAJDAR BEQA: Unë nuk jam këtu zëdhënës i Qeverisë, po na u ka drejtuar me shkrim, edhe kryetarit të Kuvendit, edhe komisionit, ministri i Drejtësisë për ligjet që janë drejtuar për të ardhur në komision. Por mendoj që duhet t'i kryejmë këto ligje të tjera.

Nuk thashë unë që janë të këqija interpelancat apo rekomandimet a rezolutat që po i nxjerrim, por jemi duke i përsëritur nga viti në vit, për shumë pika janë gati të njëjtat, në të dytin mandat jam që po i nxjerrim nga viti në vit.

Nuk është mirë ta pengojmë agjendën evropiane. Jam shumë i interesuar për të gjitha çështjet që janë shqetësime të qytetarëve, t'i shtrojmë këto, edhe me debate, edhe me interpelanca, po jo me interpelanca folklorike, patriotike, e dimë që janë shumë marrëveshje të tjera, të cilat i rregullojnë këto çështje.

Nuk është mirë të themi që nuk është pozita për interpelancë, se kemi raste kur edhe pozita ka kërkuar interpelancë, kemi raste kur edhe pozita kërkon debat parlamentar. Është mirë të angazhohemi më shumë t'i kryejmë detyrat...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka Bilall Sherifi, shef i Grupit Parlamentar Nisma. Urdhëroni!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kjo është temë, të cilën e kemi biseduar edhe në komision së bashku me përfaqësuesit e Agjencisë Anti Korrupsion dhe mendoj që kam përshtypjen së paku që kemi një keqkuptim, secili e sheh ndryshe rolin e kësaj agjencie dhe varësisht si e shohim, pastaj i ndërtojmë edhe pritjet dhe varësisht prej pritjeve, herë zhgënjehemi e herë entuziazmohemi me rezultatet që i ka sjellë ajo.

Agjencia Kundër Korrupsionit është dera e parë, adresa e parë e atyre që preken nga korrupsioni, ose i atyre, të cilët dëmtohen nga korrupsioni ose i atyre, të cilëve u kërkohet korrupsioni, nën një. Dhe nën dy, është institucioni i cili është i autorizuar ta mbikëqyrë aspektin formal, atë të letrave, atë që e deklarojnë zyrtarët mbi rritjen, zhvillimin, uljen e ku ta di unë, stagnimin e pasurisë së tyre. Pra, nëse i ndërtojmë pritjet tona mbi bazën edhe të përgjegjësive që i ka, del se raporti i kësaj agjencie është korrekt. Të gjitha punët, të cilat ata i kanë kryer, i kanë pasqyruar në këtë raport.

Tash, nëse mbi bazën e punëve të këtyre, të kësaj agjencie, të punëtorëve të agjencisë, të cilat i kanë bërë këto dhe i kanë përcjellë tek organet tjera, siç është Prokuroria, nuk ka rezultuar ndonjë rezultat më i madh, më i mirë, atëherë nuk është përgjegjës Agjencia Kundër Korrupsionit dhe rrjedhimisht nuk është përgjegjës as raporti. Pra, duhet t'i ndajmë përgjegjësitë dhe duhet t'i ndajmë pastaj edhe pritshmëritë. Unë mendoj që puna jo e mjaftueshme është bërë në nivelin e Prokurorisë dhe gjykatave, por jo edhe në nivelin e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Kjo është detyra e tyre. Ata janë një numër i zyrtarëve, të cilët i shqyrtojnë ankesat, denoncimet dhe i analizojnë nëse janë për t'u përcjellë më tej apo nuk janë për t'u përcjell më tej dhe e mbikëqyrin, siç thashë, zhvillimin, rritjen apo zvogëlimin e pasurisë zyrtare.

Ajo që unë do të kisha thënë këtu, se vërtet e kemi një numër të madh, një gamë shumë të madhe të zyrtarëve, të cilët janë të përfshirë këtu, dhe duke pasur parasysh që është numri i madh pastaj e vështirëson edhe kontrollimin e tyre, rritjen e pasurisë, qoftë të tyre, qoftë të familjarëve të tyre.

Po të isha unë në vend të tyre, do ta kisha pasur një prioritet se si do të përcillja këtë situatë. Nuk është njëjtë, nuk mund që njëjtë ta përcjellësh një asamblist, një deputetë, një punëtor zyrtar të prokurimit, një ministër apo zyrtarë të tjerë, të cilët kanë pushtet ekzekutiv. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, vendimi i tyre është i tillë, i cili mund të jetë veprim korruptiv, apo mund të mos jetë veprim korruptiv. Nuk është njëjtë sikur të ushtrosh ndikimin nga cilësia e deputetit, sikur të jesh në listë si asamblist nga cilësia e asamblistit me idenë se ti, duke qenë asamblist mund të ushtrosh ndikim, me zyrtarin i cili drejtpërdrejt e ka vendimin në dorë. Unë mendoj që kjo, nëse do të ndahej, do të diferencoheshin zyrtarët nga ata që ushtrojnë ndikim, tash po e përmbledh në një fjali, dhe ata që e kanë pushtetin drejtpërdrejt në duar për të marrë vendime, do të mund të rritej efikasiteti i luftës kundër këtyre dukurive, për të cilat Agjencia Kundër Korrupsionit është e mandatuar me ligj për të vepruar.

Unë nuk kam pas ndonjë pritje kush e di se sa më të madhe se kaq, prandaj konsideroj që raporti është korrekt. A jemi të kënaqur me rezultatin në përgjithësi të luftës kundër këtyre dukurive, s'besoj që dikush është i kënaqur, qoftë ai që është në pushtet, që ishte dje, që është sot, apo qoftë ata që ishin në pozitë dje dhe vazhdojnë të jenë edhe sot. Në përgjithësi, shoqëria nëpër çdo sondazh, nëpër çdo anketë, shoqëria jonë e percepton korrupsionin si shumë të lartë, por kur pyetet për përvojën personale me tentimin për të korruptuar, apo për ta korruptuar, del se është më i vogël se sa është perceptimi, por mjafton edhe kjo shifër, jo vetëm e perceptimit, por edhe atyre të cilët janë të prekur drejtpërdrejt nga kjo dukuri të shihet që është shumë e lartë dhe kemi nevojë të punojmë më shumë, qoftë në përmirësimin e infrastrukturës ligjore, qoftë në ngritjen e kapaciteteve apo burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e Administratës Shtetërore, Prokurorisë, gjykatave, Agjencisë Kundër Korrupsionit, që ta parandalojmë sa më shumë zhvillimin e këtyre dukurive, kryerjen e këtyre dukurive, sepse fatkeqësisht në momentin kur një veprim korruptiv ndodh dhe as marrësi dhe as dhënësi nuk kanë më interes ta denoncojnë për faktin se ligji i njëjtë i sanksionon pastaj të dytë, si marrësin, ashtu edhe dhënësin.

Prandaj, le të punojmë më shumë në ndërtimin e kapaciteteve, infrastrukturës ligjore dhe kapaciteteve njerëzore e profesionale që këto dukuri të mund të parandalohen ndër vite dhe duke i parandaluar do të mund ta zvogëlojmë edhe më shumë në vitet në vijim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu, le të përgatitet Arbër Rexhaj dhe shkojmë në pauzë. Urdhëro, Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi shumica e çështjeve sa i përket raportit u dhanë dhe si grup parlamentar duhet të mbështesim raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e sigurisht që gjatë këtyre viteve të trajtimit të këtyre raporteve është parë më se e nevojshme që disa çështje sa i përket raportimit dhe mënyrës së raportimit të ndryshohen me legjislacionin në fuqi, të precizohen disa çështje, sepse edhe vetë agjencia në raste të caktuara vendoset në dilema se si të veprojë.

Më ka rastisur që vitin e kaluar të takoj zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit për disa raste të cilat kanë qenë shumë të diskutueshme, për shembull vonimi në deklarimin e pasurisë të zyrtarëve publikë, disa prej tyre me arsye, sepse ndodh që kemi pasur edhe deputetë në mandatin ose vitin e kaluar, të cilët kanë qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe kanë qenë në shërim jashtë vendit dhe disa zyrtarë publikë, të cilët kanë qenë në shërim jashtë vendit, e të cilëve pastaj u është bërë kallëzimi penal për shkak se nuk kanë arritur me kohë ta dorëzojnë aplikacionin apo formularin e deklarimit të pasurisë dhe për këtë pastaj është bërë kallëzimi penal që, për mendimin tim, ka qenë tejet i gabueshëm, sepse të paktën në aspektin human dhe njerëzor këtu duhet t'i mbështetnim, e jo t'ua bënim edhe një kallëzim penal pse janë në shërim jashtë vendit dhe s'kanë mundur ta dorëzojnë formularin e deklarimit të pasurisë dhe kjo pastaj si shifër e kallëzimit penal është paraqit në raportin e Agjencisë me Prokurorinë, por që sigurisht që pastaj edhe Prokuroria e ka parë që nuk ka pas asnjë element të veprës penale, sepse njerëzit kanë qenë në shërim jashtë vendit dhe nuk kanë pasur as mundësi praktike e as teorike për të dorëzuar formularin, e në veçanti në gjendjen shëndetësore çfarë kanë qenë dhe pastaj të merren me aspektet e plotësimit të formularëve për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe këto çështje duhet të parashihen.

Një çështje tjetër që për mua me rëndësi dhe mendoj që te profesionistët shëndetësor po paraqet vështirësi është kërkesa për deklarim të pasurisë të drejtorëve të klinikave në Qendrën Klinike Universitare dhe drejtorët e klinikave në spitalet regjionale. Tërësisht i panevojshëm deklarimi i pasurisë të profesionistëve shëndetësorë, të cilët nuk kanë me nënshkrimin e tyre në menaxhim asnjë buxhet. Ata nuk kanë të drejtë ta blejnë as një shiringë në klinikën e tyre, e atëherë cila ka qenë logjika, sepse kur është përpiluar regjistri janë trajtuar drejtorët klinikë sikur të jenë drejtorë administrativë, ose menaxherë të ndonjë komune ku menaxhohet me buxhetin, apo me paranë publike. Mendoj që kur të përpilohet ligji i ri duhet t'i kenë në konsideratë këto çështje, e në

veçanti edhe mënyrën e deklaramit të pasurisë, që ajo të jetë shumë më efikase, shumë më e kontrollueshme, shumë më e monitorueshme, por që vërtet të jetë më efikase në luftimin e korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Diskutuesi i fundit për këtë pikë është Arbër Rexha. Urdhëro!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Në fakt, nuk e pata ndërmend ta marr fare fjalën për të diskutuar për këtë çështje, sepse në tërësi u pajtova me Albulenën derisa diskutonte. Megjithatë, dua ta marr fjalën për shkak të parimësisë, sepse nuk u pajtova me deputetin Hajdar Beqa, i cili tha se ky Kuvend, në veçanti opozita, por edhe pozita, po e bllokoi agjendën evropiane. Në fakt, mendoj se kjo Qeveri ka agjendë antievropiane dhe për këtë u konstatua kur në mënyrë të paligjshme i depërtuan shtetasit turq dhe se mbi këtë bazë pothuajse të gjitha ambasadat dhe Bashkimi Evropian reagojnë për këtë gjë, sepse u tundën themelet e institucioneve të Republikës së Kosovës, u shkelën liritë dhe të drejtat e njeriut dhe se me agjendë evropiane nënkupton kur ti e lufton krimin dhe korrupsionin, e unë bëj një pyetje retorike, sepse nuk po kërkoj përgjigje për këtë çështje: Sa kryetarë komunash për shkak të korrupsionit e kriminalitetit janë dënuar në krejt Republikën e Kosovës?

Po, me aq sa kam njohuri është një. Ai është Xhabir Zharku dhe tashmë nuk gjendet në Kosovë, pra ka ikur. Dhe, pas një kohe do të kthehet dhe sigurisht kur të kthehet, vendi i tij nuk do të jetë në burg.

Sa drejtorë të komunave të Republikës së Kosovës janë dënuar? Ka, por megjithatë ka shumë pak! Pastaj, çështja e interpelancave që u shtrua këtu, interpelancat janë kontrolli më demokratik i mundshëm. Kolegu nga PDK-ja, Hajdar Beqa, tha se interpelancat po e vonojnë këtë agjendë. Unë nuk di nëse ka institut tjetër pos interpelancës, i cili është më i shëndetshëm dhe që qartëson shumë pikëpyetje dhe pikëçuditje në raport Qeveri-opozitë, Qeveri dhe qytetarë. Prandaj, edhe Hajdari, i cili përherë, sa herë e merr fjalën, përkujdeset që të thotë “jam në mandatin e dytë”, këtë gjë elementare do të duhej pra ta dinte dhe unë e di që e di.

Edhe një çështje për fund, pa dashur që me personin e dytë të replikojë, tha se korrupsioni më shumë është perceptim dhe se korrupsioni është më shumë konceptim. Në fakt, nëse i shohim raportet e ndryshme, e shohim që jemi ndër vendet më të korruptuara në botë, sidomos në këtë pjesë të Evropës dhe si raport i kësaj edhe ekonomikisht humbim çdo ditë e më shumë, prandaj nuk është perceptim, sepse po ma kujton thënien e Presidentit kur përherë e kishte në sfond diskutimin për korrupsionin, ai i referohej si perceptim. Hyni nëpër administratat komunale në komuna të ndryshme, aty do ta shihni korrupsionin në bazë të drejtpërdrejtë. Shkoni në inspektorate të komunave të ndryshme të Kosovës, aty do ta shihni korrupsionin drejtpërdrejt. Kudo ku ka institucione të Republikës së Kosovës, e që janë në shërbim të qytetarëve, do ta shihni korrupsionin drejtpërdrejt.

Prandaj, sigurisht inkurajoj edhe qytetarët në përgjithësi që ta lajmërojnë korrupsionin dhe se nuk mund të themi që korrupsioni është konceptim e perceptim, por është një dukuri negative, është realitet, me të cilin ne si qytetarë të Republikës së Kosovës përballemi çdo ditë dhe vazhdimisht. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Për replikë, fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, e nderuar!

I nderuar deputet Rexha,

Unë e thashë dhe po e them prapë që ne duhet të kemi prioritete si shtet, Qeveria ka agjendë evropiane. Ju i keni ndërruar metodat, ne jemi për interpelanca, jemi për t'u dënuar të gjithë ata që në këtë vend i kanë shkelur ligjet e Kosovës dhe atë e kryejnë, janë organet dhe pushtetet, besoj që edhe ti e di që këto janë të ndara, i kemi pushtetet e ndara kush ka për t'i dënuar, kush ka për t'i bërë ligjet, por prioritet do ta kemi agjendën evropiane, prioritet do t'i kemi ligjet që e rregullojnë jetën e këtyre qytetarëve. Andaj, do t'i kryejmë edhe këto interpelanca, të mos humbim kohë, se në mandatin e kaluar na e keni humbur kohën me gaz lotsjellës, na e keni humbur kohën me sjellje të pahijshme, nga të cilat krejt lajmet kryesore në botë e kanë nxjerrë Kosovën që nuk është e përgatitur që ta menaxhojë shtetin falë angazhimit tuaj.

Andaj, nuk është mirë të na ktheni në të kaluarën, se e dimë çka keni bërë ju. Ju keni qenë po më duket zyrtar edhe në komunë, atëherë po flet për perceptim dhe konceptim. Për shembull, jahti a ka qenë perceptim për ty, a ka qenë konceptim? Për shembull, aferat e fundit që dolën me prona publike, “prontot” e fundit që po i quajmë, a qysh të doni i quajmë, a janë perceptim a konceptim? Këto janë ashiqare vepra penale, andaj ne jemi për atë që të gjithë ata që e shkelin ligjin në këtë vend, a janë PDK, a janë Vetëvendosje, a në çfarë partie të jenë, ata duhet të përgjigjen në harmonizim me ligjet, të cilat i shkelin. Por, nuk është mirë që këtu vetëm hajt të flasim, të humbim kohë, apo t'i citoni deputetët tjerë çka po thonë. Jemi të gatshëm që të punojmë 24 orë, shtatë ditë në javë, veç t'i kryejmë edhe këto interpelanca tuaja, por jo interpelanca me rekomandime, po ta përsëris “fontanë dëshirash”, se nuk bëhet zhvillimi ekonomik me një rekomandim, nuk bëhet bashkimi kombëtar me një rekomandim. Ne duhet që të interesohemi dhe të angazhohemi. Ne kemi Kushtetutë, e kemi të përcaktuar në Kushtetutë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Faleminderit! Për kundër-replikë, fjalën e ka Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Unë e kam shumë të qartë që Partia Demokratike e Kosovës përherë mundohet që siç është vetë t'i bëjë edhe partitë tjera bashkë dhe konceptimin e korrupsionit e të kriminalitetit në vend ta shpërndajë edhe në Vetëvendosje, gjë që nuk është kështu, sepse subjekti më i pastër dhe më

konsistent përherë e në vazhdimësi ka qenë Lëvizja Vetëvendosje, e sa u përket rekomandimeve si “fontanë dëshirash”, një gjë mund të jua them, se po qe se ju e dëgjoni Vetëvendosjen dhe i shtyni këto rekomandime përpara, sigurisht që ne kësaj keqqueverisje do t’ia shtojmë vizionin nëpërmjet rekomandimeve tona, sepse opozita nuk ka rrugë tjetër çfarë realisht do të bëjë.

Sa i përket gazit lotsjellës, besoj që ka qenë i shëndetshëm, sepse i ka hapur sytë në atë kohë për humbjen e 8 200 hektarëve tokë, ndërsa së fundmi nuk mundi t’jua hapë, sepse ato ia dhatë Malit të Zi.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! A ta ka përmend emrin, Bekim? Kemi përfunduar edhe me këtë pikë të rendit të ditës.

Shkojmë në pauzë deri në orën 15:30. Faleminderit!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

**KRYESUESI:** Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë!

Po vazhdojmë me pikën e 19 të rendit të ditës që është,

### **19. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017**

Besoj që gjatë shqyrtimit të këtyre dy raporteve sa janë deri në pikën e 20-të, do ta kemi kuorumin për t’i votuar ligjet që i kemi kaluar në lexim të parë.

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, zonjën Sala Berisha-Shala,... s’qenka këtu hiç, për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit të komisionit.

Nuk është! Zoti Lumir Abdixhiku nuk është! Atëherë, e kalojmë derisa të vijnë këta nëse duan të thonë diçka.



## **20. Shqyrtimi i raportit vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017**

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është, kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike nuk është, Nait Hasani! Dhe, mua më mbetet që ta anuloj si pikë të rendit të ditës këtë dhe tjetrën për seancën tjetër të radhës.

## **21. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017**

Lumiri, a vjen? Zoti Hoti, a dëshironi diçka? Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

E gjithë seanca sot prej mëngjesit ka vazhduar pa kuorum. Paradite ishin disa deputetë, aty-këtu ndonjë ministër, tash po e fillojmë prapë seancën pa kuorum, por ajo që është shqetësuese dhe ministrat përkatës, edhe raportuesit, kryetarët e komisioneve përkatëse që i kanë pikat e rendit të ditës nuk janë të pranishëm. Unë mendoj që seanca nuk duhet që të vazhdojë kështu. Ju jeni kryesues, ju e keni të drejtën të vazhdoni ose jo, por unë mendoj që kjo nuk është serioze kështu, gjithë ky Kuvend me 120 deputetë, personat që janë përgjegjës për të raportuar këtu para deputetëve sipas agjendës që e kanë marrë nuk janë këtu dhe besoj që nuk ka kuptim të vazhdojmë kështu.

Është mirë që seanca të ndërpritet dhe të mblidhet Kryesia e ta shohë këtë punë me seriozitet, ose ta lëmë këtë punë, të mblidhemi ta shpërndajmë Kuvendin, sepse s'ka kuptim kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Avdullah! Unë u mundova që t'ua tërheq vërejtjen me mëditje, se s'di qysh t'u them ndryshe. E s'lodhet kush për atë mëditje, por edhe aty pati reagime. Dikush thotë pse s'po vijnë, dikush pse s'po dënohen, unë nuk di çka të bëj, ta them të drejtën. Pse është mirë, sepse të paktën se ne kemi prapë këto për t'i kaluar, prapë na duhet të vijmë dhe të ulemi në këto ulëse të Parlamentit për t'i kaluar të njëjtat raporte, të njëjtat ligje. Unë nuk po e kuptoj pse deputetët nuk duhet të vijnë për t'i miratuar! Në qoftë se ka një qëndrim politik, atëherë le të thuhet që "s'po duam të vijmë për ta bërë kuorumin" qysh është thënë shumë herë, por edhe Qeveria, meqenëse s'po vjen, prapë është në rregull.

Unë jam dakord, nuk kam kurrgjë kundër nga ajo që po e thua. Po besoj që ndoshta vijnë, i presim edhe pak, në mos ardhshin vendosim edhe ta mbyllin seancën, pse jo? Qysh të doni. Po në pauzë ishim deri tash, Avdullah!

Zoti Mikullovc i ka kërkuar fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë i bashkëngjitëm propozimit që e dha zoti Avdullah Hoti, mendoj që punën e Kuvendit duhet ta bëjmë çështje. Kështu nuk punohet, dje e sot ne po punojmë me 20, 30, 50 deputetë, ndërsa jemi 120. Të thirren kryetarët e partive, të thirren kryetarët e grupeve parlamentare, të mblidhet Kryesia e Kuvendit dhe të vendosni, o të shpërndahemi, o të punojmë. Kjo vërtet s'ka kuptim. Ne këto materiale i dëgjuam, i kalojmë, por prapë duhet t'i kalojmë edhe një herë krejt prej fillimit. Kjo është humbje kohe, mor vëlla!

KRYESUESI: O Adem, nuk është Jovanoviçi kryetar më. Nuk mund ashtu! Ademi e ka fjalën!

ADEM MIKULLOVCI: Ndoshta unë jam nostalgjik për kohën e monizmit, veç për besë po më vjen ta them "ku është ajo kohë"! Veç kaq po them.

KRYESUESI: Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën!

BILALL SHERIFI: Kryesues, faleminderit!

Po të them kështu, pasi Samiu s'po i thotë Kadriut kryetar, e po të them unë ty, na janë ngatërruar krejt. Ne jse hajgaren anash.

Unë mendoj që për në orën 15:30 e lamë që të votojmë, dhe nëse nuk votohet duhet të vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës, nëse ka interesim dhe të shteren debatet. Nëse jo, atëherë nëse nuk kemi kuorum për të hyrë në votim, atëherë le t'i lëmë sërish deputetët e lirë kush do të qëndrojë, kush do le të ecën, le t'i shohin punët e veta. Unë erdha për të votuar, se edhe unë kam çfarë të bëj për të mos qenë këtu. Nuk është që pse rri këtu, nuk kam tjetër gjë çfarë të bëjë. Kështu që merre një vendim, je kryesues i seancës, ose e vazhdojmë punën, ose ndërprite seancën, ose le të vazhdojmë siç e kemi bërë gjatë tërë ditës veç me shqyrtime dhe në fund e kemi shtyrë për votim për një herë tjetër.

KRYESUESI: Atëherë, unë ju falënderoj të gjithëve që jeni këtu. Kemi kuorum prej 61 vetave. Ju lus që t'i zini vendet dhe të fillojmë votimin.

Milaim, e kemi kryer, s'kemi hapur debat për kurrjë.

Pika e gjashtë e rendit të ditës, që ka mbetur pa u votuar, është:

## ***6. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit penal të Republikës së Kosovës***

Ju lus që t'i zini vendet dhe të votoni për, ose kundër, është çështje e juaja.

Diskutimet kanë përfunduar në seance të mbajtur më 5 qershor 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, nuk është proceduar në votim. Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projekt-kodit penal. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Dëshironi ta përsërisim apo po saboton dikush, a s'po doni të votoni, se s'po di...? Atëherë, edhe një herë e përsërisim. Ju lus, nëse dikujt s'i punon kartela apo nëse dikush s'ka kartelë, le të lajmërohet.

Kemi 64 deputetë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Në rregull, unë kisha kërkuar nga shefat e grupeve parlamentare, në qoftë se dikush nuk është dakord që të votohet ligji, të deklarohen për cilin ligj nuk janë dakord, por të votohet për ose kundër, se kështu s'ka kuptim. Prapë do të vijnë këtu të ulen. Regjia, na e sillni listën e votuesve, ta shohim kush s'po voton. Bravo!

Jepja Ilir Dedës fjalën, se po më thotë diçka e s'po e marr vesh.

**ILIR DEDA:** Faleminderit!

Kryesues, është me rëndësi me ju tregua deputetëve, që kalimi në lexim të parë i Kodit Penal ka të bëjë me liberalizim të vizave, është me rëndësi. Tash, në qoftë se njerëzit nuk po duan ta votojnë, unë të kisha lutur t'i thërrasësh shefat e grupeve parlamentare, shikoni çka ka mosmarrëveshje. Ne nuk mundemi tash për shkak të... se është irelevante prë të mos votuar tash. Ne duhet ta kryejmë këtë obligim. S'mundet krejt agjenda e këtij shteti të mbetet e bllokuar pse shtatë-tetë vetë s'po duan të votojnë.

*(Ndërprerje e incizimit)*

**KRYESUESI:** Unë lus administratën që të gjitha kartelat e deputetëve që nuk janë të pranishëm në sallë, të hiqen nga ato vendet e votimit. Çdo deputet që nuk është në sallë t'i hiqet kartela. Kemi 86 kartela të vendosura dhe po votojnë 55 deputetë.

Atëherë, po hyjmë edhe një herë në votim. Ju lus për prezencë të votoni. Ata që s'janë të pranishëm do të propozoj masat që ju kam thënë më herët. Ju lus që të votojmë për prezencë. Votojmë tash! Atëherë, po fillojmë edhe një herë po futemi në votim. Regjia i ka rregulluar çështjen e prezencës. Votojmë edhe një herë shqyrtimin e parë të Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 62 deputetë. 58 janë për. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projekt-kodin Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projekt-kodin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

### ***7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare***

Diskutimi është kryer. Ka mbetur vetëm votimi. Votojmë tani! A ka dikush tjetër pa kartelë? Edhe një herë e përsërisim, pra.

Edhe një herë e përsërisim votimin. Votojmë tani!

Duhet me qenë 61 vota, me votua kundër më shumë se gjysma, atëherë s'kalon, po kështu... as nuk kalon, as kalon. Mbetet pezull dhe duhet me e përsëritë prapë votimin. Kjo është ajo që mund ta them.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë, kanë votuar 63 deputetë. 56 vota janë për, 2 vota kundër, 5 abstenime. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-072 për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

### ***8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor***

Diskutimet kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Në sallë kemi 76 deputetë.

Faleminderit! Kanë votuar 61 deputetë. 54 vota janë për, 7 kundër, asnjë abstenim. Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

***9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme***

Diskutimet kanë përfunduar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 64 deputetë. 57 vota janë për, 6 kundër, 1 abstenim. Konstatohet që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-133 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

***10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor***

Diskutimet kanë përfunduar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit!

Kanë votuar 65 deputetë. 50 janë për, 15 kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

***11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferë***

Diskutimet kanë përfunduar.

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit!

Kanë votuar 66 deputetë. 53 deputetë janë për, 13 kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-066 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

***12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120***

Diskutimet kanë përfunduar. Ka mbetur vetëm votimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Ju lus për vëmendje! Faleminderit!

Kanë votuar 63 deputetë. 50 vota janë për, 13 kundër. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

***13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës***

Diskutimet kanë përfunduar.

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 66 deputetë. Për janë 52 vota, kundër 14, kanë abstenuar 0 vota. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-067 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### ***15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komplexin Memorial “Adem Jashari”***

Diskutimet kanë përfunduar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 75 deputetë. 75 vota janë për. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-059 për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### ***17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare***

Diskutimet kanë përfunduar.

Votojmë raportin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 76 deputetë. Për janë 71, 2 janë kundër, 4 abstenime. Konstatohet që Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

#### ***18. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017***

Diskutimet kanë përfunduar.

Votojmë raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017. Votojmë tani!

Kanë votuar 76 deputetë. Për janë 59,11 kundër, 6 abstenime. Konstatohet që Kuvendi miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017.

Tani, të nderuar zonja dhe zotërinj,

Unë kisha propozuar që të paktën t'i kalojmë sa të kemi mundësi këto, me qëllim që ta përfundojmë sonte këtë seancë edhe të na mbetet nesër të pushojmë. Edhe të premtën kemi seancën tjetër me ato interpelancat me kryeministrin.

Në qoftë se jeni dakord, unë po vazhdoj, në qoftë se nuk jeni dakord...

E kemi edhe një gabim, që m'i kanë sjellë. Kërkoj falje nga të gjithë ju, është një, ta quaj, moskujdes imi më shumë sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, ka ngelur pa u votuar.

Propozimi i rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimin e Qeverisë numër 02/34 të datës 5. 3. 2018.

A duhet propozuar rezolutën zonja Mimoza Kusari, apo e kemi kryer? Atëherë, veç e votojmë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, rezoluta është harmonizuar me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Votojmë tani!

Edhe një herë po e përsëris, nejse, kjo u miratua. Kanë votuar 68 deputetë, për janë 58 vota, kundër janë 8 dhe 2 abstenime. Konstatoj se Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, harmonizuar me grupet e tjera parlamentare.

Unë e lexova në fillim. E ke mikrofonin, fol!

A po do të përsëritet votimi? Në rregull, e përsëris.

Bëhet fjalë për votimin e propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 02/34 të datës 05.03.2018. Kjo është, më shumë nuk kam tekst, nuk e di qysh jeni marrë vesh si grupe parlamentare. Diskutimet i keni pasur, ka mbetur të harmonizohet, këta po thonë që është harmonizuar, unë e hedh në votim, votojmë tani:

Kanë votuar 73 deputetë, për janë 57 vota, kundër janë 16 vota, asnjë nuk ka abstenuar. Konstatoj që Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të harmonizuar me grupet e tjera parlamentare.

## **19. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.



E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, a është Sala këtu apo e ka lënë dikë, nuk është, zoti Abdixhiku, as ai nuk është.

Atëherë fjalën e ka zoti Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj të vitit 2018 e shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2017 të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

#### R e k o m a n d i m

Të miratohet raporti vjetor i punës i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017.

Arsyetimin me raportin e keni para jush dhe besoj që duhet të kalojë si vlerësim i komisionit.

Nëse më lejohet, edhe në emër të grupit kisha folur.

KRYESUESI: Vazhdo, në emër të grupit.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, në fakt, duhet të jetë një prej autoriteteve kryesore që sigurohet që në një rregullim ekonomik çfarë e kemi ne, një ekonomi të tregut, ashtu qysh është e përcaktuar edhe me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, të kuptojë që ekonomia nuk fillon e mbaron vetëm te konsumatori, por është i gjithë zinxhiri i vlerës në ekonomi, i cili duhet të trajtohet.

Në bazë të raportit që na është paraqitur neve, të gjitha gjetjet kanë të bëjnë me konsumatorin e fundit dhe ankesa te shitja me pakicë. Por, në sistemin tonë ekonomik ka edhe agjentë të tjerë apo aktorë të tjerë ekonomikë, në të cilët tema e konkurrencës nuk trajtohet apo nuk shikohet fare. Dhe, besoj shumë që autoriteti i konkurrencës duhet të merret edhe me këto relacione ekonomike, pra relacionin që e kanë prodhuesit me blerës, relacionin që e kanë shitësit me shumicë me shitësit me pakicë dhe relacione të tjera, të cilat janë në zinxhirë të vlerës.

Është tepër me rëndësi që edhe këto interaksione ekonomike, edhe këto ndërveprime ekonomike të trajtohen nga Autoriteti i Konkurrencës.

Dhe, në anën tjetër, të mos humbim energji dhe kohë duke trajtuar temën sikurse këtu që i shihni në raport që është trajtuar tema e floktarëve apo berberëve në një komunë si temë konkurrence.

Pra, kemi situata shumë më të ndërlikuar e shumë më të rëndësishme ekonomike, siç janë themi prodhuesit dhe relacioni që e kanë prodhuesit me blerësit me shumicë dhe prodhuesit vendorë karshi prodhuesve të tjerë që importojnë mallra.

Mendoj që edhe këto në këtë nivel ka kuptim dhe duhet Autoriteti i Konkurrencës të involvohet dhe t'i trajtojë edhe këto tema.

Në anën tjetër, gjithashtu mendoj që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në raportin e tij është munduar të paraqesë një përshkrim të punëve që i ka bërë, më shumë se, të themi, sfidat reale që janë në sferën e konkurrencës në interaksionin ekonomik që ndodh në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht ne si grup parlamentar do të abstenojmë nga përkrahja e këtij raporti, meqë mendojmë se trajton vetëm një aspekt të konkurrencës dhe trajton vetëm sipërfaqësisht temat e konkurrencës në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kryetari i komisionit, Abdixhiku, nuk e ka autorizuar askënd, zonja Safete Hadergjona në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

**SAFETE HADERGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Raporti i plotëson të gjitha kushtet, të cilat janë paraparë me ligj për të raportuar.

Ne si Komision për Buxhet dhe Financa e kemi përkrahur këtë raport dhe kërkojmë nga Kuvendi që të përkrahët. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të grupit parlamentar, zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje raportin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Ne po besoj se si Kuvend para së gjithash duhet të diskutojmë për sfidat me të cilat sot përballen disa agjenci të pavarura. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës shpeshherë përfundon duke u marrë me punë, të cilat duken të vogla, në dukje, siç e tha më herët edhe kolegu Sejdiu, mirëpo kjo është pikërisht për faktin se vendimet dhe vërejtjet e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nuk zbatohen nga institucione të tjera.

Shembull po marr, edhe pse nuk është pjesë e këtij raporti, reagimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës lidhur me Udhëzimin administrativ 02/2018 të Ministrisë së Infrastrukturës, i cili ka të bëjë me homologimin, siç e kemi potencuar edhe më parë, i cili i zgjat në pafundësi operatorit aktual monopoli në fushën e homologimit dhe nuk është marrë fare parasysh nga Ministria e Infrastrukturës. Komentet dhe vërejtjet kanë qenë shumë substanciale, janë dhënë gjatë draftimit të Udhëzimit administrativ, por Ministria e Infrastrukturës, përkundër vërejtjeve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, e nënshkruan një Udhëzim të tillë administrim, i cili sot është në fuqi dhe është kundërkushtetues.

Ka edhe raste të tjera kur vendimet e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nuk zbatohen, mirëpo megjithatë, brenda kapaciteteve të kufizuara që ka, ne konsiderojmë që ai autoritet po bën një punë të mirë.

Unë mund të përmend në Raportin e fundit të vendit të Komisionit Evropian është një ndër dy agjencitë, e cila ka shënuar progres dhe gjithashtu një meritë të madhe ka në fitimin e një projekti me IPA fondet, i cili është projekt prej një milion e gjysmë për forcimin e kapaciteteve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Unë konsideroj që nëse ne si Kuvend e shohim të nevojshme që këto institucione duhet të ekzistojnë edhe më tutje, duhet t'i fuqizojmë dhe duhet, në fakt, t'i thërrasim institucionet, të cilat nuk po i zbatojnë vendimet e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Konsiderojmë që raporti i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas rregullave dhe procedurave dhe gjithashtu e çmojmë, siç thashë, punën e tyre që kanë bërë brenda kapaciteteve të kufizuara dhe kërkojmë përkrahjen për një raport të tillë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në aspektin formal e teknik natyrisht që ky raport i plotëson kushtet siç i plotësojnë edhe raportet e tjera.

Mirëpo vërejtja themelore është se në Kosovë kemi monopole të jashtëzakonshme të agjencive të ndryshme, organizatave të ndryshme, të cilat nuk janë luftuar dhe ende ekzistojnë.

Ne kishim para 2-3 ditësh diskutimin në lidhje me Kartonin e gjelbër dhe shoqatat e sigurimeve. Aty kemi një monopol të qartë, edhe ky monopol është dëshmuar nëpërmjet shifrave të ndryshme, dëshmime që nuk mund të kundërshtohen dhe ne nuk kemi asnjë moment të kësaj

agjencie që të ketë ndërhyrë ose të ketë hetuar monopole të tilla. Ky është njëri nga monopolet, ne kemi edhe monopole të tjera që nuk janë luftuar.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e voton kundër këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Sami! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Para se të shpreh mbështetjen e Grupit Parlamentar Nisma për këtë ligj, desha të bëj një informacion për kolegun tim, Kurteshi. Besoj që është me vlerë, e ai le ta gjykojë vetë.

Kjo agjenci, i nderuar, ka bërë shumë vërejtje, shumë sugjerime, po ministria s'ia ka marrë fare për bazë. Kështu që ne, për hir të proceseve nëpër të cilat po kalojmë duhet t'i kalojmë ligjet, jo t'i bllokojmë. Por Agjencia e Konkurrencës ka bërë disa herë vërejtje, madje, në qoftë se dëshironi, se ju Vetëvendosja nganjëherë nuk po flisni me emra, po unë po e përmend vetëm një rast për t'ju bindur që kanë bërë vërejtje.

Kjo agjenci e ka shpallur si të jashtëligjshëm ose kundër ligjit Qendrën për homologimin e makinave dhe askush nuk ia ka marrë për bazë. Këto agjenci në Kosovë janë minishtete brenda shtetit.

Çdo agjenci e pavarur është minishtet brenda shtetit të Kosovës. Nganjëherë kur dalin jashtë terezisë, se rrogat i kanë shumë të mëdha, janë bosa, pagesat e mira, domethënë Trusti Pensional pse ta prishë terezinë e vet kur e ka rrogën 6500 euro. Krejt këta bosa e kanë rrogën dyfishin e çdo deputetit të Parlamentit të Kosovës.

Prandaj, nuk janë ata budallenj sikur unë të flasim kështu trup e të kenë konflikt edhe brenda familjes. Mua shpeshherë edhe gruaja më kritikon kur shkoj te shtëpia, thotë: “Çka hamami po fol ti, a mos je kah ndreq diçka, veç po fol dhe kurrgjë”.

Kështu që problemi këtu është, nuk është problemi që këta nuk kanë dhënë rekomandime, kanë dhënë shumë rekomandime, po askush s'po ua vë veshin, sepse po vazhdojnë me avazin e vjetër.

Prandaj, i nderuar Kurteshi, unë pajtohem me vërejtjet tua, në pika të përgjithshme, po ne e mbështesim në emër të Nismës. Unë personalisht nuk e kisha mbështetur, po qëndrimi i Grupit Nisma është për ta mbështetur.

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është lajmëruar zoti Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Nuk është replikë. Mendoj se zoti Zeka nuk e pati parasysh që kemi të bëjmë me raportin vjetor, jo me ligjin, po ne jse kjo është një çështje tjetër.

Unë mendoj se ne nuk kemi mospajtime të mëdha, nuk janë ato mospajtime të mëdha. Një agjenci e ka për detyrë të bëjë zhurmë, unë po them që ende nuk është luftuar monopoli i shoqatave të sigurimeve, edhe ne kemi sigurime të mëdha në forma të ndryshme, edhe kurrë nuk janë hetuar asnjëherë.

Përndryshe, çdo agjenci së paku e ka derën të hapur te grupet e ndryshme parlamentare, por edhe në komisione.

Nuk e di, pajtohem plotësisht që askush nuk i merr parasysh këto. Edhe vërejtja për homologimin ka ardhur shumë vonë, qysh e di ti, po është e mirë, më mirë vonë se kurrë. Mirëpo ne kemi një varg monopolesh të tjera në Kosovë që, megjithatë, nuk luftohet dhe kjo është arseja që ne nuk mund t'i mbyllim sytë para kësaj. Ata e kanë derën hapur, nëse jo te Qeveria, në komisione të ndryshme dhe në grupe parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Zeka.

MILAIM ZEKA: Sami, kërkoj falje për atë lapsusin që e bëra, se është fjala për raportin. Po veç si plotësim, zoti kryetar, ne sot kemi pasur disa herë debate këtu, e nuk po i mëshojmë asaj tabelës qitëse kryesore, krejt problemet që po na vijnë në seancë, që e tha edhe zoti Avdullah Hoti këtu me shumë të drejtë, po na vijnë si rezultat se ne nuk po arrijmë si deputetë të Parlamentit të Kosovës ta ndryshojmë Rregulloren që e kemi nga viti 2010. Ne të gjithë flasim, e kur të vijë puna te ndryshimi, ja i heqim kartelat, ja dalim jashtë, hajgare bëjmë.

Pse të flasim ne, kur mund ta rregullojmë nëpërmjet Rregullores së Parlamentit disiplinën brenda, kush nuk voton t'i hiqet mëditja, kush nuk është i pranishëm në sallë, e tjera, e tjera.

Prandaj, zoti Kurteshi, jam plotësisht në dakordim, veç kërkoj falje për lapsusin që e bëra, në vend të ligjit, domethënë është fjala për raport.

KRYESUESI: Jo për këtë punë Rregullorja është në rregull, edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese po u zbatua, është në rregull. Po ne kur nuk duam t'i zbatojmë, nuk duam, çka të bëjmë.

Zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Unë vetëm një fjalë.

Ju lus që si kryesues ta respektojme gjuhën parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dakord jam. Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,

Kolegë të nderuar,

Po flasim për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, duhet theksuar fillimisht që është një institucion që edhe pse ekziston një kohë të gjatë, vetëm me këtë komisionin e fundit ka filluar të funksionalizohet, në fakt të realizojë objektivat që i ka.

Në kontekst ose në sferën e konkurrencës në ekonomi të tregut ose në ekonomi të tregut të lirë rregullat e konkurrencës zbatohen në tri shtylla, njëra prej tyre është administrative, që e luan rolin kryesor Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Mirëpo janë edhe dy shtylla të tjera, është aspekti civil, ku palët paditen ndërmjet veti. Po fatkeqësisht çka ka ndodhur është që gjykatat me disa vendime e kanë hequr barrën prej vetit dhe e kanë transferuar tek Autoriteti dhe, është shtylla e tretë, aspekti penal, që në fakt nuk realizohet fare te ne. Kështu që i vetmi në këtë betejë që ka mbetur është Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe, në fakt, edhe në Raportin e fundit të progresit ka qenë një prej pak pikave të shpresës sa i përket progresit në Kosovë që është përmendur në natyrë pak më pozitive.

Kushdo që e ka përcjellë punën e tyre, e ka vënë re që, edhe pse sfidohen jashtëzakonisht shumë, edhe me mungesë të buxhetit, stafit, e të tjera, që është jashtëzakonisht i nevojshëm në këtë agjenci që rregullon një sferë tepër të ndërlikuar, nuk e kanë këtë, po ata po mundohen me ato vegla të punës që i kanë ta bëjnë më së miri punën e tyre.

Dhe unë besoj që kjo ka reflektuar në disa prej vendimeve të tyre, natyrisht edhe raporti i tregon jo vetëm aspektet dhe punën e tyre, po i tregon edhe sfidat që i kanë.

Unë mund të them që ne si Parlament duhet siguruar që shumë prej problemeve që u përmendën nga parafolësit për t'u adresuar nga kjo agjenci, ne duhet t'i japim mbështetje më të madhe buxhetore që ta pajisim atë edhe me burimet financiare, edhe njerëzore që i nevojiten për të analizuar tregun, për t'i vënë re edhe marrëveshjet e jashtëligjshme, edhe veprimet si kartel, eventualisht nëse diku ka edhe ndonjë monopol, që edhe ato të zërthehen, me ç'rast krijohet një treg i lirë dhe konkurrent që përfundimisht përfiton konsumatori dhe qytetari.

Unë e përkrah këtë raport, natyrisht kërkoj edhe mbështetjen për këtë agjenci, e përgëzoj për punën që ka bërë në funksionalizim, por njëherësh bëj edhe thirrje që të bëhet zbatimi i konkurrencës në tri shtyllat, e jo vetëm të pritet nga kjo agjenci të rregullojë tërë tregun, sepse

është thjesht e pamundur, siç është e pamundur edhe në Bashkimin Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për këtë arsye ekzistojnë edhe këto dy shtylla të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që është një agjenci e rëndësishme, nëse funksionon si duhet.

U përmend më herët që ka shumë agjenci, të cilat vërtet ndihen si pashallarë apo si shtet brenda shtetit këtu në Kosovë.

Besoj që gradualisht me trajtimin tonë të ligjeve, do t'i ndryshojmë. U përmend edhe më herët homologimi. Homologimi është duke e ndëshkuar qytetarin e Republikës së Kosovës, për arsye se nëse blihet një makinë e re, do të thotë vitin e parë minimumin duhet të jetë e liruar nga homologimi dhe ajo nuk po ndodh, edhe pse e ka prodhuar një makinë Gjermania apo dikush tjetër, duhet t'i nënshtrohet homologimit që është e padrejtë.

Prandaj, unë shpresoj që kjo do të vazhdojë punën dhe ne natyrisht që do ta përkrahim dhe do t'i urojmë punë të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konsideroj që debati është kryer.

Do ta votojmë raportin vjetor të Autoriteti Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017.

Lus regjinë dhe juve deputetë që t'i zini vendet dhe të votoni. Kjo kërkesë u bëhet edhe zotit Milaim Zeka, edhe Sashës.

Votojmë tani:

Kanë votuar 68 deputetë, 54 deputetë janë për, 11 kundër dhe 3 abstenime. Konstatohet që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017.

## ***20. Shqyrtimi i raportit vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017***

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka shqyrtuar raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësuesin e Qeverisë duhet ftuar, por s'qenka këtu, kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Media, zotin Nait Hasani e zëvendëson zonja Pantina, e cila do ta bëjë raportimin. Zonja Pantina, e keni fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2018, e shqyrtoi raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin që të miratohet raporti vjetor i statistikave zyrtare për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Imet Rrahmani e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe ka qëndrimin e njëjtë me qëndrimin e përfaqësuesve të vet në Komisionin Funkcional për Administratë, Qeverisje Lokale dhe Medie.

Nga raporti vërehet se viteve të fundit, edhe sistemi i statistikave zyrtare të Kosovës ka arritur përparime të dukshme në përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Ligji për statistikën zyrtare. Gjithashtu, vërehet se Agjencia e Statistikave si rezultat i një angazhimi konkret dhe përkrahjes nga Qeveria në vitet e kaluara ka arritur që vitin 2017 ta përmbyllë me shumë të arritura. Si rezultat i përkrahjes së atëhershme me pozita të reja dhe me buxhet shtesë dhe si rezultat i një riorganizimi të brendshëm më të mirë, plani i punës është realizuar në tërësi. Produktet statistikore tani janë shumë më gjithëpërfshirëse në kuptimin e fushave të mbuluara, më të besueshme dhe më reale në kuptimin kohor dhe janë më lehtë të qasshme edhe nga shfrytëzuesit e brendshëm dhe ata të jashtëm. E vlerësojmë angazhimin në përmbushjen e kritereve që sistemi i statistikave të Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës të jenë partnerë të barabartë në Eurostat dhe i vlerësojmë gjithashtu dhe të gjitha aktivitetet në proceset euro integruese.

Gjithashtu, grupi ynë mendon se nuk është mirë që Këshilli i Statistikave të Kosovës ka shumë kohë që është pa mandat, e gjithashtu mendojmë se ngecja në mbledhjen e të dhënave statistikore në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe sportit, karshi fushave tjera, nuk mund të përmirësohet me buxhetin aktual që e ka Agjencia e Statistikave të Kosovës. Për fund, dua të theksoj se Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah në parim raportin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Izmaku!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë së Statistikave për vitin 2017 dhe e ka këtë vlerësim. Pra, duke u bazuar në Ligjin ekzistues për statistikën zyrtare, bartësi kryesor i statistikave zyrtare në vendin tonë është Agjencia e Statistikave. Raporti i paraqitur nga ASK, i bazuar në zhvillimet e aktiviteteve të fundit, në sistemin statistikor të Kosovës paraqet një



zhvillim të dukshëm, vlerësim ky që është pranuar dhe vlerësuar edhe nga Eurostat, pra si institucion qendror për statistika zyrtare në BE.

Viti 2017 e ka një ngritje në performansën e Agjencisë, duke filluar pra nga aspekti i provimeve statistikore, ashtu edhe në praninë në nivel ndërkombëtar të ASK-së. ASK e ka realizuar në tërësi planin vjetor të punës për vitin 2017, ku si vazhdimësi e vitit të mëparshëm e ka zgjeruar sferën e provimeve statistikore për nevojat e përdoruesve. Vlerësimi ndërkombëtar në vitin 2017 nga ekipi i ekspertëve të angazhuar nga Eurostat, i quajtur “Peer review” është një e arritur shumë e madhe për sistemin statistikor, pra e ka një vlerësim shumë pozitiv. ASK e ka ngritur bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, siç është: Eurostat, UNDP, UNICEF, Banka Botërore, FMN e të tjerë. Sa i përket teknologjisë informative, është bërë një avancim duke e lansuar ueb-faqen e re të ASK-së në platformën “.net”, duke rritur sigurinë ndaj sulmeve eventuale kibernetike, si dhe është bërë një zhvillim i hovshëm i platformës online.

ASK ka edhe sfida sigurisht dhe mungesa në punën e vet, duke e zhvilluar aktivitetin në një ndërtesë shumë të vjetër dhe asnjëherë deri tani të rinovuar. Gjithashtu, ka mungesë të theksuar të resurseve për shkaqe të mungesave buxhetore dhe në bazë të informacioneve që kemi si komision, ASK më shumë është përkrahur deri tani nga buxheti dhe donatorë ndërkombëtarë sesa nga institucionet vendimmarrëse. Pra, në këtë drejtim edhe si anëtarë të komisionit ne kemi nevojë që ta japim një kontribut që të forcohet edhe në aspektin e infrastrukturës.

Sigurisht që ne si grup parlamentar e mbështetim punën dhe raportin e Agjencisë për vitin raportues dhe njëkohësisht e inkurajojmë gjithë stafin për punën e mirë duke qenë ambiciozë për zhvillime dhe kualitete të reja. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Kollçaku e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje vlerëson se sa i përket raportit, ky raport është shumë më i kompletuar se raportet e viteve të kaluara, ka shënuar përmirësim të performansës, mirëpo duke e pasur parasysh rëndësinë e madhe të statistikave në fakt për të gjitha planifikimet, mendojmë se te disa shifra nuk ishte dashur sa i përket papunësisë dhe nuk janë në përputhje me ato të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie, sikur që nuk janë edhe në përputhje me të dhënat që disponojmë nga Trusti. Këtu kemi vërejtje.

Ndërsa, sa i përket raportit mbetet që secili deputet ta vlerësojë veçanërisht, prandaj unë personalisht do të abstenoj dhe u mbetet deputetëve tjerë të bëjnë vlerësimin e raportit veç e veç secili anëtar i grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetar!

Duhet e përmendur se Agjencia e Statistikave ka shënuar përmirësim edhe në rritjen e kualitetit të punës së tyre, por edhe në hartimin e raportit, i falënderoj që kanë marrë përsipër vërejtjet e dhëna të viteve të kaluara.

Më vjen keq që askush nga Qeveria nuk është këtu, por është për keqardhje që Agjencia nuk e ka as vëmendjen e duhur, por as mbështetjen nga Qeveria dhe institucionet tjera shtetërore. Një nga shqetësimet që edhe Agjencia vetë e ka ngrehur, por besoj se edhe ne kemi, është fakti që shumë nga institucionet nuk i ofrojnë të dhënat e tyre për Agjencinë e Statistikave. Agjencia nuk i prodhon vetë këto raporte, apo statistikat që i publikon. Ata këto të dhëna duhet t'i marrin nga njësi të ndryshme administrative, e të cilat janë ministri, komuna apo agjenci tjera, që janë kryesisht agjenci dhe organizata shtetërore. Prandaj, Qeveria duhet të jetë më e vëmendshme dhe të bëjë presion te këto institucione që Agjencisë t'i ofrohen të dhënat në kohë, sepse shumë herë kanë pasur vonesa në publikimin e raporteve për shkak se ata vetë nuk kanë arritur t'i grumbullojnë të dhënat e nevojshme.

Në anën tjetër, arsyeja pse ekziston Agjencia është që raportet që ata prodhojnë të jenë të përdorshme në momentin, në kohën kur Qeverisë dhe institucioneve tjera i duhet për të përgatitur plane, strategji, e kështu me radhë. Dhe, po ashtu është për keqardhje se sa pak shfrytëzohen të dhënat dhe raportet që publikon kjo agjenci nga institucionet e ndryshme, duke filluar nga Qeveria, për hartimin e planeve, përfshirë këtu edhe për planifikimin buxhetor për institucione të ndryshme.

Nuk dua ta përsëris, zoti Rrahmani po ashtu e shtroi faktin, shqetësimin se kjo Agjenci për një kohë të gjatë po funksionon pa Këshill dhe edhe këtu vërejtjet duhet t'i shkojnë më shumë Qeverisë sesa vetë Agjencisë, dhe po ashtu, për shkak të buxhetit të kufizuar që ka kjo Agjenci, shumicën e raporteve që i ka prodhuar janë bërë me ndihmën e donatorëve të ndryshëm. Është koha që institucionet tona, Qeveria në veçanti, të ndajë më shumë buxhet dhe në të njëjtën kohë të kërkojë më shumë ndoshta publikim të raporteve edhe nga Agjencia.

Ndërsa, sa i përket vetë Agjencisë së Statistikave, ndonëse raporti nga Eurostat i nxjerr disa të dhëna pozitive, një nga vërejtjet e dhëna në këtë raport është përdorimi i pamjaftueshëm, ose jo në nivel të kënaqshëm i teknologjisë informative, e cila edhe do të ndihmonte më shumë që Agjencia më shpejt dhe më lehtë t'i mbledhë të dhënat e tyre, por edhe të dhënat që ata mbledhin do të jenë më të besueshme, sepse ka raste kur intervistuesit edhe nuk i prezantojnë saktë të dhënat që ata duhet t'i grumbullojnë dhe shpeshherë formularët nuk i plotësojnë me të dhënat e mbledhura nga terreni, por i plotësojnë vetë dhe kjo pastaj bëhet problem, sepse në fund raporti i hartuar mund të mos jetë i saktë dhe të dhënat e prezantuara atje në këto raporte mund të mos

jenë reale, të vërteta dhe, ndonëse siç thashë, Qeveria nuk i shfrytëzon mjaftueshëm ato për planifikime të ndryshme strategjike në rast se do t'i shfrytëzonte, mund edhe të bënte planifikime negative.

Ne do ta mbështetim raportin e statistikave dhe edhe një herë i bëjmë thirrje Qeverisë që t'ia kushtojë edhe vëmendjen e duhur, por edhe mbështetjen e duhur kësaj Agjencie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky raport ka kaluar nëpër të gjitha procedurat aprovuese nga ASK-ja në Qeverinë e Kosovës, pastaj në komisionin përkatës parlamentar dhe tash, pra sot, po diskutohet në seancën e Kuvendit të Kosovës për miratim. Bazuar në raportin vjetor të vitit 2017, Agjencia e Statistikave të Kosovës e ka realizuar planin e vet vjetor në mënyrë të suksesshme dhe e ka treguar një performancë të mirë.

Kjo është vërtetuar edhe në rastin e auditimit apo vlerësimit profesional nga Eurostat. Ky raport, përveç informatave mbi zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme, matjes dhe fuqizimit të kornizës vlerësuese dhe monitoruese, gjithashtu ofron informata për numrin e publikimeve, titujt dhe frekuencat e publikimeve në nivel të ASK-së dhe të fushave sektoriale që janë realizuar gjatë vitit 2017. Në kuadër të procesit të rëndësishëm të integriteteve evropiane, statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës e kanë një rol shumë të rëndësishëm. Pikërisht në bazë të kësaj rëndësie që ka sistemi statistikor i Kosovës, ASK-ja duhet të përkrahët dhe të mbështetet shumë më shumë duke miratuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të statistikave të Kosovës nr. 04/L-036, i cili është në proces të miratimit në Parlamentin e Kosovës.

Po e ripërsëris, ASK-ja duhet përkrahur në aspektin buxhetor, duke ofruar kushte më të mira për stafin e kësaj Agjencie. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i jep përkrahje raportit vjetor të ASK-së. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, fjala për ju!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Edhe shumë mirë që erdhe, e kam së pari një kështu selam për nënkryetarin Xhavit Halitin, po ai tash shkoi, e po më vjen keq që duhet të flas pas shpine.

Ai foli për fjalorin parlamentar, e unë kisha lutur Xhavit Halitin që të premtën të na sjellë me shkrim, se fotokopje kemi të mjaftueshme, një kod se çka duhet të flasim në Parlament, qysh duhet të sillemi, a duhet të rrëshqasim, a s' duhet të rrëshqasim, se ai nganjëherë po rrëshqet. Kështu që edhe një kod për hipokrizinë, që ta shohim se në çfarë mënyre hipokrite sillen disa deputetë të Parlamentit, që shajnë vetë me veti, e çka s' flasin vetë me vete, e të paktën unë kur kam diçka, e them edhe në foltore, edhe këtu nga mikrofoli. Kjo ishte e para.

Jam shumë krenar edhe për fjalorin tim parlamentar, edhe për sjelljen në raport me kolegët, edhe për çdo gjë, kur i shoh do yrnkë të këqij këtu në Parlament.

Tash, sa u përket statistikave, nuk po e zgjas se folën edhe Shqipja, Imeti, Rasimi, unë veç i jap mbështetje kësaj Agjencie të Statistikave dhe e lus Parlamentin e Kosovës edhe Qeverinë që të ndajnë buxhet shtesë, sepse është nga agjencitë më të rëndësishme të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nuk ka deputetë të lajmëruar për diskutim.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe ndonjë deputetë, ju lutem! Kemi edhe me dorë, shtatë deputetë me dorë. A jeni të gjithë për? Të gjithë janë për! 60 në mënyrë elektronike, 55 për. 2 kundër. 10 abstenime. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017.

Para se të vazhdoj me pikat e rendit të ditës, vetëm kisha dashur të di a dëshironi të vazhdojmë edhe këto raporte, janë edhe tri raporte që t'i shqyrtojmë, apo doni që të shkojmë në votime. Vazhdojmë me raporte, a? Veç kisha kërkuar që deputetët të qëndrojnë në sallë derisa t'i përfundojmë këto dy raporte, e tani futemi në proces të votimit të fshehtë përnjëherë. Po shkojmë edhe me një raport, pastaj si të vendosni ju, kryetarë të grupeve parlamentare, vetëm mundësisht thirrini deputetët.

## **21. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017**

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Në emër të Komisionit FunkSIONAL, nuk ka! Në emër të grupeve parlamentare, Naser Osmani në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Raporti është mirë i sistemuar dhe paraqitet në katër pjesë që është lehtë për t'u kuptuar, domethënë që ka të bëjë me raportimin e përgjithshëm si pjesë e parë. Raportimin e autoriteteve konkurruese, raportimin për vetë institucionin dhe raportin financiar, të cilit ia ka përgatitur dhe ia ka paraqitur Komisionit për Buxhet dhe Financa. Nga raporti shihet se për këtë periudhë, domethënë për vitin 2017, janë 10 214 kontrata publike të nënshkruara në një vlerë prej 354 milionë për institucionet qeveritare, 109 milionë për institucionet publike dhe 2 milionë për OJQ-të dhe institucionet e tjera. Pra, gjithsej në një shumë prej 459 milionë e 789 mijë euro, që kap në përgjithësi diku 10,24% të bruto-produktit shoqëror vendor.

400 milionë vlerë e këtyre kontratave janë zhvilluar me procedurë konkurruese, domethënë me procedurën e rregullt, 3 milionë janë proceduar me procedurën e kufizuar dhe pjesa tjetër ka qenë me procedurën e negociuar, që paraqet diku 9,17%, të cilën e kemi vlerësuar si shumë të lartë, prandaj kemi kërkuar dhe kërkojmë si grup parlamentar që të KRPP-ja më shumë të bashkëpunojë sidomos me Ministrinë e Financave dhe që ta avancojë më tutje prokurimin elektronik për të cilin kemi konsideruar që është një procedurë, e cila duhet të gjejë hapësirë më të madhe në prokurim. Sa i përket buxhetit, KRPP-ja ka shpenzuar 81,86% të buxhetit dhe e konsiderojmë si të kënaqshme. Ajo që ka mbetur për neve pak e paqartë, pak e diskutueshme, ka të bëjë me interpretimin e nenit 9.4, që Ministria e Integritetit ka kërkuar që kjo të interpretohet ashtu qysh e parasheh ligji, sepse e interpretuar kështu është në kundërshtim me MSA-në, që ne kemi obligime pasi Kosova është pjesë kontraktuale në këtë relacion. Po ashtu, për këtë nen ka bërë vërejtje edhe Autoriteti i Konkurrencës për të cilin KRPP-ja nuk e ka marrë për bazë, por ka një interpretim të vetin, të cilin konsiderohet që është në kundërshtim me interesat dhe me vetë MSA-në.

Grupi Parlamentar do ta votojë raportin si të tillë, sepse edhe ky raport gjatë prezantimit që ka bërë përfaqësuesi e ka bërë në praninë e auditorëve, të cilët faktikisht edhe e kanë audituar dhe të cilët kanë konsideruar që shpenzimet buxhetore, të paktën pa këtë pjesën tjetër, janë të kënaqshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Safete Hadërgjonaj, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Ne si grup do t'i përkrahim rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ta miratuar raportin e këtij institucioni, pasi raporti është përmbajtjesor, i detajuar dhe përmban të gjitha të dhënat, të cilat i parasheh Ligji për prokurimin publik, përfshirë këtu edhe raportin financiar.

Nga raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik shohim se 87,5% e kontratave të nënshkruara janë me procedurë të hapur, që është procedura më transparente, kurse me procedurë të negociuar janë vetëm 9,17% e kontratave. Totali i aneks kontratave për vitin 2017 është vetëm 0,86%, që domethënë është bërë përmirësim në këtë fushë, për arsye se në të kaluarën ka pasur shumë diskutime që ka shumë aneks kontrata. Meqenëse e kam përcjellë kontinuitetin e raportimit nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, nga viti në vit vërehet se ka përmirësime të dukshme sa i përket fushës së prokurimit. Ne jemi të interesuar që sa më shpejt të vihet në përdorim prokurimi elektronik, sepse çështja e prokurimit ka qenë një çështje shumë e diskutuar dhe duhet bërë hapa pozitivë në mënyrë që t'i hapim mundësi vetes drejt integritetit evropian.

Nga raportimet e kaluara kemi vërejtur se kontratat e negociuara kanë qenë në një vlerë më të lartë, e tash e shohim se janë zvogëluar shumë, kryesisht kontratat që kanë shpenzuar me procedurë të negociuar janë Telekom i Kosovës dhe Korporata Energjetike e Kosovës. Por, edhe në vitin e kaluar këto dy kompani kanë pasur kontrata të negociuara dhe në vitin e kaluar, çka do të thotë që duhet bërë më shumë në këtë drejtim, sepse këto procedura nuk janë shumë të transparente dhe duhet të ecim më shumë në drejtim të transparencës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me sugjerimin që të bëhet më shumë drejt prokurimit, në mënyrë që procedurat të jenë transparente dhe prokurimi të jetë me efikasitet dhe eficiency, në mënyrë që t'i kryejmë obligimet tona në drejtim të plotësimit të kushteve për integrim evropian. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ali Lajçi e ka fjalën, në emër të Grupit.

**ALI LAJÇI:** Po ashtu, ne e kemi shqyrtuar këtë raport në komision, siç u tha. Ka shënuar një progres në vijimësi ky raport në krahasim me vitet e mëparshme në raportim, ka hapur shumë perspektivë në kuptim të një transparence, e cila gjithnjë e më tej shkon në proces, e po ashtu ana kontraktuese është e niveleve e cila i përmbush standardet dhe gjithnjë e më tej është afër realizimit të standardeve, sidomos të përputhshmërisë së standardeve që kërkohen në adaptim të atyre ndërkombëtare të BE-së.

Dhe në këtë mes, mendohet se është pozitive dhe duhet të përkrahet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Frashër Krasniqi, urdhëro!

**FRASHËR KRASNIQI:** Të nderuar deputetë!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovë,

Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017, në 18 faqet e tij të para, filluar prej kornizës ligjore, përshkrimi i institucionit e deri te fushëveprimi që mbulon

institucionin, është pothuajse i panevojshëm, i gjatë. Është një përsëritje vit pas viti dhe më shumë është një përmbledhje për ta rritur kuantitetin e një raporti rreth 80 faqe sesa ndonjë e re, të cilën duhet ta dinë deputetët.

I rekomandoj Komisionit që për këtë pjesë të raportit të bëhet një broshurë, të cilën mund t'ua dorëzojnë çdo vit deputetëve të rinj, por të mos i futin si pjesë të raportit, sepse është krejt e panevojshme. Në vazhdimin e tij, raporti sjell informacione të rëndësishme, edhe pse jo krejt të panjohura. Por, çka na duket neve e rëndësishme për të theksuar është që vlera e përgjithshme e mjeteve që ndahen nga Buxheti i Kosovës, përfshirë këtu edhe mjetet për autostrada, e kam fjalën mjetet që ndahen për tenderë, në vitin 2017 është diku është 641,3 milionë euro, përafërsisht 1/3 e Buxhetit të Kosovës.

Natyrisht që është shumë e rëndësishme që procesi i tenderimit të jetë i përgatitur mirë nga punonjësit profesionistë dhe të rrjedhë pa pengesa. Por, ajo që na bën të jemi skeptikë në punën e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është fakti se me raportin e OSHP-së, që e kemi pikë të rendit të ditës pas kësaj, del që i kemi diku 553 ankesa, prej të cilave 322 janë të shpallura si ankesa të drejta, në të cilat është shkelë ligji përkatës.

Atëherë, si është e mundur që përkundër analizës, rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, rekomandimeve për ndryshime të ligjeve apo pjesëve të tyre nga KRPP-ja prapë kemi një numër kaq të madh të shkeljeve të ligjit me rastin e prokurimit publik.

Dhe e dyta, si është e mundur që këto probleme që shfaqen në prokurimin publik janë të njëjta pothuajse, së paku prej vitit 2014 e këndeje. Në një rast normal, nëse institucionet do të bashkëvepronin në bashkëpunim me njëra tjetrën dhe me Qeverinë, shkeljet që i evidenton vit pas viti Organi i Shqyrtimit të Prokurimit publik e që janë vazhdimisht të njëjta, do të duhej që numri i ankesave pra të ishte më i vogël, ndërsa më i vogël do të ishte edhe numri i ankesave të vlerësuar si të drejta, sepse do të kishim një përmirësim të punës së këtyre institucioneve.

Tani, nga raporti në veçanti nuk e di ku çalon problemi, tek rekomandimet e dobëta apo tek problemi i Qeverisë që nuk e bën implementimin e tyre, por kjo është mirë të sqarohet. Këtë raport të cilin normalisht do ta shqyrtojmë në pikën tjetër, ndërlidhet me raportin e Komisionit Rregullativ, flet për 322 raste të shkeljes së ligjit, gjë që paraqet një numër shumë të madh shkeljesh. Për t'i evidentuar këto KRPP-ja do të duhej së bashku me Qeverinë të kishte punuar ndër vite për t'i eliminuar këto shkelje. Kjo si duket nuk ka ndodhur, prandaj edhe probleme në Prokurimin publik mbesin të njëjta.

Ne ftojmë Qeverinë e Kosovës, që së bashku me KRPP-në dhe OSHP-në t'i bashkërendisin problemet, t'i analizojnë së bashku ato dhe të mundësojnë që 1/3-ta e Buxhetit të Kosovës të shpenzohet konform ligjeve.

Unë besoj shumë, që në 322 rastet e ankesave të operatorëve ekonomikë të shpallura si të drejta nga OSHP-ja ka punë edhe për Prokurorinë, madje edhe për Policinë, për krime të rënda. Nëse të gjitha këto organe që i ceka KRPP-ja, OSHP-ja, Qeveria e Kosovës, Policia dhe Prokuroria nuk e bëjnë mirë punën e tyre, nuk nxjerrin mësim nga dështimet, nuk i ndjekin rastet e mashtrimeve dhe shkeljeve të ligjeve, nuk e përmirësojnë bazën ligjore, atëherë do të kemi vazhdimisht dhe pandërprerë keqpërdorime të parasë publike.

Prandaj, ne si deputetë të Partisë Socialdemokrate besoj se së paku do të abstenojmë në këtë raport të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Blerim Kuçi, urdhëro!

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit, kryetar!

E para, ky raport ka disa elemente pozitive, por ato që duhet cekur janë se auditori gjeneral, ose Zyra e Auditorit Gjeneral ka dhënë opinion të pamodifikuar këtij institucioni. Kjo është e mirë dhe është shumë pozitive, se është në njëfarë forme nota më e lartë në këtë aspekt.

Po ashtu, edhe raporti për vendin apo siç po i themi ne raporti i progresit, ka potencuar, ose ka adresuar, të arritura në zbatimin e prokurimit publik.

Pra, janë këto dy elemente pozitive të cilat nuk u thanë edhe unë po mundohem t'i potencoj, sepse edhe duhet. Por, ajo që në fakt ka disa probleme është, këtij institucioni, kjo nuk është si vërejtje, por si kërkesë edhe ndaj këtij institucioni dhe neve si deputetë, po edhe Kuvendit të Kosovës, të shikoj ta rregullojmë mënyrën, procedurat e prokurimit, sepse me këto procedura të prokurimit e sidomos me metodën me të cilën kryesisht bëhen prokurimet, me çmimin më të ulët, shumica e kompanive sidomos kompanitë ndërtimore janë në kolaps. Pse janë në kolaps? Sepse bëhet një analizë e çmimeve dhe projekteve e të gjitha analizat që përcaktojnë për një projekt një shumë të caktuar e një buxhet të caktuar, kontratat lidhen shumë më ulët se ajo analizë që është bërë.

Në këtë formë, me këtë trend, del se komisionet që përcjellin punimet, aty diçka nuk është në rregull. Kur një pjesë e ekspertëve bën një analizë, përcakton një buxhet, për një projekt edhe kontrata lidhet me çmim shumë më të ulët, atëherë dëmtohen kompanitë, dëmtohet edhe kualiteti i punimeve. Institucionet, siç është KRPP, duhet analizuar sidomos duhet përcaktuar abnormalitetin e çmimeve të ulëta, se është mundësi e tyre dhe duhet analizuar edhe duhet theksuar dhe kërkuar prej organeve të prokurimit dhe institucioneve tona, që sa më shumë ta analizojnë këtë çështje. Në qoftë se, nuk e preferon dhe nuk ka një kujdes të veçantë në këtë punë, atëherë do të vazhdojë trendi siç është duke vazhduar. Kompanitë ndërtimore do të falimentojnë, kualiteti i punëve do të bjerë dhe mënyra e keqpërdorimit do të jetë si kërkesë çdoherë.



Pra, në një kohë të caktuar ka pasur tenderë që janë dhënë me procedurat, çmimi ekonomikisht më i favorshëm, tash janë ndaluar. Janë ndaluar sepse “na ka djegë çorba buzët”, por nuk bën “t’i fryjmë kosit”. Në këtë aspekt e kisha lutur edhe KRPP-në të ketë kujdes, sidomos me çmimet anormale nëpër konkurse dhe tenderë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më deputetë që e kanë kërkuar fjalën. Shkojmë drejtpërdrejt në votim.

Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2017. Votojmë tash!

57 deputetë kanë votuar. 41 për, 2 kundër, 14 abstenime. A votojmë edhe një herë për çdo rast apo...

Edhe një herë e përsërisim, s’kanë dashur deputetët të votojnë, se janë 67. Do të thotë prezenca është, me e pas parasysh, për atë po e vë në votim edhe një herë.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! 70 deputetë kanë votuar. 48 për, 3 kundër, 19 abstenime. Kuvendi miratoi raportin vjetor.

Në marrëveshje me grupet parlamentare, unë do të bëj disa lëvizje në rendin e ditës, pikave të rendit të ditës. Do të shkoj

## **27. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve joshumicë**

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit, që t’i propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Grupet parlamentare LDK-ja i ka sjellë emrat. Grupi Parlamentar i AAK-së duhet ta propozojë një anëtar, përkatësisht zëvendëskryetar i par, kush e dëshiron fjalën nga AAK-ja? Zoti Isufi, një emër për zëvendëskryetar të parë.

AHMET ISUFI: Rasim Selmanaj.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+, zëvendëskryetarin e dytë apo kryetarin, Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Ne e propozojmë Albert Kinollin.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së i ka propozuar. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar. Partia Socialdemokrate një anëtar, ju lutem! Sali Salihu, urdhëro!

SALI SALIHU: Frashër Krasniqin e propozojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista Serbe, një anëtar na duhet. Urdhëroni, zonja Jasmina.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Srpska lista predlaže poslanicu Jelenu Bontić.

KRYETARI: Faleminderit! Nisma Socialdemokrate po ashtu e paska një anëtar. Nisma?

Kush është për komisionin me ngritje formale të dorës. Kundër nuk ka. Ka Arbeni. Abstenim? Kemi 74 deputetë. komisioni emëroi anëtarët e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve joshumicë. Nisma Socialdemokrate sjell në administratë edhe një emër dhe përfundon.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve që të veprojnë në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Tani i kemi dy pika të rendit të ditës me të cilat do të shkojmë bashkërisht në votim të fshehtë.

## **25. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, dhe**

## **26. Emërimi i një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.**

Komisioni për Bujqësi, por edhe Komisioni ad hoc për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës kanë rekomanduar zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë nga dy kandidatë të propozuar. Po ashtu, janë dy kandidatë të propozuar për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Do t'i ftoj ndaras në fillim. E ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, zotin Daut Haradinaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Po shohim se ka paraqitur raportin, po mendoj është për. Ne e kemi marrë të shkruar.

Zonja Jasmina Zhivković, a dëshironi ju për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës të paraqisni raportin? Urdhëroni, zonja Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsedniče!

Na osnovu člana 67 i 71 Poslovnika Skupštine i člana 26 Zakona o RTK, Ad-Hoc Komisija je izvršila intervju sa kandidatima koji su se prijavili za članove odbora RTK i Skupštini je dostavila preporuku da se tajnim glasanjem bira jedan član odbora RTK. Za jednu poziciju člana odbora RTK iz redova albanske zajednice ad hoc komisija predlaže dva kandidata i to: Arian Krasniqi i Labeart Abdulah. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit shumë, zonja Jasmina Zhivković! Në të njëjtën kohë për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, pasi s'është kryetari i komisionit, janë dy kandidatë: Bislim Zogaj dhe Besim Mulaj. Në të dyja rastet duhet shumica e thjeshtë e deputetëve të cilët janë të pranishëm.

Atëherë, do të shkojmë grupet parlamentare për dy rastet, votim i fshehtë, i propozojnë anëtarët e Komisionit votues. Lidhja Demokratike e Kosovës?

AVDULLAH HOTI: Fidan Rekaliu.

KRYETARI: Partia Demokratike e Kosovës?

MEMLI KRASNIQI: Deputetja Evxheni Thaçi-Dragusha.

KRYETARI: Lëvizja Vetëvendosje?

GLAUK KONJUFCA: Sali Zyba.

KRYETARI: Partia Socialdemokrate?

DARDAN SEJDIU: Sali Salihu.

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës?

AHMET JUSUFI: Rasim Selmanaj.

KRYETARI: Lista serbe.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Jelena Bontić.

KRYETARI: Nisma? 6+?

ALBERT KINOLLI: Deputeti Danush Ademi.

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për formimin e Komisionit votues. Kemi prani të mjaftueshme.

A ka dikush kundër? Një kundër, Hajdari. Abstenim? S'ka. Për të gjithë. Atëherë, Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit Votues për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe të njëjtën kohë për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Komisioni le të zërë vend. Unë do t'i thërras menjëherë deputetët për votim.

Fletëvotimet do të jenë dy ngjyrash dhe do të votohet në dy kutia. Do të thotë ndaras në bazë të ngjyrës. Kutitë janë të ndara me ngjyra, po ashtu. Një person i administratës është aty për asistencë.

Komisioni le të zërë vend, ju lutem!

Edhe një njoftim, në ndërkohë të bëhet gati Komisioni votues:

Më datën 10 qershor për hir të 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit do të kemi seancë solemne në Prizren, në Kompleksin Historik të Lidhjes së Prizrenit. Do të thotë, do të jeni të ftuar edhe nga administrata e Kuvendit, deputetët e Kuvendit të kësaj legjislature, Legjislatura e 17 Shkurtit 2008 në të njëjtën kohë, në orën 10:00.

Po, urdhëro! Nisma e ka një propozim.

MILAIM ZEKA: Për Komisionin e Pavarur të Medieve anëtar të Komisionit ad-hoc Milaim Zeka.

KRYETARI: Milaim Zeka, të lutem zëre vendin. Votim formal edhe për Milaimin. A ka dikush kundër? S'ka kundër. Aprovohet, zërë vend të lutem.

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albert Kinolli, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Andin Hoti, Anton Çuni, Arban Abrashi,

Do të thotë, kemi një komision për dy votime. Kolegë deputetë, u mundova të jem edhe i qartë. Në qoftë se nuk ka ndonjë reagim, vazhdojmë menjëherë. Vazhdojmë!

Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliçaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj,

Edhe një njoftim. Vazhdimi i seancës për interpelancë do të jetë ditën e premte, në orën 11:00, por kisha kërkuar edhe një herë nga kryeministri që të kemi njoftim zyrtar.

Të premten në orën 11:00, interpelancat të cilat i kemi vendosur bashkërisht, të cilat u shtynë të gjitha. Kryeministri ka shprehur gatishmëri të premten, po të kemi edhe një konfirmim, të premten në orën 11:00. Ju njoftojmë me shkrim prapë, gjithsesi. Edhe në qoftë se, mbetet diçka nga sot, se nuk kemi kuorum në votim, do të vendosen para asaj seance vetëm për votim, pikat e sotme të rendit të ditës.

Duda Balje, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çaushti, Driton Selmanaj, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Evxheni Thaçi-Drangusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Famire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalju, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Avdyli, Haxhi Shala, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Dedaj, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shemsi Sylja, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

Në qoftë se ka deputetë ose unë rastësisht që se kam thirr ose nuk e ka dëgjua kur e kam thirr ju lutem të gjithë jeni të thirrur të votoni.

Ta dëgjojmë Komisionin, janë votat tuaja.

**EVGJENIJA THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!**

Tani do t'i lexojmë fletëvotimet për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Vota e parë është,

Besim Mulaj,

Bislim Zogaj,

Bislim Zogaj,

Besim Mulaj,

Besim Zogaj,

Bislim Mulaj,

Bislim Mulaj,

Bislim Mulaj,

Besim Mulaj,

Bislim Zogaj,

Besim Mulaj,

Bislim Zogaj,

Bislim Zogaj,

Bislim Zogaj,

Bislim Zogaj,

Bislim Zogaj,

Besim Mulaj,

Besim Mulaj,

Bislim Zogaj,

Besim Mulaj,

Bislim Zogaj,

Besim Mulaj,

Besim Mulaj

Bislim Zogaj,

Bislim Zogaj,

Tash do të vazhdoj vetëm me mbiemrat Zogaj&Mulaj, për arsye se po ngatërrohen. Votat tjera janë:

Zogaj,

Zogaj,

Mulaj,

Mulaj

Zogaj,

Zogaj,

Mulaj,

Zogaj,

Zogaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
E pavlefshme,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
E pavlefshme,  
Zogaj,  
E pavlefshme,  
Mulaj,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Mulja,  
Zogaj,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Zogaj,

Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Zogaj,  
E pavlefshme,  
Zogaj,  
Mulaj,  
Mulaj,  
Zogaj,  
Zogaj dhe  
Bislim Zogaj.

\* \* \*

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga komisioni e kemi zonjën Thaçi-Dragusha që ta japë rezultatin.

**EVEGJENI THAÇI-DRAGUSHA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ju paraqes raportin për rezultatet e votimit për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës.

Në mbështetje të neneve 65 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 Ligjit nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, si dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 6 qershor 2018, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, në seancën plenare, të mbajtur më 6 qershor 2018, konstaton:

- në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë,
- të pavlefshme janë 4 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

1. Bislim Zogaj i ka fituar 45 vota dhe
2. Besim Mulaj i ka fituar 36 vota. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë, me këtë raport i urojmë zotit Bislim Zogaj zgjedhjen drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës me mandat 5-vjeçar. Faleminderit!

Jemi në proces të votimit, ditën e premte, në orën 11:00, i kemi interpelancat, do të thotë janë tri interpelanca, e konfirmuar me kryeministrin, biseduam dhe e konfirmoi pjesëmarrjen. Do të thotë, ditën e premte, në orën 11:00.



Komisioni është duke na dhënë votimin e juaj. Ju lutem, koncentrim!

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tani do t'i lexojmë me radhë fletëvotimet për emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës:

Arian Krasniqi,  
Labeat Abdullahu,  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
ArianKrasniqi  
ArianKrasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
ArianKrasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
E pavlefshme  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu

Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
E pavlefshme  
Arian Krasniqi  
E pavlefshme  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
E pavlefshme  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi

Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Labeat Abdullahu  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Arian Krasniqi  
Faleminderit!

KRYETARI: A i presim rezultatet, ju lutem!

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, kryetar!

Do të ju lexoj tani raportin për rezultatet e votimit për emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur më 6 qershor 2018, konstaton se në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë. Të pavlefshme janë katër fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë janë:

1. Arian Krasniqi i ka fituar 39 vota dhe
2. Labeat Abdullahu i ka fituar 42 vota. Faleminderit!

KRYETARI: Nga numri i pjesëmarrjes në votim asnjëri nga kandidatët nuk i ka marrë gjysmën e votave, të cilat është dashur. Shkojmë në përsëritje të konkursit, kjo është ajo. Faleminderit! Atëherë, kështu në qoftë se, po po vazhdojmë, vetëm ta gjej fillin.

### **23. Shqyrtimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017**

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Nuk e kemi kryetaren e komisionit, as kryetarin e Komisionit të Financave. Nga grupet parlamentare nuk është lajmëruar askush. Lajmërohuni, ju lutem! Korab Sejdiu, në emër të LDK-së.

**KORAB SEJDIU: Përshëndetje!**

Lidhur me këtë raport ne në vazhdimësi kur kemi mundësi që të flasim për drejtësinë, dhe për sundimin e së drejtës, në vazhdimësi flasim fjalë të mëdha, mirëpo kur është puna për të ofruar financim të mjaftueshëm për çfarëdo institucioni të drejtësisë, atëherë themi që interesat tona lidhur me këto institucione janë sekondare, më interesante, po na duhet qoftë të shtrojmë asfalt apo të bëjmë diçka, të japim gjoba 53 milionë, apo diçka të tillë.

Kështu që unë po e përmend këtë, sepse edhe vetë ky institucion i cili e ka paraqitur një raport para komisionit ku ka raportuar ka theksuar që secili prej punëtorëve të këtij institucioni i kryen së paku 2-3 pozita, do të thotë nuk ka mjaftueshëm burime njerëzore, njëkohësisht ka probleme serioze edhe me objektin në të cilën gjendet për arsye se nuk është i përshtatshëm për kryerjen e funksioneve që i ka. Ndërsa, obligimet të cilat i përkasin dhe detyrat të cilat i ka Akademia e Drejtësisë janë jashtëzakonisht të rëndësishme duke e pasur parasysh që ky institucion është që i trajnon jo vetëm gjyqtarët, por edhe është i angazhuar në arsimin e vazhdueshëm të tyre, analizën e nevojave kur duhet të ketë investim të mëtutjeshëm në trajnime e kështu me radhë dhe në vazhdimësi kërkesat e tyre po bien në vesh të heshtur. Kështu që natyrisht raporti i tyre paraqet punën, por paraqet edhe një mori sfidash që ne e kemi obligim t'u ndihmojmë atyre për t'i tejkaluar dhe besoj nuk mund të flasim për shumë institucione tjera, veçanërisht për Gjyqësorin dhe përmirësimin e gjendjes së tyre, nëse ne veç nuk e ndihmojmë Akademinë e Drejtësisë si parakusht për zhvillimin e cilitdo institucion tjetër të drejtësisë.

Kështu që ne si grup e përkrahim këtë raport me një vërejtje serioze për këtë Parlament, por edhe për Qeverinë, që në hartimin e buxhetit të radhës të jenë më serioz në alokimin e mjeteve të mjaftueshme për Akademinë e Drejtësisë. Faleminderit!

**KRYETARI: Nezir Çoçaj, nga Partia Demokratike e Kosovës.**

**NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!**

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017 dhe e mbështet punën që po bëhet në këtë akademi.

Ligji për Akademinë e Drejtësisë ka kërkuar transformim nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në Akademi të Drejtësisë, si dhe nxjerrjen dhe harmonizimin e rregulloreve të parapara me ligj. Në raport përmendet misioni i Akademisë, që është ofrimi i trajnimeve cilësore, veprimtarisë kërkimore dhe botuese për nevojat e sistemit gjyqësor, prokurorial dhe profesioneve të lira me qëllim të ngritjes së profesionalizimit, pavarësisë në punë, paanshmërisë, efikasitetit dhe besimit të publikut.

Ne si grup parlamentar e inkurajojmë Akademinë që ta realizojë misionin e saj. Në raport i kemi të paraqitura të gjitha kompetencat ligjore të Akademisë, organizimin e Akademisë dhe kontinuitetin e saj, duke bërë ndarjen detyrave dhe përgjegjësive në rrafshin vertikal dhe horizontal. Për të lexuar misionin e saj, raporti përmban edhe sfidat me të cilat është përballur Akademia në vitin 2017, e që përkundër këtyre sfidave vërehet një angazhim i shtuar i Akademisë në aktivitetet trajnuese për ngritjen e kapaciteteve profesionale për sistemin gjyqësor, prokurorial dhe profesioneve të lira. Andaj, ne si grup e përkrahim dhe do ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

**KRYETARI:** Sami Kurteshi, nga Lëvizja Vetëvendosje.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Dy çështje në lidhje me këtë raport, një nuk qenka as kryetarja e komisionit as zëvendëskryetari. Njëri është dashur ta paraqesë. Sa për informim, komisioni përfaqësues e ka dëgjuar Akademinë e Drejtësisë dhe ka rekomanduar miratimin e tij.

Sa i përket Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne natyrisht që e kemi shqyrtuar këtë raport, jemi marrë me raportin edhe për të mos i përsëritur vërejtjet që i tha deputeti Sejdiu në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ato janë vërejtje që qëndrojnë, natyrisht edhe vërejtjet e tjera janë shprehur në formë rekomandimesh nga përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë në raportin e tyre.

Megjithatë, duhet theksuar dhe vërejtur disa gjëra. Ajo që në shumicën e raporteve të këtyre agjencive duket e qartë, është se në të gjitha këto raporte, në shumicën e tyre, së paku, jo në të gjitha, kemi një përshkrim, një formë deskriptive, pa marrë parasysh se raportet në aspektin formal duken mirë, edhe në aspektin gjuhësor kanë një strukturë të mirë, po kanë vetëm aspektin deskriptiv, domethënë vetëm përshkruhen aktivitetet, përshkruhen gjërat dhe mungon aspekti përmbajtësor, rekomandimet përmbajtësore dhe një aspekt normativ i këtyre raporteve.

Pse po e them këtë? Ne kemi raportin e Akademisë, në faqen 27 janë objektivat e programit të trajnimit të vazhdueshëm. Këto objektiva janë të listuara këtu në 7, 8 apo 9 pika dhe pastaj, kur shqyrtohet raporti, realisht kurrkund në raport nuk gjendet asnjë fjalë për arritjen apo mosarritjen, realizimin apo mosrealizimin e këtyre objektivave. Urdhëroni!

**KRYETARI:** Më duhet të reagoj. Kërkoj falje, po ka reagime që një orë e gjysmë a dy disa deputetë po insistojnë të lëshohet klima, disa po protestojnë pse po lëshohet klima. Ka krijuar konfuzion te personeli. Ose votojmë, pa shaka, të vendosë shumica, nuk ka kështu. Ai ankohet, këta të tjerët i përdorin këto për freskim. Problem është. Vazhdoni, zoti Kurteshi, por nuk mund të funksionojë administrata kështu me këto kërkesa.

Ndalen i nja 10 minuta, një herë ndaleni, veç... Vazhdo të lutem, zoti Kurteshi. Kërkoj falje!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë isha te ajo pjesa, te objektivat e programit të trajnimit të vazhdueshëm. E theksova, po e them edhe një herë, ajo që më mungon mua dhe natyrisht do të duhej t'u mungonte edhe deputetëve të tjerë, është një evoluim i objektiveve. A janë realizuar apo nuk janë realizuar, a janë arritur apo nuk janë arritur këto objektiva?

Po ashtu, përveç përshkrimit, kemi vetëm rekomandime të karakterit teknik dhe administrativ, që megjithatë janë të vlefshme, sepse ky institucion ballafaqohet me këto çështje, me këto probleme, të cilat i përmendi edhe kolegu Korab Sejdiu. Mendoj se mungon ajo pjesa e rekomandimeve përmbajtjesore dhe rekomandimeve normative për arritjen apo realizimin e objektiveve. Në kuadër të rekomandimeve edhe të përshkrimit ka shumë statistika, që mund të jenë për shumicën e deputetëve pak irrituese, nëse nuk e lexojnë raportin në tërësi. Natyrisht, se është një raport relativisht voluminoz, jo ndër më voluminozët, mund të humben, por nuk ka sqarime për arritjen e objektiveve.

Megjithatë, ndër rekomandimet dhe sfidat kur i lexojmë dhe i krahasojmë me objektivat e programit të trajnimit, ka një shpërputhje relativisht të madhe. Unë mendoj se përfaqësuesit e Akademisë i dëgjojnë këto dhe i marrin përsipër, se jo vetëm çështjet administrative dhe teknike janë çështje që i interesojnë Kuvendit, por janë edhe çështjet e objektiveve përmbajtjesore që duhet të realizohen, sepse kemi të bëjmë me institucionin që ka përgjegjësi për përgatitjen, trajnimin e gjithë stafit, të gjithë njerëzve që punojnë në sistemin e drejtësisë.

Këto janë çështjet që unë mendoj se megjithatë përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë duhet t'i kenë parasysh. Pajtohem me kolegun Sejdiu se ky institucion, sikur edhe institucionet e tjera në sistemin e drejtësisë ka nevojë për ndihmë konkrete. Unë nuk e di a ka nevojë për një ndërtesë të veçantë, por ka nevojë për ndihmë konkrete në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, profesionale, që vijnë me rritjen e numrit të njerëzve dhe me shtrimin e kërkesave për ngritje profesionale, sidomos të gjyqtarëve dhe prokurorëve, po edhe të stafit ndihmës administrativ dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, që sigurisht do të vijnë me ligjet e reja.

Zoti kryetar,

Sa i përket kësaj, e kreuva. E kam edhe një çështje.

Në pjesën e paradites kishim një problem, nuk po them konflikt, me nënkryetarin e Kuvendit si kryesues i seancës. Unë e di se ne të gjithë mund të rrëshqasim, mund të bëjmë shkarje të ndryshme, mirëpo mënyra e sjelljes së tillë, e personalizimit të çështjeve, mandej e banalizimit të tyre dhe e ngritjes së tyre në konflikte personale, nuk është një çështje që duhet të pritët nga një kryesues i seancës.

Megjithatë, kryesuesi i seancës e ka një dokument para vetes, që rregullon udhëheqjen e seancës dhe në atë dokument janë disa hapa në vazhdimësi që rregullojnë menaxhimin, qoftë edhe fjalën e një deputeti apo deputeteje në Kuvendin e Kosovës. Ata hapa janë të shkallëshkallshëm, mirëpo ndërprerja e tillë e fjalës, pa e ditur çfarë dua të them, mandej thënia e fjalës së fundit si fjalë e parë, si “nuk ke asnjë të drejtë”, se “të nxjerr nga seanca”, pa e ditur çfarë po dua të them, megjithatë unë mendoj se është një arrogancë dhe arbitraritet që nuk i lejohet askujt këtu.

Unë e kam ngritur zërin për t’u dëgjuar, por në atë zë besoj se nuk e ka gjetur asnjë fjalë, asnjë shprehje që ka mundur ta fyejë as personalisht e në asnjë formë udhëheqësin e seancës. Unë ju lutem që t’ia tërhiqni vërejtjen nënkryetarit, zotit Haliti, që të mos veprojë në mënyrë të tillë arbitrare me deputetët dhe deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, unë e kam ngritur zërin për t’u dëgjuar dhe nëse dikujt i ka penguar ngritja e zërit nga unë, unë kërkoj që tani falje, por ajo ka qenë vetëm fjalë për t’u dëgjuar. Faleminderit, zoti kryesues!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ju, zoti Kurteshi, jeni veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare. Ne të gjithë jemi të zgjedhur të popullit. Secili e ka mënyrën e vet të udhëheqjes. Rregullorja e krijon atë mundësi, por mundësisht të kemi mirëkuptim për njëri-tjetrin. Ta ruajmë njëri-tjetrin. Nganjëherë ndoshta unë s’mund t’ua ndal fjalën, edhe pse Rregullorja ma jep atë mundësi. Nganjëherë edhe kritikohem për këtë çështje, po mundohuni ta ruajmë njëri-tjetrin.

Zoti Shkumbin Demalijaj e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

**SHKUMBIN DEMALIJAJ:** Faleminderit, kryetar!

Lidhur me raportin e Akademisë së Drejtësisë grupi ynë parlamentar e përkrah këtë raport, kolegët paraprakisht folën edhe për format, edhe për format integrale të paraqitjes së raportit, po ato nuk dominojnë mbi atë për çka ky mekanizëm funksionon.

Në radhë të parë, duhet të mbështetet ky institucion. Veprimtarinë e tij e ushtron në një objekt me qira, ku për shkak të gjithë asaj veprimtarie në të ardhmen edhe arkivi i këtij institucioni, i kësaj Akademie, mund të dëmtohet. Ka nevojë për mbështetje kadrovike, për shkak se tash me implementimin e marrëveshjes së drejtësisë, ku edhe pjesëtarët nga Prokuroria dhe gjykatësit që vijnë, në radhë të parë në veri nga pakicat, dhe implementimi i kësaj marrëveshjeje këta gjykatës dhe prokurorë duan trajnim profesional dhe kjo mundësi u ofrohet duke u mbështetur financiarisht ky mekanizëm.

Administrata është e vogël aty, por besoj se brenda gjashtëmuorit të dytë, kur jemi tash për mundësinë e rebalancit të buxhetit kur të vijë, shpresojmë se edhe në komision, po edhe te Qeveria drejtuesit e Akademisë së Drejtësisë do t’i drejtohen për mbështetje financiare, çka edhe

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë promotore për ndihmë financiare, jo ndihmë, po mbështetje financiare institucionale, në këtë rast, të kësaj Akademie. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fikrim Damka s'qenka, sa po e shoh, nga 6+-i. Atëherë, i kemi edhe dy deputetë që janë lajmëruar për diskutim. Drita Millaku e ka fjalën

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Ky raport duket voluminoz, siç thanë edhe parafolësit, për nga vëllimi apo numri i faqeve, por në realitet më tepër pasqyron çështje se çka parashih Ligji për Akademinë e Drejtësisë, se sa çështjet apo punët e kryera gjatë vitit 2017.

Në faqen 12 të këtij raporti shkruan se Akademia ka pasur vështirësi në zbatimin e planit të trajnimeve, për shkak se është transformuar nga institucioni gjyqësor i Kosovës me Ligjin nr. 05/L-095. Por, këto vështirësi i ka kaluar falë bashkëpunimit ndërinstitucional. Ky pasqyrim është përgjithësues, sepse nuk pasqyrohet se çfarë bashkëpunimi ka pasur, të cilës natyrë, të asaj teknike apo të natyrës profesionale.

Në faqen numër 19, pika c, kur i referohet trajnimit të stafit, shkruan se gjatë vitit 2018 janë kryer disa trajnime, siç janë pasqyruar në tabelën numër 1, për në tabelën që referohet janë paraqitur trajnimet e stafit të akademisë për vitin 2017. Ndoshta, është një gabim teknik, por më jep përshtypje të një paqartësie dhe të një raporti sa për t'u dukur voluminoz.

Në faqen 75, pika 6.11, shkruan se gjatë vitit 2017 e kanë kryer praktikën profesionale dy studentë dhe nuk i referohet se nga cili universitet ishin ata studentë, çfarë kategorie janë pranuar, domethënë me çfarë kriteresh, kur dihet se kërkesa për praktikë të tilla ka shumë, si dhe studentë të drejtësisë ka shumë në Republikën e Kosovës.

Sa u përket financave të këtij institucioni, vërehet se donacionet, edhe pse janë përfituar, nuk janë shpenzuar, siç është pasqyruar në tabelën 1 të faqes 80 të këtij raporti. Nga 16 127 euro të alokuara, kanë mbetur të shpenzuara edhe 13 302,90 centë. Kjo jep një përshtypje se nuk ka pasur projekte apo nuk janë arsyetuar mirë që këto mjete financiare nuk janë shpenzuar. Po ashtu, në aneksin 1 të këtij raporti janë pasqyruar edhe trajnimet e organizuara dhe të kryera nga prokurorët dhe gjyqtarët dhe në rubrikën ku shkruhet "Financuesi" shkruhet vetëm se kush ishte financues. Është dashur të shkruhet edhe shuma e mjeteve të shpenzuara për secilin trajnim dhe të shihet me transparencë se sa ka kushtuar secili trajnim veç e veç.

Raporti financiar për vitin 2017 i është bashkëngjitur këtij raporti si dokument, por faqet e këtij raporti nuk kanë numër dhe është vështirë t'i referohesh ndonjë çështjeje konkrete. Kështu, sipas këtij raporti, Akademia e Drejtësisë ka arritur të shpenzojë 85% të buxhetit dhe arsyetohet se shuma e mbetur është si rezultat i mosplotësimit të pozitave të lira për staf dhe atë për arsye të



ndryshme. Kjo “për arsye të ndryshme” nuk është arsyetim i mirë, sepse gjatë një viti të tërë është dashur të plotësohen këto pozita, sidomos për arsye se vështirësi financiare të kësaj natyre nuk kishte, por përkundrazi kanë mbetur mjete të paplanifikuara për pagesën e pagave për stafin e kësaj akademie. Përkundrazi, në këtë raport ceket si një nga vështirësitë e funksionimit të kësaj akademie është stafi i vogël.

Domethënë, këto janë disa prej vërejtjeve, të cilat i hasëm gjatë leximit të këtij raporti. Faleminderit!

**KRYETARI:** Bekim Haxhiu. Bëhet gati Milaim Zeka. Nezir, a e ke kërkuar fjalën? Milaim Zeka një herë.

**MILAIM ZEKA:** Unë shkurt, kryetar, 30 sekonda se Emilija po më kritikon pse po flas shkurt.

E para, kjo puna e kondicionerëve s’di qysh mbeti. Herë po i çojnë lart, herë jo, po mua e Bilallin po na goditin më së shumti, nganjëherë po trullosem, s’po di çfarë po flas.

E dyta, kam dëgjuar mbrëmë një deputete ka propozuar të ndërpritet seanca puna e iftarit. E unë kisha thënë që të mos harrojmë, mund ta ndërpresim seancën, është Panairi i Librit, mirë do të ishte të shkojmë ta blejmë ndonjë libër ne si deputetë. Kaq!

Për raportin jam krejt dakord.

**KRYETARI:** Faleminderit! Kësaj të fundit i bashkëngjitemi të gjithë. Është problem. Do të shohim çfarë mund të bëjmë, për arsye se kur i dëmtojmë shumë deputetë, është rationale kërkesa, shohim çfarë mund të bëjmë.

Nezir Çoçaj, fjala për ju. Deputeti i fundit.

**NEZIR ÇOÇAJ:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Do të jem shumë i shkurtër, do të flas në emrin tim, por dua t’i theksoj disa gjëra që parafolësit i potencuan. Si pjesë e këtij komisioni edhe drejtori i nderuar ka qenë në raportim në komisionin tonë dhe si sfidë ka potencuar. Unë dhe kolegët jemi shumë të vetëdijshëm që ministri aktual ka rritur numrin në të gjitha ato organizata që raportojnë, gjegjësisht janë pjesë në njëfarë mënyre edhe e Ministrisë së Drejtësisë. Shpresoj që gjatë këtij viti do të zgjidhet edhe ky problem, ashtu e kishte mendjen edhe drejtori i kësaj Akademie. Po ashtu, edhe drejtori na tha se kemi zotimin për parcelën dhe projektimin e ndërtesës së ardhshme të Akademisë së Drejtësisë.

Besoj që të gjithë e dimë që pushteti lokal ndan parcelë edhe për institucionet qendrore. Pra, pasi që e kemi zotimin, unë shpresoj shumë që edhe ministria, gjegjësisht edhe ne si deputetë do ta luajmë një rol pozitiv në ndarjen e buxhetit për ndërtimin e kësaj godine, që është

jashtëzakonisht e domosdoshme dhe ku edhe si institut gjyqësor, po edhe si Akademi kanë pasur problem me hapësirat e nevojshme.

Po ashtu, gjatë raportimit kemi parë se kjo Akademi ka luajtur një rol jashtëzakonisht të mirë dhe progresiv, duke trajnuar 1901 zyrtarë nga gjykata, nga gjyqësori dhe prokurorët, si dhe të tjerë. Mendoj që të gjitha këto trajnime janë të akredituara dhe të certifikuara, ashtu siç ka thënë edhe vetë drejtori. Ana pozitive tjetër është se kemi edhe gjashtë kurse të trajnimit që bëhen nëpërmjet metodës e-learning, po ashtu kemi edhe një bibliotekë digjitale, ku kanë qasje të gjithë qytetarët, gjegjësisht ata që merren me sistem të drejtësisë, po edhe e mira tjetër është se të gjithë kanë mundësi të kenë qasje edhe në burimet e jashtme.

Mendoj se në të ardhmen ne si deputetë të këtij Kuvendi duhet të ndajmë buxhet, pra nëse parashihet për 2018, gjegjësisht 2019, që sa më shpejt Akademia e Drejtësisë ta ketë edhe godinën e saj, pasi që kemi zotim për parcelë dhe projektimin e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputet të paraqitur më. Do të votojmë në momentin kur t'i kemi 61 deputetë. Mendojmë për të premtën.

## **22. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017**

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Nuk e kemi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL. Grupet parlamentare, a ka dëshirë dikush të flasë?

Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Kryetar, faleminderit!

Unë e mora fjalën vetëm për të thënë që grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport dhe nuk kemi një mendim të unifikuar.

E kemi lënë që çdo deputet të votojë veçmas, sepse është një mendim që puna e këtij institucioni dhe raporti nuk shkojnë në harmoni. Ka vërejtje shumë të mëdha në punën e këtij institucioni, sidomos prej operatorëve ekonomikë, kurse raporti në formën e shkruar, ne mund të bisedojmë për raportin si raport, për formën e shkruar, por vërejtjet e deputetëve tanë, të grupit tonë parlamentar për punën e këtij institucioni janë shumë të mëdha.

Kështu që kemi vendosur të mos kemi një vendim të unifikuar, por do të votojmë veçmas çdo deputet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në pjesën e përfundimit të debatit. Jemi në votim të raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017. Do të votojmë ditën e premte, sepse s'kemi kuorum. Për aq sa edhe pikën e 28-të e rendit të ditës do të votojmë ditën e premte, për arsye se nuk kemi kuorum. Jemi në marrëveshje në mes Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Socialdemokrate për kryetar të komisionit. Tërhiqet ai propozim, për arsye se do të jetë, do të bartet në mbledhje të Kryesisë.

Në të njëjtën kohë, Partia Social Demokrate e ka tërhequr propozimin e vet për një anëtar të Komisionit për AKI-në, për faktin se nuk ka të drejtë ta ketë. Më falni, se s'e kam materialin, derisa ta gjejnë, e thashë sipas mbamendjes, anëtar të Komisionit për Komunitete, kërkoj falje. Edhe ajo është tërhequr e do të thotë, shkojmë në votim vetëm për anëtarë të komisionit me ato propozimet që i kanë dhënë grupet parlamentare, pa kryetarin e Grupit Parlamentar, i cili tërhiqet në mbledhjen e Kryesisë dhe pa anëtarin e Komisionit për Komunitete, të cilin e tërheq Partia Social Demokrate.

Nuk kemi pika të tjera të rendit të ditës.

I falënderoj shumë deputetët për punën e tyre.

Takohemi ditën e premte dhe në vazhdim të kësaj seance dhe në tri interpelancat që i kemi me kryeministrin e Republikës së Kosovës, në orën 11:00.

Mirupafshim!

\* \* \*

*E premte, më 8 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po vazhdojmë me pikën e rendit të ditës:

**4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të LDK-së në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe Postës së Kosovës**

Tani këtu të dy grupet parlamentare janë marrë vesh që ta kenë një pikë të rendit të ditës. Nuk e di a jeni marrë vesh kush do ta prezantojë.

Rregullat i dimë të gjithë, atëherë zoti Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje do ta prezantojë ekspozenë.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Kryeministër,

Kabinet i Qeverisë,

Telekomi i Kosovës dikur ishte kompania më fitimprurëse në Kosovë dhe Buxheti i Kosovës vilte dividendë për çdo vit.

Vetëm në vitin 2009 ishin 200 milionë euro, ndërkaq për pesë vjet, 2009-2013, gjithsej 420 milionë euro.

Sot Telekomit i Kosovës e ka vështirë të paguajë pagat.

Qeveria e Kosovës duhet ta pranojë që Telekomit është në krizë, në mënyrë që ta mundësojë të dalë nga kriza.

Askund në botë ndërmarrjet e telekomunikimit nuk falimentojnë, ato e kanë të garantuar fitimin.

Çështja është vetëm se cila fiton më shumë, kështu ka qenë edhe në Telekomit e Kosovës.

Mirëpo në Telekomit e Kosovës nuk lejoheshin investimet dhe Telekomit të Kosovës i kanoseshin me privatizim qysh prej se ishte në kulmin e fitimprurjes. Tentimi i parë i privatizimit të PTK-së u patë bërë në vitin 2010, pra menjëherë sa u pa deidentata për 200 milionë eurosh.

Mandej Projektligji për buxhet që na u pati sjellë në mars të vitit 2011, në nenin 4 të tij e parashihte shitjen e Telekomit.

Telekomi i Kosovës ka 2274 punëtorë, sipas raportit të vitit 2016, me pasuri rreth 124 milionë euro.

Pjesëmarrjen në treg e Valës është 55.6% dhe Vala vazhdon të prijë me rreth 58.45% të të hyrave në treg.

Të hyrat për punëtorë janë diçka mbi 33 mijë euro, e që është dhjetëfish më pak se sa mesatarja botërore.

Ndërkaq, të hyrat për konsumator janë larta, janë 66 euro, ta zëmë është 50% më shumë se sa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që do të thotë se kërkesa është tejet e mirë për Valën dhe ka lojalitet të qytetarëve ndaj saj.

Nga viti 2015 në vitin 2016 raportohet se është rritur numri i konsumatorëve, por janë zvogëluar të hyrat e janë rritur shpenzimet. Problemi është veç se te keqmenaxhimi, te udhëheqja e mbrapshtë, kjo vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues në PTK në muajin mars u emërua Nuredin Krasniqi, një njeri i njohur për manipulimet me Bankën Kreditore dhe me fondet e 3%-shit, kurse pas tij zoti Zeqir Kiçina që erdhi si kryetar i Degës së AAK-së.

Telekomi i Kosovës ka pasur gjithmonë kuadro shumë të përgatitura profesionalisht, jo vetëm të inxhinierëve, por edhe të ekonomistëve dhe të juristëve. Domsdo shtrohet pyetja si është e mundur që Telekomit i Kosovës të bjerë në krizë, duke pasur parasysh kuadrin e brendshëm të saj, teknologjinë shumë të avancuar dhe veprimtarinë më profitabile në tregun botëror të komunikimeve?

Përgjigjja është e thjeshtë: kuadrot e brendshëm të Telekomit të Kosovës janë marginalizuar, janë eliminuar nga postet vendimmarrëse, madje janë larguar krejt.

Kosova ka qindra ekonomisë e inxhinierë të mirë e të suksesshëm që janë përjashtuar për t'u bërë aty udhëheqës një herë Nuredin Krasniqi, e më pas Zeqir Kiçina.

Por, natyrisht që kulmi i krimit të organizuar në Telekomit e Kosovës është kontrata me Dardafonin, përkatësisht tani Z-Mobil, kontratë kjo e cila është aktuale dhe dëmet e së cilës vazhdojnë të thellohen. Kontrata joligjore e Telekomit me Z-mobil ia plaçkit çerekun e të hyrave Telekomit të Kosovës.

Përveç kontratës së dëmshme me Z-Mobile, duhet të rishikohen edhe kontratat e tjera që janë po aq të dëmshme, për shembull, kontrata me Art-Motion, që për çudi është blerë nga Devolli.

Marrja në shfrytëzim me qira të shumë objekteve është gjithashtu pjesë e krimit të organizuar.

Për shembull, në qendër të Prishtinës, afër Hotelit Grand, objekti vlen një milion euro, por merret me qira për tetë vjet dhe paguhen tre milionë euro, pra derisa i gjithë objekti vlen një milion euro, e deri te luksi nga drejtuesit e Telekomit të Kosovës, sikurse për shembull, shkuarja në udhëtime zyrtare në Monte Carlo e në Dubai.

Gjithashtu kemi informacionin që Devollët e kanë një partner në Qipro. Ndërkohë dihet që ata nuk bëjnë investime në Z-Mobile, kur të nevojitet një investim, atëherë e merr një partner, por derisa nuk të nevojitet për investime, pse e merr partnerin ekonomik. Unë dyshoj që kjo ka të bëjë me haraçin që ata e paguajnë dikujt në Kosovë nëpërmjet kësaj kompanie që e kanë në Qipro.

Dhe jo vetëm kaq. Legalisht mësova që nuk ka më ‘Devolli Kompani’ në Kosovë, e kanë bartur kapitalin e tyre në Maltë dhe shtrohet pyetja pse në Maltë, në Maltë tatimet janë më të larta se në Kosovë. Prej kujt po fshihen ata? Ata po e ndjejnë rrezikun e ndryshimeve të mëdha në Kosovë dhe po dëshirojnë që kapitali i tyre në rast të rrezikut për konfiskim pas proceseve gjyqësore, të mos ndodhet në vend, pra në shtetin tonë.

Lëvizja Vetëvendosje propozon një rezolutë, e cila i ka 12 pika dhe për të cilën nuk po marr kohë t’ua lexoj tani, por duhet theksuar që nuk ka dështuar Telekomit, por ka dështuar shteti, nuk po falimenton Telekomit i Kosovës, por po falimenton shteti, përkatësisht Prokuroria dhe Qeveria. Prokuroria që është në shërbim të pakicës dhe kjo Qeveri që është Qeveri e pakicës.

Këto 12 pika janë ato të cilat e nxjerrin Telekomit nga kriza. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Veç një sekondë, duan edhe këta të LDK-së, kryeministër, të flasë Abdixhiku, pastaj ti.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Dikur Postë-Telekomit i Kosovës njihej si aseti më i suksesshëm në vend, ishte modern, kishte vlerë, sillte fitime e kontribuonte edhe me dividendë në buxhet.

200 milionë euro i kishte kontribuar vetëm në vitin 2010. Po në të njëjtën vit, sipas analizave vlerësuese të kohës, ky aset vlente hiç më pak se 600 milionë euro, atëherë kompani më me renome botërore, si “Deutsche Telekom” kishin shprehur interesimin për privatizim dhe modernizim të ndërmarrjes.

600 milionë euro të parapara nga shitja mjafton të sillnin shumë gjëra në rend, në Kosovë, e merri i “Deutsche Telekom” jepte siguri për shumë investitorë të tjerë.

Kompanitë e interesuara fatkeqësisht ishin tërhequr nga procesi privatizues për shkak të, si e quanin ata, aferave korruptive rreth PTK-së,

Që nga atëherë një serë veprimesh politike të kapjes së tenderëve, punësimeve militante, kontratave të dëmshme dhe të aferave gjyqësore dhe çka jo tjetër kanë sjellë këtë aset në buzë të falimentimit.

Dhe, në shumë pak raste të tjera nëpër botë mund të gjendet një situatë që një ndërmarrje me tipare të Telekomit mund të arrijë në këtë gjendje, me tipare të Telekomit të Kosovës.

Një ndërmarrje që operon vetë e dyta në treg që është pra duopol, që ka mbi 50% të tregut në posedim, është praktikisht e pafalimentueshme, s’mund të falimentohet një ndërmarrje që është duopol dhe që mban 50% të tregut.

Vetëm praktikatat më të mbrapshta biznesore mund të kthejnë përmbys këtë proces.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar kolegë,

Për të kuptuar problemet e Telekomit duhet të kthehemi në zanafillë dhe për t’i ideuar zgjidhjet nga tash e tutje duhet të kthehemi prapa në kohë.

Në këtë kthim pas, unë mora pasqyrat financiare të PTK-së nëpër vite.

Që nga viti 2010 e këndej, për të kuptuar tregimin që numrat e Telekomit ndërtojmë dhe në këto numra ka disa paradokse që secili me pak dije mund t’i observojë.

Një ndër raportet me shqetësuese të Telekomit është ai i të hyrave të nëpër vite, të qarkullimit të Telekomit nëpër vite.

Në vitin 2011 të hyrat e Telekomit ishin 160 milionë euro, ndërsa sot kur flasim këtu janë 70 milionë euro. Ky është grafikoni i të hyrave të PTK-së.

Ky grafikon tregon rënie të lirë, prej 160 milionë eurove, në më pak se shtatë vjet, ne kemi rënë në 70%, pra bëhet fjalë për 130% rënie të të hyrave të Telekomit.

Dhe, shpesh kam dëgjuar arsyetime, kryesisht nga zyrtarët e Telekomit, se trendi i të hyrave, ky trend është i njëjtë nëpër Evropë. Dhe, për kuriozitet i mora të hyrat e Telekomit nëpër Evropë dhe ky është një grafikon i të hyrave nëpër Evropë. Pra, ky është grafikoni i të hyrave në Kosovë dhe ky është grafikoni i të hyrave të tregut dhe Telekomit në Evropë.

Në Evropë për këto vjet të njëjta, të hyrat e Telekomit kanë rënë për 3%, në Kosovë ka rënë për 130% në Telekomin e Kosovës.

Për më tepër, rënia e të hyrave nuk është karakteristikë fare për operatorët privatë, pra të gjithë operatorët e tjerë privatë kanë pasur rritje eksponenciale, veç Telekomit i Kosovës ka pasur rënie prej 130% të të hyrave.

Dhe, në kohën kur të hyrat po bijën drastikisht, një fenomen tjetër në PTK kishte rritje, ishte punësimi dhe e kam fjalën për punësimin militant. Tash ku ka një rënie drastike sikur kjo, e pakta që një ndërmarrje normale duhet të bëjë është shkurtimi i shpenzimeve dhe me siguri nisja e ristrukturimit të brendshëm, por kjo nuk ka ndodhur në PTK, përkundrazi numri i të punësuarve është rritur, edhe një herë po ju tregoj grafikonin e të punësuarve në PTK.

Pra, shikoni diskrepancën në kohën kur të hyrat kanë rënie të lirë, punësimi ka rritje eksponenciale në PTK, përveç numrit të të punësuarve, ka pasur rritje eksponenciale edhe të pagave. Sot paga mesatare në PTK është 1000 euro, pra mesatarja, kujdes, nuk po flas për pagën maksimale, ka pagë 5000 euro në PTK, menaxhmenti merr sot pagë deri në 5 000 euro, përderisa dërgon kompaninë në rënie për 130% në pak vjet.

Telekomi i Kosovës i ka sot 2 300 punëtorë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Vazhdoja, le ta përfundojë ekspozenë edhe në emër të grupit!

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit! Pra Telekomit i Kosovës i ka 2300 punëtorë, e ka mbi 50% të tregut, kompania konkurrenente IPKO e ka 40% të tregut dhe i ka 300 punëtorë. Tash krahasoni 2300 me 300, bëhet fjalë për treg për afërsisht të njëjtë.

Sa për krahasim, Telekomit i Kosovës i ndan 37% të të hyrave në paga, gati 40%. Dhe, po e krahasove këtë numër me të gjitha telekomet e rajonit dhe të Evropës, e kupton se është trefish më i lartë. Në rajon mesatarja e të hyrave që ndahet për paga është vetëm 13%, por apetiti për



paga dhe për punëtorë s'ka qenë synimi i vetëm në PTK. PTK ishte shndërruar edhe në ndërmarrje që krijonte kontrata absurde, të cilat po u respektuan, krijonin dëm, po u kundërshtuan, krijonin dëm.

Ndër të tjerash ishte nënshkruar edhe kontrata e famshme Dardafon, kontratë absurde, e cila jep konkurrentit të PTK-së mbi 15% të tregut.

Ky është grafikoni i pjesëmarrjes së tregut të ndërmarrjeve. Në vitin 2010, kur është nënshkruar kontrata e Dardafonit, PTK i ka pas 65% të tregut, sot i ka 50.

Në vitin 2010 kur është nënshkruar kontrata e re me Dardafon, Dardafoni ka pasur 0% të tregut, sot i ka 15. Pra 15% të tregut Telekomit i Kosovës ia ka falur një kompanie të tretë private.

Tash edhe punësimi, edhe keqpërdorimi, edhe kontratat e dëmshme në thelb kanë një emërues të përbashkët dhe atë duhet thënë qartë: është interferenca politike, interferenca partiake.

Sipas një hulumtimi të organizatës Çohu, nga 16 pozita, sepse PTK i ka 16 pozita të zyrtarëve të lartë, menaxhuese, si drejtorë departamentesh, auditorë të brendshëm, deri te pozitat vendimmarrëse, si ato të zëvendëskryeshefi dhe drejtorëve ekzekutivë të operatorit Vala, nga 16 pozita, 13 u kanë takuar anëtarëve aktivë të Partisë Demokratike të Kosovës. 13 prej 16 pozitave. Dy kryeshefat e fundit, këta të njëjtit që e kanë bërë këtë rënie të të hyrave, punësimet e mëdha, kanë qenë anëtarë aktivë të Partisë Demokratike të Kosovës. Madje, njëri prej tyre sa ishte kryeshef ekzekutiv i PTK-së, ishte edhe në listë të deputetëve dhe kur e kishin pyetur a do të mbash postin e kryeshefit të Postës nëse zgjidhesh deputet, për naivitët kishte thënë, po e citoj: “Varet nga kërkesat e partisë a duhet t’i mbaj unë dy pozicionet ose jo”.

Dhe, interferimi i PDK-së në PTK është dëshmuar edhe me atë aferën e famshme “Pronto”, kur kryeministri i asokohshëm, Thaçi, urdhëronte shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, Grabovcin dhe ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Beqaj, që të zgjedhin anëtarët e Bordit të PTK-së. Pra, ka pasur interferenca partiake të drejtpërdrejta.

Edhe, i nderuar kryeministër, ndoshta ne s'mund t'ju mbajmë përgjegjës me të drejtë për të gjitha zhvillimet e viteve të fundit, por duhet t'ju mbajmë përgjegjës për këta tetë muajt e fundit dhe për mënyrën se si PTK menaxhohet në vijim. Dhe, nëse kërkoni zgjedhje, kryeministër, të sinqertë, të njëmend e pa kalkulime partiake, duhet ta dini se shkaktarët kryesorë të PTK-së dhe falimentimit të Telekomit i keni brenda koalicionit qeverisës, brenda partnerit të madh tuajin dhe pa shikëputjen e tyre nga Telekomit është e pamundur të shpëtohet Telekomit. Nëse doni zgjidhje, nuk do të jetë nëpërmjet zëvendësimit të njërit ndikim politik me ndikimin tjetër politik, jo nëpërmjet vendosjes së njerëzve partiakë në krye të Telekomit, por nëpërmjet implementimit të shpejtë të disa masave puro biznesore në një ambient që funksionon krejtësisht përveç se biznes.

E para, ne e ftojmë Qeverinë e Kosovës që të vendosë moratorium të punësimit në Telekom. Vetëm këtë vit janë punësuar mbi 70 njerëz në Telekom, pra në kohën kur ende kemi rënie të të hyrave, kur kemi rrëshqitje drejt falimentimit, Telekom punëson njerëz më tutje. Ne kërkojmë që të vendoset moratorium i Qeverisë mbi punësimin e PTK-së. E dyta, ju ftojmë që të shkarkoni gjithë menaxhmentin e lartë të PTK-së dhe të shikoni mundësinë t'i kaloni kompetencat menaxhuese preferuese tek një institucion menaxhues potencialisht i jashtëm. Ky institucion për disa vjet me radhë do të bënte shkurtimin e tepricave të vetëshkaktuara nga njerëzit aty, do t'i ndërpriste kontratat e dëmshme për Kosovën si shtet dhe do të ndërpriste që është më e rëndësishmja interferimin politik në PTK. E treta, Qeveria e Kosovës duhet të ftojë Prokurorinë e vendit për të hetuar të gjitha kontratat, punësimet e marrëveshjet e dëmshme që ekzistojnë aty dhe Qeveria duhet të formojë edhe një task forcë që ndihmon Prokurorinë në qasjen e dokumenteve relevante. E katërta, të zvogëlohen proporcionalisht me qarkullimin edhe kompensimet financiare në paga në PTK, ato s'mund të kalojnë një përqindje të dhënë dhe të arsyeshme dhe s'mund të jenë 40% siç janë sot.

E pesta, pasi të kemi marrë e ndërprerë masat drejt punësimit, pasi të keni zbrazur Telekomën nga punësimet e tepruara dhe pasi ta keni pastruar atë nga aferat korruptive, do të ishte mirë të vendosnim bashkë që ta privatizojmë të njëjtin aset dhe të hapim më tutje tregun, pra ta liberalizojmë atë për ndërmarrje të tjera. Dhe, shpresojmë që Qeveria e Kosovës do t'i marrë këta hapa parasysh. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ :** I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Kurti, zoti Abdixhiku,

Kompania që po flasim ne, Telekom, dikur ka qenë po ashtu së bashku edhe me Postën, një kompani shoqërore, ku në bazë të Rregullores atëherë UNMIK 2005-ën të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, pra ka kaluar, është transformuar në korporatë. Njëkohësisht, nëpër etapa ka ndodhur edhe ndarja e asetëve, por edhe disa funksioneve, një pjesë e këtyre asetëve, pronave dhe disa funksione i janë bartur Postës, një pjesë e funksioneve ose produkteve janë ruajtur për Telekomën.

Që atëherë, kjo kompani në operim, pra është parë si perspektivë e zhvillimit dhe si perspektivë e profitit për buxhetin e për Kosovën, në vitet e hershme ka dhënë dividendë për Kosovën, i ka dhënë para buxhetit. Për fat të keq, pra pas një periudhe të caktuar kohore, kompania ka shënuar rënie dhe kjo rënie tani rezulton me një kompani që ka humbje, që ka minuse të mëdha financiare dhe ekonomike. Nëse mund të flas diçka për numrin e të punësuarve në kompani, për shembull, dua veç t'ju jap pak të dhëna: në vitin 2018 janë punësuar 104 punëtorë, kontratë mbi vepër, tash në këtë vit, mirëpo nuk janë këto rezultat i menaxhmentit të ri, janë vazhdim i logjikës që ka

ekzistuar deri në zgjedhjen e bordit. Vetëm 3 njerëz rezultojnë pas zgjedhjes së Bordit të punësuar, kjo është e vërteta. Vetëm tre vetë janë punësuar pas zgjedhjes së Bordit të ri. Pastaj, ndërhyrja në këtë kompani, unë vetë i kam vizituar Telekomin edhe Postën, pa e ditur se në çfarë gjendje janë. I kam pyetur ata, menaxhmentin, a mund t'i jepni ju Kosovës një plan biznesi? Kur mora vesh se si është gjendja, për t'i dhënë një premtim a një propozim vendit tuaj, se ju mund t'i nxirrni këto kompani në fitim, të kalohet nga kjo gjendje në një gjendje tjetër. E kuptova që kurrkush s'e mori këtë gatishmëri, rezultat i kësaj ndodhi edhe ndryshimi në menaxhment.

Pra, unë edhe atëherë i paralajmërova që ata që dëshirojnë t'i udhëheqin këto me humbje, s'ka logjikë të vazhdojnë. Mirëpo, tash gjendjen çfarë e kemi sot, realisht ju tregoj, kemi trashëguar një gjendje financiare ku borxhi total i kompanisë sot është 60 milionë euro, nga të dhënat që i posedojmë ne. Ky borxh nëpër vite ka vazhduar kështu, do të thotë, në 2015-tën 51 milionë, me radhë nëpër vite, deri në këtë vit janë shtuar 4 milionë, pra me humbjet që ka punuar kompania, por edhe këtë vit është me humbje. Çka e ka shkaktuar një gjendje të këtillë? E para, menjëherë them, menaxhimi i dobët, me krejt projektet, me resurse, mungesa e një plani biznes të mirëfilltë dhe kjo është e vërtetë, se s'ka si të jetë ndryshe në këtë kompani. Pastaj, është pezullimi i investimeve që ka mund të krijojë pozicion më të qëndrueshëm, më të favorshëm në treg. Janë kontratat e dëmshme, kontrata të shumta të llojeve të ndryshme, nuk janë veç një kategori ose një, është një listë e kontratave që janë të dëmshme, janë proceset gjyqësore dhe arbitrazhet e humbura, është mungesa e një strategjie të qartë si të dilet nga kjo gjendje.

Tani menjëherë pas identifikimit të kësaj gjendjeje, ne kemi intensifikuar dhe kemi skanuar gjendjen në kompani, kemi kërkuar ndërprerjen e të gjitha kontratave të tjera komerciale, të cilat lejojnë edhe më tutje funksionimin. Nuk kemi guxuar të kërkojmë ndërprerjen e ndonjë kontrate që e ndal funksionimin ose e ndal ndonjë produkt, por të gjitha kontratat e tjera kemi kërkuar pezullim. Me Bordin e drejtorëve që është tashmë ekzistues, pra që disa janë ushtrues detyre, kemi kërkuar po ashtu prej tyre të themelohet një grup që i vlerëson krejt kontratat e qirave, disa kontrata janë anomali, në total. Po ashtu, kemi kërkuar që të përgatitet një plan, pra që buron prej tyre se si mund ta shmangim falimentimin e ndërmarrjes dhe si mund t'i ndalim humbjet. Edhe ne e kemi propozuar atë që u tha këtu, uljen e shpenzimeve operative, pastaj rritjen e inkasimit, një pjesë e inkasimit nuk ka ndodhur në mënyrën e duhur, në këtë rast edhe institucionet bëjnë pjesë, ka edhe disa elemente të tjera që janë direkt të lidhura, po them ashtu, me marrjen e përgjegjësive në menaxhim. Paga mesatare në Telekom është diku 908 euro, shpenzimet e tjera janë disi të pashpjegueshme gjatë operimit. Disa masa janë më se të nevojshme, të ndalet degradimi i kësaj kompanie është shumë e nevojshme. Arsyeja pse ne i kemi vënë një, po them ashtu, një transparencë gjendjes dhe pse e kemi nxjerrë në dritë këtë gjendje, nuk është vetëm të gjenden fajtorët, se ata i gjejnë Prokuroria, institucionet e rendit, por është të ngrihet edhe vetëdija dhe ta detyrojmë ne veten si ta kthejmë gjendjen në një gjendje tjetër, pra në një gjendje profitabile dhe që mundësisht ta aftësojmë këtë kompani që nesër, kur kalon në treg, ose kur gjen

një partner, ose nëse shkojmë në privatizim të aksioneve, ose çka do qoftë, pra që të mund t'i sjellim profit vendit tonë.

Unë besoj shumë se këto ditë dhe në ditët që shkuan të gjithë e kanë kuptuar që duhet ta gjejmë daljen nga gjendja që është sjellë kjo kompani, po, praktikat e deritashme të menaxhimit, lëshimet që janë bërë, duhet të ndalen. Është mirë t'i shohim krejt elementet që kishin mundur ta kthejmë kompaninë në gjendje funksionale dhe të gjitha kontratat e kësaj kompanie, qofshin me operatorë të tjerë, qofshin të qirasë, qofshin kontrata për shërbime, është mirë të trajtohen me kujdesin më të madh dhe implikimet e tyre, në mënyrë që procesi i mëtejshëm të jetë më i qartë. Unë nuk e kam sot një plan të mirëfilltë të masave, po i kemi identifikuar një numër të këtyre masave që ishte dashur të merren, ne mendojmë po ashtu që edhe ulja e pagave është logjike në këtë rast, pra është logjike, për faktin se, e them edhe një herë, paga mesatare është e lartë, është mbi mesataren e vendit, dhe një ulje për një kohë të caktuar që do të ishte ose 10%, ose ku e di unë, nuk do të ishte rrezik për punëtorët, për përkundrazi, një përkrahje që të nxirret kompania nga gjendja që është. Me këtë nuk po them që barra për ta shpëtuar kompaninë duhet të bie vetëm mbi punëtorët, por ju siguroj që nëse nuk ndërmerret një zinxhirë i masave, pra e uljes së shpenzimeve, e ndërprerjes së kontratave, e ndërprerjes ose e sanimit, ose e mosvazhdimin të kontratave të dëmshme, kompania është në gjendje të vështirë.

Unë apeloj nëse ju bie të udhëtoni, nëse takoni investitorë potencialë, kompani serioze, mirë është Kosova të hapë debat, diskutim, të ftojë investitorë për Telekomin tonë. Në vendet përreth si Deuche Telekom, Vodafone, Orange e kompani të tjera i kanë privatizuar kompanitë, nuk e di si e ka emrin i Austrisë, e tjerë, ose në Serbi, Norvegji, është mirë edhe Kosova ta ndjekë këtë shembull, pra të gjejë ndonjë partner që është serioz, ndonjë kompani që është serioze, e cila nuk do ta komprometonte veten për ndonjë marrëdhënie të kontaminuar me dikë në Kosovë. Pra do të vinte si investitor serioz, nga i cili ne kishim fituar një partner dhe një investitor në këtë rast, por po ashtu edhe kompania kishte mundur të kthehej në trende, në ato numrat, pra, po i quaj edhe një herë fitues.

Kjo është mendoj dalja në fund dhe sa më shpejt që e gjejmë një partner sa më serioz, nuk po flas për këto kombinimet e natyrave të tjera, se për ato kemi bërë përvojë, për shembull, kemi pas hezitime në të kaluarën, por ata që kanë pasur sukses në rajon, për shembull Vodafon, Deuche Telekom, Orange, i Norvegjisë, i Austrisë, kushdo që janë këto kompanitë më të mëdha, të Italisë nëse ka, por kompani të mëdha që janë serioze, që kanë treg global, prej Amerike nëse ka një kompani të tillë, por ata përtojnë të hyjnë se është treg i vogël, larg, po kishte qenë interesant po ashtu të ofrohej një partner sa më serioz, po flas për kompani serioze që operojnë me standarde të larta antikorrupsion. Faleminderit!

KRYESUESI: Minutat e PDK-së, ti diskuto, po diskuto për temën, jo për fshesa. Zoti Beqa e ka fjalën!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, zoti Haliti!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë këtu dola jo të elaboroj temën apo të diskutojmë për temën, që konsideroj që është temë e rëndësishme, por desha për hir të opinionit publik që deputeti i Lidhjes Demokratike, i cili e ngriti këtë çështje, u drejtua nga Partia Demokratike, ndër të tjera tha që ka qenë një kryeshef i Postës, ka qenë kandidat për deputet i Partisë Demokratike.

Unë jam në Partinë Demokratike nga themelimi dhe është mirë të jemi të vërtetë, të mos themi të pavërteta, asnjë kryeshef nuk ka qenë kandidat për deputet në Partinë Demokratike, do të thotë as deputet. Unë e di që në Lidhjen Demokratike edhe sot ka deputet që e kanë të ngrirë pozitën në Postë, ka deputet në këtë legjislaturë aktualisht. Këtë që po e them, zoti Lumir, po ta them vetëm për arsye të së vërtetës dhe është mirë kur të shtrosh çështje serioze, ta thuash të vërtetën për hir të opinionit publik, se atëherë ku të besojmë në ato tabelat që i the, ku ka rënie të të hyrave, ku ka ngritje të punësimeve. Nëse është e pavërteta në start, atëherë ne ku të besojmë në këto tjerat. Është mirë të na sqaroni për hir të opinionit publik, me emër dhe me mbiemër, se kryeshefat kanë emra, kanë mbiemra dhe janë qytetarë të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdixhiku, kundër-replikë!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Unë këtu e kam një fotografi, është Ejup Qerimi, lë PTK-në për PDK-në, ju s'keni nevojë të fshiheni prej njerëzve tuaj, në mos ka qenë kandidat, ka qenë në rend të parë të Partisë Demokratike, këtu po e shoh me Hashim Thaçin dhe me krejt të tjerët. Domethënë, mos u fshihni prej njerëzve tuaj, ju mund të thoni, po, ka qenë anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës, po ta mohoni njeriun tuaj, është pak absurde.

KRYESUESI: E ka kërkuar, po paraprakisht zoti Kurti ka replikë me kryeministrin, e ke kryer ti. Minutat e partisë i keni!

ALBIN KURTI: Për më se një dekadë në Postën dhe Telekomin e Kosovës, posaçërisht në Telekomin e Kosovës janë futur një mori 'kuaj të Trojës'. Nuk ka pasur vetëm një 'kalë të Trojës', ka pasur shumë 'kuaj të Trojës', por ja që edhe një dekadë më vonë nuk e kanë rrëzuar Telekomin e Kosovës. Kjo tregon se sa i fuqishëm e sa fitimprurës është Telekom i Kosovës. Unë nuk pajtohem me kryeministrin, i cili tha që menaxhmenti ka qenë i dobët. Menaxhmenti nuk ka qenë i dobët, menaxhmenti ka qenë i mbrapshtë, se menaxhmenti i dobët i bie që menaxhmenti është dashur të jetë i fuqishëm në drejtimin dhe kahen e njëjtë. Unë besoj që drejtimi dhe kahja janë të mbrapshta. Nuk është problemi menaxhmenti i dobët, nuk është

problemi te mungesa e fuqisë dhe energjisë së menaxhmentit, problemi është te orientimi i gabuar, te drejtimi dhe kahja e mbrapsht e menaxhmentit.

Në Postën dhe Telekomin e Kosovës nuk zgjidhet çështja me investitorët e huaj, sepse është instaluar kleptokracia, për më tepër, investitorët e huaj as që vijnë në këtë situatë. Prej kreut e deri te tenderët më të imët ka kleptokraci, e kanë shndërruar Postën dhe Telekomin e Kosovës, siç e tha një profesor në tryezën e djeshme, “si një thes të shqyer, ku secili që hyn, e shqyen thesin edhe pak”. Nuk ka investime të huaja këtu, edhe pse unë nuk besoj që ato janë zgjidhje në aktualitetin tonë, jo vetëm të PTK-së, dhe kur po them kleptokraci, e kam fjalën që edhe në tenderët kur blihen lapsat kimikë, edhe blloqet e letrës A4 vidhet. Ka shkuar deri në pesëfishin e çmimit të lapsit kimik, pra është një kleptokraci prej lart, e cila e ka përfshirë gjithë sistemin e Telekomit dhe nuk mund të thërrasësh për investime të huaja në këtë situatë, aty ka nevojë për menaxhment të emergjencës, ka nevojë për ndërhyrje të shpejtë dhe për auditim nga Auditori i Përgjithshëm. Pra, ajo çfarë po propozojmë ne është ndërprerje e menjëhershme e kontratës me Z-mobile dhe për hetimin e kësaj kontrate në tërësinë e saj, meqë jam i bindur që do të provonte se kjo kontratë është produkt i krimit të organizuar.

Pra, në Telekomin e Kosovës duhet të kemi menaxhment të krizës që përbëhet prej profesionistëve të dëshmuar në fushën e telekomunikacionit, mbikëqyrje të përgjegjshme publike dhe raportim sipas procedurës ligjore, sidomos këtu në Kuvendin e Republikës. Kjo nënkupton që Qeveria duhet të shkarkojë Bordin dhe menaxhmentin e lartë, duhet të rriten investimet sidomos në përmirësimin e shërbimeve të internetit dhe të televizionit kabllor dhe të vazhdohet me një diversifikim horizontal të produkteve, për shembull, me ofrim të modelit ‘Cloud’ për firmat dhe qytetarët vendorë. Numri i konsumatorëve për shërbime të internetit në Telekomin e Kosovës është zvogëluar për 13% nga viti 2015 në vitin 2016, derisa shumica e konkurrencës së Valës e përdor pikërisht infrastrukturën e Telekomit. Shtrohet pyetja: pse nuk ka të dhëna për shërbimin kabllor? Pse ky shërbim nuk është plasuar në treg? Kush e ka penguar këtë? Shërbimi kabllor ka pasur potencial shumë të madh dhe ende ka. E, sa i përket punësimit, unë besoj që një gjë tjetër është më e rëndësishme se sa numrat. Një person, me emrin i cili fillon me shkronjën G, është person real, ai ka pozitën e drejtorit për hetime dhe antikorrupsion në Postë, sot. Personi G është punësuar në vitin 2003 si rojë, si sigurim dhe ka qenë vetëm me shkollë fillore kur është punësuar. Prej vitit 2003 deri më sot ia kanë kryer edhe shkollën e mesme e ia kanë kryer edhe fakultetin, e kanë pajisur me diploma dhe sot ai person është drejtor për hetime dhe antikorrupsion në Postë.

Për të tregohet një anekdotë e vërtetë: kur ka ardhur në vitin 2003, në ditën e parë të punës, nuk ka zbritur në vendin e duhur prej një rajoni të Kosovës në Prishtinë, por ka shkuar në lagjen “Tophane” dhe në panik e sipër, e merr telefonin dhe e thërret punëdhënësin e vet, i thotë: “Kërkoj falje që po vonohem në punë, sepse më ka dërguar autobusi në Llap”, e punëdhënësi i thotë: “Si të ka çuar autobusi në Llap?”. “Po jam këtu në një vend edhe pyeta ku jam, po më

thonë të Xhamia e Llapit”. Pra, nuk ka zbritur në vendin e duhur prej autobusit dhe e ka thirrur në panik punëdhënësin e vet. Sot ky person me emrin G është drejtor për hetime dhe antikorrupsion në Postë dhe jo vetëm. Ai dy herë është arrestuar për marrje të ryshfetit për punësim, dy herë. Dy herë është arrestuar nga policia për marrje të ryshfetit për punësim dhe e gjithë kjo tragjedi, në fakt, është tragjedi edhe për vetë atë person, sepse ai ka qenë me shkollë fillore, nuk ka faj ai. Ai ka qenë në buzë të ekzistencës, dikush e ka marrë, e ka punësuar si rojë, si sigurim dhe e kontrollon tash e 15 vjet. Pra, nuk ka faj as ai, ka faj urdhërdhënësi, ka faj politikëbërësi, i cili ka qenë rregullisht në këto qeveritë pas shpalljes së pavarësisë.

Pra, ndonëse mund të duket që ky person është kriminel kryesor, në fakt nuk është ashtu. Ka një numër të madh të njerëzve të cilët në këtë krim të organizuar janë manipuluar dhe ndonëse duket që kanë përfituar, janë po ashtu edhe viktimë vetë ata dhe do të duhej të shndërrohen në dëshmitarë të Prokurorisë kur të çlirohet ajo, pasi të marrë fundi shteti i kapur i Kosovës.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, zoti Haliti!

Unë vetëm një sqarim, do të flas shumë shkurt, as një minutë.

Edhe një herë po e përsëris që zoti Lumir e tha një të pavërtetë në emër të Lidhjes Demokratike, sepse asnjëherë nuk ka qenë në listën e Partisë Demokratike kandidat për deputet Ejup Qerimi. Mund t’i drejtoheni KQZ-ë edhe zyrtarisht, nëse është e kundërta jap përgjegjësi për fjalën publike që them. Vetëm për hir të së vërtetës dhe të opinionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, hyjmë sipas renditjes në grupet parlamentare. Po fillojmë, zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Qytetarë,

Kolegë të nderuar,

Kryesues,

Sot flasim për një nga asetet më të rëndësishme që ka Republika e Kosovës. Rëndësia e këtij subjekti nuk ndërlidhet vetëm me arsyet ekonomike, por gjithashtu, çka është edhe më me rëndësi ka një rëndësi vitale strategjike për vendin, për arsye se ndërlidhet me vetë telekomunikimin në vend.

Nëse flasim për PTK-në, vlen të theksohet se mund të kalojnë ditë, javë e ndoshta edhe muaj të tërë duke diskutuar mënyrat e ndryshme sesi kryesisht PDK-ja, siç edhe u diskutua më parë, e ka shkatërruar këtë aset të rëndësishëm të Kosovës. Por, ky është thjesht një sekret publik, që nuk e meriton të diskutohet tutje. Por, në fakt, sot më me dëshirë diskutoj lidhur me zgjidhjen që mund të ofrohet për ta shpëtuar PTK-në nëse kjo veç është e mundur.

Para se të propozohet ndonjë zgjidhje për PTK-në duhet përmbledhur disa nga problemet që duhet adresuar në këtë zgjidhje, e ato janë: keqmenaxhimi ekstrem; politizimi i skajshëm i menaxhmentit; shpenzimet kontraverse; kontratat e dëmshme; humbja e tregut; mbipunësimi; humbjet e rasteve gjyqësore dhe të Arbitrazhit e kështu me radhë. Ta jap vetëm një shembull, një rast i Arbitrazhit, përfaqësuesi në Arbitrazh në gjuhën angleze i PTK-së nuk e flet gjuhën angleze. Tash, paramendoni çfarë angazhimi dhe sa kanë qenë të interesuar për t'i fituar rastet. Por, më e rëndësishmja është se PTK nuk është më likuide. Së paku ashtu na është thënë nga vetë menaxhmenti i tyre. Pra, edhe pse ka asete, të hyrat nuk po ua mbulojnë pagesat që i vijnë gjatë muajve me radhë.

Këto janë probleme konkrete që në fakt kërkojnë zgjidhje konkrete. Edhe pse unë kam dyshim se do të ketë zgjidhje, sepse nuk mund të presim zgjidhje nga ata që janë shkak i shkatërrimit të PTK-së dhe të cilët janë pjesë vendimmarrëse e kësaj shumice minoritare. Janë pikërisht të njëjtit që me vite të tëra e kanë monopolizuar rahatimin e militantëve në këtë institucion nga bordi e deri te punëtori i fundit, rojtari apo edhe pastruesi.

Prandaj, nuk pres shumë nga ju, përpos vazhdimësisë së keqe. Pavarësisht, dua të theksoj një ide sesi të dilet nga kjo situatë. Problemi i PTK-së është se aktualisht është në një gjendje ku ka sulme nga të gjitha anët dhe është duke u fundosur, pa pasur mundësi të marrë frymë dhe të reagojë ndaj sulmeve, kërcënimeve dhe dëmeve që po i shkaktohen nga të gjitha anët. Duke pasur parasysh këtë, ekziston një mundësi ligjore për ta ndihmuar PTK-në. Kjo zgjidhje nuk është infuzioni i parave nga shteti në këtë institucion të krimbur, një infuzion i tillë vetëm sa do t'ia zgjaste "vuajtjen" edhe për një kohë, por në asnjë mënyrë nuk do të ishte zgjidhje. Përkundrazi, veç do ta çonte poshtë tutje paranë e taksapaguesit kosovar.

Pra, ku qëndron zgjidhja? Korporatat anekënd botës, që gjenden në një situatë të tillë, normalisht e futin veten në procedurë të riorganizimit. Edhe pse ndoshta kjo si terminologji mund të ketë konotacion negativ, mirëpo në rastet kur bëhet me qëllim të riorganizimit është zgjidhje e shkëlqyeshme. Kjo procedurë është ajo që i jep kohë këtij institucioni për të marrë frymë. Me rastin e hyrjes në riorganizim shpallet moratorium, me ç'rast pezullohen të gjitha sulmet dhe kërkesat, pra PTK-ja e fiton mundësinë që në rrethana pa kërcënime dhe presion të vendosë sesi të dalë nga kjo krizë.

Është pikërisht gjatë kësaj procedure që mundësohet paraqitja e një plani të riorganizimit. Plani i riorganizimi nënkupton, ndër të tjera, identifikimin e problemeve, si dhe adresimin e tyre si çështje që e kanë sjellë PTK-në në prag të varrit. Më pastaj, si pjesë e planit të riorganizimit ofrohen zgjidhje konkretet sesi PTK-ja të nxirret nga kriza aktuale. Pra, si të rimëkëmbet ajo dhe si të kthehet si konkurrent i denjë në treg? PTK-ja del nga procedura e riorganizimit vetëm pas zbatimit të plotë të këtij plani. Tash, shtrohet pyetja se kush e bën këtë plan të riorganizimit? Këtu në fakt qëndron sfida e madhe, kush do ta bëjë atë?



Ata që e sollën këtu, keqmenaxhmenti i sotëm, të njëjtit që do t'i falimentonin edhe kompanitë e famshme, si Amazon dhe Google së bashku, e lëre më PTK-në? Dyshoj!

Prandaj, zgjidhja, përkatësisht hartimi dhe zbatimi i një plani të suksesshëm të riorganizimit është po aq i mundshëm aq sa ka angazhim të sinqertë të njerëzve të duhur e jo tezakëve, miqve, truprojave, militantëve, siç e kemi pa që po e bën edhe kjo Qeveria e fundit.

PTK-ja mund të shpëtohet dhe kjo mund të arrihet me hartimin dhe zbatimin e një plani të duhur të riorganizimit, sepse problemi i PTK-së është financiar, ndër të tjera, dhe më pak i ndërlidhur me modelin ekonomik. Në botë sot kompanitë më të fuqishme ndoshta janë vetë ato të telekomunikacionit, me ç'rast edhe kuptohet që modeli ekonomik nëse udhëhiqet dhe menaxhohet mirë është i suksesshëm.

E problemet financiare me të cilat aktualisht ballafaqohet Telekomit janë dhe mund të kurohen, mirëpo se a shpëtohet varet nga ajo se cili është qëllimi juaj, a e keni sinqerisht qëllimin e shpëtimit të PTK-së, apo thjesht krejt çka po bëni është të vazhdoni ta shkatërroni me qëllim të blerjes së PTK-së nga grupet e juaja të interesit me çmim të lirë, siç keni bërë me rrjetin e Distribuimit, tokat bujqësore e shumë asete të tjera. Së paku mos na humbni kohë, na tregoni nëse ky është qëllimi, që ta kursejmë qytetarin këtij vendi që mund eventualisht t'i prezantoni. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë, veçanërisht punëtorë të dy ndërmarrjeve, Teleomit dhe Postës së Kosovës,

Unë dhe grupi i PDK-së e ka pritur me kënaqësi iniciativën për këtë debat. Prita që në fillim që së paku prej kolegëve që kanë orientim profesional në këtë drejtim ta bëjnë një ndarje. Pra, u fol për Telekomit, por nuk u fol asnjë fjalë për Postën e Kosovës. Kështu që më lejoni që unë të koncentrohem kryesisht te problemet, problematika dhe funksionimi i Postës së Kosovës.

Mund ta marr me mend se me sa kureshtje dhe ankth do të përcjellin, të nderuar kolegë deputetë, këtë debat sot, qindra punëtorë në Postë dhe Telekom. Pra, ka disa muaj që punëtorët e Postës, pra qindra postierë dhe punëtorë të tjerë në këtë ndërmarrje nuk arrijnë ta marrin pagën si krejt sektori publik, por me vonesa deri në mesin e muajit për shkak të problemeve financiare që janë grumbulluar, edhe nga mungesa e përkrahjes institucionale dhe pamundësia e operimit të kësaj ndërmarrjeje, e cila në të gjitha vendet e rajonit e më gjerë mbështetet me shërbimet që ofron shteti. Duke mos e pasur për vite me radhë këtë mbështetje, menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje ka

kërkuar mbështetjen në formën e duhur zyrtare nga ne. Pra, secili deputet sot e ka pasur në kutitë postare shkresën ku na adresohet personalisht secilit deputet me kërkesat dhe orientimet strategjike sesi mund të dalë nga kriza ndërmarrja e Postës.

Pamundësia e funksionimit të mëtutjeshëm ka bërë që muajve të fundit kjo ndërmarrje të ketë problem edhe me sigurimin e pagave, ku pastaj kjo gjë bëhet duke ndarë pjesëshëm pagat dhe këto fillimisht për kategorinë e punonjësve të angazhuar si postierë, e dikur kah mesi i muajit edhe për pjesën tjetër.

Shkak për këtë gjendje është edhe qasja shumë neglizhuese e Qeverisë dhe ministrisë përkatëse, por edhe e ministrave të kaluar lidhur me gjendjen e rëndë financiare funksionale që po e kalon Posta e Kosovës, si një ndërmarrje publike qendrore, e cila u pavarësua pas ndarjes nga PTK, që nga viti 2012. Ligji për shërbimin postar e obligon Postën që ta kryejë shërbimin universal postar, që kjo ndërmarrje kryen me shumë përgjegjësi, e që i bie, po e sqaroj teknikisht, një dërgesë e thjeshtë që vjen prej një gjykate dhe duhet të shkojë në një fshat të thellë të komunës, për shembull, Dragash, Prizren, Mitrovicë, ose kudo në Kosovë, e ka një çmim për shembull 0,40 centë.

Këtë tarifë për çdo vit e cakton dhe monitoron ARKEP-i si një organ kompetent. Posta obligohet ta dërgojë qoftë edhe vetëm një shkresë të vetme, edhe si letër rekomanduese, edhe si shërbim ditor, dhe kjo pastaj e ka një kosto, e cila mund të arrijë deri në 40 euro në ditë, sepse përfshihen të gjitha shpenzimet tjera dhe të cilat arrijnë këto vlera gati çdo ditë. Andaj, edhe janë krijuar humbjet të cilat me ligjin postar është dashur çdo vit t'i mbulojë MZHE. Këtë shërbim nuk e kryen asnjë ndërmarrje private, sepse është pa llogari fitimprurëse për ta. Të njëjtin shërbim postar simotra e kryejnë në tërë rajonin, por krejt postat në rajon, përfshirë edhe Shqipërinë, i kanë të marra shërbimet sociale, ndërsa shteti ynë ia ka ofruar vetëm skemat sociale. Me ligjin për shërbimet postare, MZHE ka obligim që humbjet që i krijohen Postës me shërbimin universal duhet të mbulohen. Për këtë ka edhe marrëveshje që nga viti 2014, por kurrë asnjëherë nuk është implementuar.

Janë me dhjetëra shkresa të kaluara nëpër gjykata e përmbaures, ku secila ia jep të drejtën ligjore Postës dhe ende asnjë ekzekutim me asnjë cent s'u ndihmua. Menaxhmenti dhe Bordi i kësaj ndërmarrjeje konkretisht edhe kryeshefi kanë bërë përpjekje titanike dhe arritën që t'i shtojnë shërbimet e Postës me shërbime inovative, por përsëri e pamjaftueshme për t'i përmbushur obligimet dhe me detyrimet e pagave për punëtorët dhe në operim në përgjithësi.

Gjithë këta muaj s'ka lënë derë qeveritare pa trokitur dhe deputet pa takuar, pra duke e ndjekur rrugën institucionale dhe ende nuk u ndihmua. Sot po ashtu, pra po e theksoj edhe një herë, edhe një herë u tentua që ne të bindemi dhe të marrim parasysh duke na dërguar një dokument

orientues sesi mund ta ndihmojmë që të mos vdesë kjo ndërmarrje. Ky menaxhment e ka sqaruar shumë mirë çfarë duan. Duan shërbime dhe punë, dhe nuk po kërkojnë asgjë falas.

Si është e mundur që nga viti 2012 shërbimet sociale t'i marrin bankat komerciale dhe plus të kemi humbje si institucione duke paguar me tarifa të larta, e të mos i jepen Postës shërbimet e skemave, me të cilat këta do t'i kishin nxjerrë shpenzimet e veta si ndërmarrje. A mos dikujt i ka konvnuar që bankat komerciale t'i kryejnë këto shërbime dhe asete që ne vetë i ndërtojmë. Ne vetë i ndërtojmë si shtet, t'i shkatërrojmë dalëngadalë. Ministri aktual, i nderuari ministri Lluka, është pajtuar në parim për disa shërbime nga institucionet e Kosovës, siç janë pra 20 skema sociale, pensionale, shërbimet postare nga MPJ, vendosja e zyrave postare në institucione publike e shtetërore, ku qytetarët mund t'i kryejnë pagesat dhe kjo ndërmarrje të mëkëmbet shumë shpejt.

Menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje i ka ulur pagat dy herë radhazi, por kjo nuk ka mjaftuar që të stabilizohet gjendja. Çdo muaj negociohet me punëtorë që të mos shpërthejnë në protesta, sepse menaxhmenti dhe Bordi i kësaj ndërmarrjeje kanë shpresa te ne si Kuvend dhe si Qeveri.

Dhe, krejt në fund, asgjë s'po kërkojnë, pra përveç të së drejtës ligjore që ne ua kemi miratuar vetë me ligj si Kuvend. Po kërkojnë shërbimet që të mbijetojnë, pra duan punë, dhe në shkresat që i kemi përpara i kemi të gjitha shërbimet të cilat ata i kërkojnë që t'u ofrohen dhe këta të dalin nga kriza me punën e vet.

Më lejoni që në shpejtësi t'i lexoj. Pra, pensionet bazë, pensionet e personave me aftësi të kufizuara, pensionet bazë jokontributdhënëse, pensionet për të verbrit, pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, pensionet e pjesëmarrësve të TMK-së, skemat sociale, kompensimet e familjeve dhe të gjithë i kemi përpara, pra mos t'i renditi, sepse janë shumë, por me mundësi që t'u ofrohen këto shërbime nga shteti, Posta do të dalë nga kriza.

Unë jam e sigurt që deputetët kolegë të mi që janë në komisionin përkatës e njohin këtë çështje edhe më mirë se unë, mirëpo ne kemi obligim si deputetë që secili ta japim kontributin tonë. Por, më lejoni me shumë respekt, i nderuar kryeministër, të them që në këtë mandat të kemi ty zot shtëpie dhe duhet ta përkrahni dhe ta udhëzoni ministrin e Zhvillimit Ekonomik që mjetet e takuara për humbjet në vitin 2017 t'i barten kësaj ndërmarrjeje, pra e kam fjalën për Postën, po e sqaroj edhe një herë.

Nuk na jepet komoditeti të qëndrojmë dhe të shikojmë sesi po shkatërrohen institucionet që në krejt botën kurrë nuk privatizohen. Është pra Posta, njëra ndër to. Pra, të mos presim që të na vijjnë mijëra punëtorë këtu në shesh, pastaj ne të veprojmë. Sipas obligimeve që kemi secili me punën e vet, duhet të veprojmë.

I nderuar kryeministër,  
Ministër,

Unë ju gëzova lajmit për mbështetje për Ferronikelin, sepse janë edhe aty me qindra familje që presin bukë nga ajo fabrikë. Le të veprohet njëjtë, sepse me një vullnet pozitiv kjo ndërmarrje mund të mbijetojë dhe të forcohet shumë, por duhet ofruar dorën, sepse është duke u fundosur. Punëtorët na drejtohen neve deputetëve për ndihmë, sepse jemi të zgjedhurit e tyre. Pra, t'i respektojmë këto shkresa zyrtare dhe kërkesën e menaxhmentin në mënyrë shumë të arsyeshme, që ne t'u ofrojmë punë, shërbime dhe ata të mbijetojnë vetë.

Unë pres që pas këtij debati të bashkohemi me rekomandime, sepse në rekomandime mendoj se duhet ta vendosim edhe pjesën që vetë Posta propozon, pasi u fol veç për Telekomin, propozon zgjidhje, dhe pastaj sigurisht se do të bashkohemi edhe rreth votimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë,

Unë në emër të grupit do ta lexoj një letër të ekspertit të telekomunikacionit, profesorit Ismet Hamiti:

*Letër pa zarf Prokurorit të Shtetit*

“I nderuar Prokuror i Shtetit,

Ju shkruaj për të paraqitur një krim kundër pasurisë dhe interesit publik. Nëpërmjet kontratës së PTK-së me Z-Mobile është krijuar një mekanizëm legal për plaçkitjen e pasurisë publike me përmasa të mëdha, ideatorë të së cilit janë individë me nivelet më të larta të pushtetit e zaptues janë veglat e tyre në PTK dhe në institucionet e shtetit.

Zbatimin e nisën Etrur Rrustemaj dhe Ilir Salihu, me anëtarët tjerë të Bordit, e licenoi Anton Berisha, e miratoi me shumë zell Rexhë Gjonbalaj me anëtarët tjerë të Bordit dhe e nënshkroi Shyqyri Haxha, e mbrojti Ahmet Shala dhe heshti për të Agim Çeku. Dhe, nuk vepruan shumë zyrtarë të tjerë që kishin dijeni për të, përfshirë edhe individë në sistemin e ndjekjes dhe atë të drejtësisë.

Dëmi që i është shkaktuar interesit publik me këtë kontratë është baras me të gjitha të hyrat e Z-Mobile, që nga ekzistenca e kësaj kontrate deri më sot dhe rritet për çdo ditë që kalon. Po të mos ekzistonte kjo kontratë, të gjitha këto të hyra do të ishin të PTK-së. Sikur e gjithë kjo të mos mjaftonte, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj e inskenuan humbjen e arbitrazhit, me të cilën synojnë të plaçkiten edhe 30 milionë të tjera të pasurisë publike. Krejt kjo paraqet shembull

shkollor të krimit të organizuar që për nga përmasat e dëmit të shkaktuar dhe numrit të individëve të përfshirë është ndër më të mëdhenjtë në gjithë kohën e pasluftës.

Nismëtarë të zbatimit të krimit ishin drejtori i PTK-së i asaj kohe Etrur Rustemaj dhe Bordi i PTK-së, i përbërë nga Ilir Salihu, kryetar dhe anëtarët Jasper Dik, Enver Xharra, Patrik Robin, Varden Leen, Edmond Hajrizi dhe Isa Krasniqi. Këta individë janë përgjegjës për shpalljen e publikuar më 30 mars 2007, të titulluar “Mundësi atraktive për operatorët mobilë virtualë”, me të cilën shprehej interesi i PTK-së për ndërmarrje të përbashkët me operatorët e mundshëm të rrjetave mobile virtuale. Me këtë shpallje ata kërkonin operator virtual, i cili duke e shfrytëzuar infrastrukturën e PTK-së do të ofronin të njëjtat shërbime që ofronte PTK-ja. Me një fjalë, këta individë shpallën tender për t’i krijuar konkurrent kompanisë që e drejtonin ata vetë edhe atë me pasurinë e vetë kompanisë, rast ky i pashembullt në universin biznesor në botë. Mund të dëshmohej lehtë se ky veprim ishte në dëm të PTK-së dhe të interesit publik, prandaj e përbën një krim të rëndë.

Nëse kësaj i shtohet fakti se këtë veprim ata e kanë kryer me porosi dhe për interes të individëve të paracaktuar, ata i bën pjesëtarë të një grupi më të gjerë kriminel.

Anton Berisha, kryetar i atëhershëm i Autoriteti Rregullator të Telekomunikacionit, është po ashtu pjesë e krimit, sepse jo vetëm që nuk i pengoi veprimet skajshmërisht të dëmshme për interesin publik, e që e kishte detyrë themelore, shkeli çdo gjë që mund të shkelej dhe e licenoi operatorin virtual të zgjedhur nga Bordi dhe menaxhmenti i PTK-së, në bazë të shpalljes së datës 30 mars 2007. Prandaj, si nënshkruer i licencës ai është përgjegjës për plaçkitjen e pasurisë publike nëpërmjet Z-Mobile që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Rexhë Gjonbalaj me anëtarët tjerë të bordit të përmendur më sipër janë përgjegjës për miratimin e kontratës, kurse Shyqyri Haxha, ish-drejtor i PTK-së, është përgjegjës për miratimin në bord dhe nënshkrimin e kontratës me Z-Mobile. Dëmi që i është shkaktuar interesit publik me këtë kontratë është baras me të gjitha të hyrat e Z-Mobile që nga ekzistenca e kësaj kontrate e deri sot, që mund të dihet lehtë dhe rritet për çdo ditë që kalon. Po të mos ekzistonte kjo kontratë, të gjitha këto të hyra do të ishin të PTK-së. Prandaj, këta individë me miratimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate kanë kryer krim të rëndë kundër pasurisë dhe interesit publik.

Ky krim kishte mbrojtës të zellshëm në pozita të larta zyrtare. Në mbledhjen e Parlamentit më 26 shkurt 2009, duke iu përgjigjur pyetjeve të përsëritura të disa deputetëve, ministri i atëhershëm i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, jo vetëm që e mashtroi Parlamentin që është në vetvete veprim i dënueshëm, por ai edhe e mbrojti me këmbëngulje kontratën me Dardafonin, më vonë të transformuar në Z-Mobile, duke e kualifikuar atë si marrëveshje legjitime dhe të dobishme afariste. Ky individ duhet patjetër të shpjegojë se përse e bëri këtë në kohën kur nuk kishte njeri

në këtë vend që nuk e kuptonte se kontrata e PTK-së me Dardafonin ishte e kurdisur për individë të caktuar dhe skajshmërisht e dëmshme për interesin publik.

Ky zyrtar, jo vetëm që nuk e pengoi, gjë që e kishte për detyrë, por ai edhe e arsyetoi krimin në autoritetin më të lartë të vendit, në Parlament. Prandaj, Ahmet Shala ka kryer krim për mospendimin dhe arsyetimin e këtij krimi dhe për këtë duhet nxjerrë para drejtësisë.

Por, për përgatitjen e këtij krimi ishin të njoftuar me letrën time (pra të profesor Hamitit), të datës 27 maj 2007 edhe në OKB, në Nju-Jork, zyrtarët kryesor të UNMIK-ut në Prishtinë dhe kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Agim Çeku. Nuk jam në dijeni të asnjë veprimi nga ata për ta penguar këtë krim. Do të ishte më se normale që Prokuroria të interesohej se pse Agim Çeku nuk e bëri atë për të cilën ishte paguar. Pse nuk e pengoi krimin, për të cilin kishte dijeni dhe pse e kishte mbrojtur krimin duke heshtur për të?

Me mosveprimin e tij ai ka ndihmuar kryerjen e këtij krimi dhe duhet të konsiderohet pjesë e këtij grupi kriminal dhe të japë llogari para drejtësisë.

Edhe humbja në Arbitrazh është skemë e ideuar nga nivelet më të larta të pushtetit, ndërsa zbatuesit janë Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj. Me të vërtetë, kjo skemë nuk është aspak origjinale, sepse zbatohet për plaçkitjen e pronës publike gjithandej në vendet ku sundon krimi e korrupsioni. Në këtë rast, në këtë skemë synohet të plaçkiten edhe mbi 30 milionë euro të pasurisë publike dhe ata individë që e kurdisën krejt këtë janë pjesë e të njëjtit grup kriminal. Nuk ka asnjë dyshim se të gjithë këta individë dhe të tjerët, që hetimet do t'i zbulojnë, sidomos ndër ata që ishin në bordet e PTK-së që nga viti 2007, e që nuk u përmendën këtu me veprimet dhe mosveprimet e veta e kanë bërë këtë krim. Por, po ashtu nuk ka asnjë dyshim se të gjithë këta janë vegla të individëve në nivelet më të larta të pushtetit, që janë kupola e këtij krimi të grupit kriminal të organizuar.

Prandaj, ju drejtohem me respekt që të ndërmerrni krejt çka është e nevojshme që të ndërpritet plaçkitja e pasurisë publike e përmasave të mëdha dhe që grupi kriminal që e ideoi dhe ezbatoi kontratën me Z-Mobile të sillet para drejtësisë”.

Edhe në emër të Grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne i kërkojmë Prokurorisë që të mos zbrapset para grupeve kriminale dhe ta hetojë gjithë këtë degradim që ia shkaktuan Telekomit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar i kryeministër,

I nderuar ministër i Zhvillimit Ekonomik,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, ekonomia e Republikës së Kosovës ka 18 vjet që është duke u rënduar nga një model ekonomik, i cili sillet rreth dy të pavërtetave të mëdha. E pavërteta e parë është që fjala infrastrukturë është e barabartë me fjalën “asfalt” dhe me dënimin e fundit me Bechtel&Enka e kemi parë edhe këtë.

E pavërteta e dytë është që privatizimi i pronës publike sjell deri të zhvillimi ekonomik. Por, që të dy këto të pavërteta s’janë as më shumë e as më pak se retorikë e domosdoshme për të gjitha qeveritë e deritanishme dhe përdoret vetëm si zëvendësim i vobektë i një plani zhvillimor, i cili secilës Qeveri i mungon tash e 18 vjet.

Rrallëherë mund të gjendet ndonjë proces ekonomik, i cili mund të gjykohet pa ndonjë provë empirike, apo hulumtim të mirëfilltë. Por, ja që e pavërteta e dytë, procesi i privatizimit në Kosovë është i tillë, pra nuk kemi nevojë as për hulumtim e as për provë empirike, sepse thjesht mund të konkludojmë se ka qenë gjithçka, përveçse i suksesshëm.

Tash dy dekada më vonë, ky proces nuk ka sjellë as vende të reja të punës, nuk ka krijuar as ekonomi të strukturuar e të qëndrueshme, nuk ka krijuar as efikasitet ky fetish i këtij modeli ekonomik dhe nuk ka asnjë të mirë sa i përket punësimit.

Të qartësohem, që të mos keqkuptohem, këtu tendenca për të keqkuptuar diskutime ekonomike është e jashtëzakonshme.

Nuk po them që privatizimi nuk mund të jetë i dobishëm, por është i dobishëm vetëm në raste kur ai shihet në kuadër të një strategjie të mirëfilltë zhvillimore, e jo si qëllim në vetvete.

Ky është pikërisht momenti që na paraqitet tash e dy dekada, që privatizimi është qëllim në vetvete dhe ky model i privatizimit na ka sjellë, siç e thashë, barabartë me zero punësim, barabartë me zero ekonomi të strukturuar e hiç më pak përfitime financiare, sepse që të dyja këto modele, edhe asfalti, edhe privatizimi, veç po na rëndojnë me dënime në arbitrazh e dënime në mospagesa.

Por, siç shihet, tashmë po vjen radha edhe te asetit tjetër strategjik, Posta edhe Telekomit i Kosovës, përkatësisht Telekomit i Kosovës, sepse ne e privatizojmë potencialin e profitit, e nacionalizojmë humbjen. Asete që janë ndërtuar nga publiku, nga qytetarët e Kosovës, e që kanë qenë në funksion të qytetarëve.

Për privatizimin e ndërmarrjeve publike duket se secila Qeveri tash e 18 vjet ka marrë mësim nga një metodë që mësohet në shkollat e biznesit, e që i thonë “Management Buyouts” (blerje nga

menaxhmenti). Kjo metodë është e ngjashme në të gjitha aspektet ligjore dhe financiare sikurse shitblerja e thjeshtë e një kompanie tjetër.

Por, e veçanta e kësaj metode është në faktin se blerësit janë menaxherët ekzistues të kompanisë, në këtë rast Qeveria dhe qeveritë e deritanishme.

Pra, këta menaxherë përveç që e njohin kompaninë në detaje, ata janë gjithashtu të interesuar të bëhen pronarë me çmim sa më të ulët të mundshëm, rrjedhimisht këta menaxherë, pra qeveritë e zhvlerësojnë kompaninë deri në pikën ku arrin ajo të bëhet e kapshme për xhepat e tyre apo biznesmenëve që ata i përkrahin dhe, në këtë pikë ata e blejnë kompaninë, duke u shndërruar menaxherët, në këtë rast qeveritarët, në pronarë të kompanisë.

Pra, shndërrohet prona publike në pronë private me çmimin më të ulët të mundshëm.

Le ta analizojmë pak çka ka ndodhur me PTK-në, më saktësisht prej vitit 2008.

Qeveritë prej këtij viti, së paku prej këtij viti, po flas prej vitit të pavarësisë, kur kemi filluar një farë diskutimi për mirëqenie e zhvillim, tashmë pasi e kemi tejkaluar një prej sfidave, ende të patejkaluar edhe sot e kësaj dite, sido që të jetë.

Prej këtij viti qeveritë me borde, drejtorë, punësime partiake e parapartiake, me ndalimin e investimeve në PTK kanë tentuar dhe në masë të madhe deri vonë e kanë zhvlerësuar PTK-në, por sa për informacion, deri në vitin 2013 ose 2014, nëse nuk gaboj, PTK-ja ka gjeneruar fitim, deri në 60 milionë ka qenë fitimi, më duket dhe kjo ka shkuar si devidentë në shtet.

Dhe çka ka ndodhur? Sot, në vitin 2018, obligimet e një aseti strategjik janë 60 milionë euro, afro 60 milionë euro dhe, në fakt, e kemi zhvlerësuar ndërmarrjen publike dhe e kemi bërë të gatshme për shitblerje. Ata që e kanë zhvlerësuar, ata do të bëhen tash ithtarët më të mëdhenj të privatizimit.

Pra, siç duket, zhvlerësimi është metoda, shpronësimi është qëllimi, e privatizimi është modeli, me të cilin tash e 18 vjet po e trajtojmë secilën ndërmarrje publike e që mund të jetë aset strategjik për zhvillim.

Pra, unë pretendoj edhe e them sot këtu kjo që shohim në Telekomin e Kosovës është gjithçka përveçse privatizim. Është gjithçka përveçse zhvillim, është thjesht përgatitje për shitblerje nga aktorët tashmë të njohur.



Secili shtet që synon zhvillimin dhe rritjen ekonomike, e kupton që pronësia mbi asetet strategjike, sidomos pronësia mbi shumicën e aksioneve në asete strategjike, është esenciale për zhvillim të një vendi.

Pra, kushdo që ia dëshiron të mirën Kosovës, e aq më pak tash, nuk do të mendonte fare për privatizim të kësaj ndërmarrjeje, por do të mendonte për revitalizim të kësaj ndërmarrjeje.

Nëse edhe një herë i shohim 18 vjetët e fundit, do të kuptojmë që privatizimi thjesht nuk ka sjellë asnjë dobi ekonomike. Po të ishte ashtu, atëherë Telekom i Sllovenisë, i cili është pronar i IPKO-s, do të privatizohej, pronë e Telekomit të Sllovenisë, pronari i Telekomit të Sllovenisë është shteti slloven me 62.5% të aksioneve dhe po ky shtet slloven sot në Republikën e Kosovës gjeneron 70 milionë euro qarkullim, me 33% tregut, ndërsa Telekom i Kosovës, me 67% të tregut i qarkullon të njëjtat numra.

Pra, në fakt, tashmë është e qartë që zhvlerësimi deri në privatizim, pra shitblerja është qëllimi, e jo revitalizimi apo shndërrimi i Telekomit në një aset strategjik.

Për informacion tuajin, gjithashtu edhe Deutsche Telekom shumicë kryesore të aksioneve ka shtetin gjerman, pra një shtet të cilin ne e marrim si shembull. 32% të aksioneve në Deutsche Telekom janë pronësi e shtetit gjerman dhe Bankës Investive.

Pse në Republikën e Kosovës nuk mund t'i mbajmë, të themi 32% në pronësi publike, ndërsa pjesa tjetër të jetë pronë e një fondi sovran, i cili zhvillon industrinë si Telekom, si energjetika, si minierat.

Pra, dhe këtë mund ta bëjmë, meqë jemi, përsëri po e them, shteti me kursimet nacionale më të mëdha në rajon.

Edhe disa elemente që po dua t'i potencoj sot këtu sa i përket Telekomit.

E kam të qartë që situata në të cilën ndodhet Posta dhe Telekom i Kosovës është e vështirë, po gjithashtu dua të them që kur ndalen investimet në potencial të rritjes së një biznesi, atëherë tregu për të bëhet problematik.

Posta dhe Telekom i Kosovës kanë infrastrukturë të jashtëzakonshme sa i përket shtrirjes infrastrukture, të themi, rrjetit për televizion, rrjetit për internet. Shtrirje më të mirë se konkurenti, i cili është në treg, por gjithsesi treg shumë më pak, sepse në një moment të caktuar kohor Qeveria ka marrë vendim, jo kjo Qeveri, qeveritë e kaluara ka marrë vendim që të ndalin secilin investim të mundshëm që mund të rriste vlerën e këtij aseti strategjik.

Dhe, rruga përpara tashmë është e qartë dhe e thjeshtë: në vend të punësimit, investim në shtrirjen e tregut edhe për shërbime të tjera që mund të japë Telekomit.

Në vend të ndarjes së qarkullimit apo ndaljes së shitjes në mes të Telekomit e Z-Mobile, shitje vetëm për Telekom. Në vend të qasjes si aset, i cili duhet zhvlerësuar për shitblerje, qasje si aset nacional, i cili mund të zhvillohet dhe të gjitha këta janë hapa të thjeshtë dhe konkretë.

E vetmja që duhet, kryeministër, është vullneti politik për t'iu përqsuar Telekomit të Kosovës si aset, i cili mund të zhvillohet, e jo si aset, i cili duhet zhvlerësohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Ne tani e kemi një interpelancë, e cila është thirrur nga dy parti politike dhe me vetë faktin që është thirrur nga dy partitë tregon se ka pasur garë se cila do të marrë më shumë hapësirë për debat, e konsideroj se debat ka pasur për 18 vjet sa i përket Postë Telekomit të Kosovës.

Gjatë këtyre viteve, në të gjitha mandatet është folur për keqmenaxhim, është folur për 'futje të duarve' të politikës në Postë Telekomit e Kosovës, madje edhe një aset, i cili është konsideruar që do të ketë vlerën e diku një miliardi, tani ka mbërritur deri te falimentimi që tregon se vërtet kjo ndërmarrje publike është shkatërruar dhe i ka protagonistët e saj.

Unë i kuptoj ata që nuk kanë pasur qasje në qeverisje, që nuk i kanë futur duart në Postë Telekomit e Kosovës, por nuk mund t'i kuptoj ata që kanë qenë drejtpërdrejt të involvuar në këto procese dhe e kanë pruar në këtë gjendje të rëndë Telekomit e Kosovës.

Para se të kritikojmë, të piskasim e të gjejmë sa më shumë fajtorë në të kaluarën, unë konsideroj se tani duhen ide dhe strategji që Postë-Telekomit e Kosovës ta nxjerrin nga kriza që është. Nuk ka nevojë të zbulohet uji i nxehtë, si thonë, po duhet të shikohen modelet më të mira që i kanë bërë vendet, sidomos ato në transicion dhe të merret një model me specifikat që i ka Kosova, e të gjendet zgjidhja e duhur.

Vetëm një strategji me ide reale dhe me një përgjegjësi të lartë të ekspertizës që mund të bëhet, mund ta nxjerrë Telekomit nga kriza.

Unë nuk po e zgjas më shumë, por konsideroj nëse nxirret një rezolutë në këtë Parlament, duhet të jetë e përbërë nga analiza, e cila duhet të bëhet mbi gjendjen dhe idetë mbi të cilat duhet të dilet nga kjo gjendje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Së pari rreth paraqitësve të rezolutës.

Kjo rezolutë hiç nuk i ka shkuar Vetëvendosjes dhe LDK-së, Vetëvendosjes po, po është dashur të vijë me neve ta bëjnë, sepse të bësh rezolutë me ata që e kanë vjedhur Postë Telekomin e Kosovës, të bëhesh bashkë me hajnat, po më duket pak e çuditshme. Tash çka po flas, ju kallëzoj.

Nganjëherë Vetëvendosja po i shkel do parime që do t'u kushtojë shumë në të ardhmen, në zgjedhje të lira.

Është një kryetar i komunës, nuk po ia tregoj emrin kush është, nuk po flas për Ramiz Lladrovcin, po, po ndodhi të thotë që “ka me u kthye Serbia këtu e hajde bëjmë bashkë koalicion”, unë me ta nuk bëj koalicion. I them: “Le të kthehet Serbia, po me ty nuk bëj koalicion”.

Tani, para se të hyj në temë, i kam krejt minutat, edhe të PDK-së, edhe të këtyre, se m'i kanë falur krejt, do t'i përgjigjem Naser Rugovës e t'i tregoj çfarë hipokriti, dallaveraxhi e demagog është.

Diogjeni ishte lodhur prej grekëve në Greqinë e Lashtë antike, se ai e heq veten si intelektual, a e keni parë, thotë unë jam... ia merr mendja që kur flet ai, krejt i ndalin çezmat, as bardakët e çajit s'i lajnë veç ta dëgjojnë Naser Rugovën çka po flet.

E Diogjeni, baci Adem, ishte lodhur prej grekëve pisa, sikur unë qysh jam lodhur prej Naser Rugovës, edhe hi ai në kacë të rasoit. Kur hyn aty, shkon një grek i thotë: “A mundem, bre Diogjen, të të ndihmoj diçka?” I thotë: “Po, shumë më ndihmon ti, veç lëshomi rrezet e diellit”.

Jam lodhur, bre, prej njerëzve hipokritë, unë ndoshta flas ndonjëherë pa lidhje, ndoshta flas edhe banalisht, po nuk bëj punë banale. Disa bëni punë banale e dilni këtu dhe mendoni që ky popull i shkretë e qytetarët janë budallenj, janë ahmakë, janë injorantë, po na jemi në rëntgenin e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, leni hipokrizitë, sepse unë çka të flas, mendoj që më dëgjojnë katër vajzat e mia dhe, në qoftë se njëra prej çikave të mia më thotë: “Babë, ke përdorur një shprehje pa lidhje”, atëherë

unë e ndali dhe..., lini hipokrizitë, lini marritë, lini ata që i thonë femrës ‘motra jem’, e pastaj i thonë: “Hajde shkojmë në atë pushimin ditor në dash me të shti në punë”, lini këto marri!

Tash po kaloj te Postë-Telekomi i Kosovës, këtu dua të dal tash.

Së pari, krejt hajnat dhe dallaveraxhinjtë në Postë-Telekomin e Kosovës i përbëjnë PDK-ja e LDK-ja. Ne Nisma dhe AAK-ja ende s’na ka ardhur rendi, tash ia kemi nisur të vjedhim, se tash jemi në pushtet. Ti për Fatmirin, nëse ke diçka urdhëro, dil e fol deri në sabah, po kur ta bëke ky ‘ciu-ciu’, nuk folje hiç, Kadriu, lëri ti ato llafe, Kadriu e Fatmiri, mos fol prej vendit, dil çka duash për Fatmir Limajn fol, të lutem mos fol prej vendit, çka duash fol, hiç nuk prekem, veç a ke fakte. Nëse ke fakte kundër gruas time, dil e fol këtu, se jo më për Fatmir Limajn, s’jam i martuar me Fatmir Limajn, leni këto marri. Prej vendit mos bëni ‘dert e vërt’.

Po kalojmë te Posta, te Bordi. LDK-ja, nuk po flas për juve djemtë e rinj që keni ardhur, po më tregoni ju kush është reja e nënkryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës me emrin Metije Jashari që ka qenë në Bord të Postë-Telekomit të Kosovës, një.

Kush është Mehdi Gjokli, janë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pse këta të Bordit nuk thanë po vidhet Posta e t’ju informojnë juve qysh po më informojnë njerëzit dhe të dilet këtu në foltore e të thuhet se u shkatërrua Posta.

E tash, unë po kaloj te gjërat që i kam ngritur këtu para tetë muajve për kryekriminelin e Postës që e ka fundosur, për Agron Mustafën.

Agron Mustafa, i nderuar kryeministër, a paska shkuar a? Ku është more? Po, dëgjoje këtë. Ky kryeministri im mund të kërkojë raport prej shefit të Policisë kur ka kërkuar truporë 24 orë Agron Mustafa që ta ruajnë policia e Kosovës, a e di, Albin, për çka e ka pasur motivacionin? E di çka ka dhënë arsytim? Po do të më vrasë djali i një familje të shenjtë në Kosovë. Po do të më vras filani, nuk po e keqpërdor në foltore emrin e asaj familje të shenjtë, po ti po e di kush është, e ai po do me më vra, e 24 orë.

Ky Agron mafia, juve të Vetëvendosjes po ju tregoj, se ju ende nuk jeni hajna, e kjo më bashkon me juve.

të parën punë kur e ka bërë si ka ardhur në Postë Telekomini e Kosovës e ka larguar vajzën e kryekomandantit Adem Jashari, Shqipe Jasharin. A e di pse? Se ajo nuk ka pranuar të vjedhë bashkë me Agron Mustafën.

Unë jam i vetmi që në këtë foltore e kam bërë publike kur janë rrahur me Rexhë Gjonbalajn, kryetari i Bordit të Postë Telekomit të Kosovës e ka rrahur Agron Mustafën në mbledhje. E kam

bërë publike që Agron Mustafa e ka rrahur një femër në restorantin “Diçka po zihet” dhe a e dini në prezencën e kujt e ka rrahur? Në prezencën e Komandantit të Policisë së Prishtinës! Merre me mend, jo merre pa mend e ruaj mendtë, se trenohesh. Këtu krejt sendet duhet të merren pa mend për t’i ruajtur mendtë në krye!

Domethënë, ky ka qenë Agron Mustafa dhe ky është Agron Mustafa, i cili, kush m’i jep minutat? I kam minutat e AAK-së.

Ky Agron Mustafa e ka futur 3G-në e 4G-në me antena, të cilat fare nuk janë në këto dimensione, as nuk janë të 3G-së, as të 4G-së.

Agron Mustafa ka bërë kontrata fiktive me portale inekzistente për të vjedhur para në xhep të vetit, ka nënshkruar kontrata të Postë Telekomit të Kosovës nëpër oborre të shtëpive të katundarëve të shkretë, ua kanë dhënë 300 euro, i kanë shkruar kontratat 3000 euro.

Këta mafiozë, këta mafiozë e kanë bërë Postë Telekomit e Kosovës, Valën 900, sikur një lopë që mbahet prej një fshatari, po qumështin ua ka dhënë Z-Mobile dhe IPKO-s dhe krejt këto gjëra i ka kurorëzuar me një dëm të jashtëzakonshëm, me një kancer publik, duke ua dhënë 2.8 milionë euro portaleve e mediave, jo t’i shërbejnë interesit publik, po t’i shërbejnë infektimit të interesit publik, të shajnë, të hapin dezinformata, t’i bëjnë 900 mijë faqe të zeza nëpërmjet portaleve e mediave.

Prandaj, ajo letra që e lexoi Albulena Haxhiu është sikur të ma kishte vjedhur mua, si ta kisha shkruar unë, është krejt e saktë. Këto i kemi ditur krejt, edhe po i dimë krejt, po çka t’u bëhet atyre hetuesve të policisë me orë 60 mijë euro që, Albulenë, nesër po iu tek, ta shpifin ty një akuzë, ta nxjerrin një aferë! Domethënë, këtu është ndërtuar sistemi i keq, është ndërtuar sistemi kriminal, prandaj këtë sistem duhet ta rrëzojmë. Dhe, në rrëzimin e këtij sistemi duhet të na ndihmojë në mënyrë absolute kryeministri i Kosovës, pasi që ka ardhur në pushtet i ri, prapë i besoj, nuk jam njeri që i paragjykoj njerëzit, nuk di afera në të cilat është përzier Qeveria aktuale në krye me Ramush Haradinajn.

Unë për vete nuk kam dokumente, në mënyrë hipotetike dalim të gjithë faqezi, hajna, dilenxhi.

Prandaj, i nderuar kryeministër,

T’u kisha lutur, i kam thënë edhe ministrit Llukaj, që është afër teje, vetëm ma jep ti një mundësi, vetëm të ma sjellë raportin Qeveria prej që ka ardhur në fuqi si drejtor i Valës Agron Mustafa sa darka e dreka i ka hëngër, sa udhëtime i ka bërë, në cilat hotele ka fjetur dhe qysh i ka sponsorizuar mediat pa kurrfarë kriteresh, duke i shkelur të gjitha rregullat dhe e ka shkatërruar Valën.

Po e përfundoj fjalën time, i nderuar kryeministër, 40 milionë fitim i ka pasur Postë Telekomit i Kosovës në vitin 2013, 40 milionë, këta thonë 'revidenca', qysh thotë Dardan Sejdiu, unë s'e njoh gjuhën ekonomike. Jo, Albinin s'e pyes dhe sot a e dini ku jemi? Sot jemi në zero, në zero! Sot jemi minus 20, imagjinoni dhe dua t'i drejtohem me një fjalë sindikatës së Valës dhe Postë Telekomit të Kosovës, edhe çdo punëtori atje. Në qoftë se çdo punëtor i Postë Telekomit të Kosovës ka heshtur dhe është duke heshtur për të gjitha këto hajni, për të gjitha këto keqpërdorime, në çfarëdo ndërmarrje publike, qoftë në Postë, qoftë në KEK, qoftë në AKM, qoftë në Radiotelevizion të Kosovës, edhe ju jeni bashkëfajtorë të krimit.

Sindikata e Postë Telekomit të Kosovës për turpin më të madh, kryeministër, për turpin më të madh, kryeministër, të kësaj sindikate, nuk e ka ngritur zërin kur u shkatërrua Posta, për ata e ngrenë zërin vetëm kur të vijë puna te xhepi dhe te rrogat e tyre.

Prandaj, turp le ta kenë, se po të isha unë kryeministër i Kosovës, pa ia ngjitur drynin, se s'po flas si Xheva të marr vota atje në Postë a në Feronikël, unë ia kisha ngjitur drynin! A e dini pse ia kisha ngjitur drynin? Se ajo shtëpi ku vidhet, Xhevë, janë të gjithë fajtorë. Janë të gjithë fajtorë, nuk mund të themi se 3500 familje, çka 3500 familje? Kur hip në liftin e Postë Telekomit të Kosovës, çdo punëtor atje ma tregon nga një hajni të Postës, kur të vijë puna të flasim, s'flasim askush! E njëjta situatë në aeroport ka qenë, e njëjta situatë në privatizim, e njëjta situatë në Radiotelevizion të Kosovës, në të gjitha anët.

Prandaj, kryeministër, e ke shansin historik: në qoftë se bën ndryshime, në qoftë se i bie në kokë krimit duke spastruar, në radhë të parë Policinë nga kriminelë hetues, Prokurorinë nga prokurorët kriminelë, të cilët u ngrenë aktakuza policëve për 10 euro, në qoftë se u bie në kokë bordeve, të cilat nuk shkarkojnë asnjë drejtor, atëherë do të mbetesh në histori si njeri që thonë: "Valla, të paktën bile këtë, këtë, këtë e ka bërë!" Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! A po do të flasësh, kryeministri e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Këtu në konstatimin e gjendjes të mirë, ose të keqe, ose të mbrapshtë, si e tha edhe Albini ose dikush tjetër, për shkak të menaxhimit të mbrapshtë, nuk besoj që kemi dallime as si grupe politike, as si deputetë. Nuk besoj që fatkeqësisht Telekomit bën përjashtim prej plot praktikave të tjera që ka ndodhur, si menaxhimi, kujdesi e qasja nuk kanë qenë në rregull ose e gabuar ose e mbrapshtë.

Të dilet nga kjo gjendje, po ashtu nuk do të jetë lehtë. Mirëpo, mendoj se ekziston një vetëdije që është një aset i këtij vendi dhe në mos për asgjë tjetër, e kemi edhe nderin tonë t'i korrigjojmë. I kanë shkuar gabim ose mbrapsht, dhe unë propozoj që ta përcjellim së bashku këtë gjendje atje dhe Parlamenti, edhe Qeveria dhe mekanizmat tjerë dhe jam thellë i bindur që në Telekom ka

njerëz të mirë. Me siguri në gjithë atë kompani ka njerëz korrekt. Në fakt, unë kur kam mbajtur takim me ta më ka bërë përshtypje korrekte menaxhmenti i Postës, drejtori e ata kolegët ishin shumë të kujdesshëm. Ata na e dhanë një opsion qysh ta kthejmë Postën në fitimprurëse. Më kujtohet, ata më patën thënë “po ta na jepen disa funksione, pos bankës”, thanë “pak hidhërohen disa banka private, se ua marrim ndonjë produkt, por ne e kthejmë rentabilitetin në fitim”, dhe nuk ishte shuma e madhe, të jua them të drejtën. Thanë me një funksion, me një post-bankë t’i çojnë pensionet, disa shërbime tjera, mund të kthehej gjendja në Postë dhe Posta nuk është pak. Është aset bukur i madh, është publik, ka pronë, ka shërbime. Në fund të fundit, është edhe interes i vendit tonë, se megjithatë çohet edhe porosia, dhe ajo porosi konsiderohet e sigurt përderisa dërgohet prej një mekanizmi të këtillë si posta.

Te Telekom, gjendja është shumë më e rëndë. Pra, është bukur problem qysh të dalim prej kësaj gjendjeje. Ju e dini, ne e kemi çuar statutin e Trepçës këtu në Parlament dhe i kam dëgjuar plot njerëz, duke thënë “i keq, s’vjen”. Merreni shqyrtojeni, por mos e çoni aprovimin në pakufi. Kryejeni! Unë mendoj dhe ta kini parasysh, ne nganjëherë për shkak të debatit të brendshëm po i lëmë temat në pakufi. Ju kisha lutur, mos e çoni në pakufi statutin e Trepçës, sa më shpejt që mund të hyjë në rend të ditës, urdhëroni përmirësojeni çka ka defekt, po kryejeni.

Arsyeja pse po flas për Postën, për shembull një variant do të kishte qenë të bankrotohet, përnjëmend të bankrotohet, por një mbrëmje një vendim i caktuar dhe të ndalen krejt obligimet. Më fal, nuk po flas për Postën, por për Telekom, dhe aty t’i humbim krejt obligimet që i kemi ndaj kontraktuesve, ndaj atij, ndaj këtij, dhe të nesërmen të fillojë një kompani e re pa ato obligime, kur i lë me gishta në gojë plot, që nuk kanë qenë as dashamirës, as korrekte, mirëpo është zor të bëhet kjo për shumë arsye. Shembull, nëse e merr vesh ai që ti po do ta bësh kështu, ai shpejt t’i bllokoi xhirollogaritë, ose ta bën një padi, ose ta krijon... Është zor të bëhet si veprim. Rasti i Trepçës ka qenë shumë i mirë se Parlamenti e ka marrë një vendim, Parlamenti e ka nxjerrë Trepçën prej obligimeve paraprake, ka krijuar kompani të re, mirëpo edhe kjo kompani e re, edhe një herë po e përsëris, është mirë t’ia nisë me statut të ri, përndryshe e vonojmë veten, e lodhim dhe Trepça mbetet për diskutime edhe në tavolina tjera, nëse ne s’e aktivizojmë veten.

Edhe për Telekom, unë ju siguroj se u shtrua pyetja e u thanë shumë, a po doni ta rrëzojmë deri në fund dhe ta blini prapë ju, çka po dua unë në këtë rast është për ta nxjerrë një drejtë të Kosovës, por këtë të drejtë të Kosovës nuk mund ta kthejmë para 10 viteve, nuk po gjej mënyra qysh ta kthejmë, se nëse dikush e ka formulën pse jo. Por, po duam një të drejtë të Kosovës ta nxjerrim, që nënkupton ta rikthejmë kompaninë në parametra, që të paktën nuk frikësohet dikush për të investuar në këtë kompani, ndonjë investitor potencial, e të jua them të drejtën nuk e di kush mund të jetë i interesuar. Kur kam qenë në “Vjena Forum” në Sofje, këdo që e kam pa publikisht e kam thirrur, prandaj kam dal në foltore, e kam një fjalim të postuar, kam thënë që kemi mundësi për investime, edhe në miniera, edhe në Telekom. Nëse keni dëgjuar, nëse keni,

nëse ka ide, projekte serioze, është mirë të na njoftoni si Qeveri, është mirë t'i thërrasim, është mirë të vijmë. Pse? Vazhdimi në pakufi i kësaj gjendjeje nuk e ndihmon daljen nga kjo gjendje. Pra, duhet një periudhë kohore që më shkurt t'i marrim disa vendime së bashku, e nëse e lëmë bukur gjatë vështirë se do të kemi rezultate që do të kishim mundur të tregojmë se kemi bërë diçka.

Pra, nëse vonohemi vetvetiu do ta pranojmë dështimin. Pra, është në pyetje, unë po flas për një deri në 3 muaj të kemi rezultate, ndryshe e pranojmë që kemi dështuar së bashku.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, fjalën e ka zonja Nagavci.

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit, kryesues!

Sot është e qartë tashmë se ndërmarrjet publike si Telekomit dhe Posta e Kosovës ka vite që po shihen vetëm si mundësi për të marrë përfitime financiare dhe shërbime, përkatësisht si mundësi për të pasur keqpërdorime prej atyre që vazhdimisht e kanë parë një ndërmarrje të tillë si ndërmarrje nga e cila përfitojnë vetëm grupe të ngushta të interesit. Dhe, aty kanë ndodhur keqpërdorime prej atyre më të vogla deri te krimet e rënda, pa u afruar asnjëherë një mbështetje nga Qeveria e Kosovës, e cila është edhe aksionare e saj.

Në vend të saj, përpjekjet për ta privatizuar atë kanë qenë të vazhdueshme, e ashtu siç po shihet tashmë, kur këto përpjekje kanë dështuar, ka përpjekje për ta falimentuar. Është e qartë tashmë, u fol edhe më herët se janë disa faktorë që e kanë shkaktuar një gjendje të tanishme, përkatësisht gjendjen e krizës në Telekomit e Kosovës. Duke qenë se Telekomit i Kosovës ka pasur gjithmonë, domethënë edhe në të kaluarën, edhe gjatë ditëve të sotme akoma, kuadro shumë të përgatitura profesionistë, jo vetëm të inxhinierëve, por edhe të ekonomistëve dhe të juristëve, atëherë në kushte normale në një vend ku mbizotërojnë rendi e ligji me të drejtë do të shtrohej pyetja se si është e mundur që Telekomit i Kosovës të bjerë në një krizë, duke pasur parasysh kuadrin e saj të brendshëm të përgatitur mirë profesionalisht, teknologjinë shumë të avancuar dhe veprimtarinë më profitabile në tregun botëror të komunikimeve.

Por, në vendet si Kosova, ashtu si e krijuan gjatë këtyre viteve, apo thënë më mirë se si e degraduan, përgjigjja është e thjeshtë: Kuadrot e brendshme të Telekomit të Kosovës janë marginalizuar, madje janë eliminuar nga postet vendimmarrëse, janë larguar krejtësisht dhe jo pak raste ka pasur të persekutimit për shkak të qëndrimeve të tyre profesionale dhe konsensusente në ruajtjen e të mirës së kësaj ndërmarrjeje. Dhe, në vend të tyre, grupet politike, pra grupe të caktuara të individëve me nivele të larta të pushtetit për realizimin e interesave të tyre personale e financiare sollën menaxherë nga jashtë, të dëgjueshëm, të korruptueshëm, që me veprimet e tyre dhe shpeshherë edhe nga mosdija kanë nënshkruar kontrata shumë të dëmshme, ashtu siç u përmend veçanërisht kontrata me Dardafonin, përkatësisht Z-Mobile.



Pra, fatkeqësisht, menaxhimi i dobët i kontrolluar nga politika, përkatësisht nga këto grupe të ngushta të interesit, e solli Telekomit të Kosovës në gjendjen në të cilën jemi sot. Edhe pse kudo në botë kompanitë e telekomunikacionit janë shumë fitimprurëse, në Kosovë po ndodh e kundërta. Sot është në një gjendje të tillë, sa Telekomit të Kosovës nuk mund t'i mbulojë as shpenzimet e veta rrjedhëse dhe kjo po ndodh, sepse vazhdimisht fitimet po i plaçkiten nëpërmjet mekanizmave nga më të ndryshmit.

Ashtu siç është tashmë e qartë, Telekomit të Kosovës i plaçkiten nëpërmjet operatorit Z-Mobile së paku 30% e të hyrave. U përmend edhe në letrën që e lexoi zonja Haxhiu se e gjithë kjo filloi me një shpallje publike të bërë më 30 mars 2007 nga vetë Posta dhe Telekomit të Kosovës, e quajtur “mundësi atraktive për operatorët mobilë dhe virtualë”, ku ndër të tjera shpallej se janë të interesuar që të ngrenë konkurrencën nëpërmjet ofertës së shërbimit në tregun e telefonisë mobile.

Kjo tregon sesa shumë është degraduar ky institucion, sepse si ka mundësi që një kompani, qoftë ajo publike, apo private, të bëjë një thirrje publike që t'ia rrisë konkurrencën vetes? Dhe, pikërisht këtu do të duhej nisur hetimi i krimit nga vetë bordi dhe menaxhmenti i atëhershëm, të cilët bënë krim duke lejuar përdorimin e infrastrukturës së saj nga dikush tjetër, nën maskën e një operatori virtual për t'i ofruar të njëjtat shërbime që i ofronte vetë PTK-ja.

Ky rast i pashembullt besojmë se nuk ka ndodhur gjëkund tjetër dhe ashtu sikur u përmend në letrën, të cilën e lexoi zonja Haxhiu, domethënë ku u paraqitën të gjitha detajet e këtij krimi të organizuar, ku kishim pjesëmarrës aktivë e pasivë persona që me veprimet ose mosveprimet e tyre mundësuan që të sillej kjo kompani publike në gjendjen në të cilën po e shohim tani, është e qartë situata dhe sesi kanë nisur i gjithë ky krim i organizuar. Letra e profesor Ismet Hamiti duhet të sjellë në vëmendje, letra pra që u lexua këtu, i është drejtuar Prokurorit të Shtetit më 22 dhjetor 2016. Në atë letër profesor Hamiti u drejtohej institucioneve të vendit, përkatësisht Prokurorit të Shtetit që të ndërmerrnin krejt çka është e nevojshme që të ndërpritet plaçkitja e pasurisë publike e përmasave të mëdha dhe që grupi kriminal që e ideoi dhe zbatoi kontratën me Z-Mobile të sillej para drejtësisë.

Për më shumë, një letër e dytë iu drejtua Prokurorit të Shtetit pas një viti, saktësisht më 20. 12. 2017, me të cilën ai rikërkonte hetimin e krimit. Për më keq, Prokuroria zgjodhi të merrej jo me tërë krimin dhe keqbërësit, por vetëm me një hallkë të tij, duke e mashtruar kështu opinionin dhe duke i nxjerrë ata të pafajshëm me qëllim që të amnistohen të gjithë keqbërësit e vërtetë. Pra, dëmi që po i shkaktohet vazhdon t'i shkaktohet interesit publik dhe qytetarëve të këtij vendi është kolosal, andaj dhe kjo gjendje duhet përfunduar sa më parë. Urgjentisht duhet të krijohet një grup i menaxhimit të krizës që do të mund ta nxirrte ndërmarrjen nga kjo gjendje aktuale në të cilën është tani. Prokuroria e Shtetit gjithsesi duhet ta shkëpusë kontratën për operatorin

virtual Z-Mobile dhe tërë këtë skemë të paraqitjes, përkatësisht të plaçkitjes së Telekomit. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në këtë diskutim për Telekomin dhe gjendjen në Telekom natyrisht nuk ka sesi të mos diskutojmë edhe për atë paradigme ekonomike, të cilën e kemi ndjekur deri tash si Republikë e Kosovës, por besa edhe para shpalljes së pavarësisë, e që mendoj që është arsyeja kryesore pse sot jemi në këtë gjendje në Telekom, sepse nuk jemi vetëm në Telekom, por jemi gati në secilën ndërmarrje publike, e besa në ekonomi, në përgjithësi.

Dhe, mendoj që kjo paradigme ekonomike mund të përmblihet dhe të shpjegohet thjesht nga një fjali, e cila thotë që pasuria është barrë. Pra, në Republikën e Kosovës, edhe prej shpalljes së pavarësisë fatkeqësisht, por edhe para shpalljes së pavarësisë, disi tërë ai kapacitet ekonomik që e kemi pasur, një pjesë e të cilit nuk ka qenë në gjendjen më të mirë pas luftës, e në pjesë ka qenë goxha e shkatërruar, por sidoqoftë me politikat institucionale, fillimisht të UNMIK-ut, e pastaj edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në njëfarë mënyre pasuria është llogaritur si barrë dhe duke u llogaritur si barrë natyrisht që mjetet e mekanizmat që janë propozuar kanë pasur për qëllim, ndërmjet tjerash, edhe ta heqin qafe këtë pasuri, sepse e kanë konsideruar si barrë.

Mirëpo, jo vetëm barrë. Nëse e analizojmë trajtimin që ia kemi bërë pasurisë publike përgjithësisht nga secila qeveri, shihet që në fakt ajo është parë si e dy natyrave të ndryshme. Pra, në njërën anë është parë si plaçkë, e si plaçkë i janë marrë pjesët më të mira dhe më të vlefshme ato që kanë mundur të merren shpejt e shpejt dhe pastaj pjesa e mbetur është trajtuar si barrë. Dhe, këtu do të thosha që në këtë kuptim pasurinë e kemi trajtuar si shtet, sikur të kishim qenë kusarë, të cilët e gjejnë një pasuri ose e vjedhin një pasuri të madhe dhe ia marrin më të mirat atë që është e transportueshme, pjesën tjetër e lënë aty, sepse natyrisht që nuk mund ta bartin dhe u shkakton më shumë probleme gjatë bartjes sesa do t'u sillte ndonjë dobi ajo pjesë e mbetur.

Dhe, në këtë drejtim, duke e parë edhe si barrë, edhe si plaçkë, pra përveç korrupsionit, e kemi pasur edhe një qasje të gabuar, që po e shoh edhe sot në deklaratimet e Qeverisë karshi Telekomit të Republikës së Kosovës. Pra, kemi qenë të përqendruar te mirëmbajtja e status quos, e jo te zhvillimi, përparimi i kapaciteteve ekonomike dhe në këtë drejtim privatizimi është parë si mjeti më i dobishëm dhe efektiv i heqjes qafe të barrës, të cilën fillimisht e filluam me ndërmarrje shoqërore, pastaj u vazhdua edhe me ndërmarrje publike dhe sot, edhe këtu e pashë, edhe nga

paraqitjet e kryeministrit, që sa herë që flitet për Telekomin ta zëmë propozohet që privatizimi do të jetë zgjidhja.

Dhe, kjo siç e përmendi edhe deputeti Sejdiu më herët, edhe nëse e matim në aspektin e historikut të vonë të Republikës së Kosovës, por që besa edhe nëse e shtrijmë analizën krahasuese edhe me vendet tjera të botës, por edhe të Evropës, për shembull me vendet e Evropës Lindore, e shoh që në fakt privatizimi nuk është zgjidhje karshi korrupsionit e hajnisë. Në vend se ta ndalë korrupsionin, privatizimi në shumë raste e përshpejton atë, siç e thotë edhe profesori Goseph Stigles. Po të kthehemi te Telekom. U ravijëzuan këto tri problemet madhore që i ka Telekom sot në Kosovë, e që secila prej tyre e ka një historik në mënyrën sesi është trajtuar ai. Për mendimin tim, problemi më i madh që e ka Telekom është që i është ngushtuar tregu. Pra, problemi i parë më i madh është që i është cinguar dhe ngushtuar tregu dhe kjo është bërë nëpërmjet Z-Mobile, i cili i përdor resurset dhe kapacitetet e Telekomit, ndërkohë që ato i shndërron në profit për vete dhe ia merr tregun dhe konsumatorët të Valës dhe, e dyta, natyrisht IPKO, e cila po ashtu me kalimin e kohës e ka marrë një pjesë të tregut të Telekomit.

Dhe, tash dikush po më thotë, po ne jse kjo është megjithatë përbrenda rregullave të konkurrencës dhe ç'faj ka IPKO-ja këtu? Por, unë mendoj që kjo megjithatë nuk ka qenë krejt e pafajshme. Po ta shohësh sekuensimin e gjërave, e shoh që për shembull te IPKO-ja nganjëherë vendimet që janë marrë nga Qeveria, ose nga qeveritë e kaluara dhe që janë bartur pastaj në vendimet e PTK-së i kanë shkuar më shumë për shtati IPKO-s edhe shtrirjes së rrjetit e tregut të IPKO-s, sesa që i kanë konvnuar në çfarë mënyre Telekomit. Për shembull, ju kujtohet që ARKEP-i i ka dhënë më parë licencë për ushtrimin ose zbatimin e teknologjisë 3G dhe pastaj 4G IPKO-s sesa që i ka dhënë Valës.

Dhe, kjo është thënë në arsyetimin që Vala nuk është e gatshme dhe IPKO është e gatshme dhe rrjedhimisht ne duhet ta hapim tregun dhe brezin frekuentorë për shërbimet 3G dhe 4G dhe rrjedhimisht IPKO ka filluar e para në mënyrë që ta marrë primatin në treg dhe sot e kësaj dite ne e shohim që në fakt IPKO-ja në këtë drejtim fatkeqësisht shërbimet 3G dhe 4G i ka shumë më të mira se Vala. Por, pse ndodh kjo që Vala nuk i ka pasur shërbimet më të mira? Prapë këtu nuk është çështje e mosdijes, por është e ndaljes në mënyrë absurde dhe absolute të investimeve në përmirësimin e teknologjisë së Valës që kanë ndodhur në vitin 2010 me dekret qeveritar, pra me urdhër të ministrit të atëhershëm të Financave dhe të Ekonomisë, Ahmet Shala, gjithnjë për ta privatizuar Valën dhe kështu Valës i është ndalë rrita në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qeverisja, ndërkohë që kjo i ka krijuar hapësirë shumë më të madhe pastaj IPKO-s për t'u zgjeruar.

E dyta është që Valës i janë cinguar mundësitë dhe cungimi i mundësive vjen drejtpërdrejt prej vendimeve të qeverive. Domethënë, në një rën anë ndalja, prapë po e them, e investimeve në Valë, që ia ka cinguar mundësitë dhe, e dyta, marrja e dividendës të përcëdoitshme në miliona

euro, të cilat kanë qenë para që kanë mundur lehtë të përdoren për investime dhe për përmirësimin e rrjetit dhe të shërbimeve që i jep Vala.

Dhe, e treta është që në të njëjtën kohë i janë ngritur edhe shpenzimet, kryesisht nëpërmjet punësimit, nëpërmjet pagave, zgjerimit të rrjetit të punëtorëve e kështu me radhë dhe ky është edhe paradoksi i cili tregon që në fakt Vala, ose menaxhimi i deritashëm i Valës nuk ka ardhur nga mosdija, siç mund të pretendohet nganjëherë, sepse shpesh thuhet që ne nuk dimë t'i qeverisim ndërmarrjet publike, rrjedhimisht duhet privatizuar ato. Po t'i shohësh të tria dhe mënyra qysh janë bërë këto, kjo tregon që ka njerëz që kanë ditur shumë mirë, por kanë ditur për keq dhe e kanë kuptuar saktësisht sesi mund të dëmtohet një ndërmarrje dhe i kanë marrë të gjitha masat për ta dëmtuar qëllimshëm një ndërmarrje publike, siç është Vala. Pra, problemi këtu ka qenë që synimi karshi Telekomit të Kosovës ka qenë për ta shkatërruar, e jo për ta zhvilluar atë. Po të donin, të njëjtë njerëz do të kishin mundur, po ta kishin qëllimin e mirë, që ta menaxhonin shumë mirë dhe t'ia rrisnin vlerën dhe ta konsolidonin e zhvillonin ndërmarrjen.

Dhe, tash ne po diskutojmë në një situatë jashtëzakonisht të rëndë, sepse e kemi para vetes një Telekom, i cili edhe nëpërmjet letrave që janë dërguar është gati afër falimentimit dhe prapë kemi ardhur në një situatë kur për 18 -19 vjet në Kosovë vazhdimisht diskutojmë se si të shpëtojmë, e asnjëherë sesi të zhvillohemi dhe tash me Valën pak a shumë e kemi të njëjtën logjikë. Propozimet që i pashë këtu, edhe në rezolutë, e që janë natyrisht edhe të pranueshme, edhe shumë të mira, mendoj që duhet t'i analizojmë edhe nga një perspektivë tjetër. Deri tash unë pashë diskutime, të cilat kërkojnë që të ndalet e keqja. Pak a shumë po e përmbledh kështu. Pra, të gjitha ato propozime të deritashme tregojnë që duhet të ndalet e keqja në Telekom, për ç'gjë jam plotësisht dakord - duhet të ndalet e keqja.

Mirëpo, ndalja e keqes, edhe pse e domosdoshme është e pamjaftueshme, dhe mendoj që më shumë se në Telekom kurrkund nuk është kjo e vërtetë. Duhet ta ndalim të keqen, korrupsionin, mbipunësimin dhe të gjitha këto. Mirëpo, kjo megjithatë mund të rezultojë të jetë e pamjaftueshme për ta zhvilluar Valën dhe Telekomin, nëse nuk ka plan për zhvillim.

Prandaj, që në të njëjtën kohë, duke menduar se si ta ndalim të keqen, duhet ta mendojmë edhe si ta zhvillojmë Valën tutje, përndryshe do ta ndalim të keqen, por prapë do ta kemi një Valë në të cilën më nuk po vidhet, por e cila e ka të pamundur të zhvillohet dhe mendoj që kjo i sjell një dobi të vogël ekonomisë dhe Telekomit në Republikën e Kosovës, por jo atë që do të duhej ta kishim. Njëri prej propozimeve të zhvillimit të Telekomit ishte ai që u dha nga Dardan Sejdiu në të cilin duhet të ndryshohet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë që ta Visari përfundojë fjalimin! Visar, s'keni më kohë, por që ta përfundosh fjalën.

VISAR YMERI: ...që të ristrukturohet pronësia mbi Valën, në mënyrë që ta kemi një mundësi, e cila i ikën njëherë anë kësaj stihisë së privatizimit, por në anën tjetër e bën një hap tutje drejt ndarjes së menaxhimit të drejtpërdrejtë nga qeveritë dhe institucionet publike, të cilat nuk po mund të dalin nga kjo vorbulla e korrupsionit dhe keqpërdorimit të ndërmarrjes publike për qëllime elektorale. Dhe, kjo mundësi e artë është natyrisht fondi sovran, përgjegjësi e të cilit do ta kishte që përveç pronësisë mbi asetet strategjike të Republikë së Kosovës, përgjegjësi kryesore dhe ekskluzive do ta kishte rritjen e vlerës së tyre dhe zhvillimin e tyre.

Dhe, mendoj që kjo është rruga përpara, veçanërisht me Telekomin, por jo vetëm me Telekomin, edhe me Trepçën, edhe me energjetikën, edhe me ndërmarrjet tjera strategjike të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

U tha e u përsërit se marrëveshjet e natyrës jotransparente dhe të dyshimta e kanë sjellë Postën dhe Telekomin e Kosovës në prag të falimentimit, duke i krijuar borxhe të mëdha kompanisë pa kurrfarë arsye të natyrës biznesore.

Por, të nderuar deputetë, sot kjo kompani nuk duhet trajtuar vetëm si biznes apo vetëm të milet nga buxheti, por duhet trajtuar edhe si aset strategjik, jo vetëm i zhvillimit dhe rritjes së mirëqenies, por edhe si çështje e sigurisë nacionale. Trajtimi serioz i kësaj problematike do të ishte një veprim i duhur në mbrojtjen edhe të kompanive tjera publike, si KEK-u e Trepça. Pa dashur të përsëris, se unë e kam një fjalë pak më të gjatë, në fund dëshiroj të them se këndellja e kësaj kompanie është një test serioz, jo veç për politikën, por edhe për segmentet tjera të shtetit ligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia jap fjalën deputetit Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të them të drejtën, biseda jonë rreth kësaj interpelance më shumë i përshtatet interpelancës paraprake sesa gjendjes aktuale të Telekomit në Republikën e Kosovës, sepse i tërë diskutimi më shumë është i vrojtuar në atë çka ka ndodhur në të kaluarën me të drejtë, e theksuar në mënyrë të saktë se këtu kemi të bëjmë me një krim të organizuar.

Në interpelancën paraprake ne biseduam rreth korrupsionit, edhe politik, edhe krimin të organizuar në Republikën e Kosovës, dhe tash këtu po përkthehet që veç po dëshmohet ajo çka e thamë paraprakisht që individë, struktura politike, pa dallim siç duket, të shtytur e të ndikuar për interesa personale e kanë çuar para një falimentimi total Telekomit e Kosovës dhe kjo sigurisht që do të ndodhë edhe Postën e Kosovës. Nga një raport i cili u është dërguar deputetëve, ku kërkohet një lloj ndihme, sigurisht kanë dashur që t'u paraprijnë të gjitha atyre të këqijave që kanë ndodhur në keqmenaxhim, në keqpërdorim, që konsiderohet para publike.

Nëse në Kosovën tonë, në vitet 2009-2013 janë dorëzuar 410 milionë euro dividendë dhe tash jemi me 60 milionë euro borxh, kjo nuk do koment, kjo është më tepër se sa krim. Dhe, nëse ne theksojmë këtu ose tentojmë që të themi nuk do të merremi me të kaluarën, por do të shikojmë të ardhmen, sigurisht kjo është vetëm inkurajim edhe më i madh për ata që e kanë keqpërdorur gjithë këtë para, këtë treg ta quaj dhe këtë zhvillim të Republikës së Kosovës, nënkuptohet nëpërmjet këtij aseti shumë të vlefshëm, i cili nga të gjithë ata emra që u theksuan asnjëri nuk është para përgjegjesisë penale.

Por, ata emra në publik i kanë disa padronë, ashtu siç i dëgjuam. Unë kurrë nuk i kam dëgjuar ata që kanë ndonjë fuqi dhe që përmenden me ndonjë fuqi të caktuar. Sejdi Hoxha thonë e ka Azem Sylën, ky tjetri Kiçina që ka ardhur tash thonë e ka Ramushin, ai tjetri thonë e ka Kadriun... Nuk përmenden ata, përmenden liderët. Nëse këta dëshirojnë ta tolerojnë emrin e tyre dhe ata të fshihen me keqpërdorime prapa tyre, atëherë është diçka tjetër, por është perceptimi dhe opinioni publik ndaj asaj që dëgjohet çdo ditë. Unë nuk e kisha dëgjuar më parë, as të cilës parti janë, as të cilit subjekt, ndoshta edhe për shkak të profilit dhe të angazhimit politik dhe atij profesional.

Andaj, kolegët e mi, sidomos këta të profesionit, i potencuan disa masa. Për mendimin tim unë këto masa nuk i shoh pa evidentim të pasojave dhe pa përcaktim të kësaj përgjegjësie, sepse Bordi e ka deklaruar para disa ditësh ka raportuar atë që kemi dëgjuar para Qeverisë që PTK-ja është në krizë të madhe financiare dhe e cila rrezikon të falimentojë për këta dymbëdhjetë muajt e ardhshëm. Kërkesa që tash ne të krijojmë fond nga taksat e qytetarëve e t'i shpëtojmë këta njerëz të korruptuar, këta njerëz të mbingarkuar me këto punësime, nga njëri deri te tjetri, sepse derisa ne po flasim personalisht mua këtu po më vijnë informacione se si këta i shkëmbejnë punëtorët. Domethënë, këta individë i shkëmbejnë punëtorët prej Postës në Telekom, prej Telekomit në Postë, duke i rehatuar individë, struktura, familjarë, e tjerë, e tjerë... pa asnjë arsyeshmëri financiare, as buxhetore, vetëm për ngarkesë dhe dërgojnë edhe raporte të brendshme të auditimit, ku vetëm dy shembuj po i potencoj. Një toner i një printeri është faturuar 300 euro. Ministri i Zhvillimit Ekonomik sigurisht se duhet t'i ketë këto përpara. Veturat zyrtare, mirëmbajtja e tyre është faturuar 13 mijë euro. Unë mendova mos është kësi ndonjë xhip i blinduar që bart të holla, por ishte fjala për vetura të thjeshta.

Raportet e auditorit të brendshëm, që i ka bërë edhe në Postë edhe në Telekom. Andaj, ministër, kryeministër mbi të gjitha, mendoj që nuk e kemi luksin për t'i mbuluar këto krime, as si Kuvend, as si individë, as nuk e kemi luksin me i mbrojt individët, pavarësisht kush mund të jenë apo kujt i takojnë. Unë ju dëgjova me vëmendje kur në fjalimin tuaj e potencuat disa herë që keni kërkuar, “kemi kërkuar”, kemi kërkuar”... Unë besoj që kjo duhet të dallojë të bërit veprim dhe nga kërkesa për të marrë masa. Dua të besoj që nënkupton që ju do të kërkonit llogari të shpejtë nga këto kërkesa, se kua kanë arritur menaxhmenti apo Bordi që të shohim në këtë rënie drastike, qoftë të të hyrave, qoftë të rritjes së punësimeve pa ndonjë arsyeshmëri, pa dashur me e prek pjesën e ndershme të njerëzve që punojnë me vite të tëra dhe kontribuojnë sipas detyrës zyrtare.

Pjesa tjetër, që thuhet “për të mbrojtur edhe të drejtat e punëtorëve” edhe kjo pjesë e këtyre sindikatave, domethënë kryetarit të sindikatës i ishte rritur rroga për tri gradë. Normalisht, që edhe ai nuk merret shumë me të drejtat, qoftë të punëtorëve apo me këto shkelje ligjore dhe kjo duket se është një riciklim i të këqijave, mbi të gjitha duke dëmtuar pronën publike në tërësi. Kjo luftë për monopol dhe tenderomani ishte edhe pista kryesore e hetimeve në rastin e vrasjes së Elvis Pistës dhe besoj që ndërgjegjja e dikujt duhet t'i vret edhe për këtë aspekt, e cila ka kaluar tash në heshtje dhe si duket nuk tentohet të shkohet më tutje, sepse dihet edhe se ku do të përfundojë, si duket edhe si hetim edhe si zbulim i këtij krimi makabër.

Andaj, besoj që edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, por edhe Qeveria si aksionar duhet jo vetëm të ndërmarrë masa konkrete, por duke u marrë me të kaluarën sidomos e lehtëson të ardhmen. Ajo që dëgjuam dhe që është pjesë e marrëveshjeve tash thuhet që për tetë vjet me radhë Z-Mobile nuk do t'i paguajë asnjë cent Telekomit të Kosovës për të gjithë segmentin e klientëve që përdor, qoftë me shërbime telefonike, qoftë me internetin 3-G, 4-G, e tjerë. Dhe, kjo e dëmton në masë të madhe edhe në përqindje të të hyrave, por edhe në zhvlerësimin e këtij asetit publik shumë të vlefshëm, që e potencuan me të drejtë edhe kolegët tjerë.

Unë me shpresë të madhe po e përfundoj që besimi është i vogël që mund të kemi ndonjë rezultat konkret, sepse nga të gjithë ata emra, klientelë që u përmendën, si duket në Kosovën tonë është e pamundur që të ekzistojë një vullnet i fuqishëm politik për të ndaluar këtë fenomen i cili nuk po jep rezultate konkrete në luftën kundër krimit dhe korrupsionit në vend.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Urdhëro, kryeministër! Kryeministri e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Vërtet ajo gjendja nuk është e mirë në Telekom dhe vështirësitë janë edhe në Postë, nuk po them që Aleanca, se ka edhe ajo ndonjë meritë të gjendjes së keqe në...

Megjithatë, ky Zeqa është qe pak ditë, Kiçina, tre janë punësuar prej tij. Nuk e di a ka dhënë ndonjë tender ende, por është... nuk ka mbërri se s'i ka rënë, pra ju kisha lutur që ta kuptojmë këtë dallim.

Unë e shoh, për shembull, zoti Zemaj, njëra prej kontratave me Telekomin është e datës 24 maj 2017. Arsyeja pse po e cek është, se gjendja është bartur prej vitit në vit dhe po ashtu, disa ministra që janë ndërlidhur me këtë kompani, jo të ndërlidhur se kanë pasur punë direkt, por ai i transportit, i financave, e tjerë, e tjerë... dhe Komisioni ndërministror. Unë sigurt nuk kam bërë ndonjë hulumtim për të bërë kush sa është meritore për të keq dhe nuk dua të hy në atë, se s'mund ta bëj. Nëse dikush duhet ta bëjë, janë disa të tjerë, ata e kanë emrin prokuror, a ku e di unë... Kur po them unë që s'dua të kthehem prapa, nuk është se unë s'po dua ta di se çka ka ndodhur krejt Kosova, por unë e kam zor të njëjtën kohë edhe të kthehem mbrapa dhe ta gjej një gjendje sot, po edhe të shikoj çfarë po bëjmë.

Sugjerimi im është, ne të gjithë pasi që po pajtohemi që nuk është gjendja e mirë, ndoshta-ndoshta t'i japim krejt ato vlerësime konkrete se si ta nxjerrim këtë kompani në dritë, ta quajmë, ose në sukses. Unë e ceka me qëllim shembullin e Trepçës. Ju e dini, ne kemi pasur këtu në Parlament një herë debat dhe ai debat ka shkuar gati në kundërshtinë e një nate, megjithatë kemi rezultuar me një ligj dhe sot mund të konstatohet, ose të konsiderohet, si një nismë e re. Nëse ka mundësi të gjejmë një formulë që me e nisë këtë kompani në këmbë të veta, jemi të interesuar, besoni. Edhe nuk po e them kështu për kurrfarë... që nuk është lehtë, nuk është lehtë. Pra, në cilëndo variant që të shkojmë, ky parlament dhe Kosova duhet marrë disa rreziqe. Pra, për operimin, për veprimin me kompaninë tonë, me Telekomin.

Sa i përket Postës, mendoj se me pak vullnet të mirë kishim mundur ta kthejmë në kompani profitabile, se edhe shumë janë më të vogla. Ata i kanë kërkuar veç shërbimet e post-bankës, me sa kam dëgjuar prej tyre. Nëse në të ardhmen kjo kompani lehet në stih kështu, sigurt e kemi jo veç falimentim, po do të kemi probleme me bllokim të xhirollogarive, me bllokim të aseteve, do të humbim jo veç në financa si Kosovë, po mund të humbim edhe në patundshmëri e në të drejta e prona tjera, që s'është mirë me i ndodh Kosovës ashtu.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të përpiqem të jem i shkurt, por më tepër të përçoj ndoshta atë që mendoj se është pikëpamje, ose synim, se kah duhet të shkojnë këto ndërmarrje në të ardhmen, ose që ne si Parlament në atë që s'kemi arritur ta bëjmë disa herë këtu në Kuvend, që tani pas disa viteve, pasi që kam qenë pjesë e Parlamentit edhe në legjislaturën kur këtu është diskutuar për privatizimin e Valës, kanë



qenë nja dy përpjekje për privatizimin e Valës. Herën e parë është menduar se Vala do të shitet prej 600-800 milionë. Herën e dytë oferta ka qenë prej 250-300 milionë, oferta që ne si Kuvend i kemi rrëzuar dhe tani mund të themi lirisht, se nëse shikojmë vitet prapa, nëse ne ose herën e parë 600-800 milionë t'i kishim investua në zhvillimin ekonomik, disa prej tyre t'i kishim investuar në Trepçë, sot do të ndryshonte situata sa i përket zhvillimit ekonomik.

Kemi vendosur si Parlament, nuk jemi pa përgjegjësi edhe ne si deputetë, prandaj kjo është një përgjegjësi, ose një vendimmarrje e përgjithshme. Po, është e vërtetë që në fazën e privatizimit kur ka filluar, të Valës, ka pasur një vendim të ministrit të Financave që të mos vazhdohet me investime në Valë. Dhe, atëherë kritika e opozitës ka qenë se pse po investohet në diçka që është në prag të privatizimit. Prandaj, e arsyeshme ka qenë që në procesin e privatizimit, derisa është duke vijuar të mos investohet, por që pastaj ato investime të vazhdojnë më vonë.

Janë humbur hapa të mëdhenj në ndërmarrjen publike të Telekomit dhe të Valës. Shpresoj të mos humbim këta hapa tani edhe tek Posta, sepse Posta mund të mbijetojë dhe mund të jetë profitabile. Në momente të caktuara, mendoj se tani duhet Qeveria e Kosovës ta mbështesë Postën për themelimin e Post-Bankës. Ju e dini që në shumë vende të zhvilluara dhe shumë kompani postare kanë Post-Bankën. Nuk ka punëtor, as të Telekomit, as të Valës, as të Postës, pothuajse që nuk është në kredi. Pse këta punëtorë të këtyre kompanive të futen në kredi në bankat profitabile, që sot janë në Kosovë e të cilat konsiderohet që sot kanë një profit vjetor prej 100 milionë eurosh, përse atëherë të mos u mundësohet, të paktën t'u huazohet, fondi nëpërmjet të cilit do ta hapnin post-bankën. Mendoj që kjo do të ndihmonte, sepse Posta tashmë ka të licencuara ofrimin e disa shërbimeve financiare dhe ne të jemi në aspektin e vendimmarrjes sot që na duhet këtu në Parlamentin e Kosovës, të shohim tutje përpara, se çfarë do të bëjmë, sepse nëse fillojmë të atakojmë njëri-tjetrin pothuajse të gjitha partitë politike kanë qenë në udhëheqje edhe në nivelin lokal edhe në atë qendror. Të gjitha kanë pasur dhe kanë futur duart në ndërmarrjet publike, qoftë në Prishtinë, qoftë në Gjakovë, qoftë në Mitrovicë dhe në ndërmarrjet publike qendrore. Bash asnjëra parti hiç lehtë nuk e ka lënë me i rahatua militantët partiakë për interesa të përfitimit të votave nëpër ndërmarrjet publike, qoftë të nivelit lokal, qoftë të atij qendrore, por që ne sot duhet të mendojmë me një objektiv shumë më të qartë.

Nëse, ta zëmë, në fillim Telekomi ka pasur të shtrirë tërë rrjetin telefonik në Republikën e Kosovës, ka qenë projekti i Dardanetit dhe i digjitalizimit të ofrimit të Televizioneve, kabllove digjitale nëpërmjet kësaj që është bllokuar dhe nuk është lejuar, por që u janë krijuar favore pastaj kompanive private dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në performancën, ose në profitin, pastaj të këtyre ndërmarrjeve. Sot mendoj që ne duhet të nxjerrim disa rekomandime të cilat kanë me ndihmuar zhvillimin e këtyre dy kompanive dhe në veçanti të mendohet në aspektet e mbështetjes së Qeverisë, që këto kompani të jenë profitabile. Jo të gjitha ndërmarrjet publike sot operojnë me humbje, ka ndërmarrje publike të cilat kanë ditur të veprojnë edhe me profite edhe të nxjerrin kompanitë në prag të falimentimeve, t'i nxjerrin nga gjendje të tilla, por që

kryesisht është përgjegjësi menaxheriale dhe duam t'i dallojmë edhe menaxherët. Edhe në këto kompani që sot po bisedojmë për to kanë pasur menaxherë të suksesshëm disa prej tyre edhe në periudha të caktuara ky menaxhim ka ardhur në shprehje, por që ne si parlament i Kosovës në fazën kur është dashur me ia dhënë një hap zhvillimit të vendit edhe zhvillimit të këtyre kompanive u kemi krijuar favore atyre që sot po i kritikojmë, ose atyre që pastaj në mënyrë indirekte kanë përfituar e të cilat janë kompanitë aktuale në treg. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po i dëgjoj me kujdes krejt këtë diskutim dhe u përpoqa t'i gjej transkriptet e fillimit të hajnisë me Dardafonin. E gjeta këtu transkriptin e datës 26 shkurt 2009, kur një deputet në këtë Kuvend e hap çështjen e shitjes së Dardafonit dhe i bën pyetje ministrit Ahmet Shala dhe kryeministrit të atëhershëm, se si është e mundur që kjo shitje qysh në vitin 2008 është rregulluar në atë mënyrë me gjithë kundërshtimin e menaxherëve dhe të Bordit të PTK-së, që 73% e fitimit t'i ndahet gjatë asaj ndarjeje operatorit privat dhe 20% Postës, kur gjithkund është e kundërta.

Problemi që Ahmet Shala atëherë ka qenë ministër është interesant, unë po ua lexoj drejtpërdrejtë çka thotë në fund, kur i përgjigjet deputetit. Thotë: “Jo, këtë punë duhet me ia sqarua edhe publikut...” edhe këtu “po duket sikur u bë nami... Në të vërtetë gjithçka është në konformitet me ligjin.”, ashtu thotë ministri, ka dashur të thotë “në pajtim me ligjin”. Qysh atëherë deputeti i nderuar që s'po dua t'ia përmend emrin, Driton Tali, ka nxjerrë këtë çështje dhe ka diskutuar edhe me bordin me gjasë, edhe me menaxherët e PTK-së, kanë deklaruar se kjo është e kundërligjshme dhe vepër penale. Atëherë i përmend diku, përmenden edhe emrat e Agim Çekut, Anton Berishës... domethënë të të gjitha partive. Mirëpo, ajo çka është me rëndësi thotë: “Një vit përpara është vlerësuar se PTK-ja ka vlerën diku rreth 1 miliardë. Meqenëse, synimet janë për privatizim dhe krejt kjo shitje, krejt këto malverzime janë bërë me këtë qëllim dhe dikush nga kreu i shtetit është i përzier, domethënë tash i ka rënë në 300 milionë dhe mendohet që kjo të shitet.

Është interesant se qysh atëherë është kërkuar, unë pajtohem me disa deputetë, një hetim për këtë çështje, madje edhe nga EULEX-i dhe UNMIK-u dhe siç po shihet edhe ata kanë qenë të përzier nga koka në lidhje me këtë çështje.

Megjithatë, unë shqetësohem me gjithë këtë gjendje. U shit Ferronikeli, u dha falë, dështoi. U shit Aeroporti, KEDS-i u shit, KEK-u në formën e Counter-Globalit, tash Posta është pru në gjendje më mirë me u shitë, se sa me u mbajt, sepse po gjeneron vetëm humbje dhe askush kurrë nuk ka marrë përgjegjësi. Si është bre e mundur krejt të punojnë, krejt të shitet edhe kurrë kurrkush nuk merr asnjë përgjegjësi. Asnjë njeri nuk ka shkuar në burg në përgjegjësi penale, edhe pse Kosovës i është sjellë fundi me këto vjedhje me këto privatizime, me këtë mënyrë të

plaçkitjes. Kjo nuk është vjedhje hajni e vogël, kjo është plaçkitje në sy të të gjithë popullit të Kosovës. Është futur plaçkitja në sistem.

Këtu është kryeministri, unë e di që ka trashëguar këtu shumë gjëra, i ka trashëguar edhe nga bashkëpartiakët e vetë, nuk janë veç dy partitë e mëdha. Mirëpo, a ka mundësi ky kryeministër apo çdo kryeministër tjetër të ndërrojë këtë sistem të hajnisë dhe të plaçkitjes ashiqare edhe askush kurrë mos të shkojë në përgjegjësi? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Bekim Haxhiu, replikë.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit! Faleminderit, i nderuar!

Jo për të replikuar por për shkak se përmende një çështje të cilën e thash këtu. Edhe Samiu e di që pas luftës Telefonja kabllore ka qenë e vetmja në Kosovë derisa është zhvilluar kjo telefonja mobile. Po i referohem asaj që u diskutua, sepse kërkesa ose mendimi im laik në këtë fushë, por mendoj që ka mundur të zhvillohet sistemi digjital nëpërmjet kësaj telefonie, përpara se të zhvillohet edhe IPKO-ja edhe sistemet tjera kabllore dhe të ishte shumë profitabile.

Se a ka vjedhur ndokush apo jo, le të mbanë përgjegjësi individuale. Do të thotë, po, le të mbajë përgjegjësi individuale kushdo që ka vjedhur, edhe ata zyrtarët e BVI-së atje që kanë dashur t'i aranzhojnë disa tenderë për qira, edhe ata duhet përmendur, Sami. Edhe ata të partive tjera, cilido që ka vjedhur duhet të vazhdojmë dhe unë mendoj që disa prej këtyre rasteve që ju i potencuat edhe kanë qenë në organet e ndjekjes dhe të drejtësisë.

Por, më se e vërtetë është që tash e thatë e potencuat edhe vetë, që tash ka mbetur Telekom dhe Vala, me i dhënë për falë, a? Kemi pasur mundësi me e shitë 800 milionë, tash ka mbetur me e dhënë për falë, ose duhet mbështetur, sepse vizioni do të thotë i tjerëve ka qenë ky që duhet me e prurë në këtë nivel. Ndërsa, Partia Demokratike ka pasur projekte zhvillimore edhe për vendin edhe për këto kompani, por që nga të tjerët nuk janë pranuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Sami Kurteshi, kundër replikë.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit!

Unë po e shoh që po pajtohem të gjithë. Në të vërtetë, nuk ishte kjo replikë dhe unë e falënderoj, po unë përsëri po i bëj Prokurorisë ftesë, atyre prokurorëve që janë të kapur e kryeprokurorit të Prishtinës, filloni more hetimet! Plaçkitja është e hapur, hajnia është e hapur, emrat janë, dokumentet janë, filloni more hetimet! Kaq!

**KRYESUESI:** Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Unë s'e kam ditur që bëj aq sherr, se isha matur, nuk e kisha bërë, po kur i kemi kërkuar këto masat për t'i ndalë harxhimet, për fat të keq jam prishur edhe me medie. Pra, janë detyruar me i ndal edhe ato sponsorizime e ato. I kam bërë disa armiq te ata që i kanë marrë sponsorizim, se nuk janë veç mediet, po edhe mekanizmat tjerë, institucionet tjera në Postë.

Njëkohësisht, edhe te ato planet e kufizimeve plot kontrata e plot veprime mund të ndërmerren dhe ne kemi një listë të këtyre veprimeve, që kishim mundur me e stabilizua gjendjen. Këto pagat fillojnë me 490 euro për disa roje e disa që janë kategoria e katërt, deri në dhjetë, në dhjetë janë njëmijë. Prej 11 njëfarë grade ashtu, deri në 16 janë prej 1300-2000 pagat. E drejtori ekzekutiv, a kryedrejtor, a kryeshefi, a qysh i thonë, e ka 5200. Unë e kisha bërë edhe një sistem që këta menaxhmenti të mund ta krijojnë bonusin nëse krijojnë profit. I kisha prurë në dofarë pagash më korrekt dhe nëse krijohet profiti, nëse e bëmë kompaninë në kushte profitabile, atëherë po shkojmë me atë përqindjen që parashihet në biznes, ka forma të caktuara që e motivon menaxhmentin për më shumë benificione.

Pse po e them këtë? Vërtet unë s'kam kërkuar asnjë masë dhe sigurt, po i siguroj të gjithë ata që i ka prekur kjo ndërhyrja që ka bërë Qeveria në këtë kompani, ose interesimi për këtë temë edhe ju që po e bëni sot, se edhe ju jeni kah e bëni këtë, unë s'e kam bërë këtë kundër atyre që kanë pasur marrëdhënie me Telekomin, marrëdhënie financiare, përfitime, as edhe kundër personalit. Mirëpo, ne kemi mundur edhe të heshtim dhe një ditë veç me e marrë lajmin që ka bankrotuar.

Tani, unë po e kërkoj edhe ndihmën e juaj dhe të gjithkujt, se si ta nxjerrim këtë kompani në dritë, si t'ia nisim diku kah e mbara. Të gjitha këto propozime e sugjerime që i dëgjuam sot për pjesën e Prokurorisë, për pjesën e Ligjit, për pjesën e... ato janë aspekt tjetër. Sot po flasim se si me e nxjerrë ne Telekomin nga sot, ose çka mund të ju themi nesër atyre.

E kjo është edhe arsyeja pse mendoj që ata që dëshirojnë vërtet me e shty këtë proces kah duhet, është momenti i fundit me bë diçka, ju siguroj që është momenti i fundit, nuk po e them këtë fjalë goje. Ne informatat i kemi që janë vërtet shumë të këqija gjendja dhe është momenti i fundit me ia gjet një dalje. Tash mund të thoni, ky po na tmerron, po thotë s'ka kohë, e paska njet me e çua dika! Shikoni, mos e qofshim ne dikah, epilogu dihet çka është. Pra, mos thoni nesër "e bankrotoi Qeveria". Nuk e bankroton Qeveria, por trendi qysh është duke shkuar, është i keq, pra është veç në minus e në minus. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Zoti Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Unë sot më shumë po i drejtohem kryeministrit.

Ne sot kemi, kryeministër, një rezolutë, kemi shumë rekomandime dhe ide brenda këtij debati, që ndoshta është i vonuar, por më mirë sot, se të shtyhet më tutje.

Ajo që më bëri përshtypje, megjithatë, përveç atyre paraqitjeve krejtësisht politike, këtu ka edhe ide e rekomandime të sinqerta për zgjidhjen e problemit të Postës.

Unë dua të them, duke të njohur, edhe pse nuk është në favorin ndoshta edhe politik të Aleancës, zgjidhja i përmbledh të gjitha këto rekomandime e ide është ajo fillestare, të krijohet një bord krejtësisht politik, në kuptimin politik që përfaqësuesit e grupeve parlamentare të dërgojnë përfaqësues profesionalë në këtë bord. Ashtu-kështu, bordet po themi që janë politike, hajde ta bëjmë një zgjidhje politike.

E di që nuk është ndoshta e mirë në aspektin partiak, edhe të koalicionit, po kjo do të ishte një vullnet juaji kombëtar, po edhe si gjentëlmën. Kjo do të ishte zgjidhja fillestare, pastaj ato rekomandime, vendime që mund të merren, të mira, të dhimbshme ose të padhembshme, le të mbesin pjesë e bordit, normalisht duke u dakorduar e duke koordinuar punën me Qeverinë, pse jo edhe me Kuvendin. Rekomandimet tuaja nëpërmjet këtij bordi për Postën do të jenë shumë më të lehta.

Në qoftë se duam një zgjedhje, edhe partitë politike, grupet parlamentare, në qoftë se do të jenë të sinqerta, atëherë kjo është një zgjedhje fillestare, e përkohshme, që mund t'i japë një drejtim kësaj çështjeje.

E tha edhe zoti Selmanaj që është kjo një shenjë edhe për ndërmarrjet e tjera, është një shenjë edhe për një ndërmarrje, është një mesazh qoftë edhe për Trepçën, qoftë edhe për kompani të rëndësishme, nacionale, çfarë janë Posta edhe Trepça.

Pra, ky është një propozim jo shumë politik, por kjo nuk është më zgjidhje politike, kjo është kombëtare, është nacionale, vlerë nacionale, po më duket që këtu pati ide të mira, të sinqerta, rekomandime, propozime, ta krijojmë një bord politik, unë them kushtësisht emërtimit po i them politik, ku grupet parlamentare me fuqinë e vet politike i çojnë përfaqësuesit profesionalë, ama profesionalë. Normalisht kjo krejtësisht bëhet në dakordim edhe me punën e Qeverisë, edhe ato rekomandime përmes jush si kryeministër, e vendimet i marrim në këtë Kuvend.

Ky është propozimi im, jo i grupit parlamentar, po është krejtësisht imi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, zoti kryesues, vetëm një kujtesë ndoshta kemi harruar pak çështjen e Rregullores, sepse Rregullorja thotë që interpelanca zgjat më së tepërmi tri orë dhe thotë kështu: “Kryeministri ka mundësi 15 minuta në fillim të prezantojë dhe më pas koha e tij u merret kohës së deputetëve që vijnë nga radhët e shumicës”, në funksion që të ruhet edhe instrumenti i rëndësishëm i interpelancës, të mos e shndërrojmë në debat parlamentar, sepse ai është instrument tjetër. Prandaj, veç ta respektojmë Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Në fakt, unë tash kur po i dëgjoj shumicën e kolegëve deputetë, m’u kujtua njëri prej armiqve më të mëdhenj të Kosovës në vitet ’94-95, thoshte: “Çfarë po kërkojnë shqiptarët e Kosovës?” Përgjigjja ishte që kërkojnë pavarësi. Ai thoshte: “More s’mund ta mbajnë, sot po ua dhamë, këta s’mund ta mbajnë as 24 orë”. Besoni, tash kur po diskutojmë tema të tilla, po them në çfarë shtate kemi ardhur! E shkatërroam Trepçën, e shkatërroam Ferronikelin, e shkatërroam Ballkanin e Suharekës, e shkatërroam Fabrikën e Amortizatorëve, shkatërroam me dhjetëra e dhjetëra e dhjetëra fabrika, tash i erdh rendi edhe Postës.

Dhe, tash dilema është si është e mundur që një kompani publike deri në vitin 2011 të na sjellë dividendë 410 milionë, sot gati po bankroton.

Disa arsyetime që unë i dëgjova nga menaxhmenti thoshin që këto forma alternative, si Viberi, sikur ka ndikuar që të bie produktiviteti. Po si është e mundur, se Viber është edhe në gjithë Evropën dhe pse atje ka rënie 3%, e tek ne 130%! Prandaj, duket sikur arsye themelore tash në këtë fazë ose të them angazhimi themelor do të duhej të ishte që Qeveria të kërkojë një auditim të thellë, çfarë në fakt ka ndodhur aty brenda? Kush janë këta njerëzit që kaq lehtë e shkatërrojnë një kompani publike? Tash ne s’mund të merremi vetëm me pasojën, pa u marrë me shkakun dhe, për fatin e keq, shkakun duket që është politika, sepse 3-4 drejtorë, të cilët i ka pasur kjo kompani, lidhen me PDK-në: Etrur Rrustemi, Ejup Qerimi, Agron Mustafa së fundit, anëtar i Kryesisë së Degës së PDK-së në Prishtinë, dhe tash këtu po dihet që politika është fajtori kryesor.

Për t’iu përgjigjur paksa zotit Milaim Zeka, i cili u nxeh kur e thashë, por unë desha veç t’ia kujtoj që një kohë kur ka filluar degradimi i kësaj, të them i punësimeve në këtë Postë, ka qenë zoti Fatmir Limaj ministër i Infrastrukturës.

Unë po ju kujtoj një rast personal: në fshatin tim të lindjes, në Mushtisht të Suharekës, rreth 1000 shtëpi i ka ai fshat, ekziston Posta dhe në kohën e Fatmir Limës janë sjellë dy punëtorë nga Bellanica e Malishevës, ndërkohë rinia e Mushtishtit silleshin nëpër rrugë. Dhe, çfarë bëjnë fshatarët, nuk e di kush, e kanë djegur Postën dhe qe 10 vjet nuk kemi Postë në Mushtisht, si rezultat i tensionit, i mllëfit që kanë pasur ndaj Fatmir Limës. Vetëm desha t’ia kujtoj atij, sepse ai tha jo PDK-ja, jo LDK-ja, tash me e pa faj, të gjithë pothuajse kemi faj, po normalisht që dikush po duket se e ka fajin kryesor dhe tash kemi ardhur në situatë ku jemi.

Cili është shqetësimi im tash në këtë fazë. Që unë nuk po shoh, kryeministër, prej juve dhe asnjë fjalë nuk e dëgjova as prej ministrit, cili është plani? Çka të bëhet? Ju po kërkon ndihmë prej neve ose po thoni sikur po na deklaroni sikur nuk e keni ditur gjendjen brenda. Këto është dashur t'i dini para se ta merrni pozitën!

Para 2-3 ditësh thatë që unë nuk jam për bisedime në tavolinë, sepse nuk kam ndonjë zgjuarsis që të gjendem aty. Më herët na the që kam marrë një vendim për faljen e borxheve, po mandej e mora vesh që nuk kishte pasur nevojë ta marr, tash po thua ejani, ndihmoni, se s'po di çka! More, mos ke hyrë në mal pa sakicë, kryeministër! Më fal që po e lëshoj në këtë rrafsh, e di që ju nuk jeni fajtori kryesor për këtë, sepse jeni vonë, tash e keni marrë Qeverinë. Por, qasja pa asnjë ofertë, pa asnjë model se si të bëjmë tash, çka të bëjmë tash, vërtet për mua është shqetësimi serioz.

Ta ketë roja 500 euro pagën, e kirurgu i zemrës në Kosovë 500 euro pagën, po diçka vërtet s'po funksionon dhe kur po diskutoni tani jemi duke menduar akoma, domethënë akoma s'kemi as masë emergjente çfarë duhet të bëjmë me PTK-në, kur po diskutojmë, po thoni, shiheni kur takoheni me njerëz atje, shihni mos po e bindni ndonjë kompani të vijë, po s'është kjo qasje, kryeministër. Unë e kuptoj dëshirën e vullnetin e mirë tuajin që ta bëjmë një zgjidhje, por unë mendoj që Qeveria është dashur ta ketë zgjidhjen së paku emergjente deri në një fazë tjetër, kur i kishim dhënë përgjigje edhe PTK-së, edhe Trepçës, edhe shumë kompanive të tjera të rëndësishme për Kosovën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti kryeministër e keni fjalën, nuk po e prishim rendin.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Në fillim nuk i marr 15 minuta, 2-3. Interpelanca është thirrur prej Parlamentit dhe Parlamenti megjithatë është punëdhënësi edhe i Qeverisë. Edhe rekomandimet tuaja, sugjerimet tuaja, mendimet tuaja nuk janë të pavlefshme për ne, na ndihmojnë, në këtë temë po flas, konkret.

Ajo që unë mund t'ju them juve është po, kemi ndërhyrë në gjendjen në kompani, pra nuk e kemi lejuar një vazhdim çfarë ka qenë, nuk po themi që kjo ndërhyrje është një zgjidhje, nuk është zgjidhja, po kemi ndërhyrë. Ne si zgjidhje kemi disa masa, disa kufizime, pra, t'i ndalim humbjet, po çka të bëjmë me një kompani si kjo, janë praktikat biznesore që kishim pasur dëshirë t'i aplikojmë, po në rastin konkret problemi është pikërisht humbjet, pra e ke një mall ose një kompani që është me humbje.

Për këtë po them edhe një herë, nuk po duam t'ju qesim para aktit të kryer, çka të bëjmë me te, po ia vlen, është njëra prej situatave kur ia vlen që edhe të marrim edhe kontribute të ndërsjella. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Potencialet janë përparësi e padiskutueshme e Telekomit karshi konkurrencës.

E para, infrastrukturë cilësore, optike dhe bakër e instaluar nënë tokë sipas rregullave, jo me tela nëpër hava sikur të tjerët.

E dyta, mbulim i lartë i territorit dhe i popullsisë.

E treta, linja ndërkombëtare me të gjitha shtetet e rajonit, prezencë në nyjat më të mëdha evropiane nëpërmjet telekomeve dhe parterëve.

Edhe e katërta, është lojaliteti i madh i popullsisë ndaj Valës, por ka edhe raste të tjera në rajon, për shembull, në Maqedoni shumica e tregut ka ngelur në Mobi Mak, edhe pse janë prezentë edhe dy operatorë të tjerë.

Pra, Telekom i jo që nuk do të duhej të ishte në krizë po shansi ynë, veçse dikush edhe mund të mendojë që më mirë ta kishim shitur dikur se sa ta shesim tani. Mirëpo, a e dini çfarë ka qenë Telekom i dikur, 200 milionë euro dividendë në vitin 2009, nuk mund ta shesësh diçka që të sjellë 200 milionë euro dividendë.

Nëse kemi një pulë që t'i bënë vezët e arta, eventualisht i shtet vezët, po pulën nuk e shet dot. Kush është ai i çmendur që e shet pulën që i bënë vezët e arta. Nëse dikush mendon që është dashur të shitet PTK-ja në vitet 2009 e 2010, kjo është si të mendosh që pulën që t'i bënë vezët e arta, ta shesësh. Prandaj, ka qenë absurde që aso kohe të shitet PTK-ja.

Dhe, rrënimi i PTK-së, duhet ta kuptojmë një herë e përgjithmonë, nuk është fatkeqësi natyrore, por është krim i organizuar.

Problemi me kryeministrin Haradinaj është që ky nuk po dëshiron të merret me problemin e PTK-së si krim i organizuar, ky po i qaset gati si OJQ. A mund të bëjmë diçka të vogël e të përbirohemi e të shpëtojmë pa e ngucur bash askënd? Po, nuk është mundur ashtu, se është krim i organizuar, pa u ballafaquar me kriminelët, nuk ka zgjidhe. Ky është problemi i qasjes së kryeministrit.

Ka tri mënyra për ta zgjidhur lëmshin e korrupsionit në sektorin e telekomunikimit.

E para është dështimi, siç e dini, për ta arkëtuar garancinë bankare prej 16.2 milionë eurosh, që është 20% e ofertës financiare të të ranguarit të parë në tenderin për operatorin e dytë të



telefonisë mobile KOSSELL, të gjithë e mbani në mend kur u pati detyrua Dukagjini që të tërhiqet.

Këtu dua t'ju kujtoj një deklaram të ministrit Ahmet Shala në Kuvendin e Kosovës, nuk e di nëse ka qenë viti 2009 ose 2010, kur ai nën presionin e disa deputetëve pranoi se garancia bankare e KOSSELL është në Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit dhe vetëm duhet të arkëtohet. Afati për këtë arkëtim ishte janari i vitit 2011, i cili kaloi pa u derdhur në buxhetin e Kosovës 16.2 milionë euro, pra kjo është mënyra e parë për ta zhdrivilluar lëmshin e korrupsionit.

Mënyra e dytë është hetimi i kontratës së Z-Mobile, e cila ishte goditja vendimtare kundër Telekomit. Përkundër faktit se kjo kontratë ishte konsideruar si e dëmshme për PTK-në, Qeveria insistonte që ajo të nënshkruhet dhe madje nënshkrimin e saj e vendosi si kusht për këdo që do të vinte drejtor në PTK, gjë të cilin e pranoi veç një kandidat, Shyqeri Haxha.

Pra, të gjithë po pajtohemi që kontrata me Dardafon, tash Z-Mobile, është produkt i krimit të organizuar.

Deputetët e të gjitha partive ishin një zëri në këtë. Prandaj, kryeministër, shkarkoje Bordin, ndërprerje kontratën me Z-Mobile dhe bëri nga kjo foltore thirrje Prokurorisë që ta hetojë këtë kontratë, konkretisht, shkarkoje qysh sot Bordin, menaxhmentin e emergjencës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe dy minuta më tepër se grupi që i keni.

ALBIN KURTI: Pra, shkarkimi i Bordit, menaxhmenti i emergjencës me profesionistë, ndërprerja e kontratës me Z-Mobile dhe thirrja e Prokurorisë që të hetohet ajo. Mënyra e tretë, për ta kuptuar krimin që ndodh dhe për ta luftuar atë, është shikimi i pasqyrave financiare dhe krahasimi i tyre me kompanitë private, në të cilat politika kishte të lidhura interesat. Ndërkohë, që operatorët privatë po rriteshin, që nga viti 2010 PTK-ja po binte me shpejtësi të jashtëzakonshme. Kështu në vitin 2009 dividendata 200 milionë, në vitin 2014 veç 10 milionë! Dhe, sot nuk po mund t'i përballojë as pagat e të punësuarve.

Kryeministër, Qeveri, deputetë,

Telekomi i Kosovës është në klinikë emergjente, duhet t'i ndalet gjakderdhja, nuk mund të jetë terapia një ventilator shtesë në dhomë për freskimin e pacientit, nuk mund të jetë, është në klinikë emergjente. Edhe një herë po them, çasti është tash, Kuvendi është këtu, ju jeni këtu, shkarkimi i Bordit, ndërprerja e kontratës me Z-Mobile dhe thirrje Prokurorisë që të hetojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Tani me kujdesin më të madh, kur po ka shpërputhje, s'po kam qare pa i shpjeguar. Dikush po harron që një "ngo" s'kishte mundur tash të emërojë bord të ri, ka shkuar bordi, Albin, s'di a e di, s'është ai që e ka sjellë këtu gjendjen, s'është ai, ka shkuar drejtori, fatkeqësisht ose fatmirësisht, ndoshta. Neve na ka mbetur dëmi, e dëmin ose si polic, ose si prokuror, ose si qytetar a si politikan e do një plan biznesi. S'mund ta nxjerrësh një gjendje të numrave pasi ke hyrë duke e mësuar ekonominë, Dardani e Lumiri duhet të na marrin lakmi mua e ty, se jemi duke i marrë vesh temat, e s'ka qysh të dalë ndryshe pa e gjetur një formulë, një plan biznesi çka t'i bëhet Postës. Bordi veç ka shkuar në shtëpi. Pajtohem me ty.

Por, ka edhe diçka që hezitova ta them deri tash, jemi në foltore, është publik, duhet të kihet kujdes me veprime të njëanshme, kur janë kontratat, për shkak se një herë e kemi hëngër me një arbitrazh pikërisht në këtë temë, dhe çdo deklaram, çdo veprim duhet të matet çka po bëjmë. A na pëlqen, a s'na pëlqen, po duhet matur, se e kemi marrë një vendim të dëmshëm dhe i kemi pasojat e atij vendimi, si Kosovë. Për këta, ju lutem, shikoni ne nuk jemi pa një vizion si të dilet prej kësaj gjendjeje. Si kryetar Qeverie nëse i bëj thirrje Prokurorisë a dikujt, mund ta bëj, por jo nga këtu, atëherë shfrytëzoj ndonjë kanal të punës, nëse bash duhet. Por, jam duke thënë diçka tjetër, po gjendjen e kemi të rëndë, ndërhyrja ka ndodhur, në menaxhment ka ndryshime (*ndërprerje e incizimit*) dhe çka tjetër, kufizime kemi vendosur. Çka bëjmë më tutje si plan biznesi, ju thashë nuk jam kundër, unë mendoj që Parlamenti, në këtë rast, ndonjë komision që është për këto tema që keni sugjerime konkrete nuk jemi kundër tyre, pra është një gjendje e rëndë që e ka gjetur kjo Qeveri dhe e cila nuk po përton të merret me këtë temë, por jo veç për qëllimin ligjor, pra qëllimi ligjor është një, e kemi dhe qëllimin ekonomik, të punëtorëve, të bilancit të kësaj kompanie dhe po duam ta lëvizim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse kjo interpelancë realisht e ka temën e trajtimit të dy ndërmarrjeve të publike: Telekomin dhe Postën dhe 90% e fokusit ishte për Telekomin e Kosovës. Kanë qenë një kompani vite më parë, por tash janë dy ndërmarrje të veçanta dhe duke marrë shkas nga një numër shkresash që ne i kemi pranuar si deputetë, veçanërisht si anëtarë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, dhe që e kemi trajtuar pak, por ka mbetur që të trajtohet edhe në një mbledhje tjetër, një problem i Postës së Kosovës që ndërlidhet me shërbimin universal postar, unë do të flas për këtë çështje, duke shfrytëzuar edhe prezencën e kryeministrit dhe të ministrit.

Do të thotë, ne kemi pranuar disa shkresa edhe nga bordet, edhe nga menaxhmenti i Postës, me anë të cilave jemi njoftuar se Qeveria, konkretisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk e ka zbatuar një marrëveshje që buron nga Ligji për shërbimet postare dhe që lidhet me mbulimin e humbjeve financiare që ka pasur Posta e Kosovës gjatë ofrimit të shërbimit universal postar. Sipas Ligjit për shërbimet postare, Posta është e obliguar që ta ofrojë këtë shërbim në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe me nenin 45 të Ligjit në fjalë, definohet qartë se kur Posta krijon humbje financiare nga ofrimi i shërbimit universal postar, atëherë kjo humbje duhet të kompensohet nga Qeveria.

Për zbatimin e këtij detyrimi ligjor Posta e Kosovës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë nënshkruar edhe një marrëveshje në shkurt të vitit 2014, me një kohëzgjatje pesëvjeçare, sipas të cilës definohet mbulimi i humbjeve të Postës gjatë ofrimit të shërbimit universal.

Meqenëse Posta është ofruesi i vetëm i këtij shërbimi në Kosovë, zbatimi i këtij shërbimi mbikëqyret nga Arkep-i dhe ky institucion për çdo vit bën vlerësimin e ofrimit të këtij shërbimi, por edhe e cakton tarifën për këtë shërbim dhe tarifa aktuale për një dërgesë është 40 centë. Mosmbulimi i këtij shërbimi për vite me radhë e ka rënduar vazhdimisht gjendjen financiare të Postës së Kosovës, e cila e ka sjellë në një situatë që të mos ketë mundësi as t' i paguajë pagat për punëtorët dhe obligimet ndaj palëve të treta në afatet e parapara ligjore. Si shembull konkret, ta zëmë, muajin e fundit më shumë se gjysma e punëtorëve jam i informuar nga këto shkresa që pagat i kanë marrë diku rreth datës 10 prill. Bordi dhe menaxhmenti pas shumë kërkesave që ia kanë drejtuar ministrisë dhe Qeverisë, në lidhje me humbjet, pra, dhe duke u bazuar në marrëveshje, janë detyruar t'iu drejtohen edhe përmbaruesit privat për ta realizuar të drejtën e vet që ata e pretendojnë, normalisht, dhe përmbaruesi pastaj e ka iniciuar një propozim përmbarimi, sipas të cilës i ka obliguar ministrinë që t'i kompensojë humbjet e shkaktuara, duke u bazuar në marrëveshje dhe në ligj, në një shumë prej mbi 3 milionë euro.

Normalisht kundër këtij propozimi MZHE-ja ka parashtruar kundërshtim, por ky kundërshtim është refuzuar nga Gjykata Themelore dhe nga informatat që ne i kemi aktualisht, kjo çështje është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit. Meqenëse konsiderojmë me të vërtetë që është problem i madh, dhe Posta e Kosovës është e obliguar që ta ofrojë këtë shërbim, si shembull konkret, nëse një dërgesë duhet të shkojë në fshatrat më të thella të Kosovës, ta zëmë, diku larg në komunën e Dragashit, kostoja është 40 cent, por kostoja reale që i kushton Postës së Kosovës është shumë herë më e madhe, sepse duhet shkuar dikush atje me makina, me këtë e atë dhe ta kryejë një shërbim që është i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës dhe që është i përballueshëm financiarisht për ta. Andaj, meqenëse e kemi prezencën edhe të ministrit, edhe kryeministrit, unë do të kërkoja që Ministria e Zhvillimit Ekonomik t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm që ta zbatojë edhe Ligjin për zhvillimet postare, edhe marrëveshjen që e ka të nënshkruar me Postën për mbulimin e humbjeve që janë shkaktuar dhe që janë duke i shkaktuar Postës për ofrimin e këtij shërbimi.

Më së paku veprimin që mundet ta bëjë ministria në këtë moment është që për shembull, të fillojë pagesën e obligimeve për vitin 2017m për çka së paku s'kemi informata që ka ndonjë kontestim as nga ana e MZHE-së. Rreziku është që nëse me të vërtetë nuk ndërmerren veprime, Posta mund të përballet edhe me pamundësi totale të pagesave të pagave dhe me probleme në operim dhe funksionim, e pastaj mund të gjendemi në një situatë ndoshta ngjashëm të keqe siç e kemi gjendjen edhe me Telekomin e Kosovës, pastaj po dalim që gati asnjë ndërmarrje publike në Kosovë nuk po mbetet joprofitabile, po as funksionale. Kështu që e kishim mirëpritur, zoti ministër, angazhimin tuaj personal, por edhe të Qeverisë për ta zgjidhur këtë çështje, e konsideroj tepër të rëndësishme.

Për pjesën tjetër do ta lëmë një diskutim të mëvonshëm, për bordet politike dhe për gjëra të tjera që u thanë, sepse mendoj që ka nevojë për një trajtim pak më në detaje. Faleminderit, i nderuar kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Prej diskutuesve i fundit është Naser Rugova dhe pastaj është minutazhi i zotit Kurti dhe zotit Haradinaj.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër,

Ministra,

Kur diskutojmë për asete nacionale strategjike, siç është Telekom i Kosovës, Telekom i një shteti, atëherë vërtet duhet ta kemi një qasje shumë analitike, shumë profesionale. Ky debat e ka një mungesë materiale të caktuar edhe nga menaxhmenti, edhe nga ministria dhe realisht Telekom i Kosovës nuk është vetëm platformë elektronike, digjitale, sistem kabllor, e tjera. Telekom i Kosovës është shumë më i rëndësishëm, është truri i komunikimit ndërinstitucional, duhet të llogarisim që nesër do të kenë Ministri të Mbrojtës dhe ushtri, komunikime të tjera të natyrës së sigurisë nacionale, Agjencia Kosovare e Inteligjencës, Zyra e Presidentit, e Kryeministrit, e tjera, e tjera.

Prandaj, shihet që ka qenë një qasje joprofesionale, madje-madje edhe e vrazhdë ndaj një aseti strategjik siç është Telekom i Kosovës, i stërpolitizuar dhe tejet joprofesional. Kemi ardhur në një situatë kur një nga asetet kryesore që ka gjeneruar dhe shteti i Kosovës, buxheti i Kosovës ka përfutur dividendë të jashtëzakonshme nga një aset i tillë, tani ka ardhur buzë falimentimit. Dhe, nga të gjitha diskutimet, edhe të kolegëve deputetë, por edhe të kryeministrit të vendit thjesht deri tani nuk po e kemi një propozim konkret se çka tutje, si të procedohet që ky aset i rëndësishëm nacional të shpëtohet dhe thjesht me çfarë politikash, me çfarë masa konkrete t'i qasemi. Prandaj, zoti kryeministër, konsideroj që me urgjencë duhet të ndërpriten kontratat e dëmshme që e kanë dëmtuar skajshëm Telekomin e Kosovës. Të bëhet një fizibilitet emergjent i kërkesave, nevojave dhe masave që mund të merren. Pse të mos propozohet dhe një partneritet publiko-privat, ku shteti mund t'i ketë 51% të aksioneve dhe të shpallet një interes për investitorët e

mundshëm për pjesën tjetër. Përndryshe, me këtë qasje dhe me këto konstatime pa alternativa konkrete, frikësohem se muajt në vijim Telekom i Kosovës do të vijë para falimentimit.

Unë mendoj që Kuvendi i Kosovës në këto tema duhet ta gjejë atë konsensusin për alternativa konkrete, me masa konkrete, sepse vërtet këto ditë kemi debatuar shumë, kemi pasur mjaft debate, interpelanca, kemi votuar rezoluta me dhjetëra pika dhe nga praktika e këtyre masave që i merr Legjislativi i vendit fare pak vërehet punë konkrete për problemet që i kemi adresuar. Në fund, desha të them edhe një gjë, njëri nga kolegët deputet këtu, që s'e kam përmend sot me emër, unë kam kërkuar që të ketë sjellje parlamentare, bonton parlamentar dhe, zoti kryesues, ju dhe të gjithë që udhëhiqni me seancën të marrin masa kur përdoret fjalor joparlamentar.

Le që nuk tërhiqem nga ajo që e kam thënë, sepse po vij nga një promovim libri në Panair të librit dhe kur dëgjova tema të tilla dhe kush po flet dhe çka po thotë. Nuk e kam ndërgjegjen e vrarë kombëtare, nuk kam shitur bileta të JAT-it (Jugosllavenski aerotransport), nuk kam mashtruar askënd, nuk kam probleme me ndërgjegje, nuk kam festuar kur intelektualë, komandantë dhe veprimtarë të mëdhenj të këtij vendi janë vrarë nga dora e zezë. Prandaj, kërkoj, sepse pastaj po thoni po hapni tema të rënda, do t'i hapim, do t'i hapim dhe bëj apel për t'i hapur letrat, jemi këtu. Edhe një herë kërkoj bonton parlamentar, sjellje parlamentare, sepse unë kurrë nuk e fyej askënd në personale. Ramush Haradinaj është kryeministër, kam për ta kritikuar për të gjitha ato të bërat apo të pabërat, për shembull, që i takojnë atij me ligj dhe me Kushtetutë, kurse në gjëra personale nuk lëshohem.

Dhe, bëj apel edhe një herë, zoti kryesues, si nënkryetar i Kuvendit, nënkryetarët po edhe kryetari, të mos lejohet një fjalor i tillë në Parlamentin e Kosovës, sepse po na fyen të gjithëve si njerëz të zgjedhur. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Për nder s'di as qysh ta dalloj atë farë fjalori, se e kemi nisur ashtu dhe derisa nuk krijohen rregulla, njerit ia ndal tjetrit, hidhërohen, të flasë kush çka të dojë.

Atëherë, fjalën e ka kryeministri Ramush Haradinaj. Nëse e do fjalën, pesë minuta i ke, kryeministër.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** I nderuar kryesues dhe të nderuar kolegë deputetë, Para se ta them atë përfundimtare, kisha pasur dëshirë për një mirëkuptim. Unë e di që është edhe një interpelancë, por kam bërë gabim në planifikim, kam paraparë, i kam ftuar në iftar Bashkësinë Islame për respekt të besimtarëve që agjërojnë dhe ka koiciduar bash sot. Jo, unë për vete s'e mbaj ramazanin, po për respekt të atyre që e mbajnë e të besimtarëve, i kam ftuar ata.

Më vjen keq, por më duhet të largohem për pak kohë, mos të merret që ika prej interpelancës tjetër që është në rend. Me rrejt, jo se Zoti s'rrehet thanë, kështu që unë vetë s'e mbaj, por për respekt të atyre që janë besimtarë.

Shikoni kolegë, me qëllim nuk erdhëm me një gjendje të kryer te ju, pra me një propozim të kryer te ju në Parlament, për shkak për t'u lënë hapësirë kontributeve tuaja. Por, një gjë ju siguroj. Të gjitha masat që e ndalin degradimin e mëtejme të Telekomit jemi duke i ndërmarrë. Të gjitha masat, nuk ka masë që është në kapacitet të kësaj Qeverie, ose kushdo që të kishte qenë, qeveritë që i kanë kapacitetet ligjore që s'jemi duke e ndërmarrë për ta ndalë degradimin e mëtejme. Pastaj, një plan biznesi çka t'i bëjmë Telekomit është i nevojshëm. Orientimi ynë është gjetja e një partneri, gjetja e një investitori. Veç problemi është qysh ta sjellim për ta kthyer Telekomin si kompani atraktive, që dikujt t'i interesojë. Ajo është pjesa problematike, që e kemi tash para vetes.

Andaj, duke ju falënderuar të gjithëve, në këtë aspekt mos dyshoni. Pra, të gjitha masat që ndërpresin degradimin në këtë kompani me rëndësi për vendin jemi duke i marrë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kurti e keni fjalën, pesë minuta.

**ALBIN KURTI:** Deputetë të Kuvendit,

Për mua është e qartë që kjo Qeveri nuk po bën asgjë për arkëtimin e 16,2 milionë eurove, që kjo Qeveri nuk po bën asgjë për ndërprerjen e rrjepjes së Telekomit nga Z-Mobile, ani pse në arkiv për shkak të qeverive paraprake e ka edhe petitionin e punëtorëve të PTK-së kundër kontratës së dëmshme. Dhe, kjo Qeveri po bën gjithçka për ta bërë bordin politik, siç e bëri më 29 mars. Besa Shatri, Fidel Krasniqi, Sead Ujkani, Suzana Angjelkoviq, Skender Hoti, Osman Ejupi, asnjë emër unë nuk e njoh si ekspert nga fusha e telekomunikimeve. Kjo është absurde.

Unë kam diplomuar në Fakultetin e Elektroteknikës - Telekomunikacion me kompjuteri, këta emra s'po i njoh. Ka shumë profesorë e profesionistë, asnjë prej këtyre emrave nuk po e njoh. Kjo i bie që ky kryeministër po shpreson që Telekomin do ta nxjerrë nga kriza Zeqir Kiçina. Nuk mundet me e nxjerrë Zeqir Kiçina Telekomin nga kriza. Ju po e merrni më qafë edhe Zeqirin e shkretë edhe Telekomin e Kosovës e në fund edhe veten.

Pse nuk po i thërrisni Virtyt Koshin, që është zëvendës-president i Eriksonit për Britani, pse s'po e thërrisni Shkumbin Hamitin, pse s'po e thërrret Nusret Shalën, këta ta nxjerrin Telekomin prej krizës. Kudo në Botë gjenitë e shoqërisë janë CO të Telekomunikacionit. Me gjithë respektin për Zeqirin, por një njeri të mirë ju do ta bëni të keq, për shkak se në vendin e gabuar.

Prandaj, ne kërkojmë 12 pika në këtë:

## REZOLUTË

1. Qeveria menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute të fillojë nga zbatimi i të gjitha detyrimeve nga Ligji për ndërmarrjet publike, duke anuluar çdo vendim tjetër që bie ndesh me këtë ligj;
2. Qeveria 15 ditë nga miratimi i kësaj rezolute të ngrejë shtabin e menaxhimit të krizës në këto dy ndërmarrje, me qëllim ristrukturimin e thellë të veprimtarisë biznesore, të burimeve njerëzore dhe të planit të investimeve;
3. Përbërja e shtabit të krizës, termet e referencës dhe profili i anëtarëve të përcaktohet në bashkëpunim me Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe Qeverinë e Kosovës;
4. Të tërheqë anëtarët aktualë të Bordit të emëruar pa bazë profesionale dhe të propozojë anëtarë me integritet të lartë dhe profesionistë me përvojë të gjatë në fushën e telekomunikacionit, financave dhe të administrimit të ndërmarrjeve;
5. Auditori i përgjithshëm menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute të fillojë auditimin e performancës dhe auditimin e financave të Telekomit dhe të Postës së Kosovës;
6. Qeveria në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës të shqyrtojë pas ristrukturimit të thellë të strukturës organizative të Telekomit moratoriumin për pagesën e dividendës nga Telekomit i Kosovës për një periudhë dyvjeçare;
7. Qeveria e Kosovës si aksionari kryesor duhet të tërhiqet nga marrëveshja abuzive e ish-drejtorit të Telekomit me Kompaninë Z-Mobile;
8. Kryeministri t'i raportojë Kuvendit jo më larg se 30 ditë nga miratimi i kësaj rezolute për masat e marra në Telekomit dhe në Postën e Kosovës;
9. ARKEP të zbatojë Ligjin duke njoftuar sa më parë lidhur me tarifat e reja të licencimit të Telekomit të Kosovës;
10. Qeveria të bëjë publike të gjitha dokumentet lidhur me titullin e pronësisë së kodit telefonik +383;
11. ARKEP-i të marrë masa për pezullimin e përdorimit të kodit të Serbisë +381; dhe
12. Kuvendi i Republikës së Kosovës e fton Prokurorinë e Kosovës që të vendosë në prioritet hetimin e kontratës me Dardafon apo Z-Mobile. Faleminderit!

KRYESUESI: Abdixhiku e ka fjalën, si bashkështrues i mocionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Lidhja Demokratike e Kosovës dëshiron t'i koordinojë një pjesë të rekomandimeve, meqenëse edhe në propozimin tonë patëm ide konkrete. Pra, në thelb të trajtimit të PTK-së është problemi njerëzor i influencës politike dhe kjo influencë duhet të ndërpritet sa më parë.

Ne kemi kërkuar fillimisht me hapa të shpejtë, të menjëhershëm, vendosjen e moratoriumit në punësim, sepse gjendja e rritjes së punësisë në Telekom vazhdon edhe sot.

Kemi propozuar gjithashtu edhe ristrukturimin e menjëhershëm të PTK-së me preferencë të angazhimit të një institucioni, organizate menaxhuese në këtë PTK.

Kemi ftuar gjithashtu Qeverinë që të hapë të gjitha kontratat, t'i bëjë në dispozicion të Prokurorisë dhe të ndërtojë një task-forcë për ta bërë këtë hetim. Dhe, kemi propozuar gjithashtu gjetjen e një vizioni më afatgjatë që përfshin edhe investimet e kapitalit privat në Telekom.

Ne e ftojmë edhe Lëvizjen Vetëvendosje, por edhe partitë tjera politike parlamentare që të bëjë koordinimin e rekomandimeve me rekomandimet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne rekomandimet s'kemi akoma kuorum për t'i votuar, por prapë edhe për këtë është e njëjta gjë. Mirë është që edhe këto rekomandime të harmonizohen, në qoftë se ka mundësi, në qoftë se jo, i qesim në votim ashtu siç janë në kohën kur ka kuorum në sallë.

Tani, zoti kryeministër paska lënë një takim. Mendoj që mund ta fillojmë, mund ta bëjë ekspozenë e tij kryeministri për pikën 6. A doni ta ndërpresim? Anë, merreni fjalën ju si propozues, kush të doni, Avdullahi apo... Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Duke qenë se kryeministri ka angazhime, e kjo është interpelancë e kërkuar me të, është e rëndësishme dhe interpelanca mund të zhvillohet vetëm me prezencën e tij.

Duke qenë se ai nuk është për arsye vërtet objektive, atëherë ne propozojmë që kjo të shtyhet në një ditë tjetër me vendim të Kryesisë dhe në koordinim edhe me kryeministrin, mund ta caktojmë një herë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, për mua është në rregull, sepse ju keni të drejtë si propozues ta tërhiqni në çdo kohë çdo lloj propozimi që e keni. Unë meqenëse s'kemi kuorum, besoj që Kryesia takohet të hënën dhe e cakton seancën, ose vazhdimin e seancës, edhe për votimin e disa çështjeve që kanë mbetur pa u votuar. Faleminderit!

\* \* \*



*E enjte, më 14 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju lus që t'i zini vendet, regjia t'i bjerë ziles për t'i ftuar deputetët në sallë, sepse do të futemi në votime sipas rendit të ditës.

Nuk ka kuorum, në sallë i kemi 38 deputetë dhe unë jap pauzë 10 minuta për t'u bërë kuorumi.

I lus kryetarët e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët në sallë. Faleminderit!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, para se të fillojmë me rendin e ditës së seancës plenare të caktuar për sot.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, ka vendosur që Kuvendi të vazhdoj me procedimin e pikave të papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 5, 6 dhe 8 qershor 2018, si në vijim:

## ***22. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017***

Diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 2, 4 dhe 5 kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 6 dhe 8 qershor 2018, por në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje votimi nuk është proceduar.

Janë vetëm 43 deputetë, kjo është arsyeja pse deri tash kemi pritur. Po e shoh, më duket që nuk ka deputetë. Le të vijnë deputetë në sallë, ata të cilët janë.

Shefat e grupeve ose përfaqësuesit le të mendojnë në qoftë se nuk ka deputetë kur do ta vazhdojmë seancën, të hënën, të martën, të mërkurën. Nuk kemi çfarë të bëjmë, veç presin disa.

Na duhen edhe nja dy deputetë të vijnë.

Atëherë, shkojmë në votim. Në sallë janë 62 deputetë.

Përgatitemi për votim, raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2017.  
Votojmë tash!

Po e shihni edhe vetë s'kam nevojë t'i lexoj, na duhet edhe një herë ta hedh në votim.

Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 67 deputetë, 44 për, 18 kundër dhe 5 abstenime. Kuvendi e miratoi raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017.

### ***23. Votimi i raportit vjetor të Akademisë të Drejtësisë për vitin 2017***

Votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë, 60 për, 3 abstenime. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017.

### **28. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

KRYETARI: Grupet parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Socialdemokrate dhe Listës serbe i kanë propozuar zëvendësimet e anëtarëve në komisionet parlamentare. Propozimet e grupeve parlamentare u janë shpërndarë deputetëve.

Nga propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Socialdemokrate sipas marrëveshjes me kryetarët e këtyre dy grupeve më 6 qershor 2018 hiqet propozimi i PSD-së për anëtar të Komisionit për Komunitete dhe propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komisionit për Mbrojtjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Lista serbe ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Parlamentar si në vijim: Sasha Milosavljeviq anëtar të komisionit për të Drejtat e Njeriut në vend të deputetes Miljana Nikoliq.

Të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që me ngritje dore të deklaroheni. Urdhëro! Albulena Haxhiu, pastaj Driton Çausi nga PSD, e kanë fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Të nderua deputetë,

Ne e kemi proceduar propozimin për plotësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare nga grupi ynë parlamentar më 16. 3. 2018. Më lejoni që vetëm disa ndryshime, shpresoj që

Administrata e Kuvendit do t'i evidentojë për shkak se ka disa gabime. Po mundohem që t'i theksoj për faktin se pastaj duhet të votohen. Tek Komisioni për Buxhet janë zoti Ali Lajçi dhe zonja Arbërie Nagavci, dhe jo zonja Fitore Pacolli. Ka qenë një gabim i asistentëve tanë. Po ashtu edhe te Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë janë deputeti Shemsi Syla dhe Arbër Rexhaj, pastaj te Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës zëvendëskryetar i parë është Rexhep Selimi dhe deputeti Xhelal Sveçla.

Në ndërkohë ju lutem na njoftoni në qoftë se edhe Grupi Parlamentar i PSD-së e ka tërhequr propozimin për kryetar të Komisionit për AKI, sepse besoj e dini që propozimi i tyre ka qenë që të jetë Fisnik Ismaili kryetar i këtij komisioni, në anën tjetër ky komision i takon Lëvizjes Vetëvendosje, prandaj meqë nuk e kemi një marrëveshje paraprake, atëherë kemi vendosur që çështja e kryetarit të Komisionit, përkatësisht këtij komisioni të vendoset në një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Driton Çausi, urdhëro!

DRITON ÇAUSHI: Janë vetëm dy sqarime që grupi ynë parlamentar duhet t'i bëjë. E para, sa i takon Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim duhet ta tërheqim propozimin tonë dhe gjithashtu tërhiqet propozimi ynë për kryesues të Komisionit për Mbikëqyrje të AKI-së.

Sa i takon kryesimit të këtij Komisioni, do të jetë një vendim politik i Kryesisë së Kuvendit.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Në rregull! Atëherë kërkoj që me ndritje dore të deklaroheni për propozimet në fjalë. Ka dikush kundër? Nuk ka!

Konsideroj që Kuvendi i miratoi propozimet e grupeve parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Socialdemokrate dhe Listës serbe.

***5. Votimi i Propozim-Rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike Telekomit dhe Postës së Kosovës***

Debati ka përfunduar, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk ka kuorum për votim.

Nuk ka dhjetë herë të lexohen, po pse s'po e votoni pra, pasi janë deputetët.

Po s'dua t'jua jap fjalën, po ti pse po bërtet! A po doni të bëni hajgare me mua, a qysh e keni hallin? Nëse është harmonizuar, votojeni!

Unë mund ta hedh edhe një herë në votim, nëse është harmonizuar, votojeni, nëse nuk është harmonizuar, dy herë për një çështje nuk e merr fjalën kurrkush. Jo!

## **6. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës...**

E kemi një kërkesë të kryeministrit që ta shtyjme interpelancën për orën 13:30, arsyeja është se kryeministri ka shkuar në promovim të autostradës Prishtinë - Hani i Elezit. Kështu që unë besoj që duhet pasur parasysh këtë, kur të vijë kryeministri, futemi drejtpërdrejt në interpelancë. A je dakord Avdullah?

Mirë, për pikën paraprake, por unë nuk po dua të hap diskutim, sepse, shiko Avdullah, në qoftë se ju e keni harmonizuar, ju mund ta votoni. Në qoftë se nuk e keni harmonizuar, mund të votoni kundër. Kjo është!

Unë fjalën nuk ia ndal kurrkujt, jo, unë po jua ndal fjalën sepse ju po e keqpërdorni dhe po e kërkon fjalën në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit. Edhe tani po e kërkon fjalën në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, sepse ti s'je propozues.

E, pse s'po e votoni atëherë. Çka të lexojë? Po i ka lexuar atë ditë, qysh? Sot janë harmonizuar, në rregull, hajt.

Shiko, është bërë foltorja e Kuvendit, të mos flas tash. Nuk ka kuptim kështu. Ose komunikoni me letra, me deputetët dhe me rregulla sipas Rregullores, unë nuk mundem dhe është e pamundur që ai që e drejton seancën i këqyr 120 deputetë dhe secilit ia bën qejfin këtu. Të lutem! Unë për hir të korrektësisë...

Unë e kam Rregulloren, nuk e kam as Teutën, as Albulenën, as Avdullahun, as juve 120 vetëve s'ju marr parasysh hiç, veç Rregulloren. Nëse doni ta zbatoni Rregulloren, e zbatojmë, nëse doni me britma, ju mund të bërtisni sa të doni, mund të thoni çka të doni, mund të shani qysh keni sharë, por unë Rregulloren e zbatoj. Nëse mendoni që duhet të udhëheq, nëse mendoni që duhet krijuar anarki dhe të zhvillojë debat sipas dëshirave çdo kush këtu, atëherë nuk ka nevojë për drejtues të Kuvendit hiç, e lëmë foltoresh, me rend flasim dhe kaq është ajo punë.

Unë për hir të korrektësisë, sipas informacionit që e kam, meqë po insistohet, kemi harmonizim të kësaj propozim-rezolute sipas Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të LDK-së, mund ta lexoni harmonizimin që e keni bërë dhe e votojmë, por pa diskutim, pa debat.

Mirë, nëse kjo s'është votuar, duhet edhe një herë ta shtimë në rend të ditës. Unë po dua ta shkel Rregulloren për shkak se Avdullah Hoti po kërkon që ta shkel unë, edhe Albulena po kërkon ta shkel. Për të dytë po dua ta shkel, edhe për Grupin Parlamentar të LDK-së, edhe të Vetëvendosjes. Lexoni rekomandimet, zoti Hoti e ke fjalën!

AVDULLAH HOTI: Kryesues i seancës, unë mendoj që fjalorin që je duke e përdorur nuk ka vend në këtë seancë. "Dua ose s'dua me ta dhënë fjalën", besoj që nuk duhet të përdoret nga kryesuesi i seancës. Më lejoni ta sqaroj, pika që lidhet me këtë rezolutë...

KRYESUESI: Rregulloren e interpretoj unë, Avdullah, jo ti. Ti s'ke të drejtë, unë e interpretoj. Dhe, ti ke të drejtë të ankohesh ku të kesh qejf.

AVDULLAH HOTI: A më lejon të flas tash?

Janë dy interpelanca të kërkuara nga dy grupe parlamentare që janë bërë bashkë, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe i Vetëvendosjes. Ne si dy grupe propozuese të kësaj e kemi harmonizuar këtë rezolutë dhe kërkesa e deputetëve nga Lëvizja Vetëvendosje ishte që të lexojë rezolutën e harmonizuar në mes të dy grupeve iniciuese të kësaj interpelance dhe kërkesa ishte që të lexohet rezoluta e harmonizuar dhe të dalë në votim. Deputetët e tjerë votojnë sipas bindjeve të tyre, kjo ishte kërkesa. Nuk kishim për qëllim të hapim debatin, por ta lexojmë rezolutën e harmonizuar, kjo është.

KRYESUESI: Sipas Rregullores, a ua keni dorëzuar deputetëve me shkrim harmonizimin tuaj që e keni bërë, për të qenë këta të lirë ta votojnë? Është një pyetje që po e shtroj unë si kryesues i seancës, a i keni dorëzuar me shkrim secilit deputet projekt-rezolutën e harmonizuar? Në rregull! Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Zoti zëvendëskryetar,

Është momenti i fundit që t'i përmbahesh vetëm Rregullores dhe asgjë jashtë Rregullores. Nuk kam të shtoj asgjë nga ajo çfarë thashë më herët. Nuk janë vetëm dy parti opozitare në radhë të parë këtu, ka edhe një parti tjetër opozitare që s'është konsultuar fare dhe plus janë grupet parlamentare të pozitës. Do të duhej t'i diskutonin me të gjithë nëse kemi qëllimin për të ndryshuar diçka, nëse kemi qëllimin për të bërë fushatë, nuk ka zgjedhje sivjet, ta keni parasysht të gjithë.

KRYESUESI: Atëherë, zoti Hoti, për ta zbatuar Rregulloren, ju keni obligim që seancës t'ia sillni me shkrim projekt-rezolutën e harmonizuar, të përkthyer në dy gjuhë, kur ta bini projekt-

rezolutën të përkthyer në dy gjuhë dhe të harmonizuar, atëherë unë e nxjerr në votim. Kështu në kundërshtim me Rregulloren nuk e kam ndërmend ta qes në votim, as në kundërshtim me të drejtën e të gjithë atyre që duhet ta lexojnë. Faleminderit!

Nëse po doni kështu, e bëjmë kështu. Konsideroj që nuk ka çështje të tjera sa i përket seancës së kaluar, ka ngelur vetëm interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, në 13:30 vjen kryeministri dhe e vazhdojmë interpelancën.

Konsideroj që pjesa e parë ka përfunduar, e kanë mbetur ato çështje të papërfunduara.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër, e dëshironi fjalën? Në rregull është. Atëherë, sipas marrëveshjes paraprake dhe sipas kërkesës së kryeministrit kemi kaluar në pikën tjetër të radhës dhe kjo çështje është shteruar.

Sipas marrëveshjes paraprake dhe deklarimit në Kuvend, zoti Haradinaj ka kërkuar që të shtyhet pika e rendit të ditës, për të cilën është thirrur në interpelancë. Dhe, tani zoti kryeministër Haradinaj është këtu. Po fillojmë me pikën e radhës:

**5. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotit Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione**

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj lidhur me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotit Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.

Siç e dini, koha për diskutime është e ndarë sipas nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, por para se të fillojmë i kisha lutur deputetët dhe grupet parlamentare që të kenë kujdes në raport me kolegët, sepse pastaj kur po harxhohen minutat e grupeve parlamentare po duhet me... po mbesin pa minuta dhe po ndodh nganjëherë që po duhet me shkel Rregulloren. Njëkohësisht, ju njoftoj që unë e kam ndërmend sot ta zbatoj strikt Rregulloren.

Në fillim, e ka fjalën zoti Hoti si propozues, pastaj e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, deputetët sipas radhës dhe në fund, jo në çdo pyetje, në fund kryeministri e merr fjalën, i jep përgjigjet për pyetjet që i ka marrë nga deputetët dhe propozuesi i interpelancës ka pastaj pesë minuta. Sepse, seancat po stërzgaten duke iu përgjigjur çdo deputeti dhe kjo është në kundërshtim me rregulloren. Faleminderit!

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Avdullah Hoti si propozues të interpelancës ta marrë fjalën. Zoti Hoti, i keni 10 minuta. OK, s'ka problem. Zoti Zharku e ka fjalën në emër të grupit parlamentar.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Zoti kryeministër,

Ministra,

Ministre,

Kolegë deputetë,

Me gjithë akuzat publike ndaj ministrit Rikalo për keqtrajtim të shqiptarëve gjatë luftës, kryeministri ngurroi që ta lirojë atë nga detyra, derisa organet e drejtësisë t'i hetonin akuzat e ngrehura ndaj tij.

Në anën tjetër, subjekti politik i ministrit Rikalo, Lista serbe tashmë që disa muaj e ka bërë të qartë, se nuk është pjesë e Qeverisë dhe deputetët e tyre kalojnë herë në taborin e opozitës e herë kthehen në opozitë, në varshmëri nga përmbushja e kërkesave të tyre politike nga ana e Qeverisë.

Siç duket, ministri Rikalo i inkurajuar nga ngurrimi i kryeministrit për lirim të tij vazhdoi të marrë vendime tash krejtësisht në baza të interesit të tij personal dhe eventualisht të subjektit politik që përfaqëson. Përpos këtyre vendimeve të kontestueshme në aspektin e legjitimitetit për shkak të arsyeve të cekura më lartë, ka gjithashtu dyshime të bazuara edhe për ligjshmërinë e këtyre vendimeve. Kështu, përmes thirrjes për aplikim të shpallur më 14 prill 2018 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ministri Rikalo kishte ndarë 2 milionë euro për Mitrovicën e veriut nga buxheti i ministrisë pa u bazuar në planin kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural, për programin e veçantë për investime në infrastrukturën rurale dhe ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së veriut.

Vendimi i Ministrisë së Bujqësisë për ndarje të veçantë të mjeteve për komunat e regjionit të Mitrovicës është në kundërshtim me planin për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020, sipas të cilit nuk parashihet në asnjë rast ndarje e veçantë e mjeteve për grante investive, për favorizim të zonave të caktuara. Gjithashtu, vendimi për ndarje të veçantë të mjeteve për grante investive për komunat e regjionit të Mitrovicës së veriut është në kundërshtim me planin për zhvillim rural 2018, në të cilin theksohet se kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, vendimi është në kundërshtim edhe me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Bujqësisë numër 05/2018 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2018, ku në kapitullin e parë, dispozitat e përgjithshme, neni 5, shtrirja gjeografike, theksohet se programi i zhvillimit rural 2018 zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Pra, nuk është

paraparë ndarje e veçantë për zona të caktuara, sepse tërë territori i Republikës së Kosovës ka qenë i përfshirë në thirrjen për aplikim në skemën e rregullt të granteve për vitin 2018.

Po ashtu, në planin për zhvillim rural 2018 nuk ka qenë e përjashtuar asnjë komunë për qasje në grante investive, që do të thotë se janë përfshirë edhe komunat në regjionin e Mitrovicës së veriut. Ne vlerësojmë se thirrja e veçantë për aplikim për grante investive, e cila i favorizon vetëm komunat e regjionit të Mitrovicës së veriut është në kundërshtim me dokumentet e cekura dhe është bërë për qëllime politike, pas kushtëzimit të ministrit Rikalo për mos nënshkrim të planit për zhvillim rural 2018, në rast se nuk ndahet një fond i veçantë për favorizim të komunave në pjesën veriore të Kosovës.

Këtë e vërteton edhe fakti se këtë vit hapja e thirrjes për aplikim në skemën e granteve 2018 është bërë me rreth dy muaj vonesë në krahasim me vitin 2017. Ne e kemi parasysh, që nga thirrja e veçantë nuk përjashtohen nga aplikimi qytetarët e komunitetit shqiptar dhe komuniteteve tjera që jetojnë në komunat e veriut të Kosovës, por është shqetësues fakti se Qeveria pranon kushtëzime duke u fshehur pas programit të veçantë për zonat më pak të zhvilluara, e si zonë më pak e zhvilluar është vlerësuar vetëm regjioni i komunave të Mitrovicës së veriut.

Më tutje, duhet theksuar fakti se fermerët që kanë aplikuar në skemën e rregullt të granteve për vitin 2018 shkallën e përkrahjes publike për financim e kanë 50%, gjegjësisht 60%, në varshmëri të programit kurse bashkëfinancimi nga fermeri është 40%. Por, për thirrjen e veçantë për aplikim në programin Ngritja e aftësisë konkurruese në sektorin e Bujqësisë dhe Pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së veriut shkalla e përkrahjes publike është 90% e vlerës së investimit në programin e ngritjes së aftësisë konkurruese.

Pra, përveç favorizimit me thirrje të veçantë për aplikim, këtu kemi të bëjmë edhe me favorizim financiar për vlerë më të lartë të përkrahjes publike. Por, ky favorizim nuk po bëhet për përkrahje të komunitetit serb, të cilën në prapavijë e promovon ministri Rikalo, pasi që kriteret e tilla favorizuese nuk vlejné për komunat tjera me shumicë serbe, si në Graçanicë, Artanë, Klllokot, Shtërpce, Ranillug apo Partesh. Ky favorizim bëhet pikërisht me qëllim të keqpërdorimit të fondeve publike përmes komunave të cilat nuk e pranojnë Republikën e Kosovës dhe rrjedhimisht, në mungesë të rendit dhe Ligjit është pothuajse e pamundur ndjekja ligjore e keqpërdorimeve të tilla. Përndryshe, siç dihet, ka shumë raste që fermerët e komunitetit serb janë përfitues nga skema e rregullt e granteve për bujqësi dhe zhvillim rural të viteve paraprake.

Është e tepërt të flitet për përmbajtjen e thirrjes publike, e cila është ajo standarde e viteve të tjera, që flet për regjione tjera, kurse vetëm titulli është ndryshuar “për Mitrovicën e veriut”.



Megjithatë, duke qenë në presion publik për programe të tilla pa bazë ligjore, ministri Rikalo është munduar ta korrigjojë veprimin e tij kundërligjore, duke hartuar Udhëzimin Administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë zonat rurale më pak të zhvilluara, ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe përfshirja e komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës veriore dhe masës për investimet në infrastrukturën rurale. Kurse, me nenin 1 regjionin e definojnë që përbëhet nga komunat e Zveçanit, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Mitrovicës së veriut.

Hartimi i këtij udhëzimi është në kundërshtim me nenin 16/a të Ligjit 04/L-090 mbi plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, pasi që në mënyrë specifike kërkohet që të identifikohen zonat më pak të favorizuara e ministri ka identifikuar zonë të tillë vetëm Mitrovicën e veriut. Në udhëzim theksohet, se ky program do të jetë rotativ, por që çuditërisht programi fillon nga Mitrovica e veriut. Më tutje, në mënyrë specifike përcaktohet se identifikimi i zonave duhet të bëhet në bazë të kriterëve dhe objektivave jodiskriminuese, kurse në udhëzim jo është bërë në mënyrë diskrecionale, pa kurrfarë kriteri dhe objektivi. Këto shkelje dhe parregullsi pranohen edhe në mënyrë publike nga vetë ministria. Kështu, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në shpalljen publike thekson se pas një debati të shtuar dhe kërkesës së dërguar në Agjencinë Kundër Korrupsionit për marrjen e opinionit ligjor lidhur me përmbajtjen e bazës së diskriminimit, ose jo, e anulon thirrjen e mëhershme të datës 14 prill dhe ka bërë rihapjen e thirrjes për aplikim, programi i veçantë për investimet në infrastrukturën rurale dhe ngritja e aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë, pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së veriut më 26 maj me vlefshmëri deri më 10 qershor 2018, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë Zonat rurale më pak të zhvilluara, ngritja e aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe përfshirja e komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës Veriore dhe masës për investime infrastrukturale.

Por, shkeljet ligjore vazhdojnë edhe më tutje, sepse përpos udhëzimit 09/2018 është në kundërshtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural edhe rihapja e thirrjes për aplikim është bërë në kundërshtim me vet udhëzimin, pasi që shpallja është bërë më 26 maj kurse udhëzimi administrativ 09/2018 ka hyrë në fuqi më 31 maj, që do të thotë se thirrja për aplikim është bërë 5 ditë para se udhëzimi të hyjë në fuqi.

Për më tepër, ministri Rikalo po nxitë banorët e këtyre komunave që të vazhdojnë të mos e pranojnë shtetin e Kosovës, duke normuar këtë çështje edhe me akte nënligjore. Kështu, Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Bujqësisë 05//2018 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2018 dhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Bujqësisë nr. 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë Zonat rurale më pak të zhvilluara, ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe përfshirja e komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës dhe masat për investimet infrastrukturo-rurale të nënshkuara nga ministri Rikalo,

aplikuesit për grante i vendos në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese në aspektin komunal përmes trajtimit favorizues të komunave të caktuara.

Kështu, përmes dispozitave përfundimtare, neni 42 i Udhëzimit Administrativ 05/2018 dhe neni 53 i Udhëzimit Administrativ 09/2018 e trajton në mënyrë të veçantë dokumentacionin e aplikuesve për komunat Mitrovicë e veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Aplikuesit nga këto komuna mund të aplikojnë pa vërtetim për tatimin në pronë, kurse pëlqimi për ndërtim dhe leja për ndërtim të lëshuara nga këto komuna, pranohen pa vulë dhe pa logo të institucioneve të Republikës së Kosovës e që është në kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor.

Sa i përket tatimit në pronë, e njëjta gjë është bërë edhe me nenin 34, paragrafi 1, pika 10, të Udhëzimit Administrativ 03/2018 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2018. Këto dispozita janë në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 04/L-090 mbi plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural i cili përcakton se masat e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural zbatohen në bazë të objektivit dhe kriterit jodiskriminues në pajtim me parimet e barazisë dhe efektivitetit.

Natyrisht, nuk duam të paragjykojmë, as të tërheqim ndonjë paralele, se ku na çojnë politikisht aranzhime të këtilla ligjore për komunat e një regjioni të caktuar në këtë periudhë negociatash me Serbinë. Ajo që vërtetohet në këto udhëzime administrative është se, nëse je banor i këtyre komunave që udhëhiqen nga politikanë që luftojnë Republikën e Kosovës mund të përfitosh nga buxheti i shtetit pa paguar fare tatim dhe pa dorëzuar asnjë dokument të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në fund, duhet theksuar se në lidhje me grantet ministri ka pezulluar nga puna zotin Elhami Hajdari, udhëheqës i Agjencisë për Zhvillim të Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural. Përderisa ministri në deklaratat publike është thirrur në keqpërdorime të zotit Hajdari, sipas informatave të këtij të fundit, ky shkarkim lidhet me ndarjen e mjeteve për Mitrovicën e veriut dhe konfliktin e interesit të ministrit Rikalo si bashkëpronar në biznese që afarojnë në bujqësi.

Cilado qoftë e vërteta kjo është edhe një dëshmi e parregullsive dhe paligjshmërisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Deputetë të nderuar, Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të votojë mocionin si në vijim:

1. Në afat prej shtatë ditësh kalendarike Qeveria të anulojë Udhëzimin Administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë Zonat rurale më pak të zhvilluara, ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe përfshirja e komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës

veriore dhe masat për investimet në infrastrukturën rurale, si dhe të ndryshojë dhe plotësojë udhëzimet administrative 03/2018 për pagesat direkte në bujqësi për vitin 2018 dhe 05/2018 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2018, duke anuluar të gjitha dispozitat të cilat janë diskriminuese dhe shkelin barabarësinë e aplikantëve.

2. Në afat prej dy javësh Qeveria të sjellë në Kuvend një raport detaj për ndarjen e mjeteve për grante dhe subvencione nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë këtij mandati, ku përfshihen projektet për të cilat janë ndarë mjetet, përfituesit dhe procedurat që janë ndjekur në ndarjen e këtyre mjeteve.

3. Zyra Kombëtare e Auditimit të ndërmarrë një auditim të rregullsisë së ndarjes së mjeteve për grante dhe subvencione dhe t'ia paraqesë Kuvendit raportin në afat prej tre muajsh.

4. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të shqyrtojë në afat prej dy javësh programin për bujqësi dhe zhvillim rural me zyrtarë përkatës të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe t'ia paraqesë Kuvendit raport me shkrim për rregullsinë e zbatimit të këtij programi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani e ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura, kryeministri ka në dispozicion 15 minuta, nëse nuk i mjaftojnë, do të marrë nga minutat e koalicionit. Urdhëro, zoti kryeministër!

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Ju lutem, edhe unë i detyrohem Rregullores së Kuvendit dhe vetëm atëherë kur më takon koha, pra nuk kërkoj privilegje të tjera.

Zakonisht në hapje unë marr më pak kohë, e pastaj në rast të nevojës rikthehem në diskutim.

Gjendja në bujqësi e meriton vëmendjen e të gjithë neve, pra të subjekteve politike veç e veç, të atyre në opozitë, të atyre në pozitë, të Qeverisë.

Në fakt, Kosova ka aplikuar disa masa me të cilat ka mbërritur te bujqit, pra grante, subvencione e mënyra të tjera të arritjes te bujqit, por po ashtu tani së fundi, ajo që mendoj se është po ashtu.... Atëherë, me rëndësi besoj për bujqit është edhe lirimi prej taksave në lëndë të parë, ata e kanë këtë kërkesë.

Për shembull, nuk janë liruar ende prej taksës në derivate, e paguajnë ende naftën dhe lëndën e parë sikur të ishte për luks.

Jam i bindur se hiç ato aspekte të tjera, që zoti Rikalo është serb, një serb që është dyshuar për bëmat e tij në kohën e kaluar, pastaj një serb që u gjet edhe në ngjarjen kur u arrestua Gjuriq, ndodhi edhe një incident atje.

Megjithatë, si ministër mund të them që ka shprehur një shkallë të interesimit të respektueshëm dhe të kompetencës në punë. Edhe një interesim që nuk është hetuar në baza etnike ose në baza regjionale, të paktën nga unë. Pra, ne nuk përtojmë t'i trajtojmë me kujdes të gjitha të gjeturat e grupeve parlamentare të kolegëve deputetë, edhe të mekanizmave të tjerë, por ajo që kam mundur ta hetoj unë gjatë punës, një shkallë të kompetencës, një shkallë të respektit korrekt në punë të tij, në detyrat e tij.

Ju e dini, ne e kemi një fond të caktuar që i dedikohet përkrahjes së bujqve, njëkohësisht marrim donacione dhe kemi edhe partnerë ndërkombëtarë, institucionet e BE-së, USAID-in.

Me sa kam dijeni, vlerësimi ka qenë korrekt për të. Tani jemi në marrëdhënie më të ndërlikuara me Listën serbe, kjo është e vërtetë. Pra, natyra e marrëdhënieve në koalicion qeverisës është vështirësuar ose rrethanat e kanë bërë më të vështirë, e kjo është që nga rasti i arrestimit të zotit Gjuriq në veri.

Sido që të jetë, unë kam kërkuar një raport në ministri lidhur me shqetësimet e shprehura nga ju, pra nga Grupi Parlamentar i LDK-së për gjendjen në bujqësi, për veprimet e ministrit Rikalo, përfshirë edhe një shkarkim të tij.

Të gjitha këto me qëllim që ta kemi të qartë se si po ndodhin të gjitha veprimet në Ministrinë e Bujqësisë.

Megjithatë, ju siguroj që ministria është funksionale, pra zëvendësministri i caktuar është në mbledhje të Qeverisë, vazhdon puna, kjo na ka ndodhur edhe në të kaluarën, ju kujtohet, një kohë zoti Tomë Hajdari, nga zëvendësministër është kthyer në ministër të Bujqësisë, tashmë i ndjerë, pra nuk është hera e parë që Kosova është ballafaquar me një bojkot të këtillë dhe ajo që do të bëj edhe në të ardhmen ju siguroj që do të punoj që me të gjithë ata që janë në punë, pra të mos ndodhë as diskriminim, as privilegj i padrejtë i askujt.

I kemi disa shqetësime tash edhe si Qeveri, janë dëmet nga breshri, kemi disa komuna që kanë pasur dëme nga breshri, janë disa dëme nga viti paraparak që kanë ndodhë në Rahovec sidomos, por sivjet e kemi edhe një Istog, edhe në zona të tjera, në Gjilan e në zona të tjera, do t'i trajtojmë me kujdes.

Dëshiroj po ashtu t'ju siguroj që qasja ndaj qytetarëve në veri e ka një dimension edhe politik, pra sikurse Fondi i dikurshëm i famshëm i Veriut. T'ju them jemi të ballafaquar me një gjendje

që Serbia dëshiron në shumë mënyra t'i bindë serbët e veriut se nuk është Kosovë, se ata janë Serbi ose, se interesi i tyre, jeta e tyre është e mirë vetëm nëse marrin paga, kanë bashkëpunim me institucionet e Serbisë.

Kosova e ka dëshmuar se është e gatshme t'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë, pra edhe qytetarët në veri, të mbërrijë edhe te ata, ashtu si është sjellë edhe me të punësuarit. Ju e dini që një pjesë e të punësuarve që kanë punuar në institucione që nuk kanë qenë të sistemit tonë janë integruar, si në arsim, si në përgjithësi.

Pra, jemi në atë proces, e përsëris edhe një herë, jemi në atë proces ta përmbyllim, ndryshe thënë ose thënë direkt, pra sovranitetin e vendit tonë në gjithë territorin.

Nuk po zgjati më shumë, ju faleminderit për dhënien peshë të gjendjes në bujqësi, të veprimeve të ministrisë, të procesit të dedikimit të buxhetit të vendit, edhe po ashtu për shqetësimet e shprehura në mënyrën që kanë mundur të ndodhin këto në një zonë të caktuar, kategorizimi, dhënia ose devijimi nga ato që kanë qenë të dakorduara si plan nacional, do t'i trajtojmë në vazhdimësi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti kryeministër! Po vazhdojmë me grupet parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Reçica e ka fjalën.

**ELMI REÇICA:** I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar dhe i respektuar zoti kryeministër Haradinaj,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të respektuar të këtij vendi,

Kjo çështje që është shumë e rëndësishme, ndoshta do të duhej për bujqësinë të diskutojmë në rrethana të tjera më të favorshme, për t'i parë punët të cilat janë bërë dhe punët të cilat na presin. Është një pretekst, po megjithatë duhet të shikojmë pak nga e kaluara dhe të shohim çfarë është bërë për bujqësinë deri tash.

Para se të filloj, zoti kryeministër, edhe Ferizaj është dëmtuar goxha shumë prej breshrit, kështu që mos e harro edhe Ferizajn, po mendojnë që Ferizaj ka shumë dhe tash nuk ka nevojë për mbështetje, po është një nga qytetet më të dëmtuara nga breshri, bile në tri raste.

PDK-ja e ka trajtuar në vazhdimësi me prioritet bujqësinë dhe investimet e bëra në vitet e kaluara ka dhënë rezultate të jashtëzakonshme në rritjen e prodhimtarisë.

Natyrisht që ne konsiderojmë se ka nevojë për më shumë investime dhe programe që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin e bujqësisë, ne jemi vend kryesisht rural.

Duhet të dihet se programet tona për bujqësinë janë sipas direktivave të IPARD-it, instrument i paraanëtarësimit dhe si i tillë është konform standardeve evropiane.

Edhe në këtë lejohet që të ketë diskriminime pozitive për zona të caktuara për kategori të caktuara. Ta zëmë, më herët ka pasur fond dhe program të veçantë për Prishtinën, Gollakun specifikisht, Rahovecin, Suharekën dhe Malishevën për shkak që atje trajtohet shumë vreshtaria dhe përgjithësisht bujqësia.

Ta zëmë, kanë përparësi sa i përket sektorit të vreshtarisë, atë çka e thashë më herët. Dhe sa i përket mbështetjes së fermës ose fermerëve të rinj, femrës vërtet, ka pasur diskriminim pozitiv në programe të caktuara, duke marrë pikë shtesë, është fjala për ta mbështetur femrën në bujqësi.

Në këtë frymë, edhe një fond i veçantë për këtë vit për veriun nuk duhet të shihet diçka e keqe, po si gatishmëri e Qeverisë për të investuar në atë pjesë, sepse edhe ka nevojë. Ata janë qytetarë të Kosovës dhe duhet të kenë qasje në fondet qeveritare. Normalisht duhet të trajtohen, të kontrollohen dhe të mbikëqyren sikurse në të gjitha pjesët e tjera.

Ajo që duhet të kemi parasysh në këtë pikë është që nuk guxojmë që ai fond të jetë fond i përhershëm, si i veçantë, sepse në vitet e tjera duhet të jenë ata qytetarë të jenë pjesë e barabartë e aplikimit për grante dhe subvencione dhe qytetarët duhet të trajtohen të barabartë pavarësisht regjionit, përkatësisë etnike a politike ose çfarëdo tjetër.

Po duke ditur situatën, ne për këtë vit e mirëkuptojmë këtë fond dhe e shohim si të mirëqenë, por fjala është vetëm për këtë vit, jo të vazhdojë pastaj.

Neve si deputetë na intereson transparenca e lartë në implementimin e programeve dhe vendimeve të cilat merren dhe mbikëqyrja e atyre vendimeve dhe zbatimi i të gjithë atyre vendimeve që merren qoftë nga Ministria e Bujqësisë ose agjencitë përkatëse.

Ne kemi qenë të befasuar dhe nuk kemi shumë informacione të sakta pse kanë ndodhur ndryshime në strukturat implementuese të programit të bujqësisë dhe për këtë duhet të kemi informacione të sakta, të thukëta dhe ta kemi atë mundësi që edhe ne ta shprehim mendimin tonë, qoftë vërejtjet, qoftë ndonjë propozim eventual për ta tejkaluar ndonjë anashkalim të mundshëm.

Natyrisht që ne e respektojmë punën e ministrit, kompetencat ekzekutive që i ka, por puna si ministër duhet të jetë konform ligjit dhe transparent për qytetarët.

Asnjë vendim, i cilitdo ministër, i cilitdo institucionalist që merret në formën jotransparente, nuk mund ta kënaqë as këtë Kuvend, as deputetët, e jo më qytetarët, pavarësisht përkatësive, po them edhe një herë, politike dhe orientimeve të tjera.

Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se ministrat e Listës serbe meqë janë kthyer nëpër ministri, po marrin vendime, le të vijnë edhe në Kuvend, nuk është mënyra e duhur as nuk është në rregull që ata të luajnë lojë të dyfishë. Ata janë pjesë e kësaj qeverie, janë duke i marrë pagat nga buxheti i këtij vendi, sikurse të gjithë ne dhe duhet të jenë këtu. E dimë që kanë presione, e dimë që janë të shantazhuar, mirëpo interesi i tyre është që të jenë këtu dhe të punojnë në interes të këtij vendi, se nuk i donë ata çfarë sot po i futin nëpër çështje të ndryshme dhe, siç thuhet, nëpër vendime të cilat nuk janë konform as atyre, as familjeve tyre, kjo vlen edhe për ministrat, edhe për deputetët, edhe për gjithë të tjerët.

Dëshiroj të shpreh një shqetësim sa i përket implementimit të programit për bujqësi. Vitet e kaluara në muajin qershor janë shpallur rezultatet e përfituesve për grante dhe për subvencione dhe fillonte procedimi i mjeteve. Fundi i fundit, bujqësia e ka afatin e kufizuar, nuk mund të ketë zhvillim të bujqësisë gjatë dimrit dhe për këtë arsye kërkojmë që sa më shpejt të dihet saktësisht se cilat janë ata fermerë, të cilët kanë përfituar nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe agjencitë përkatëse dhe duhet të shqyrtohen ato aplikacioni sa më shpejt dhe të dihet saktësisht.

Dëshirojmë të dimë pse po ndodh kjo vonesë? A lidhen me ndryshimet që janë bërë në agjenci dhe cilat do të jenë pasojat për fermerët dhe zbatimin e plotë të programit.

Nëse do të kenë ngecje në vlerësimin dhe procedimin e mjeteve, ne rrezikojmë fermerët tanë, të cilët presin mbështetje nga shteti, por edhe rrezikojnë të gjithë ata aplikues që kanë nisur investimet dhe presin përkrahjen nga shteti.

Ta kemi parasysh që të gjithë fermerët dhe bujqit, të gjithë ata që janë duke u marrë aktivisht që sa vjet e kërkojnë mbështetjen tonë të fuqishme, kërkojnë që të jemi transparentë dhe që ne nga fondet të cilat janë të përcaktuara dhe të dedikuara për ta, t'i marrin sa më shpejt. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

**LIBURN ALIU:** Faleminderit!

Kjo interpelancë vërtet është e qëlluar, edhe pse nuk është asgjë që na bënë të befasohe me sjelljen dhe mënyrën se si qeveriset sot në Ministrinë e Bujqësisë, një gjë të tillë e kemi thënë që nga fillimi.

Kemi qenë jashtëzakonisht të bindur që ministri Rikalo do të jetë ministër, i cili do të aplikojë politikën në favor të Serbisë dhe këto politika duhet të aplikohen pikërisht në fushën jashtëzakonisht të rëndësishme për Kosovës, pra madje them për zhvillimin ekonomik të Kosovës më të rëndësishmen, në fushën e bujqësisë.

Ne mund të paraqitemi se gjoja nuk po ndodh asgjë, po në fakt Ministria e Bujqësisë nuk është vetëm duke bërë një lloj diskriminimi, të themi, të vogël, të lehtë në terren, po është drejtpërdrejt duke e mbrojtur interesin e Serbisë dhe kjo në dy rrafshë dhe konkretisht i kemi dy çështje këtu që na lidhin me çështjen e ministrit Rikalo.

Është çështja e mbështetjes së kompanive, të cilat importojnë nga Serbia edhe kur ato bëjnë shkelje, edhe konkretisht duke forcua strukturat e Serbisë përmes Listës serbe nëpër zonat ku janë serbët. Nëse ne duam të bëjmë integrim të serbëve lokalë, gjithmonë e kemi thënë se Lëvizja Vetëvendosje që kjo ndodh kur lidhjet me Beogradin janë gjithnjë më të vogla. Edhe për gjatë historisë një gjë e tillë ka qenë kështu. Sa herë që Beogradi ka pasur ndikim më të madh mbi Kosovën, marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë kanë qenë më të ashpërsuara, sa herë ndikimi i Beogradit ka qenë më i vogël, marrëdhëniet ndëretnike kanë qenë më të mira.

Pra, a po integrohen serbët lokalë përmes politikave, të cilat po i sjell Rikalo? Jo, absolutisht, po ndodh e kundërta. Ata po dezintegrohen edhe më tepër, po ndodh izolim edhe më i madh.

Në këtë rast, pra, kemi masa speciale për veriun që ministri Rikalo me të ardhur në pushtet një ndër hapat e parë dhe më efikas është programi i tij për veriun.

Duke e konsideruar veriun si një zonë më të pazhvilluar dhe duke mos u marrë fare me zona të tjera, programi për veriun, i cili hartohet nga vetë ekipi i tij, që në këtë rast përbën shkelje, sepse do të duhej të hartohej me mekanizma të tjerë dhe të zbatohesh nga mekanizma të tjerë. Tash kemi fonde të ndara në veçanti vetëm për veriun dhe, në anën tjetër, kur kemi të bëjmë me kompani, të cilave u janë ndarë grante nga Qeveria e Kosovës, pra nga vetë ministria dhe këto kompani nuk arrijnë t' i përmbushin detyrat dhe në këtë rast agjencia ua ndërpret pagesat dhe u kërkon që t' i kthejnë ato, ministri sapo të vijë në pushtet e bën të kundërtën, bënë super kontroll mbi ato kompani dhe përveç që e arsyeton pagesën e mëhershme, e bën edhe pagesën shtesë. Pse po ndodh kjo? Kush janë këto kompani? Pra është kompania, e cila saktë ato financa i merr për shkak të importit të makinerive nga Serbia. Kemi një prodhues në Serbi, i cili do t' i shesë makineritë në Kosovë dhe Qeveria e Kosovës e vë atë në prioritet në raport me cilindo tjetër në regjion apo në botë kudo, apo edhe vetë prodhuesve të brendshëm, që do të mund të siguronin ato pajisje.

Pra, Ministria e Bujqësisë, në këtë rast, përpos që vihet drejtpërdrejt në mbrojtje të prodhuesve të Serbisë, shtesë është edhe elementi tjetër që kjo ndërlidhet edhe me çështjen e brendshme dhe personale që lidhet me Rikalon dhe me atë kompani. Me çështje personale natyrisht le të merret gjykata dhe ta sqarojë atë çështje, po shumë më tepër, më me rëndësi në aspektin politik është pse vjen puna që te ne merren masa konkrete që të mbrohen kompani, të cilat importojnë mallra drejtpërdrejt nga Serbia? Pse duhet të jenë ato të veçanta, pse duhet të favorizohen ato kompani?



Pra, në këtë rast e kemi ministrin Rikalo që qartazi drejtpërdrejt punon për Qeverinë e Serbisë, për Serbinë, për dezintegrim sa më të madh të serbëve lokalë dhe punon hapur gjithnjë kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës edhe nga vetë qytetarët dhe, në anën tjetër, me të njëjtin buxhet të Republikës së Kosovës i financon të njëjtat struktura dhe të njëjtit qytetarë, të cilët i inkurajon që të mos e njohin Kosovën. Kjo është politikë e dyfishtë.

Pra u tha që nuk do të duhej të tolerohej politika e dyfishtë e Listës serbe, të cilët nuk vijnë sot në Kuvend, ndërsa i përdorin benefitet dhe i shfrytëzojnë mundësitë të cilat ua jep Qeveria sot. Kjo është politika përherë që e ka luajtur Serbia që nga paslufta deri sot, s' kemi pse e vëmë në dyshim këtë punë, ata gjithmonë luajnë rolin e njëjtë, të dyfishtë.

Pra, të mos hamendem dhe të mos dyshojmë ne që, e po tash meqenëse ata po i marrin disa nga financat nga buxheti i Kosovës, do të vijë puna se ata do të na njohin në një farë mënyre. Jo. Ata ta marrin buxhetin, t'i marrin paratë, nuk të njohin dhe kaq.

Prandaj, nëse nuk ndërtojmë mekanizma që i ndalojnë këto, atëherë asgjë më tepër, ne me buxhetin e Kosovës po e thellojmë edhe më tepër ndarjen.

Unë pajtohem me pikat të cilat janë në rezolutën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, po mendoj se duhet të shtohet edhe pika tjetër, që duhet të shkarkohet ministri Rikalo. Pa tjetër që duhet t'i shtohet edhe kjo pikë, sepse nuk ka kuptim që në qeverisjen, e cila për aq kohë të shkurtër, me aq shumë skandale dhe atë në baza të diskriminimit ndëretnik, favorizimit të veriut, në këtë rast dhe të serbëve lokalë kundrejt qytetarëve të tjerë, mendoj që shkarkimi do të ishte hapi i parë, e pastaj do të duhej të merreshin natyrisht masa të tjera që të shfuqizohen edhe udhëzimet administrative që janë marrë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga PSD-ja, kush e do fjalën? Zoti Salih Salihu.

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, zoti kryeministër, që jeni prezent sot në këtë interpelancë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm që konform kushteve të përshtatshme klimatike dhe tokësore që ka Kosova, bujqësia si degë e ekonomisë paraqet një mundësi të mirë për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe krijimin e vendeve të reja të punës, por natyrisht që për të përmbushur këtë mision, do të duhej që sfidat dhe mundësitë e tij të trajtohen me seriozitet të shtuar, duke ia dhënë vendin meritort këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë.

Po si çdoherë, edhe kësaj radhe, domethënë këtë sektor kjo Qeveri nuk po e trajton seriozisht. Bujqësia nuk po shihet si një mundësi që mund të nxisë zhvillimin ekonomik përmes punësimit, përmes rritjes së prodhimit vendor dhe përmes uljes së importit të produkteve bujqësore dhe ushqimore. Vetëm në vitin 2017 Kosova importonte produkte bujqësore dhe ushqimore në vlerë

prej 760 milionë euro, ku pjesa më e madhe është nga Serbia. Ndërsa, ju këtu Ministrinë e Bujqësisë e latë në duart e Listës serbe, duke shpresuar se këta do të punojnë në rritjen e prodhimit vendor për t'i barë ballë importit nga Serbia. Është për t'u shpresuar, por unë nuk besoj se këta do të bëjnë përpjekje ta rrisin prodhimin vendor për t'i bërë ballë importit dhe produkteve bujqësore nga Serbia.

Prejse e ka marrë pushtetin kjo Qeveri, ministri Rikalo nuk ka ardhur fare asnjëherë në Kuvend, përveçse kur është diskutuar çështja e tij si ministër i Bujqësisë, madje as kur keni shpalosur programin qeverisës për bujqësi, e as kur është diskutuar Projektligji për buxhetin e vitit 2018. Pra, ai as sot nuk ka ardhur, ndërsa sa i përket shkarkimit të kryeshefit të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, mendoj që sot vetë ministri do të duhej të vinte këtu dhe të jepte sqarim se çfarë shkelje janë bërë dhe të sqarohet me shkrim se vërtet a është në rregull suspendimi i tij apo jo?

Unë do të kisha shumë pyetje për ministrin, por mbasi nuk është këtu, si t'ju drejtohem juve, zoti kryeministër, mbase në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ka shumë probleme të tjera. Kemi probleme edhe me angazhimin e stafit, me kontratë mbi vepër, ku shumica prej tyre nuk janë fare profesionalistë, më tepër janë juristë e ekonomistë, e fare nuk kanë lidhje me bujqësi dhe marrin pjesë direkt në vlerësimin e projekteve që u japin njerëzve grante, e që përbën një shumë bukur të madhe të parave. Qëllimi i programit tuaj qeverisës është zhvillimi i bujqësisë, duke përfshirë këtu të gjitha veprimtaritë bujqësore që lidhen me prodhimin me origjinë bimore dhe shtazore. Megjithatë, programin që e keni shpalosur nuk ka pas objektiva afatgjate, mbase nuk mund të mbështeteni në planin kombëtar afatgjatë, sepse plani kombëtar 2014-2021 kurrë nuk është sjellë në Kuvendin e Kosovës për t'u aprovuar. Si mund të ndahen 50 milionë euro për çdo vit buxhet për grante dhe subvencione pa objektiva të qarta afatgjata? Çfarë po zhvillojmë? Cilët sektorë? Çfarë kulturash? Në cilin rajon? Dhe, çka po synojmë pas pesë apo dhjetë vjetëve?

Pra, që nga viti 2014 deri më tani ne ndajmë rreth 250 milionë euro për bujqësi dhe atë pa ndonjë plan apo strategji kombëtare. Nëse e analizojmë sa ka rritje të prodhimit bujqësor në periudhën pesëvjeçare, ne e vërejmë se investimet në bujqësi nuk janë përkthyer në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në mirëqenie të qytetarëve, sepse shkalla e importit pak a shumë është e njëjtë si para pesë vjetëve. Prandaj, i nderuar kryeministër, në këtë sektor nuk ka as objektiva të qarta, e as masa, të cilat çojnë te rritja e këtyre objektivave. Në programin tuaj qeverisës keni fokusuar inventarizimin dhe konsolidimin si masa të rëndësishme për ruajtjen e tokës bujqësore. Por, çfarë është duke u bërë në këtë drejtim? Fare asgjë! Nuk mund të flitet për zhvillimin e bujqësisë, për konsolidimin dhe inventarizimin e tokës bujqësore, kur në rend të parë kemi problem me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e tokave bujqësore. Ministria e Bujqësisë nuk ka asnjë inspektor të mbrojtjes së tokës bujqësore, ndërsa statistikat flasin se ne i humbim çdo vit 1 mijë hektarë tokë bujqësore. Mendoj që këtu është vendi për të shtuar numrin e punonjësve si inspektorë, zoti kryeministër, e jo ta shtosh numrin e zëvendësministrave.

Tjetër, deri më tani nuk kemi dëgjuar se ka ndonjë plan për futjen e tokës nën komosacion apo ndërtimin e sistemeve të ujitjes për të rritur prodhimin për njësi të sipërfaqes, mbase thatësia është njëri ndër faktorët kryesor për realizimin e rendimenteve të ulëta në Kosovë. Problem edhe më tutje mbetet avancimi i kornizës legislative dhe normative, këtu deri më tani ka ngecje. Të gjitha ligjet që lidhen me bujqësinë, pylltarinë, ushqimin e kështu me radhë, nuk janë proceduar nga Qeveria e kaluar, por po vazhdojnë të mos procedohen edhe në qeverisjen e tashme. Përveç kësaj, blegtoria konsiderohet si njëri ndër sektorët kyç që përbën hallkën kryesore të zhvillimit të bujqësisë. Nuk mund të paramendohet zhvillimi i bujqësisë intensive, pa zhvillim të blegtorisë, çka do të thotë se, pa një blegtori të zhvilluar, nuk mund të kemi as prodhimtari lavértare, domethënë ushqim të kafshëve, dhe as perimtari të zhvilluar e blegtori e zhvilluar do të thotë më shumë qumësht e produkte të tij, më shumë mish e produkte të tij, por edhe më shumë pleh të stallës, i cili është bazë për përmirësimi e strukturës së tokës dhe rritjes së rendimentit së prodhimit lavértare perimore. Mirëpo, ne të gjithë e dimë që ka 20 vjet e më tepër që tokat tona nuk plehërohen me pleh të stallës, ato vazhdimisht trajtohen me plehra artificiale, duke u shkatërruar nga viti në vit.

Prandaj, po themi se sektori i blegtorisë është sektori kyç në zhvillimin e gjithmbarshëm të bujqësisë dhe ekonomisë në vendin tonë në përgjithësi dhe nuk guxojmë assesi të lejojmë që në një mungesë të vullnetit, kompetencës apo edhe të përgjegjësisë, ta shkatërrojmë këtë sektor, sepse ne e pamë që Kosova importon rreth 40 milionë kg mish në vit dhe atë në cilësi dhe siguri ushqimore të dyshimtë. Por, kjo nuk mund të arrihet duke e mbështetur vetëm prodhimin primar pa politika mbrojtëse të prodhimit vendor. Numri i të punësuarve në prodhimin primar mund të jetë i madh, por vendi i punës është i qëndrueshëm vetëm nëse plasmani i produkteve të tyre është i garantuar. Prandaj, investimet kapitale në formë të granteve dhe subvencioneve, shpenzimet që bëhen për shërbime këshillimore janë të kota dhe nuk përkthehen në zhvillim të qëndrueshëm pa politika të mirëfillta bujqësore që e sjell fermerin e Kosovës në pozitë të barabartë me fermerin në rajon.

Për të gjitha këto, zoti kryeministër, natyrisht që kërkohet një angazhim dhe koordinim më i mirë ndërinstitucional i Kryeministrit, i Agjencisë së Ushqimit, i Ministrisë së Bujqësisë, të Tregtisë, Industrisë, si dhe doganave dhe gjyqësorit, por kjo tani për tani, zoti kryeministër, nuk ka ndodhur dhe nuk po ndodh as në qeverisjen tuaj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Siç po vazhdojnë këto interpelanca, po më duket një ditë kryeministrin do ta thërrasin edhe për ngrohjen globale, edhe për tema të tjera, të cilat absolutisht s'kanë të bëjnë me kryeministrin dhe me Qeverinë, sepse po shihet që më shumë po përdoren për konsum politik se sa për të sqaruar çështjet, të cilat janë shumë të ndjeshme.

Interesimi i Qeverisë normalisht është treguar që nga fillimi, edhe me programin që e ka sjellë Qeveria në Parlamentin e Kosovës, por edhe me angazhimet e drejtpërdrejta të këtij dikasteri për të ofruar edhe grante, edhe subvencione, të cilat mund ta bëjnë një angazhim shumë më të madh në sferën e bujqësisë, por po ashtu edhe që me këtë mënyrë të angazhimit të bëjnë edhe krijimin e vendeve të reja të punës. Mua po më çudit fakti pse kërkohet kjo interpelancë, kur e kemi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, e që mund ta thërrasin edhe ministrin, edhe zëvendësministrat, edhe sekretarin permanent të Ministrisë dhe të ketë Kuvendi një raport të detajuar, me të cilin pastaj do të mund t'i analizojmë të gjitha të dhënat, të cilat do të mund të dilnin pikërisht nga të dhënat e komisionit.

Po marrim detyra të huaja, në njëfarë forme, ose po duam vetëm të bëjmë zhurmë në Parlamentin e Kosovës, prandaj mendoj që komisionet funksionale duhet t'i kryejnë detyrat në raport me monitorimin dhe me kontrollin parlamentar që duhet të bëhet ndaj institucioneve dhe agjencive të shtetit. Unë nuk dua ta zgjas më shumë, por po mendoj që edhe opozita po më duket është lodhur me këtë mënyrë të thirrjes së interpelancave të pakuptimta, derisa janë adresa të caktuara, në të cilat mund të gjenden të dhënat, mund të dalin ato që janë çështje dhe përgjigje konkrete, në mënyrë që Kuvendi vërtet të dalë më serioz prej këtyre interpelancave. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Enver Hoti e ka fjalën.

**ENVER HOTI:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Vendimi që është marrë nga ministri Rikalo për ndarjen e mjeteve për pjesën veriore, mendoj, i nderuar kryeministër, është dashur të trajtohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës, është dashur të merret brenda Kabinetit qeveritar dhe të përcillet me një analizë shtesë për funksionimin dhe për realizimin e këtyre mjeteve shtesë, si do të duhej të bëhej dhe mandej të shihet dhe të kalojë nëpërmes një procedure të rregullt brenda Kabinetit qeveritar.

Po ashtu, mendoj se këtu është tejkaluar ose është anashkaluar Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural nr. 03/L-098. Po ashtu, dihet se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është kompetente dhe përgjegjëse për menaxhimin dhe ndarjen e mjeteve të tilla, prandaj nuk mendoj se duhet t'i lejohet që një menaxhim i tillë të bëhet nga institucionet e tjera, qoftë nga kabineti i ministrit, apo dikush tjetër. Këtu duhet të kemi kujdes dhe mendoj se kjo duhet të analizohet dhe të mos

jetë si masë speciale e përhershme, por duhet të bëhet mbi bazën e një plani afatgjatë brenda ligjeve, të cilat janë të aplikueshme për gjithë vendin. Ajo sa i përket shkarkimit të kryeshefit të agjencisë, të AZHB-së, mendoj se aty ndoshta është dashur të kemi më tepër informacion, të dimë cila ka qenë arsyeja, sepse ne jemi dëshmitarë se në vazhdimësi funksionimi apo ndarja e granteve dhe subvencioneve është përcjellë me defekte dhe me të meta, të cilat kanë pasur pasojë në zhvillimin apo në realizimin e objektivave dhe destinimit për çka janë bërë.

Prandaj, ne nuk mund tani të flasim për arsyen, nuk kemi ndonjë informacion shtesë se cila ka qenë arsyeja e suspendimit të kryeshefit të AZHB-së. Ne mbështesim që të shtohet aktiviteti dhe roli i kryeministrit dhe i Qeverisë në këtë çështje, po ashtu ne po e shohim se nga mosbashkëpunimi ndërinstitucional nuk po mund t'i arrijmë objektivat për të cilat ne po investojmë dhe po ndahen mjete nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe mandej prapë bujqësia, si një sektor i rëndësishëm për zhvillimin e vendit dhe për hapjen e vendeve të reja të punës, prapë po silltet në një gjendje jo të mirë dhe jostabile.

Ne mendojmë, i nderuar kryeministër, që të shtohet aktiviteti i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të parandalohen të gjitha dukuritë, të cilat e kanë përcjellë në vazhdimësi, vit pas viti, gjendjen në sektorin e bujqësisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

**EMILIJÀ REDŽEPI:** Zahvaljujem se potpredsedniče Parlamenta!

Poštovani premijeru,

Ministri,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

S obzirom da nam je na današnjem dnevnom redu interpelacija premijera naše vlade, gospodina Ramuša Haradinaja, a posla čina problematici Ministarstva za poljoprivredo i ruralni razvoj o razrešenju direktora i dodeli sredstva za grantove i subvencije našim poljoprivrednicima i farmerima.

Sa ugla gledišta pripadnika manjinskih zajednica kao i statističkih podataka kojih posedujem od strane ministarstva i agencije, pa i od strane korisnika projekta ruralnog razvoje za zajednice Srba, Bošnjaka, Turaka, Goranaca, Aškalija, Egipćana i Roma je jako zabrinjavajući fenomen. Od 2014 godine, pa sve do 2017 godine te jako malo svota novca, odnosno grantova dodeljena pripadnicima zajednice. Na osnovu statističke tabele, koju ću sada da pročitam i iznesem sve podatke u javnosti, gde se apsolutno sve zajednice diskriminisane, a neke zajednice poput Goranske i Egipćanske nisu ni ubačena tom spisku, kao da ti narodi uopšte ne postoje i ne žive na Kosovu, i nemaju prava na raspodelu državnog novca. Ova tabela koju ja držim u ruci pokazuje spisak svih grantova koji su podeljeni zajednicama od 2014 godine do 2017.

Samo za 2014 godinu Srpska zajednica dobila 3 projekata, a Turska 8, u vrednosti od 318 hiljada evra, drugi narodi ne postoje. Godina 2015 godina, Srbi su dobili 2 projekata, Turci su dobili 4 vrednost 200 hiljada evra, drugi narodi ništa. Godina 2016 Srbi su dobili 1 projekat, Truska zajednica 7, vrednost pola miliona evra, drugi narodi ne postoje. Godina 2017 Srbi su dobili 5, Turci 5, Bošnjaci 2, 373 hiljada evra. Drugi narodi ne postoje.

Milionska suma novca koja se svake godine deli našim poljoprivrednicima od strane Ministarstva za Poljoprivredu i agencije, gospodine premijeru, uopšte ne dotiče poljoprivrednike manjinskih zajednica, zbog čega su oni toliko diskriminisani. Oni nisu građani drugog reda. Molim Vas, premijeru, hitno intervenciju u vezi ovog zabrinjavajućeg problema, gde mi poslanici ispred zajednica u ovom Parlamentu a ima nas 20, moramo biti svi jedinstveni po pitanju i podići svoj glas za ovom govornicom, svako pojedinačno za svoju zajednicu, kako bi se naši poljoprivrednici oslobodili straha rigoroznih kriterijuma Ministarstva Poljoprivrede tokom apliciranja za projekte, kako bi smo i mi svi zajedno u saradnji sa našom vladom obezbedili bolje uslove i funkcionisanje na terenu, a ne da oni i za jednu obični hladnjaču za maline godinama čekaju volju ili želju nekog od ministra da im pomogne, kako im ne bi cela sezona propala a život njihovih porodicama po selima upravo zavisi od toga.

Ovo isto važi, gospodine premijeru, i za Ministarstvo za Ambijent i Prostorno Planiranje, koje zaobilazi ulaganja gde žive manjinske zajednice.

Poštovani premijeru, Bošnjačka zajednica je po broju stanovnika na nivou države Kosovo treća, po statističkim podacima zadnjeg popisa. Te zahtevam da Ministarstvo za Poljoprivredu to poštuje tokom raspodele novce za razvoj, raznih poljoprivrednih grana. Da to ne bude slučaj kao što sam gore iznela. Te od vas premijeru lično zahtevam da naši poljoprivrednici ne budu diskriminisani, te dajem se dodeli veći broj grantova kako bi normalno funkcionisali i radili ravnopravno sa albanskim poljoprivrednicima i farmerima i bili pozitivna primeru regionu po kvalitetu važan faktor proizvodnje, a sve se to reflektuje na ekonomiju naše države i svi smo u obavezi da damo svoj doprinos. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Etem Arifi e ka fjalën.

ETEM ARIFI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar, edhe pse vetëm një ministër,

Të nderuar deputetë,

Mua po më duhet ndoshta ta përsëris fjalimin e koleges time, Emilija, mirëpo realisht u fol këtu shumë, u kritikuan në këtë rast edhe ministri, kryeministri dhe kjo Qeveri. Sipas meje nuk qëndron kjo, nuk po dua ta mbroj, nuk jam këtu për ta mbrojtur as njërin, as tjetrin, nuk jam avokat i kurrkujt, por këta sigurisht kanë për t'u mbrojtur vetë, sepse ato udhëzime

administrative ose favoret që i paskan bërë sigurisht kanë ndonjë arsye, normalisht që do t'i arsyetojnë ato.

Sa i përket kësaj Qeverie, unë realisht e falënderoj në këtë rast edhe publikisht kryeministrin Ramush Haradinajn, sepse për komunitetin, në këtë rast, për komunitetin ashkalinj jeta është pak më ndryshe, janë duke u prekur gjërat nga kjo Qeveri, pikërisht nga kryeministri Haradinaj. Mirëpo, sa i përket Ministrisë së Bujqësisë, unë thashë, po më duhet ndoshta ta përsëris kolegen time, janë bërë disa udhëzime administrative që realisht nuk e di qysh janë bërë dhe nuk i kam parë ato udhëzime administrative. Po ku janë udhëzimet administrative të viteve të kaluara, të qeverive të kaluara që nuk janë mbështetur komunitetet, në këtë rast komuniteti ashkali.

Të gjitha ato grante, subvencione që janë shpërndarë nga viti 2014, si e përmendi edhe kolegia ime, domethënë në vitin 2014 asnjë projekt, asnjë grant i komunitetit ashkali nuk qëndron që ka përfituar më 2014. Kanë vazhduar njëjtë në vitin 2015, njëjtë në vitet 2016, 2017, ku janë ato udhëzime administrative. Kush i ka hartuar ato udhëzime administrative në të kaluarën? Mos të flas për komunitetin egjiptian, që nuk figurojmë fare që ekzistojmë në Kosovë edhe goranë. Në këtë rast unë po kërkoj, apeloj te kryeministri që ta ketë parasysh me ministra, në këtë rast me ministrin e Bujqësisë, sepse unë kam parë disa lëvizje që realisht unë po e potencoj prapë se nuk po dua me e mbrojt kurrkënd, nuk jam avokati kurrkujt. Edhe në Ministrinë e Bujqësisë kanë filluar gjërat me u përmirësuar, po flas për komunitetin ashkali, për komunitete.

Mirëpo, e përmenda edhe një herë, komunitetet nuk janë mbështetur në qeveritë e kaluara asnjëherë. Nuk kanë mundur të arrijnë edhe të informohen për grande ose subvencione, ose për çfarëdo tjetër, nuk kemi mundur ne të ... ne s'kemi mundur të marrim vesh kur janë shpërndarë ato, ne si deputetë në këtë rast po flas, nuk kemi qenë të informuar, e lëre më populli. Në këtë rast unë pres që në vitin 2018, në këtë mandat, që sigurisht dhe po shpresoj shumë që komunitetet kanë me u ndihmua. Sigurisht që kjo Qeveri e kemi parë ne që realisht është duke i bërë sendet ndryshe.

Është e vërtetë që favoret kanë ndodhur, po kush po i favorizon, kush i ka favorizuar këta tërë këto vitet që i lamë pas? Asnjëherë realisht unë i kam parë, po shihen disa favore që janë bërë për komunitetin serb, po komunitetet tjera, tash është ministri serb, më herët kanë qenë të gjithë shqiptarë, po komunitetet tjera nuk janë përkrahur. Ashkalinjtë nuk janë përkrahur. Asnjë projekt, asnjë grand, asnjë subvencion nuk e kanë marrë nga viti 2014 deri në vitin 2017. E këto kush i ka favorizuar?

Unë kërkoj edhe një herë, apeloj te kryeministri, t'i shikojë gjërat pak më ndryshe, sikurse ka filluar dhe realisht të merren parasysh edhe komunitetet tjera, në këtë rast komuniteti ashkali dhe egjiptian, se nuk janë paraparë, sikur të mos ekzistonin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Spektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural edhe pa këso lloj problemesh, siç është rasti i ministrit tuaj Rikalo, ka mjaft probleme. Edhe pse është dikaster i rëndësishëm së veçantë për Kosovën, ju që në start pra me marrjen e mandatit tuaj qeverisës e keni neglizhuar këtë fushë kryesore për Kosovën, duke emëruar një person tejet të dëmshëm në krye të kësaj ministrie, siç është zoti Rikalo.

Zoti kryeministër,

Ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në fillim të mandatit tuaj patëm thirrur një interpelancë, me ç'rast kemi kërkuar nga ju shkarkimin e ministrit Rikalo me kërkesën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët dëshmonin se ministri yt Rikalo ka keqtrajtuar shqiptarët gjatë luftës në Kosovë. Por, ju në atë kohë dolët këtu para nesh dhe e mbrojtët ministrin Rikalo, si dhe kolegët deputetë nga mazhoranca nuk e votuan mocionin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për shkarkim të ministrit në fjalë.

Tani jemi në një situatë të absurdit të llojit të vet, ku Lista Serbe e ka bërë të qartë se nuk është pjesë e Qeverisë, deputetët e Listës Serbe kanë kaluar në taborin e opozitës, ndërsa ministri Rikalo vazhdon të marrë vendime krejtësisht në baza të interesit të tij personal dhe urdhrave të Serbisë e assesi në dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe minoritetin serb që jeton në Kosovë, siç e kemi rastin konkret, për të cilin ne kemi marrë shkas për ta thirrur këtë interpelancë. Pra, më datë 8 maj 2018 ishte raportuar se ministri Rikalo kishte ndarë 2 milionë euro për Mitrovicën e veriut nga buxheti i ministrisë në kundërshtim me planin kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural.

Gjithashtu, po të njëjtën ditë ministri kishte pezulluar nga puna zotin Elhami Hajdarin, udhëheqës i Agjencisë për Zhvillim të Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural. Sipas informatave, ky vendim për shkarkim përbën shkelje ligjore, sepse lidhet me ndarjen e mjeteve për Mitrovicën e Veriut.

Zoti kryeministër,

Pse e toleroni një absurd të llojit të vet, që Rikalo të jetë ministër, ndërsa ai nuk vjen asnjëherë që të përgjigjet këtu para Kuvendit, as para Komisionit Parlamentar dhe ai, siç po shihet, s'ju jep llogari as juve personalisht?

Për këtë fushë mund të flasim shumë, por unë nuk dua t'i përsëris ato që para meje i tha kolegu im, zoti Lutfi Zharku. Por, me këtë rast unë mendoj se ju keni obligim t'u përgjigjeni qytetarëve



të Republikës së Kosovës për gjendjen e krijuar në këtë fushë. Sot para se ne të votojmë, që shpresoj shumë se ne do t'i votojmë këto pika apo këtë rezolutë, të cilën e ka parashtruar Lidhja Demokratike e Kosovës, unë konsideroj se kjo është pak më urgjente sepse në pikat e kësaj rezolute ne kemi afat dy javë që Qeveria të sjellë në Kuvend një raport detaj. Por, zoti kryeministër, unë po ju drejtohem juve sot këtu dhe po kërkoj që para këtyre afateve të raportimeve ju duhet të keni guxim ta shkarkoni ministrin Rikalo menjëherë.

Në të kundërtën, nëse nuk e shkarkoni duhet të jepni dorëheqje ju dhe kjo Qeveri duhet të shkojë, sepse mjaft, tashmë është bërë e tepërt. Më shumë kemi skandale se sa veprime normale të kësaj Qeverie. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Se në çfarë gjendje është sektori i bujqësisë nuk është e rastësishme të konstatohet, meqë edhe qasja që po i jepet sot dhe ajo që i është dhënë në vazhdimësi edhe nga periudha të ndryshme, tregon se është lënë anash dhe kjo çfarë po ndodh sot është vetëm një mjegullnajë në të cilën po duhet të humbet ajo vëmendje që duhet t'i kushtohet sektorit të bujqësisë.

Kjo xhurulldi e krijuar nga ministri Rikalo nuk është asgjë e re dhe as e papritur. Aty ku ka para dihet se emërohen, ose zgjidhen zyrtarë nga të fuqishmit e vendit që të kontrollojnë dhe të kanalizojnë ku e te kush duhet të shkojnë ato para. Edhe ky rast është pasojë e konfrontimit të interesave të të fuqishmëve, që janë në piramidën e shtetit tonë të kapur. Kjo interpelancë edhe nëse nuk sjell asnjë të mirë tjetër, është një rast i mirë që ne sot këtu si përfaqësues të qytetarëve të rikujtojmë vet dhe t'ua rikujtojmë opinionit gjendjen e bujqësisë në Kosovë, që ka degraduar deri në atë shkallë sa këtë degradim të na e bënte dikush e jo ne vet, duhet ta shpallnim armikun më të madh të këtij vendi.

Të rikthehem pak pas në histori. Ultranasionalistët serbë duke filluar nga Garashanini, klubi kulturor serb, konventa famëkeqe për shpërnguljen e vitit 1938, me mbarimin e luftës së dytë botërore vazhduan përpjekjet për realizimin e planeve, si për shembull te ato të elaboratit të ri të Vasa Çubriloviqit, i titulluar "Problemi i pakicave në Jugosllavi" dhe ai pushtetin e ri e mësonte se përveç spastrimit nga ana e ushtrisë gjatë operacioneve duhet zbatuar edhe metoda të tjera, në mënyrë që pakicat kombëtare të detyrohen të shpërngulen, të krijohen për ta kampe përqendrimi, ndërsa pasuria e tyre të konfiskohet. Kurse, në një letër dërguar Titos, e këshillonte që të nxirrte

një ligj e t'ua merrte dhinë shqiptarëve, pasi që me këtë arrinte dy qëllime: shkatërrimin e ekonomisë dhe të shëndetit të shqiptarëve. Dhe, kjo këshillë dihet se ishte zbatuar.

Bazuar në shënime statistikore qeveria serbe arriti që në Kosovë në periudhat midis dy luftërave, siç thuhej, për nevojat e reformës agrare, t'i kufizojë rreth 129 219 hektarë tokë, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë vendosur 13 482 familje me rreth 67 410 anëtarë në 594 vendbanime. Sipas një burimi në 14 rrethe të Kosovës 21 876 familjeve u është dhënë 81 134 hektarë tokë. Tokë në masë të konsideruar u është dhënë kishave dhe manastireve, stacioneve të xhandarmërisë, e tjera.

Sipas një raporti të drejtoratit të reformave agrare në Shkup me numër 344 datë 12. 11. 1940 në territorin e këtij drejtorati kishave dhe manastireve u janë dhënë 569 hektarë tokë, ushtrisë 1342 hektarë, xhandarmërisë 250 hektarë dhe të tjerëve. Duke përmendur se pushteti agrar në vitin 1927 Manastirit të Deçanit i ka dhënë prona 50 familjeve shqiptare të fshatit Isniq, ndërsa Manastirit të Deviçit i dhanë pronat 20 familjeve shqiptare të fshatit Llaushë të komunës së Skenderajt.

Sipas të dhënave statistikore Kosova deri në fund të luftës 1999 kishte rreth 550 000 hektarë tokë pune, mbi 200 000 hektarë pronë shoqërore apo të kooperativave. Cila është gjendja e bujqësisë sot dhe si është fshati ynë sot?

Përgjigja më e shkurtër është, se atë që nuk arriti ta bënte Serbia dhe Jugosllavia okupatore për 90 vjet e bëmë ne vetë për pak vjet. Në radhë të parë, Serbia, siç e theksuam më sipër, jo rastësisht dogji e shkatërroi fshatrat shqiptare, bagëtinë, mekanizmin bujqësor, e të tjera. Si rezultat i kësaj pas lufte pati një koncentrim të madh të popullatës rurale në qytete, duke ndryshuar strukturën demografike dhe duke krijuar probleme të rënda sociale. Sot si rezultat të kësaj kemi rajoni të tëra të boshatisura, kryesisht vise kodrinore malore, siç është braktisja e Gollakut, Rugovës, Karadakut, Shalës së Bajgorës, po edhe të fshatrave në rajonet tjera të Kosovës qendrore si Drenicë, Llapushë e vende tjera.

Toka bujqësore në Kosovë që nga paslufta është shkatërruar në masë të madhe. Këto toka janë shndërruar në zona industriale, në banesa kolektive, objekte afariste komerciale, ndërsa që parandalimi për shkatërrimin e tyre ka munguar përgjatë viteve e që sipas disa shifrave të Ministrisë së Bujqësisë mbi 500 hektarë shkatërrohen brenda një viti.

Problem mjaft i madh që i shkaktoi bujqësisë dihet se ishte privatizimi. Pa u respektuar asnjë kriter dhe toka bujqësore të sektorit shoqëror u bënë prona të agallarëve të rinj shqiptarë, që thuhet se një ari tokë e blenë për një euro dhe e keqja nuk është këtu, por atyre tokave, ose u ndryshua destinacioni, siç u tha më sipër, ose ngelën djerrina sot e kësaj dite. Ato mund të shihen kudo në Kosovë e që sot janë shndërruar në shkurre e barishta.

Toka punohet fare pak edhe nga bujqit tradicionalë e sidomos kultivohen fare pak drithërat, kryesisht gruri dhe misri, që në të gjitha shtetet e botës konsiderohen prodhime strategjike. Kjo ndodh për shkak se bujqit, ose bujku, çfarëdo që kultivon ai prodhon humbje, për shkak të tregut liberal, mos mbrojtjes së prodhimeve vendore nga shteti, pastaj mos subvencionimit adekuat e tjera.

Kosova që nga viti 2005 ka në fuqi Ligjin për tokën bujqësore, i cili ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për shfrytëzimin, mbrojtjen dhe rregullimin e tokës bujqësore. Por, ky ligj nuk u zbatua. Nga degradimi i tokës bujqësore ekspertë të bujqësisë kishin konstatuar, se Kosova deri në fund të dekadës së parë të këtij shekulli do të ketë krizë në sigurimin e ushqimit. Sipas tyre sipërfaqja e tokës së punuar në Kosovë është mjaft e ulët, që llogaritet të jetë 0,15 hektarë për kokë banori. Ndërkaq, sipas standardeve ndërkombëtare minimumi ekzistencial për prodhimin e ushqimit të mjaftueshëm është 0,17 hektarë për kokë banori. Fatkeqësisht, ky parashikim i ekspertëve doli i saktë. Sot Kosova eksporton qindra miliona euro për ushqim të degraduar, kryesisht në Serbi.

Është thënë edhe në këtë Parlament, edhe në medie, edhe më herët, se gruri dhe mielli që eksportohet nga Serbia është i cilësisë së dobët, madje vjen nga rezervat shtetërore të Serbisë dhe këtu shitet pasi veterinarët e Serbisë e ndalojnë atë grurë që të bëhet ushqim për kafshë. Ata që kalojnë nëpër Serbi tregojnë se në pjesën jugore të këtij vendi nga Nishi e Krushevcit, e vetmja prodhimtari aktive që shihet janë fabrikat e vogla të ushqimit të kafshëve, të cilin ushqim mund ta shesin vetëm në Kosovë.

Po kaq keq është edhe blegtoria. Fondi i bagëtisë së imtë, veçmas i deleve dhe dhive, dhe dihet se ka pësuar degradim dhe zvogëlim drastik. Për shembull, nga një statistikë e zyrave të vendit të rajonit të Gollakut, nga viti 1970-1982 brenda vitit janë eksportuar në Greqi rreth 70 000 qengja, që përkthyer në para me çmime të sotme bie gati 10 milionë euro. Sot në gjithë këtë regjion nuk mund të gjenden mbase as 100 krerë dele.

Diçka më e mirë është gjendja me kultivimin e lopës. Mirëpo, sado që kishte plot raste serioze të fermave të vendit, por edhe të njerëzve të ardhur nga diaspora që të ngrenë ferma të lopëve, qumështore apo për majmëri, as kjo nuk pati sukses për shkak të çmimeve.

Pra, në emër të liberalizimit të tregut shteti u ka dhënë monopol të plotë tregtarëve në dëm të prodhuesve vendor dhe si rezultat i kësaj, sot në sofrat tona në vend se të ushqehemi me drithëra, mish, prodhime qumështore, pemë e perime cilësore të vendit tonë dhe paraja të qarkullonte brenda vendit dhe t'u ndahej njerëzve tanë dhe kështu të ulej edhe shkalla e papunësisë dhe emigracionit të paligjshëm, ne sot ushqehemi me ushqime me prejardhje të dyshimta, jo rrallë edhe të kontaminuara dhe me 1 miliard euro eksport për ushqim jashtë vendit, diku gjysmë miliard në Serbi.

Një problem që ka ndikuar në shkatërrimin e bujqësisë dhe degëve të saj janë edhe kreditë bankare, të cilat në fakt janë fajde dhe kamata është aq e madhe për bujqësi që synohet me shkallën e lartë të rrezikshmërisë.

Të nderuar deputetë,

Po shkaktari kryesor i sjelljes së bujqësisë kosovare në këtë gjendje është vet koncepti shtetëror për bujqësinë, sepse dihet se që nga themelimi i institucioneve qeveritare në vend bujqësia u trajtua si segment i dorës së dytë, në mos i së tretës, dhe përderisa nuk janë rritur fondet e grandeve kjo ministri është lënë ta udhëheqin partitë minoritare. Subvencionet janë të vogla dhe nuk kanë ndonjë peshë, kurse është fshehur, ose është fshehtësi publike, se cili përfitues i një grandit apo subvencionit më të madh duhet t'i japë ryshfet diku rreth 30% të shumës së grandit, plus 18% të TVSH-së. Krahas kësaj, projekti që miratohet ai paraprakisht duhet të jetë hartuar dhe më pas të realizohet në të gjitha fazat në zyrtarë e ekspertë të caktuar, qofshin të institucioneve qeveritare apo edhe të agjencive të ndryshme.

Pra, mjetet e grandeve dhe subvencioneve, që quhen “për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit” kanë shkuar gjithmonë në xhepat e tregtarëve, klientelës së pushtetit dhe ajka në xhepin e pushtetarëve.

Prandaj, të nderuar deputetë, edhe rasti i interpelancës së sotme nuk del jashtë këtyre konturave. Pra, është luftë e njerëzve të kupolës së shtetit për përfitime dhe klientelë. I vetmi rast pozitiv për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë sot është trekëndëshi Rahovec - Xërxë - Krushë e Vogël - Mamushë. Prodhimet cilësore të specave dhe domateve të këtij vendi shiten pa asnjë pengesë në tregun e Bashkësisë Evropiane, aq sa ato mund të prodhojnë.

Dhe krejt në fund, të nderuar deputetë, e keqja më e madhe e shkatërrimit të bujqësisë dhe të mjedisit rural është humbja e shprehisë së punës së njerëzve të këtij nënqielli. Dihet shumë raste në histori, që pushtuesi u ka dhënë ndihma falas banorëve të një vendi të pushtuar, natyrisht se jo nga dashuria për ta, por dihet se humbja e shprehisë së punës dhe dembellëku shënojnë fazën e fundit të shkatërrimit të një shoqërie dhe të një kombi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Fatoni. S'është këtu, a? Zoti Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të pranishëm,

Mua më duket shumë prej jush për shumë fermerë dhe qytetarë që nuk merren me këtë veprimtari, por edhe për deputetët, disa i dëgjova si absurd fakti që në këtë interpelancë të vijë kryeministri, e jo ministri i Bujqësisë.

Megjithatë, unë mendoj që kjo e tregon më së miri një nga anomalitë e kësaj qeverie.

Pra, faktin se e kemi një ministër i cili formalisht është i dorëhequr, mirëpo ai e vazhdon punën e tij, bile-bile merr edhe vendime kaq të rëndësishme, siç është edhe shkarkimi i zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Bujqësisë, por nuk vjen në Kuvendin e Kosovës për të debatuar për atë që thirret.

Unë besoj që po të ishte thirrur kjo interpelancë, me shumë gjasë ky ministër nuk do të ishte sot për t'u përgjigjur.

Mirëpo, këtu ekziston edhe një rrezik më i madh, të cilin nuk po e trajtojmë mjaftueshëm.

Pra, fakti që është shkarkuar drejtori i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë ka sjellë si pasojë një padi nga ky për ministrin Rikalo, mirëpo edhe nga një bojkot i punës nga punëtorët e kësaj agjencie.

Kjo gjendje është duke vazhduar dhe më e keqja e kësaj pune është nëse ky bojkot i punës vazhdon, ne jemi duke rrezikuar, se qytetarët janë duke rrezikuar një vlerë prej 21 milionë euro grante për vitin aktual.

Pra, unë mendoj që zoti kryeministër duhet ta trajtojë më seriozisht këtë çështje për shkak se nuk dëgjova diçka se çka do të ndodhë më tutje, çka nëse ky bojkot i punës vazhdon edhe për një kohë.

Në anën tjetër, u përmendën nga shumë të tjerë dëmet ose parregullsitë nga veprimtaria e deritanishme e ministrit Rikalo, pra po bëjmë fjalë për një diskriminim të ri pozitiv të një komuniteti tashmë të diskriminuar pozitivisht, pra për një program të veçantë për grante për veriun e Kosovës, i cili është në kundërshtim me legjislacionin, me të gjitha rregulloret, për ndarjen e këtyre granteve.

Përveç kësaj, çështja e efektshmërisë të granteve mendoj që nuk duhet trajtuar vetëm në aktualitet. Mendoj që pajtohemi të gjithë, e më së miri fermerët, që ky program ka dështuar në misionin e tij, jo vetëm në këtë Qeveri, por në të gjitha qeveritë prej kur aplikohet.

Ka shumë probleme që e bëjnë joefikas këtë program të granteve dhe mbi të gjitha është vonesa me të cilën ky shpërndahe, por përveç kësaj edhe efekti që ka arritur në rritjen e prodhimtarisë.

Unë e dëgjova zotin Reçica që tha se janë arritur rezultate, po e citoj “të jashtëzakonshme në rritjen e prodhimtarisë”. Unë nuk besoj që ka fermerë që beson në këtë, mirëpo nëse përkundër të gjithave që e dimë deri më tani, zoti Reçica e ka një hulumtim ose një studim që diku në një komunë ka një rritje të matshme, të jashtëzakonshme ose çfarëdo të prodhimtarisë, do të ishte

mirë që të na e japë këtë lajm të mirë dhe të na prezantojë edhe neve, edhe atyre që po na shikojnë.

Ka pasur edhe hulumtime nga shoqëria civile për mënyrën se si janë ndarë këto grante, e nuk kam shpresë se kjo prirje për të politizuar ose për të partizuar dhe për të ndikuar edhe në grante dhe subvencione do të vazhdojë edhe më tutje.

Ka qenë një hulumtim i Organizatës Çohu, besoj që keni pasur mundësi ta shihni sesi ka komuna të caktuara të cilat për shkak të lidhjeve partiake ose me pushtetin kanë marrë subvencione në disproporcion me numrin e banorëve dhe numrin e fermerëve.

Pra, komuna të vogla të cilat për nga vlera e subvencioneve tejkalojnë komuna tjera të njohura për bujqësi, e të cilat te ejkalojnë ndoshta e dyfishin e popullsisë, por edhe të veprimtarisë në bujqësi.

Mendoj që rekomandimet që u lexuan nga përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës janë të drejta. Nuk mund ta rrezikojmë pra fatin e gjithë atyre aplikuesve për grante, po e përsëris është fjala për 21 milionë euro vlerë në ndihmë për fermerët dhe kryeministri përderisa gjendet para kësaj anomalie duhet ta marrë përsipër barrën e përgjegjesisë dhe të na japë pak më shumë sqarime.

Nuk e thatë zoti kryeministër, cila është baza me të cilën po ndahen këto grante në mënyrë selektive për komunat veriore, përderisa ministri nuk vjen këtu, ju takon juve, tani të na sqaroni çka do të ndodhë me grantet për shkak se po e përsëris është një rrezik i madh për gjithë veprimtarinë bujqësore.

Pra, ne do t'i përkrahim këto rekomandime dhe shpresoj që e njëjta vlen edhe për grupet tjera parlamentare. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Avdullah Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Bujqësia karakterizohet me ferma të vogla dhe kontribuon pak në bruo-prodhimin kombëtar të Kosovës, por ajo punëson një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore në Kosovë. Gjysma e popullsisë jeton në zona rurale dhe sipas statistikave gati 2/3 e këtyre personave këtyre familjeve merren me bujqësi dhe sigurojnë të ardhura për familjet e tyre.

Bujqësia në fakt siguron që plot familje, mijëra familje në zonat rurale, në veçanti nuk janë të varur nga asistenca sociale e shtetit.

Sigurisht se në këtë sektor Kosova nuk mund të jetë konkurrenente në tregjet ndërkombëtare, por ka plot produkte ku kemi përparësi krahasuese dhe në disa prej këtyre produkteve që janë bërë hapa shumë të mirë.

Ajo që dua të theksoj është se i gjithë ky sektor i rëndësishëm për punësim dhe të ardhura ka mbetur pa përkujdesje të nevojshme shtetërore gjatë këtij mandati.

Rreth 50 milionë euro grante subvencione u janë lënë dorë personave të papërgjegjshëm që nuk e kanë idenë apo rëndësinë strategjike të mbështetjes për bujqit tanë.

Potenciali i madh i Qeverisë për mbështetje të bujqësisë sot është subjekt i pazareve politike.

Kjo nënkupton se kjo Qeveri s'e ka fare brengë bujkun, e as fermerin.

Ndryshe nuk ka mundësi që të kuptohet një qasje e tillë që ministri i Bujqësisë nuk shkon fare në Qeveri, nuk merr pjesë në mbledhjet e Qeverisë, nuk paraqitet në Kuvend, por buxhetin për grante dhe subvencione e ndan për interesa të ngushta politike të tij dhe të partisë së tij.

Mua më vjen keq ta përsëris prapë, por zoti Haradinaj është më së paku kryeministër. Atë nuk e pyet më askush brenda Qeverisë.

Ai është në krye të Qeverisë ku secili anëtar punon për hesap të vetin apo të partisë së vet, duke e kthyer krejt pasurinë shtetërore në plaçkë dhe kjo është më se e evidente.

Buxheti po keqpërdoret në të gjitha drejtimet, e vendimet e Qeverisë për ndarje të buxhetit janë skandaloze.

Ta kenë të qartë të gjithë anëtarët e Qeverisë, sepse nuk mund të fshihen prapa vendimeve kolektive për ndarje të taksave të qytetarëve pa asnjë kriter.

Të kthehem te tema e interpelancës së sotme.

Unë kam pyetje për kryeministrin: Si e pranoni ju faktin se anëtarët e Kabinetit tuaj nuk ju raportojnë juve dhe nuk vijnë në mbledhjet e Qeverisë, ndërkohë që ndajnë miliona buxhetit për interesa të tyre?

Ju jeni të pafuqishëm e të përçarë, në fakt jeni shumë i fuqishëm për të sharë e për të fyer kurdo që të ju jepet mundësia, apo për të larguar me dhunë gratë nga foltorja, por tek rasti që jemi duke diskutuar ju e pranoni që jeni plotësisht i pafuqishëm.

Ju kryeministër i keni duart e lidhura për të vepruar për shkak të pazarit të turpshëm për krijimin e Qeverisë.

Ju jeni fuqishëm për të vlerësuar e për t'i çmuar rivalët tuaj politikë shqiptarë.

Ai që ju dikur e quanit të ngratë, me të cilin ju nuk mund të konkurroni, e kishte shkarkuar një ministër të komunitetit serb, e tash po del që në fakt ju jeni të ngratë.

Kryeministër, ju i keni turpëruar qytetarët e Kosovës dhe miqtë tanë ndërkombëtarë me këto sjellje. Fundi juaj në politikë nuk do të jetë i lavdishëm. Gjatë këtij mandati, ju vetë, pa ju shtyrë askush, e keni shpërfaqur veten dhe ambiciet tuaja jo të pastra për të qeverisur me Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Duket që ky kolegu im Avdullah Hoti akoma nuk e ka kaluar atë pengun e përmbysjes së Qeverisë së tij dhe nuk ka seancë që nuk merret me kryeministrin dhe me vlerësimet e kësaj natyre që po më duket që tashmë u ka dalë boja. Ka pasur shumë informata se Beogradi ka ditur të shpenzojë qindra milionë euro në Veri, ndërkohë që Kosova asnjëherë nuk e ka pasur një ofertë për këtë pjesë të atdheut, në këtë kuadër as ish-ministri Hoti. Unë besoj që ne duhet ta kuptojmë një herë e mirë se duhet ta kemi një ofertë ekonomike për Veriun e Kosovës, sepse kurrë nuk e kemi pasur një ofertë të tillë.

Zoti kryeministër,

Ju inkurajoj fuqishëm që të keni ofertë zhvillimore ekonomike për këtë pjesë, sepse na mbyti patriotizmi dhe ne duhet më në fund të bëjmë diçka tepër serioze në mënyrë që atdheu, në mënyrë që Kosova të jetë e plotë. Ndoshta sot më së miri është të thuhet “Poshtë Serbia dhe rrënoftë Shqipëria!” dhe gjithçka e kemi përfunduar me kaq, por unë kuptoj dhe unë besoj që çështja është shumë më e komplikuar se kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Hajdar Beqa. Regjia, mikrofonin!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

I nderuar kryeministër Haradinaj,



Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne realisht sot diskutuam për një çështje që konsideroj është te pjesa e dytë që e thotë LDK-ja, që në këtë rast e ka ngrehur interpelancën është shumë e rëndësishme, por pjesa e parë besoj që është krejt jashtë kompetencave tona.

Për shembull, lidhja me vendimin e fundit të ministrit Rikalo për shkarkimin e një drejtori. Kjo mendoj që s'ka të bëjë me kompetencat tona, kurse ndarja e mjeteve, granteve dhe subvencioneve, mendoj që është dashur të jetë ministri Rikalo në interpelancë, e jo kryeministri, se ministri pavarësisht çka deklaron Lista serbe çdo ditë del në punë në ministri. Dalin edhe tre ministra, tre zëvendësministra tjerë që janë aty në ministri, por edhe drejtorët tjerë dhe sekretari i përgjithshëm, të cilët i kanë detyrat e ndara dhe mendoj që nuk i lënë punët mangët për t'i kryer. Ndoshta s'është mirë të shqetësohet shumë LDK-ja.

Por, edhe te rekomandimet e LDK-së në fund, që thotë nuk kanë të bëjnë kurrgjë me pjesën e parë, as e para, as e dyta, as e treta, kanë të bëjnë vetëm për këtë pjesën që ka të bëjë me grante, apo që mendoj që janë të mira, do të thotë të tria, por nuk kanë të bëjnë për shkarkimin e drejtorit, ndoshta është dashur, pasi keni kërkuar ta kemi këtu edhe një pikë te këto të tria, edhe për shkarkimin e drejtorit.

S'po jua lexoj për të ju ngarkuar, se folën të gjithë, folëm edhe histori, folëm edhe gjeografi e bujqësi, por mendoj që bujqësia ka avancuar në nivelin e Republikës së Kosovës nga viti në vit. Këtu u lavdërua realisht edhe opozita, e ne e dimë sa akuzat i ka pasur për bujqësinë, për drejtorët, apo për grantet. Tash thotë po i mbron, po i mbron edhe po më vjen mirë që po i mbron punët që kanë ndodhur edhe në qeveritë e kaluara, meqë mendoj që janë bërë punë shumë të mira. Pavarësisht kush është ministër i cilëso parti, i shumicës a i pakicës, që është në Qeverinë e Republikës së Kosovës, e ka një program që ka për ta zbatuar, e atë program e ka kaluar edhe në Qeveri, edhe në Parlament.

Mendoj që Parlamenti duhet të diskutojë për programin dhe strategjinë e bujqësisë që është me interes shumë vital për vendin, a po zbatohet a jo, ku ka ngecur kjo, të diskutojë edhe për grantet se sa po ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë, por jo të interferojë në suspendime që kanë ndodhur apo po ndodhin. Janë institucionet në këtë vend që e rregullojnë shërbimin civil, e s'bëjnë zgjedhje, bëjnë avancimin apo suspendimin.

E kemi edhe Këshillin për Mbikëqyrje të Shërbyesve Civilë, të cilin e zgjedhim në Parlament, janë kategori kushtetuese dhe të gjithë ata zyrtarë, të cilët konsiderojnë që u është bërë e padrejtë nga eprorët, ministrat apo sekretarët permanentë, apo kryeministri, duhet t'i drejtohen Këshillit. Nëse në Këshill nuk mendojnë se e kanë marrë vendimin e merituar janë organet tjera, janë

gjykatat dhe mendoj që jemi duke interferuar në emër të depolitizimit të shërbimeve civile në këtë rast, por konsideroj që jemi duke ndikuar që ta politizojmë këtë shërbim.

Unë mendoj që në bazë të informatave që kam edhe nga zëvendësministri, zoti Krasniqi, që është nga radhët e Partisë Demokratike, më ka interesuar kur e kam parë këtë interpelancë dhe kam pyetur a po ecën procesi sipas agjendës së Qeverisë, sipas planit, se në bazë të informatave që i kemi nga ministria dhe nga zyrtarët përgjegjës, të gjitha punët po kryhen sipas planit dhe ligjit dhe punët dhe të gjitha aplikacionet për grante kanë filluar të shqyrtohen sipas ligjit në fuqi dhe sipas rregulloreve dhe atyre që i ka ministria. Unë edhe një herë ju falënderoj për fjalën dhe ju përshëndes zoti kryeministër, por mendoj që është dashur të jetë ministri lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjala është e kryeministrit, zotit Ramush Haradinaj!

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** I nderuar kryesues!

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I dëgjova diskutimet, shumica e tyre e kanë fokusimin te gjendja në bujqësi, mendoj që e meriton respektin një temë kaq me peshë, bujqësia. E vërtetë është ajo që u tha se jemi vend rural, se shumë prej nesh jetojmë në këto vendbanime, se jeta jonë bazohet nga bujqësia dhe po e filloj me urimin për nesër, për Bajram, festoni me prodhime vendore, se besoj që është mirë të festohet me prodhime vendore, kush mbërrin.

Unë dëgjova shumë diskutime, mendoj që diskutimet, pos shqetësimit që e kanë për gjendjen në bujqësi, pastaj e kanë qeverisjen, mënyrën e marrjes së vendimeve në ministri, tani me mospraninë e ministrit Rikallo dhe plot aspekte tjera. Unë që në fillim ju thashë, po marrëdhëniet me Listën serbe janë më të vështirësuar, janë më të ndërlikuara në këtë kohë, si rezultat i një incidenti që ka ndodhur. Në këtë incident, të ju them të drejtën, me sa mendohet, ka qenë objekt i trajtimit edhe vetë ministri në fjalë nga Policia e Kosovës. Nuk e dimë ende fort mirë në detaje si ka ndodhur ngjarja, por i kemi parë ato skena.

Dua të ju them kështu sinqerisht, nuk e di ende unë kush është kush, se kur ta dimë të vërtetën për çdokënd dhe për çdo aspekt të tij për nga marrëdhënia e punës që kam si kryetar qeverie dhe ministri Rikallo ka treguar respekt, është i përgjegjshëm dhe ka qenë i interesuar për punë, dhe është i interesuar për punë nga përvoja ime personale me të.

Mendoj se kjo qasje e përgjegjshme e tij është hetuar prej plot njerëzve që janë në ministri sot, shqiptarë që vijnë prej Drenicës, Dukagjinit, Llapit, prej Gollakut, prej ngado që janë. Edhe që nuk janë të Aleancës, por që janë të të gjithëve, që janë të punësuar nëpër vite, nëpër etapa. Te këto aspektet tjera, nëse ju nxirrni një vendim ose një konkluzion, ose një rezolutë si e quani, edhe aty kërkoni raport të detajuar për punën në këtë ministri, për krejt veprimet qeverisëse që

lidhen, unë jam i gatshëm të jua ofroj. Disa mendime tjera që i dëgjova shihet që kanë qëllim tjetër, pra edhe politik. Unë sa herë që vij në këtë foltore, personalizohet me mua dhe pse jo s'ka dert, unë atë jam i kënaqur, domethënë e mirëpres nuk i ik kurrë, por personi im është person interesant për ata që duan ta dinë. E kam një rrugë jetësore bukur të lavdishme dhe i qëndroj asaj kush jam, e kam mbrojtur të drejtën kur i ka rënë mirë njërit ose tjetrit krah, s'kam lejuar aty ku kam qenë unë të shkelet e drejta e askujt. Në këtë rast, nuk lejoj që as e drejta e komuniteteve të shkelet nëse unë jam aty.

Pra, nuk është qëllimi im as nuk ka qenë ndonjëherë t'ia shkel dikujt të drejtën. Ka edhe diçka për ata që po i krahasojnë Zotin me qyqanin, ky qyqani që është para jush po ju vjen në interpelanca sa herë po e thirrni. Mendoj që jam kryeministri i vetëm prej që ekziston ky Parlament që në kaq kohë u ka ardhur në kaq shumë interpelanca, nëse kjo do të thotë diçka - është shprehje e respektit për ju, nuk është injorancë, as indiferencë ndaj juve. Shprehi respekt çdoherë për ata që e meritojnë, por di të jem edhe ndryshe kur të krijohen rrethanat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Fjala është e propozuesit, zoti Hoti, apo cili dëshironi të flisni? Zoti Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Nënkryetar, faleminderit!

Kryeministër,

Ministra të nderuar,

Po i lexoj edhe një herë, ato që i patëm në fillim:

## REKOMANDIME

1. Në afat prej 7 ditësh kalendarike, Qeveria ta anulojë Udhëzimin Administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë "Zonat rurale më pak të zhvilluara, ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe përfshirja e komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës veriore dhe masës për investimet në infrastrukturë rurale", si dhe të ndryshojë dhe plotësojë Udhëzimin Administrativ 03/2018 për pagesat direkte në bujqësi për vitin 2018 dhe 05/2018 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2018, duke i anuluar të gjitha dispozitat të cilat janë diskriminuese dhe shkelin barabarësinë e aplikuesve.

2. Në afat prej 2 javësh Qeveria të sjellë në Kuvend një raport detaj për ndarjen e mjeteve për grande dhe subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë këtij mandati, ku përfshihen projektet, për të cilat janë ndarë mjetet për fituesit dhe procedurat që janë ndjekur për ndarjen e këtyre mjeteve.

3. Zyra Kombëtare e Auditimit të ndërmarrë një auditim të rregullsisë së ndarjes së mjeteve për grande dhe subvencione dhe t'i paraqesë Kuvendit raportin në afat prej tre muajsh.

4. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ta shqyrtojë në afat prej 2 javësh programin për bujqësi dhe zhvillim rural me zyrtarë përkatës së Ministrisë së Bujqësisë dhe t'i paraqesë Kuvendit raport me shkrim për rregullsinë e zbatimit të këtij programi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka të tjerë diskutues, siç po më duket se nuk ka as kuorum për t'u votuar si çështje, propozime të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

\* \* \*

*E enjte, 28 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me procedimin e pikave të papërfunduara nga seanca plenare mbajtur më 6, 8, 14 dhe 19 qershor 2018, si në vijim:

***- Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës***

Votojmë Propozim-rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjes dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, e cila u është shpërndarë deputetëve më 14 qershor 2018.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Unë ju kisha lutur më shumë për shkak të opinionit, e dini, edhe mediat po na kritikojnë që s'po i votojmë këto, prapë po ju lus, votoni për, kundër ose abstenoni, jo kështu.

E përsëris edhe një herë votimin, në sallë jemi 68 deputetë. Votojmë tani!

Nuk ka votim të duhur, e lëmë për seancën tjetër të radhës.

***5. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotit Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencioneve***

Votojmë Propozim-rezolutën e Grupit Parlamentar të LDK-së, e cila u është shpërndarë deputetëve më 18 qershor.

Lus regjinë dhe juve, të nderuar deputetë, të përgatiteni për votim. Votojmë tani!

Edhe këtë e shtyjmë për seancën e ardhshme, nuk dëshirojnë deputetët të votojnë.

\* \* \*

*E enjte, 12 korrik 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

***4. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës***

Votojmë Propozim-rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, e cila u është shpërndarë deputetëve më 14 qershor 2018.

80 deputetë janë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 73 deputetë. Për janë 40 deputetë, kundër 29, 4 kanë abstenuar. Konstatohet që Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-së.

***5. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione***

Votojmë propozim-rezolutën, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 56 deputetë. Në seancat e radhës shohim e bëjmë.

\* \* \*

*E hënë, 23 korrik 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

***4. Votim i rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, zotit Nenad Rikalo, dhe për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grande dhe subvencione***

Propozim-rezoluta u është shpërndarë deputetëve nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike më 18 qershor 2018. Votojmë tash!

94 deputetë kanë votuar. 38 për, 52 kundër, 4... , ka shkrirje globale.

\* \* \*

***5. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Unionit Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme COSME, 2014/2020***

Amendamenti i propozuar në këtë projektligj është i vetmi që ka qenë, është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 19 korrik 2018.

Votojmë! Kush është për, me dorë! Regjia, ju lutem, mbani dorën ngritur derisa të... për arsye se me elektronikë kemi vështirësi. Kush është për? A shkojmë kush është kundër, se po e shoh, shumica...

Kush është kundër nga 93 deputetët? A ka abstenim? Abstenime kemi, të lutem. Ju e konstatoji, jo unë.

85 për, 7 kundër. 93 deputetë jemi, do të thotë 1 s'e ka deklaruar votën. Por, sido që të jetë, abstenim merret ajo.

Kuvendi, ta konstatoj, e miratoi Ligjin nr. 06/L-080 me 85 vota. Do të thotë, e ka kaluar 2/3-ën, ligji nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSSME 2014/2020". Urime!

Faleminderit, Bilall! Urdhëro, Bilall. Prapë Bilalli ka kërkuar, po bën punë apeli i Bilallit.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Unë së pari shfrytëzoj rastin t'i falënderoj shumë kolegët nga Lidhja Demokratike e Kosovës që votuan këtë ligj dhe kërkoj nga ju që të trajtoni me seriozitet këtë çështje, jo të ironizoni, as opozitën, as pozitën, por thjesht të mbani rolin që keni dhe të mos dilni jashtë rolit, si kryetar Kuvendi.

Opozita, në fund të fundit, është në të drejtën e vet, kur të dojë voton, kur të dojë nuk voton. Unë i luta për faktin se është ligj që nuk është vetëm i mazhorancës dhe unë lus edhe do të angazhohem që asnjëherë ky vend të mos mazhorancë me 2/3-at. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ti, Bilall, ke përvojë shumë me ish-kryetarin e Kuvendit. Faleminderit! Po, ta kam përmendur emrin, kundër-replikë menjëherë, për ata ta përmenda, se ke lënë diçka pa e pasuruar, për ata. Urdhëro, Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Kryetar, a dëshiron të ta përsëris në çdo seancë?

Po, prandaj, këtu është problemi yt. Prandaj, kur e merr detyrën e kryetarit të Kuvendit, detyrë të parë, pastaj ke telashe t'i mësosh disa sende, disa rende... S'di a do t'i mësosh ndonjëherë! Faleminderit!

KRYETARI: Jo, s'mund t'i mësoj se 6 a 7-8 libra, si baca Jakup, edhe doktoraturën s'mund ta kryej, e kam lënë prej që kam hyrë kryetar Kuvendi asnjë provim më s'kam mundur ta jap. Faleminderit! Është shaka me Bilallin. E kam pasur kujdestar që 30 vjet, edhe s'më vjen turp.

Bilall, ta përmenda emrin, urdhëro edhe një herë.

BILALL SHERIFI: A ka mundësi polemikat me këdo që i ke, të mos e përfshish personin e tretë. Bacën Jakup s'e ke këtu të të kundërvihet, se ta kishte dhënë hakun.

KRYETARI: E bën në Facebook, hiç mos u mërzit.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*